RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)

"UNIVERSITETI "FAN S.NOLI" KORÇË"

Tiranë, qershor 2018

Nr Përmbatja Faqe

I. HYRJA 3 - 8
a. Objektivat dhe qëllimi. .....
b. Identifikimi i çështjes.....
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....
d. Përgjegjësitë e audituesve.....
e. Kriteret e vlerësimit.....
f. Standardet e auditimit.....

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....8 - 9

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....9 - 204

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....204-206

V. ANEKSE 208-224

I. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit **nr. 202/1**, datë **23.02.2018**, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 26.02.2018 deri në datën 30.04.2018, në subjektin Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, (në vijim UFSNK), për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2017, u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. [redacted], Përgjegjës Grupi
2. [redacted] Kryeauditues,
3. [redacted] Auditues,
4. [redacted].Auditues,
5. [redacted] Auditues.

a) ***Titulli***. Auditim Financiar dhe i përputhshmërisë.
b) ***Marrësi.*** Raporti i drejtohet subjektit të audituar, Universitetit "Fan S.Noli" Korçë.
c) ***Objektivat dhe qëllimi i auditimit:***

Qëllimi i auditimit:
Përcaktimi nëse pasqyrat financiare të subjektit që auditohen janë paraqitur saktë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Objektivat e auditimit synojnë:
Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.
Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:
-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

d) ***Identifikimi i çështjes.***
Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit të universitetit, që buron nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi: mbështetjen e shërbimit arsimor për të gjithë studentët, në

funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimet e këtij sektori, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë publik.

e) ***Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.***

Nëpunësi autorizues, znj[redacted] si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës (Nëpunësi zbatues) znj. [redacted] janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Sipas përcaktimeve të nenit 47, të ligjit organik mbi arsimin e lartë dhe Statutit të Universitetit, Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

f) ***Përgjegjësitë e audituesve.***

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit, Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) nëse janë zbatuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga auditues jashtë KLSH, (Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion, Inspektimi Financiar Publik, etj).

d) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant të entitetit, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për

kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

g) ***Kriteret e vlerësimit***.

Legjislacioni bazë e dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit janë:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr.154/2014 *"Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.
- ✓ ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar
- ✓ ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
- ✓ ligji nr. 147/2015, datë 17.12.2015 "*Për buxhetin e vitit 2016*", ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2017*".
- ✓ ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* i ndryshuar,
- ✓ ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në RSH*", të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014,
- ✓ ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "*Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar,
- ✓ ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, etj.
- ✓ ligji nr.8/2015, datë 22.07.2015, "*Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*";
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 432, datë 28.06.2006 "*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore*";
- ✓ VKM nr. 545, datë 11.08.2011 *"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit",* i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "*Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore",* i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, i ndryshuar,
- ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...",* i ndryshuar.
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "*Për miratimin e manualit të MFK",*
- ✓ Urdhër i MF nr.89, datë 28.12.2015 *"Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njësive Publike"* ,

- ✓ Udhëzim i Ministrit të MASR me nr. 27, date 29.12.2017 *"Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë"*,
- ✓ si edhe udhëzime dhe rregullore të *tjera*, dalë nga Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë në funksion të gjithë çështjeve sa më sipër, etj.

h) ***Standardet e auditimit*** të aplikuara në kryerjen e punës**.**
Standardet e zbatuara nga grupi i angazhimit gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";
- ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
- ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve / IFAC;
- Praktika të mira të fushës, si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Adituesve / ECA ; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI *"Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"*; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Adituesve, etj.

i) Dokumentimi i rezultateve të auditimit:
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, analizës dhe vlerësimit të observacioneve të subjektit u përgatit ky Raport i Auditimit.

<u>Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit</u>
Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke

krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.
Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450,** i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin UFSNK, **niveli i materialitetit për vitin 2016 rezultoi 6,071,428 lekë**[1]**.**
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e **testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.**
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vleresimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon, e konkretisht:

Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5%,** duke shtuar nivelin e procedurave analitike **(ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh. krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik,; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:
1. *Kontrolli aritmetik.*
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të

[1] -Shiko Aneksin 1 në fund të raportit

hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar*.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.
4. Kontrolli i vlerësimit.
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. Konfirmim nga të tretët,
Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*
7. Intervistimi
8. Raporte dhe Informacione
9. Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:
Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Universitetin e Korçës, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara si edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e kreditorëve, e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive).

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

- ✓ Universiteti i Korçës është themeluar me VKM nr. 5, datë 07.01.1992 "Për krijimin e Universitetit të Korçës".

- ✓ Statuti i Universitetit është miratuar nga Senati Akademik me vendimin e datës 09.05.2008.
- ✓ Rregullorja e brendshme e funksionimit të degëve, sektorëve, administratës së UFSNK, është miratuar me Vendimin nr.13 të Senatit Akademik, datë 30.03.2009, ku përcaktohen dhe trajtohen misioni, qëllimi, përbërja e degëve, veprimtaria, kompetencat, organizimi i sektorëve, bibliotekës, dhe kriteret e rregullat e disiplinës së punës, etj.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

a. **Objekti i këtij auditimi** është rregullshmëria financiare dhe përputhshmëria e veprimtarisë dhe e operacioneve të kryera nga ana e subjektit UFSNK përgjatë periudhës **01.01.2016** deri më **31.12.2017.**

b. **Qëllimi i auditimit**: është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale **(ISSAI 1315)**[2]**.** Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700,** ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

c. **Fushëveprimi:** Janë audituar hartimi dhe zbatimi i parimeve të buxhetit të shtetit për vitet objekt angazhimi, saktësia e rregullshmëria e pasqyrave financiare të subjektit për vitin 2016 dhe 2017, si edhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën objekt auditimi. Si kufizim i mundshëm gjatë kryerjes së auditimit shënohet mungesa në punë gjatë kryerjes së angazhimit në terren të Shefit të Sektorit të Financës, ku mund të ballafaqoheshin qëndrimet dhe diskutoheshin çështjet në kohën e duhur.

d. **Metoda e Auditimit:** Auditim mbi bazë risku.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. Dhënia e opinionit mbi pasqyrat e llogaridhënies vjetore dhe raportimit financiar.

Vlerësimi i posteve të aktivit dhe pasivit të bilancit kontabël si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. Mbajtja e kontabilitetit, evidenca kontabile, aplikimi i rregullave kontabël, si

[2] Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

dhe dokumentacioni justifikues. Saktësia e veprimeve të kryera për transaksionet në lekë dhe valutë. Respektimi i procedurave të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, etj.

Objekti: Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me kuadrin rregullator e ligjor në fuqi. Vlerësimi i posteve të aktivit dhe pasivit si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare. Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (*fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatpagesë, urdhër-shpenzim, etj.)*

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:
Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998, "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001. Auditimi vlerëson se, veprimet dhe transaksionet janë regjistruar mbi bazën e dokumenteve justifikuese, që mbështesin regjistrimet kontabël si në mënyrë kronologjike, ashtu dhe sistematike, konform përcaktimeve të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, *"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre*", ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007*"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj".*

UFSNK është njësi shpenzuese me kontabilitet më vete. Ndonëse në organigramë, si pjesë e Universitetit janë dhe Fakultetet, ato nuk mbajnë kontabilitet dhe në pikëpamjet e buxhetimit dhe mbajtjes së veprimtarisë kontabile, janë të inkuadruar dhe funksionojnë si pjesë e kësaj njësie shpenzuese.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi si dhe zbatimit të parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, përgjithësisht janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.
Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e bilanceve dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.
Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, bilanci është përpiluar dhe është dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Korçë si dhe në Ministrinë e linjës administrative (MAS).

Mbyllja e bilancit për vitin 2016 dhe 2017 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse. Veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.
Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga UFSNK, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit. Kopje e bilancit dhe pasqyrave financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, të cilat janë konfirmuar me vulosjen e tyre, brenda datës 28 shkurt të vitit pasardhës (për bilancin e vitit 2016). Bilanci është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore .
Për vitin 2016 dhe 2017 në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e Llogaridhënies Vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), që janë raportuar rregullisht si më poshtë:

- **<u>për vitin 2016</u>** janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Korçë si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, me shkresën nr. 01/08 datë 24.02.2017;
- **<u>për vitin 2017</u>** janë dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr. 455, datë 02.03.2018.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:

-për vitin 2016, me shkresën e datës 28.2.2017
-për vitin 2017, me shkresën nr. 423, datë 27.02.2018.

Auditimi u bë me të zgjedhur për këto çështje:

<u>i.ANALIZA E POSTEVE KRYESORE TE BILANCIT:</u>

<u>Auditimi i aktiveve të qëndrueshme</u>, (pasqyrat financiare /bilanci i vitit 2016):

b. <u>Objektivat e auditimit</u> të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. <u>Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:</u>
Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

-U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
-U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë deviacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
-U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

-U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.

-U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

-U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara dhe evidentimi kontabël i tyre.

Në analizë aktivet, viti 2016:

Në formatin nr. 1 totali i aktiveve të qëndrueshme është i barabartë me nen zërin "Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara" dhe "Aktivet e Qëndrueshme të Pa trupëzuara" në vlerën neto prej 380 milionë lekë në v. 2015 dhe 393 milionë lekë për v. 2016, duke i pasqyruar sipas zërave, si më poshtë:

Tabela nr.1
Të dhënat në lekë

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	*v.2016* Ushtrimi i Mbyllur	*v.2015* Ushtrimi i Paraardhes
1	**12**	**Rezultate te mbartura(saldo debitore)**		
2	**A**	**AKTIVE TE QENDRUESHME**	**393,098,801**	**380,396,849**
3	**20, 230**	**I.Te pa trupëzuara**	**13,761,353**	**15,067,707**
4	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave		
5	202	Studime dhe kërkime	16,161,131	16,965,371
6	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme		
7	209	Amortizimi i aktiveve qendrushme te pa trupezuara(-)	-2,399,778	-1,897,664
8	230	Shpenzime per rritjen e aktiv.qendr.patrupezuara		
9	**21,23,24,28**	**II.Akt.Qendr.te Trupezuara**	**379,337,448**	**365,329,142**
10	210	Toka,troje,Terene	576,000	576,000
11	211	Pyje,Kullota Plantacione		
12	212	Ndertime e Konstruksione	269,046,535	264,663,937
13	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	16,862,292	16,907,196
14	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	163,410,344	142,998,518
15	215	Mjete transporti	9,925,200	5,929,200
16	216	Rezerva shtetërore		
17	217	Kafshe pune e prodhimi		
18	218	Inventar ekonomik	114,706,390	108,248,896
19	219	Amortizimi aktiv. Qendr.te trupëzuara (-)	-195,189,313	-173,994,605
20	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		
21	232	Shpenzime proces për transferime kapitale		
22	24	Aktive te Qend.te trupëzuara te dëmtuara		
23	28	Caktime		
24	**25.26**	**III. Aktive Financiare**		
25	25	Huadhënie e nën huadhënie		
26	26	Pjesëmarrja ne kapitalin e vet		

Burimi: Drejtoria e Financës, UFSNK

1.AQPT, (Aktivet e Qëndrueshme të Patrupëzuara) **2016.**

Nga shqyrtimi i pasqyrave të llogaridhënies vjetore paraqitet kjo situatë e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme të Patrupëzuara, pasqyruar me vlerën e tyre bruto dhe pakësuar me amortizimin, si vijon:

Tabela nr.2

	A	**AKTIVE TE QENDRUESHME**	**393,098,801**	**380,396,849**
3	**20, 230**	**I. Te pa trupëzuara**	**13,761,353**	**15,067,707**
4	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave		
5	202	Studime dhe kërkime	16,161,131	16,965,371
6	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme		
7	209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme te pa trupëzuara(-)	-2,399,778	-1,897,664
8	230	Shpenzime për rritjen e aktiv.qendr. patrupëzuara		

Sa shikohet nga inventari në **llogarinë 202 " Studime dhe kërkime"** është përfshirë vlera bruto e studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 16,9 milionë lekë dhe 16,1 milionë lekë (vitet 2015 dhe 2016). Për këtë vlerë nga ana e degës së financës janë kryer dhe llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara.
Nga shqyrtimi i të dhënave analitike, rezulton se nën llogaria 202 "Studime e projektime" ka të detajuara këto artikuj:

- Dollap arshive, 30,000 x3=90,000lekë;
- Pajisje laboratori për analiza= 1,515,500 lekë
- *Soft informatikë, 98,500 lekë*
- Gjithsej: 1,704, mijë lekë
  Duke shtuar dhe vlerën sipas urdhër shpenzimeve nr. 322 e 323 prej 41,400 lekë dhe 37,800 lekë, vlera totale arrin në 1,783,200 lekë

Diferenca prej 16,161,131 lekë – 1,783,200 = 14,377,931 lek, është e pa justifikuar në mënyrë të detajuar ngase ajo përbëhet.
Përdorimi i fondeve në mënyrë të gabuar sjell edhe pasqyrimin jo të drejte e joreal të llogarive kontabël të institucionit dhe denatyralizon në mënyrë të padrejte llogaritë kontabël dhe fondet e akorduara nga buxheti i shtetit.
Për sa sipër, Dega e Thesarit Korçë, në momentin e likuidimit, duhet të ishte treguar e vëmendshme në kontrollin e dokumenteve justifikues që ka paraqitur Universiteti FSNK pranë këtij institucioni, duke mos lejuar pagesa të pajustifikuara apo me mospërputhje të dokumentacionit me fondet e dhëna në buxhet.

Duke analizuar pasqyrën "Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve të Qëndrueshme / Vlera Bruto", rezulton se shtesat e AQPT janë për 79,200 lekë, (shumë kjo e barabartë me vlerën e dy urdhër-shpenzimeve të referuara më lartë, të datës 14 dhjetor 2016).
Pakësimet/ dalje janë si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimt e AQPT, në vlerën 883, 440 lekë, shumë kjo e pa bazuar dhe pa asnjë argument.

- Bazuar ne VKM nr. 248, date 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore qendrore dhe lokale si dhe të njësive që varen prej tyre", të ndryshuar si dhe në ***Manualin e Klasifikimit Ekonomik Buxhetor***, llogaria 230, me nën llogaritë përkatëse: 230.20 "Studime fizibiliteti"; 230.21 "Përgatitje projektesh"; 230.50 "Shpenzime për patenta, e drejta e autorit, koncesionet", etj. në fund të vitit do të mbyllet dhe do të kalojë në llogarinë 202 "Shpenzime për studime e kërkime".

230.Shpenzime për rritjen e AQPT
Ky artikull përfshin shpenzimet qe kryhen nga ana e institucionit për krijimin ose blerjen e aktiveve te patrupëzuara për qëllime te institucionit ose për te trete. Përmendim shpenzimet e kryera për studime dhe përgatitje projektesh, për blerjen e patentave, te drejtën e autorit, te drejtën e mendimit intelektual, softet informatike te krijuara nga institucioni, etj.
230.20- Studime fizibiliteti
230.21 -Përgatitje projektesh
230.5 -Shpenzime për aktive të tjera të patrupëzuara.

- Nga ana tjetër, në Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik, të miratuar nga Ministria e Financave janë përcaktuar këto llogari për institucionet buxhetore:

Klasa	Sub Class	Article	Sub Article	Analysis	TYPE	P E R S H K R I M I (Albanian Description)
2	**20**				A	AKTIVE TE QENDRUESHME TE PATRUPEZUARA
2	20	201	2010	2010000	A	PRIME TE EMISIONIT OSE RIMBURSIMIT TE HUAVE
2	20	202	2020	2020000	A	STUDIME OSE KERKIME
2	20	203	2030	2030000	A	KONCESIONE , PATENTA, LICENCA, MARKA, TE DREJTA E TJERA TE NGJASHME

- ***<u>Në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit,</u> SKK nr.5, "AAGJM dhe AAGJJM", në lidhje me trajtimin kontabël të AQPT, në pikët nr. 57, 58 dhe 60, përcaktohet se:***

"Aktive afatgjata jo materiale (AAJM) janë aktive të identifikueshme **jo monetare pa përmbajtje fizike**, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për tua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative. Një aktiv i tillë është i identifikueshëm kur:
(a) është i ndashëm, d.m.th i aftë për të qenë i ndarë nga njësia ekonomike dhe shitet, transferohet, licencohet, jepet me qira ose shkëmbehet, ose individualisht ose së bashku me një kontratë të lidhur, aktiv ose detyrim, ose
(b) lind nga të drejtat kontraktuale ose të tjera ligjore, pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme ose të ndara nga njësia ekonomike ose nga të drejtat dhe detyrimet e tjera"

- ***Mbështetur në VKM Nr. 783, datë 22.11.<u>2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël</u>",*** Kapitulli III, Seksioni II, "AQPT", jepet ky përcaktim:

Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara ndiqen në kontabilitet të klasifikuar sipas natyrës së tyre, ndër të cilët:
Shpenzimet e nisjes dhe të zgjerimit – Llogaria 201
Në këtë emërtim përfshihen dy kategori shpenzimesh: a) Shpenzimet për krijimin e njësisë ekonomike (shoqërisë) në nisjen e saj ose për krijimin e njësive apo çeljen e veprimtarive të reja gjatë jetës së saj. Këto janë përgjithësisht shpenzime të natyrës administrative që nuk mund të hyjnë në vlerën e elementeve të trupëzuara (p.sh. të ngritjes së një uzine) siç janë shpenzimet për kryerjen e formaliteteve juridike, të publikimeve, të shtypjes së aksioneve e nënshkrimit të tyre, të formimit të personelit etj. Mundësia e regjistrimit të këtyre shpenzimeve në aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara është e lidhur me dy kushte kryesore të njëkohshme: *Së pari,* ato duhet të kushtëzojnë krijimin e njësisë ekonomike ose zhvillimin e saj kur ky kapërcen pragun e zakonshëm dhe shpenzimet për të kanë karakter investimi. *Së dyti*, nuk mund t'i atribuohen një produkti a shërbimi konkret të ardhshëm, ndaj nuk hyjnë në koston e tyre.

b) Shpenzimet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë tregtare dhe të operacioneve të tilla si shkrirja, ndarja apo transformimi i saj.

Edhe këto janë shpenzime të natyrës së përgjithshme që lidhen me operacionet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja (shpenzimet për shtypjen e aksioneve, nënshkrimin e tyre, publicitet etj.).

Nëse shuma e tyre është e ndjeshme, mund të kapitalizohen si aktive të patrupëzuara, por këto shpenzime mundet gjithashtu, të përballohen nga primet.

Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202

Kërkimet e aplikuara janë punime origjinale të njësisë ekonomike për të fituar njohuri të reja dhe të orientuara drejt një objektivi të caktuar d.m.th. që parashikon një aplikim ose një përdorim të veçantë.

Zhvillimet eksperimentale janë ***punimet sistematike*** të mbështetura mbi njohuritë ekzistuese të fituara nga kërkimet ose nga përvoja praktike, ***të ndërmarra me qëllim të fillimit të fabrikimit të materialeve, sendeve, të hartimit të procedurave, të sistemeve apo shërbimeve të reja ose për të përmirësuar në mënyrë thelbësore elemente të tilla ekzistuese.***

Regjistrimi i shpenzimeve për këto punime në aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara është i mundshëm kur përmbushen njëherazi këto kushte:

- kërkimet e aplikuara dhe zhvillimet kryhen për llogari të njësisë ekonomike dhe jo në funksion të një porosie për të tretë;
- shpenzimet e kryera për to nuk janë të përfshirshme në vlerën (koston) e një elementi të trupëzuar, rezultat i këtyre punimeve (krijimin e një laboratori p.sh.);
- çdo projekt duhet të jetë qartësisht i individualizuar dhe kostoja e tyre të përcaktohet në mënyrë të dalluar për t'u shpërndarë në kohë;
- çdo projekt duhet të këtë në datën e përgatitjes të llogarive vjetore shanse serioze për arritjen teknike dhe rentabilitetin tregtar.

Koncesione dhe të drejta të ngjashme, patenta, licenca, marka, procedura të drejta dhe vlera të ngjashme-Llogaria 205

Në përgjithësi janë shpenzimet e kryera për sigurimin e (marrjen) e avantazheve nga mbrojtja, në disa kushte, e shpikësit, e autorit ose e përfituesit të së drejtës për shfrytëzimin e një patente, të një licencë, të një marke (fabrikë, tregtie, shërbimi), e të drejtave të pronësisë letrare e artistike ose e titullarit të një koncesioni.

Fondet tregtare- Llogaria 207

Përbëhen nga elemente të patrupëzuar, të cilat nuk përbëjnë objekt të një vlerësimi dhe regjistrimi të veçantë në bilanc, dhe që marrin pjesë në mbajtjen ose në zhvillimin e potencialit të veprimtarisë së njësisë ekonomike. Në fakt nocioni "Fondet tregtare" rrjedh nga një koncept juridik tjetër më i gjerë: "fondet e tregtisë". Këto të fundit përfshijnë si elemente të trupëzuara (makineri, pajisje, mallra etj,); ashtu edhe elemente të patrupëzuara: emri i mirë, fama tregtare, klientela, patentat e shpikjeve, licencat dhe të gjitha elementët e tjera të përmendura me sipër që janë të lidhura me "Fondet e tregtisë".

Bazuar në legjislacionin e mësipërm rezulton se, <u>në këtë llogari janë përfshirë parregullsisht dhe elementë të inventarit, që nuk i plotësojnë kriteret për t'i klasifikuar si AQPT, por në fakt janë elemente inventari si dollapë, pajisje laboratori</u>, etj.

Në formatin nr.7 "Pasqyra e amortizimeve 2016", rezulton të jetë pasqyruar amortizimi i AQPT për shumat e nxjerra jashtë përdorimit në vlerën prej 26,503 lekë, vleftë që është e lidhur me shumën e pasqyruar tek formati nr.6 "Gjendja dhe ndryshimet e AQT", për nxjerrje jashtë përdorimit të AQPT në shumën 883,440 lekë".

Nga ana tjetër, konstatohet se janë bërë dalje jashtë përdorimit AQPT (reflektuar në pasqyrën nr. 6, viti 2016) në vleftën 883,440 lekë.

Kjo shumë përfaqëson vlerën që u korrespondon fletëdaljeve nr. 2, datë 15.11.2013 (nënshkruar nga [redacted]); nr. 3, datë 15.11.2013 (nënshkruar nga [redacted].); nr. 5, datë 17.12.2014

(nënshkruar nga [redacted]); nr. 6, datë 17.12.2014 (nënshkruar nga [redacted].); nr. 18, datë 17.12.2014 (nënshkruar nga [redacted]); nr.19, datë 17.12.2014; nr.20, datë 17.12.2014.
Nga shqyrtimi i përshkrimeve të këtyre elementeve që janë kontabilizuar në llogarinë 202 ato paraqiten në këtë trajtë:

- ***Fletëpalosje, monografi, postera, broshura, pyetësor, baner, programe konference, botime artikujsh shkencor, etj.***
- ***Kite laboratorike, (përkatësisht, 3 fletëdalje për pedagogë të Universitetit në vlerën e përgjithshme prej 275,616 lekë, analizuar si vijon:***
  22 copë x4176= 91,872 lekë, FD nr.5, datë 17.12.2014
  22 copë x4176= 91,872 lekë, FD nr.6, datë 17.12.2014
  22 copë x4176= 91,872 lekë, FD nr.7, datë 17.12.2014

Referuar kërkesave të Kapitullit II, "rregulla të përgjithshme për pasqyrat financiare vjetore", të VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", është dhënë definicioni se:

> "Në këtë kuptim **aktivet përkufizohen si elemente të pasurisë** së njësisë ekonomike me vlerë ekonomike pozitive. Ekziston një **lidhje e ngushtë midis shpenzimeve** që njësia ekonomike kryen **dhe hyrjes se një aktivi**, por këto dy akte nuk përkojnë domosdoshmërish, sepse:
> - një element i blerë apo i krijuar është i lidhur gjithnjë me kryerjen e shpenzimeve, por **<u>këto të fundit mund të kapitalizohen dhe të përfshihen në bilanc vetëm nëse nga elementi i dhënë njësia ekonomike ka siguri për përfitime ekonomike të ardhme</u>**. Në rast të kundërt shpenzimet e kryera konsiderohen **<u>shpenzime të ushtrimit</u>** dhe përfshihen drejtpërdrejt në rezultatin e tij;

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin e mësipërm rezulton se, në këtë llogari <u>janë përfshirë dhe parregullsisht elementë që nuk i plotësojnë kriteret për ti klasifikuar si AQPT, të tilla si fletëpalosje, monografi, postera, broshura, pyetësor, baner, programe konference, botime artikujsh shkencor</u>. Për pasojë regjistrimi i këtij artikulli kontabël mbart pasaktësi pasi aktivitetet promovuese të këtij karakteri nuk konsiderohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara. Grupi i auditimit sjell në vëmendje se, në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 60, i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "AAGJM dhe AAGJJM", janë dhënë këto shpjegime:

> "...një njësi ekonomike **njeh si shpenzime në periudhën kur ndodhin dhe <u>jo si AAJM</u>**, zërat e mëposhtëm:
> *(a)* markat e krijuara brenda njësisë, logot, listat e klientëve dhe zërat e ngjashëm në përmbajtje;
> *(b)* aktivitetet e nisjes (d.m.th kostot e nisjes), të cilat përfshijnë kostot e themelimit të tilla si kostot ligjore dhe të sekretarisë të bëra në krijimin e një njësie ekonomike ligjore, shpenzimet për të hapur një strukturë të re apo biznes të ri (p.sh. shpenzimet e para-hapjes) dhe shpenzimet për të filluar aktivitetet e reja ose lançimin e produkteve të reja ose proceseve (d.m.th kostot e para shfrytëzimit);
> *(c)* **aktivitetet e trajnimit**;
> *(d)* **reklamat** dhe **aktivitetet promovuese**;
> *(e)* zhvendosja ose riorganizimi pjesor ose i të gjithë njësisë ekonomike;
> *(f)* emri i mirë i krijuar brenda për brenda njësisë ekonomike"

Përfundimi:
Është vepruar në kundërshtim me legjislacionin e mësipërm që përcakton cilësitë e aktiveve dhe dallimin e AQPT nga shpenzimet korente. Nga auditimi rezulton se, në këtë llogari janë përfshirë parregullsisht dhe elementë që nuk i plotësojnë kriteret për ti klasifikuar si AQPT, të tilla si fletëpalosje, monografi, postera, broshura, pyetësor, baner, programe konference, botime artikujsh shkencor, etj. Për pasojë, regjistrimi i këtij artikulli kontabël mbart pasaktësi, pasi aktivitetet promovuese të këtij karakteri nuk konsiderohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara.

✓ Llogaria 210, "**Toka, troje e terrene**" është e kontabilizar për të dy vitet më shumë të njëjtë prej 576 mijë lekë, **mirëpo nuk është e zbërthyer në mënyrë analitike, për argumentimin e sipërfaqeve të përfshira në kontabilitetin e institucionit dhe çmimit të aplikuar për efekt vlerësimi dhe kontabilizimi.**

		Viti i analizuar	*Viti paraprak*
210	Toka, troje, terrene	576,000	576,000

Nga kryqëzimi i të dhënave të raportuara nga ana e Universitetit në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (shkresa nr. 7/20, datë 06.11.2012), në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pronave rezultojnë se për artikujt me nr. 8-13 të Formularit nr.1 për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore janë evidentuar sipërfaqja prej **21,119 m2, apo 21,1 ha**.
Nga ana tjetër, në kuadër të UFSNK funksionon dhe Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE), si njësi që drejtohet nga Fakulteti i Bujqësisë dhe e ngritur me VKM nr.76, datë 20.05.1979, e cila sipas të dhënave të disponuara nga ana e përgjegjësit të EDE ka në zotërim fondin aktual të tokës prej **18,9 ha, ose 189,000 m2**.
Konstatohet se, fondi i tokës që ka patur në administrim dhe pronësi EDE/ UFSNK në vitin 1991 **ka patur një sipërfaqe prej 59,58 ha, duke rezultuar me një diferencë prej 40,48 ha**, të cilën, Përgjegjësi i EDE Boris Canco e arsyeton me "***kthime të pronave për ish-pronarët me vendime të KKKP, ndërtimi i autostradës, ndërtime të paligjshme, si dhe pallate banimi dhe terrene sportive, të cilat në tërësi kapin shifrën e mësipërme".***

Përfundimi:
Mungojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që UFSNK ka në dispozicion si dhe bëhet domosdoshmëri përditësimi e azhurnimi i tyre i plotë, përmes matjeve fizike, azhurnimit dhe rakordimit me informacionin e administruar nga zyrat e kadastrës dhe të hipotekës.

Për të njëjtën vlerë, ky zë i aktiveve është regjistruar dhe pasqyruar në kontabilitet dhe në pasqyrat e bilancit vjetor kontabël të vitit 2017, (ndonëse gjatë periudhës 2015-2018) ka patur disa transferime nga aktivet e Universiteti për tek Bashkia e Korçës dhe për rrjedhojë ky vlerësim është jorealist dhe denatyron vlerën e këtyre pronave dhe pasurive shtetërore.

Referuar sipërfaqeve të evidentuara mbi tokat dhe trojet në vitin 2012, (shkresa dërguar Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), si dhe fondit të tokës në dispozicion të EDE, krahasuar me vlerësimin e tokës për efekt regjistrimi në bilanc, (ku është evidentuar për vleftën gjithsej 576, 000 lekë), sipërfaqja totale e tokës prej 210,119 m2 që ka UFSNK në dispozicion, (edhe kjo nuk konsiderohet si evidencë

përfundimtare), rezulton të jetë vlerësuar me një çmim prej 2,7 lekë/m2= (576,000 lekë: 210,119 m2), gjë që tregon se ky është çmim dhe vlerësim jo realist dhe që krijon riskun e abuzimet me tokat, trojet dhe terrenet e këtij institucioni shtetëror. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", referuar:

- **Vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit "tokë truall" për qytetin e Korçës, kjo vlerë varion midis çmimeve 7,535 lekë/m2 deri në 9,055 lekë për m2.**
- **Vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit "tokë bujqësore" për rrethinat dhe fshatrat e Korçës, kjo vlerë bazohet në çmimeve prej 100 lekë për m2.**

Për sa sipër,

a. **Nga përllogaritjet për tokën truall 21,119 m2** x **çmimin më të ulët për zonën kadastrale në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 prej 7535 lekë/m2 = 159,131,665 lekë ;**
b. **Nga përllogaritjet për tokën bujqësore për fondin aktual të tokës bujqësore në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016, për 189,000 m2** x **çmimin më të ulët për zonën kadastrale të rrethinave prej 100 lekë/m2 = 18,900,000 lekë.**

Për të dy kategoritë, në total <u>vlera minimale</u> që duhej kontabilizuar për kategorinë toka, troje e terrene duhet të ishte për <u>178,031,665 lekë</u>, <u>shifër kjo e konsideruar materiale për auditimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, nga 576,000 lekë e pasqyruar në bilanc, me një diferencë prej 177,455,665 lekë.</u>

✓ -Zëri "***Ndërtime e konstruksione" (llog. 212)*** për vlerën 269 milionë lekë për të dy periudhat e auditimit është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me kartelën e inventarit kontabël dhe përfshin këto lëvizje:

212	Ndërtime e Konstruksione	269,046,535	264,663,937

Edhe nga shqyrtimi i pasqyrës për lëvizjet bruto të aktiveve, (Formati nr.6),vlera e ndërtesave në fund të v.2016 është 269,046,535 lekë, e përputhur kjo me shumën e vendosur në Aktiv të bilancit kontabël.

<u>Nga ana tjetër, kjo shumë nuk përputhet me vleftën e vendosur në pasqyrën "Gjendja e aktiveve të qëndrueshme në fund të vitit 2016", (shkresa e nënshkruar nga Përgjegjësja e Degës së Financës znj[redacted] e cila ka këtë përmbajtje:</u>

nr	llogaria	emërtimi	shuma
1	212	Ndërtesa	**237,106,761**
2	214	Makineri e pajisje	163,410,344
3	218	Inventar ekonomik	114,706,390
		shuma	515,223,495

Pra, konstatohet se zërat "Makineri e pajisje" dhe "Inventar ekonomik", janë të rakorduara me postet e bilancit, në shumat e referuara më lartë, ndërsa <u>llogaria</u>

<u>"ndërtesa" ka një mospërputhje prej 31,941 mijë lekë ndaj të dhënave të bilancit për ndërtesat.</u>

Gjithashtu, nga shqyrtimi i të dhënave të evidencës analitike të ndërtesave rezulton se, në pasqyrat analitike që shoqërojnë bilancin kontabël të vitit 2016 dhe 2017 gjendja e nënllogarisë 212 "ndërtesa" paraqitet si vijon:

Të dhënat në mijë lekë

Vlera e ndertesave viti 2016

			ne fund te 2009	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**			
nr	emertimi	viti I ndertimit	vlera	vlera	vlera	vlera	vlera	vlera	Vlera		norma e amortiz	vite	amortizim
I	**Godina mesuesise**	1994	552								1%	17	94
	rikonstruk firma Abdyli	2004	45857								1%	7	3210
	rikonstruk firma Abdyli	2005	2039								1%	6	122
	rikonstruk firma leka shpk	2006	10693								1%	5	535
	rikonst firma ALBLEAA			6420							1%		0
											1%	2	0
	mirmbajtje ndertimore									851	1%	1	
	shuma		59141	65561	65561	65561	65561	65561	65561	66412	*		**3867**
II	**Godina ekonomikut**	1976	19460								1%	35	6811
	rikonst Xhengo (banjat)	2008	5866								1%	3	176
	rikonst firma konst 93			3484									
											1%	2	0
	rikonst Nika shpk							**13852**					
	shuma		25326	28810	28810	28810	28810	42662	42662	42662	*		**6987**
III	**Godina Agronomise**	1981	520								1%	20	104
	rikonst firma kons 93	2006	21604								1%	5	1080
	shuma		22124	22124	22124	22124	22124	22124	22124	22124	*		**1184**
IV	**Godina e infermerise**	1995	4233								1%	16	677
	rikonst firma konst 93	2007	8837								1%	4	353
	shuma		13070	13070	13070	13070	13070	13070	13070	13070			**1031**
	Totali		119661	129565								0	13068.92
V	**Godina Divizionit**				**8161**						**1%**	**1**	**82**
	te trasferuar	**2011**											**449**

	kontab rikonstruksion	**2012**				**48543**					**1%**	**1**	**485**
	kontab rikonstruksion	**2013**					**34605**				**1%**	**1**	**346**
	vlera gjithsej godina divizionit				8161	48543	34605	91309	91309	91309			13600
	VLERA GODINA UNIVERSITETI		118565	129564	137726	186269	220874	234726	234726	235577			
VI	**Ndertesa baza bujqesore**						**11791**	**11791**	**11791**	**11791**	1%	1	**118**
	akt marje dorezim												
VII	**NDERTESA (ISH SHTEPIA E OFICERAVE)**						**3655**	**3655**	**3655**	**3655**	1%	1	**37**
VIII	**ish konvikti I mekanikes**												
	vlera e tre situacioneve												
	rikonstruksion												
	shuma												
	EDE-ja												
	ndertime te tjera												
	Totali						**236320**	**250172**	**250172**	**251023**			1374
	vlera sipas pasqyrave aktive												
	pasqyrat e aktiveve 2120101								717	717			
	pasqyrat e aktiveve 2120103						232665	246517	246518	246518			
	pasqyrat e aktiveve 2120118						3655	3655	2657	3508			
	shuma						**236320**	**250172**	**249892**	**250743**			
	diferenca						0	0	280	280			

<u>Kjo shumë totale e gjendjes së nënllogarive të ndërtesave në fund të vitit 2016, nuk përputhet me shumën e vendosur në Aktiv të Bilancit, llog.212, posti nr.12 në Aktiv të Bilancit Kontabël) duke paraqitur këto devijime:</u>

- **Ne bilanc** vlera e ndërtesave në fund të v.2016 është **269,046 mijë lekë,**
- **Në pasqyrën ku listohen ndërtesat, vlera është 251,023 mijë lekë.**

<u>Pra, llogaria analitike e zërit "ndërtesa", paraqitet me një mospërputhje prej 18,023 mijë lekë ndaj të dhënave të evidentuara në aktiv të bilancit kontabël.</u>

Në këtë pasqyrë bëjnë pjesë dhe objektet ndërtimore për "Bazën Prodhuese" dhe "Ish-Shtëpia e Oficereve", për të cilat në fakt ekzistojnë disa procedura të transferimit te tyre ndër vite, trajtuar si më poshtë:

<u>Analiza e nënllogarisë 212, "Ndërtesa", Baza prodhuese:</u>

1. Me **VKM nr. 199, datë 04.03.2015** "Për kalimin në pronësi, nga Universiteti "F.S.Noli" Korçë, te Bashkia Korçë, të objektit "Baza Prodhuese" e UFSNK , për

përdorim nga shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova", në pikën nr. 1 përcaktohet kalimi i objekteve dhe të truallit të bazës prodhuese te Bashkia Korçë. Përmes këtij Vendimi, shfuqizohet VKM nr. 235, datë 27.03.2013 që bazën prodhuese të asaj shkolle, nga bashkia e Korçës i kalon Universitetit "F.S.Noli" Korçë.

2. Urdhri i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë z[redacted] me **nr. 89, datë 01.04.2015** "Për caktimin e anëtarëve të komisionit për kalimin e pronësisë, nga Universiteti "F.S.Noli" Korçë te Bashkia Korçë, të objektit "Baza Prodhuese" e UFSNK, për përdorim nga shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova".
3. Urdhri i ish-Rektorit Z[redacted]., me **nr.76, datë 15.04.2015** "Për krijimin e komisionit për dorëzimin e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra për kalimin e objektit "Baza Prodhuese" nga Universiteti "F.S.Noli" Korçë te Bashkia Korçë, për përdorim nga shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova".
4. Procesverbali trepalësh, **datë 15.04.2015** për dorëzimin nga UFSNK dhe marrjes në dorëzim të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra nga Bashkia Korçë dhe përfaqësuesit e *SHMB "I.Terova " Korçë. Procesverbali i dorëzimit është nënshkruar rregullisht nga përaqësuesit e autorizuar të UFSNK , të Bashkisë Korçë dhe për SHMB "I.Terova" Korçë.*
5. Shkresa e UFSNK me **nr. 6/7 prot, datë 29.01.2016**, i është drejtuar Degës së Thesarit Korçë me objekt "Dërgohen pasqyrat e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2015".
   Në pasqyrën/ Formati nr.6"Shtesa dhe pakësime të aktiveve fikse", në rubrikën "Aktive të dala 2015", kolona "Kalime" është evidentuar shuma 3,655,215 lekë, vlerë kjo e barabartë me shumën e llogarisë 212 "Ndërtesa" në procesverbalin trepalësh për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra për Bashkinë Korçë.
6. Në faqen nr. 19, të Raportit të Auditimit të Brendshëm të MASH, (dërguar me shkresën nr. 6153/3 prot, datë 31.8.2016), kur analizohen gjendja dhe tepricat e llogarive të vitit 2015, në pakësimin e AQT për vlerën prej 13 milionë lekë bëjnë pjesë dhe "kalimi i objektit të bazës prodhuese të UFSNK te Bashkia Korçë, për tu përdorur nga SHMB "I.Terova":
   -Ndërtesa: 3,6 milionë lekë;
   -Makinerie pajisje: 11 milionë lekë;
   -Kafshë pune e prodhimi: 1,6 milionë lekë;
   -Inventar ekonomik: 1,4 milionë lekë.
7. Nga ana tjetër, në pasqyrën analitike të llogarisë 212 "Ndërtesa", për vitin 2016 dhe 2017, vlera e këtij objekti prej ***3,655,215 lekë* është përfshirë në pasqyrën analitike të kësaj llogarie.**

<u>Analiza e nënllogarisë 212, "Ndërtesa", "Shtëpia e oficereve":</u>

Në lidhje me këtë pasuri kanë ndodhur këto transferime për periudhën 2012-2017, sipas këtyre akteve të referuara në vijim:

- ✓ Me **VKM nr. 530, datë 07.08.2012,** "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te MASH për Universitetin "F.S.Noli" Korçë, të pronës nr. 549 me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...". Për sa sipër, është mbajtur akt-dorëzimi i pronës, nga anëtarët e komisioneve respektive dhe është nënshkruar akt-dorëzimi me nr. 286 prot, datë 27.12.2012 të MM dhe me nr. 323 prot, datë 15.01.2013 të MASH

- ✓ Me **VKM nr. 76, datë 28.01.2015**, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MAS te MMSR për Drejtorinë Rajonale të SHKP Korçë, të aneksit të godinës me emërtimin "Ish Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...". Ka kaluar sipërfaqja prej 219 m2 për DRSHKP.
- ✓ Me **VKM nr. 152, datë 29.02.2016**, "Për kalimin në pronësi nga MAS te Bashkia Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë". ***Sipas pikës nr. 2 të këtij vendimi, VKM nr. 530, datë 7.8.2102 i ndryshuar, shfuqizohet.***
- ✓ Me **VKM nr. 193, datë 15.03.2017**, "Për një ndryshim në VKM nr. 152, datë 29.2.2016 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MAS te MMSR për Drejtorinë rajonale të SHKP Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...dhe për kalimin në përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me sipërfaqe 348 m2.

Nga analiza e Formatit nr.6 bashkëlidhur bilancit, nuk rezulton të jetë gjendje në fillim të vitin 2016, pjesa e mbetur pa kaluar, për të cilën ka dalë VKM nr. 152, datë 29.02.2016, "Për kalimin në pronësi nga MAS te Bashkia Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë.

Përfundimi:
Në bilanc dhe në formatin nr. 6, vlera e AQT "Ndërtesa", në fund të v.2016 pasqyrohet për 269,046,535 lekë, në një pasqyrë për 237,106,761 lekë, kurse në tabelën ku listohet historiku i AQT-ve paraqiten për 251,023 mijë lekë, duke krijuar mospërputhje dhe mosrakordime ndaj shumës së pasqyruar në bilanc midis llogarisë sintetike dhe atyre analitike për 31,939,774 lekë = (269,046 mijë – 237,106 mijë).

Dhurimi i librave:
Nga shqyrtimi i formatit nr. 6 që shoqëron Bilancin Kontabël, ka rezultuar se, gjatë vitit 2016, llogaria nr.212 (në grupin e Aktiveve të Qëndrueshme) është pakësuar për vlerën **1,163,800 lekë**, e cila ka të bëjë me fondin e librave të dhuruara nga Universiteti për ente të tjera ose pedagogë dhe studentë te tij. Më hollësisht paraqitet kjo situatë si më poshtë:

- ✓ Nga ana e Komisionit të përbërë nga znj.[redacted], ngritur për Inventarizimin e Fondit të Librit pranë bibliotekave të fakulteteve, në relacionin e datës 24 qershor 2016 është bërë prezent kjo gjendje e lëvizjeve në fondin e librit universitar:

1. Dhuruar Shkollës së Gjuhëve të Huaja një fond librash me vlerë 68,070 lekë;
2. Dhuruar pedagogëve libra me vlerë 70,000 lekë;
3. Dhuruar libra pedagogëve dhe të ftuarve me vlerë 366,300 lekë;
4. Dhuruar Universiteteve të tjera libra me vlerë 727,500 lekë;
   Shuma gjithsej: 1,231,870 lekë (nga e cila, 1,163,800 lekë janë nga llogaria 212 dhe 68,070 lekë nga llogaria 321)

Konstatime:

1. Në lidhje me fondin e dhuruar për Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja Korçë me vlerë 68,070 lekë këto veprime janë kryer sipas kërkesës së datës 12 maj 2015, që ish-dekani [redacted] i ka drejtuar ish-rektorit [redacted]., ku i propozohet nxjerrja nga inventari i një fondi librash të dhuruara nga donatorët dhe që nuk janë në shërbim të programeve të studimit. Ish-Kancelari, [redacted] në të njëjtën datë i është përgjigjur zyrtarisht dekanit të Fak. Edukimit dhe Filologjisë se transferimet bazohen në procesverbalin e palëve dhe kopjet e tij dorëzohen në financë për ekzekutim. Në funksion të kësaj kërkese është mbajtur procesverbali i datës 13 maj 2015, i cili është nënshkruar nga 3 përfaqësues të UFSNK dhe 3 përfaqësues të Gjimnazit, për marrje në dorëzim të 158 librave me vlerë 79 mijë lekë, fakt i konfirmuar dhe nga drejtori i shkollës znj.[redacted]. me shkresën nr. 134 prot, datë 15.5.2015. Nuk janë prerë fletëdalje nga magazina për Gjimnazin e Gjuhëve të Huaja.

2. **<u>Për grupin e dytë, dokumentacioni për veprimet e dhurimit është hartuar dhe nënshkruar në vitin 2015, (për 330 copë libra, me vlerë 366,300 lekë), që lidhen me aktivitete që janë kryer 3-4 vite më parë</u>**, përkatësisht gjatë viteve 2012 dhe 2014 dhe nuk ka asnjë gjurmë veprime në kontabilitetet e viteve respektive. Këto veprime ngarkojnë më përgjegjësi ish-Dekanin e Fakultetit [redacted]. dhe përfaqësuesi i Qendrës së Ekselencës z[redacted] *Konkretisht:*

✓ Procesverbal i datës 12 janar 2015, për shpërndarje libri, në konferencën "Lidhjet kulturore dhe historike të shqiptaro-rumune", (**Korçë, mars 2012**), nënshkruar nga dekani [redacted] dhe përfaqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted]., për 110 kopje libra.

✓ Procesverbal i datës 12 janar 2015, për shpërndarje libri, në aktivitetin "Akademia Jubilare me rastin e 40 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit", (**Korçë, nëntor 2012**), nënshkruar nga dekani [redacted] dhe për përfaqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted] për 110 kopje libra.

✓ Procesverbal i datës 12 janar 2015, për shpërndarje libri, të botimit " Vjetari shkencor "FEF Simpozium shkencor; ndihmesat e pedagogëve doktorantë në fushën e edukimit dhe filologjisë", (**Korçë, Shtator 2014**), nënshkruar nga ish-dekani [redacted] dhe për përfaqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted] për 110 kopje libra.

Për parregullsitë e mësipërme, kjo shumë prej 366,300 lekë është shpenzim i pajustifikuar dhe pa efektivitet.

3. **<u>Nuk ka asnjë praktikë shkresore e administrativ për justifikimin e shumës prej 727,500 lekë, që u përkojnë 1164 librave libra, (nga një kontingjent prej 9900 copë libra të siguruara nga donatorët në kuadër të projektit "[redacted] dhe që u janë dhuruar universiteteve të tjera</u>. Bashkëlidhur dokumentacionit të disponuar nga ana e Drejtorisë së Financës për artikujt kontabël të regjistruar, është një plan shpërndarje që mban nënshkrimet e punonjësit të bibliotekës [redacted] përgjegjëses së departamentit znj[redacted] dhe koordinatorit të projektit Z[redacted]. <u>Ky plan nuk është i miratuar. Pra, nuk ka nënshkrim nga ana e rekorit për shpërndarje të këtyre librave dhe shkresa është pa numër protokolli e pa datë</u>.**

Sipas këtij plani, 20 komplete me nga 20 copë libra secili, janë shpërndarë në panairin e organizuar nga Ministria e Integrimit; 9 komplete me nga 20 copë janë shpërndarë nga [redacted]. në universitetet që kanë programe studimi në infermieri; 18 komplete me nga 20 copë janë tërhequr nga pedagogia [redacted] së bashku me 180 libra obstetrike-gjinekologji, 60 libra fiziologji, 43 libra ABC e jetës, diabetit dhe dhimbjes, të cilat u janë shpërndarë studentëve, por mungon miratimi për sa sipër.

Për parregullsitë e mësipërme, kjo shumë prej 727,500 lekë është shpenzim i pajustifikuar e pa efektivitet.

4. Fakti që, disa shkresa të konsideruara si procesverbale mbi planin e shpërndarjes së botimeve të realizuara nga fakultetet, mbajnë datën 12 janar 2015 dhe u referohen librave të dhuruara në aktiviteteve (konferenca) te mbajtura në mars 2012, nëntor 2012, shtator 2014 etj; tregon për **mos pasqyrim me saktësi të ngjarjeve dhe veprimeve ekonomike në momentin kur ato ndodhin.** Për sa sipër, është vepruar në shkelje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet.

✓ Zëri ***"Mjete transporti" (llog. 215)*** është për vlerën 9,925 mijë lekë, që i zbërthyer në mënyre analitike përfshin vlerën e një mjeti auto veturë, një mjeti autobus dhe një fugoni në inventar dhe dispozicion të UFSNK. Në mënyrë të detajuar llogaria 215 "Mjete transporti", paraqitet si vijon:

	Emërtesa	Njesia	sasia	cmimi	vlera
A	**mjete transporti**				
1	Autobus	copë	1	2994000	2994000
2	Fugon (auto veturë)	"	1	2796000	2796000
3	Auto veturë	"	1	3996000	3996000
	Shuma				**9,786,000**
B	**Mjete kundra zjarrit**				
3	fikse zjarri	cop	5	12000	60000
4	detektor sinjalizim zjarri	cop	30	2640	79200
	Shuma				139200
	totali				**9,925,200**

✓ Zëri ***"Inventar ekonomik" (llog. 218)*** për vlerën 114,7 milionë lekë për v. 2016 nga 108,2 milionë lekë që ishte para një viti. Zëri "Inventar ekonomik" është i zbërthyer në mënyrë analitike, me një shtesë të vlerës bruto prej 6,5 milionë lekë, ku sipas njësisë shpenzuese janë me efekte të më poshtme:
-të hyrat nga blerjet gjatë vitit 2016 në vlerën prej 7,3 milionë lekë;
-të dala jashtë përdorimit në shumën totale prej 0,8 milionë lekë.

Aktivet Qarkulluese më 31.12.2016 përfshijnë gjendjen e mallrave prej 38,2 milionë lekë, inventarin prej 23,2 milionë dhe mallra 14,9 milionë lekë. Rritja e këtij grupi të aktiveve qarkulluese kundrejt vitit të mëparshëm është prej 0,8 milionë lekë.

ii. ANALIZA E DEBI-KREDIVE:
ii/a- Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

"Kërkesat e arkëtimit mbi Debitorët" *(Klasa 4),* pasqyrohen në aktiv të bilancit, (formati nr. 1), për vlerën 20,250,535 lekë për v.2016 dhe 19,567 mijë lekë në v. 2015, ku e gjithë kjo vlerë është kontabilizuar tek "Të tjera operacione me shtetin (debitor)", e cila në analizë në formatin nr. 2 përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen nga viti i mëparshëm si ***"Personeli e llogari të lidhura"*** (llog. 42) për 13,312,190 lekë; ***"detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa" (Llog. 431)*** për 1,638 mijë lekë si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për 5,299,372 lekë.

Në bilanc nuk janë evidentuar detyrime ndaj të tretëve për shërbime të kryera në vitin e mëparshëm.

Të dhënat në lekë

			v.2016	*v.2015*
38	**Klasa 4**	**II.Kerkesa arketimi mbi Debitoret**	**20,250,535**	**19,567,261**
39	409	Furnitorë(Debitorë),parapagime pagesa pjesore		
40	411-418	Klientë e llogari te ngjashme		
41	423.429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba		
42	431	Te drejta e taksa per t'u derdhur ne shtet		
43	432	Tatime mbledh nga shteti për llog. Pushtetit Lokal		
44	433	Shpenz. fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti		
45	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	20,250,535	19,567,261
46	435	Sigurime Shoqërore		
47	436	Sigurime Shëndetësore		
48	437,438	Organizma te tjerë shoqërore		
49	44	Institucione te tjera publike		
50	45	Marrëdhënie me instit.brenda dhe jashtë sistemit		
51	465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja let. vlere vendosjes		
52	468	Debitorë te ndryshëm		
53	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		

Burimi: Drejtoria e Financës, UFSNK

ii-c. gjendja e inventarit.

28	**Klasa 3**	**I. Gjendja e Inventarit**	**38,248,764**	**39,595,091**
29	31	Materiale		
30	32	Objekte inventari	23,292,603	23,467,072
31	33	Prodhime, punime e shërbime ne proces		
32	34	Produkte		
33	35	Mallra	14,956,161	16,128,019

- Llogarite financiare:

54	**50.59**	**III.Llogarite financiare**	**108,974,273**	**106,357,053**
55	50	Letra me vlere te vendosjes		
56	511	Vlera për tu arkëtuar		
57	512	Llogari ne banke		
58	52O	Disponibilitete ne thesar	108,974,273	106,357,053
59	531	Llogari ne arke		
60	532	Vlera te tjera		
61	54	Akreditiva dhe paradhënie		
62	56	Llogari ne organizma krediti		
63	59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlere vendosjes(-)		

Kjo shumë prej 108,974,273 lekë është e barabartë me shumën e kreditimeve të kryera gjatë vitit dhe të evidentuara në pasqyrën nr. 6 "Pasqyra e lëvizjes së fondeve 2016".

Si gjetje u konstatua:

Gjatë viteve që janë objekt auditimi, një pjesë e detyrimeve të lindura apo faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera, janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës. Vlera e detyrimit të mbetura pa u likuiduar, nuk është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Vlerat e këtyre faturave janë likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse, por janë kontabilizuar dhe janë paraqitur si detyrim dhe në të njëjtën kohë edhe si likuidim i këtij detyrimeve në llogarinë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në pasiv të bilancit.

20	Klasa 4	II.Detyrime afatshkurter	20,250,535	19,567,261
21	419	Klientë (Kreditore), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	0	0
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	13,312,190	12,805,725
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	1,638,973	1,620,048
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llog. Pusht.Lokal		
26	433	Shteti fatkeqësi natyrore		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)		
28	435	Sigurime shoqërore	5,299,372	5,106,488
29	436	Sigurime shëndetësore		
30	437.438	Organizma te tjere shoqërore		
31	44	Institucione te tjera publike		
32	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jasht sistemit		
33	460	Huadhënës		
34	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letr,vlere		
35	466	Kreditore për mjete ne ruajtje		
36	467	Kreditore te ndryshëm		35,000

Kështu, mund të përmendim:

Sa likuiduar në vitin 2016 detyrime të viti 2015 pa i paraqitur si detyrime në bilanc:

- Me urdhër-shpenzimin nr.6, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e operatorit ekonomik .[redacted] Korçë, për detyrime të muajit dhjetor 2015, në vleftën **154,900 lekë**;
- Me urdhër-shpenzimin nr.7, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet për ruajtjen dhe sigurinë fizike të objekteve të kontraktura me operatorin ekonomik [redacted], për detyrime të faturës së lëshuar me nr. 616, datë 31.12.2015, në vleftën **1,140,390 lekë**;
- Me urdhër-shpenzimin nr.8, datë 25.01.2016 janë likuiduar faturat e telefonit të ish-Kancelarit për periudhën 1-13 dhjetor 2015 në vlerën **2,420 lekë** dhe për faturat e telefonit të përdorur nga ana e Rektorit të Universitetit, në shumën **3,536 lekë** (likuiduar me Urdhër shpenzimin nr. 9, datë 25.01.2016);
- Me urdhër-shpenzimin nr.10, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e internetit për operatorin ekonomik [redacted] për detyrime të lindura me kontratën e nënshkruar dhe sipas faturës me nr. 198017358, datë 16 dhjetor 2015, në shumën **96,000 lekë**;
- Me urdhër-shpenzimin nr.14, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e operatorit ekonomik [redacted], për detyrime të faturave të lëshuara për energjinë elektrike të konsumuar gjatë muajit dhjetor 2015, (faturat e datës 15 dhjetor, 29, 30 dhe 31 dhjetor), në vleftën e përgjithshme **241,352 lekë**;

- Me urdhër-shpenzimin nr.15, datë 15.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e operatorit ekonomik [redacted] për detyrime të periudhës 1 dhjetor-31 dhjetor 2015, në vleftën **60,862 lekë**, (fatura e datës 31 dhjetor);
- Me urdhër-shpenzimin nr.12, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet postare ndaj [redacted] Korçë, për detyrime të lindura në bazë të faturës nr.1323, datë 31.12. 2015, në vleftën **7,128 lekë**, etj.

Kjo situatë është korrigjuar në pasqyrimin e detyrimeve të vitit 2016 , që janë likuiduar në vitin 2017 duke paraqitur si detyrime në bilanc: për .[redacted] energji elektrike etj, për shumën 551,761 lekë, e njëjtë me shumën pasqyruar në pasiv të bilancit, (kolona nr.32).

Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël nuk është mbështetur mbi bazën e parimit të kontabilitetit rrjedhës pra mbi **bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara** me qëllim që pasqyrat financiare të përmbushin objektivat e tyre, por vetëm në standarde të cilat aplikohen mbi bazën e parimit të kontabilitetit mbi baza monetare. Si rrjedhim efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (*ka ndodhur kur vlerat ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen*) dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera (vlerat e faturave, vendimeve gjyqësore që shlyhen në disa vite, kontratave të lidhura gjatë vitit ushtrimor me afat një vjeçar ose shume vjeçar) duhet të pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin, mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

iii. RAKORDIMET E PASQYRAVE TË BILANCIT FINANCIAR:

Auditimi u bë me të zgjedhur për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- -Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:

-***Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve*** të bilancit kontabël (formatet 1 dhe 2), në shumën 545,916,254 lekë ne v.2015 dhe 560,572,373 lekë për v.2016;
-Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 ***"Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara"*** për vlerën e tyre bruto (kolona 19), është e barabartë me 16,161,131 lekë, shumë e pasqyruar në kolonën nr.5 të formatit nr. 1 të Bilancit në zërin "Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara". Rakordon dhe vlera e paraqitur në kolonën 5 të Formatit nr.6 mbi vlerën bruto të AQT, e cila është pasqyruar për shumën bruto më 31.12.2016 për 574,526,761 lekë, vlerë kjo, që po ti zbresësh amortizimin 195,189,313 lekë të evidentuar në formatit nr.7 të deklaratave vjetore, jep vlerën neto të AQT prej 379,337,448 lekë për v. 2016, duke rakorduar me totalin e klasës së II-të, AQT.

- Auditimi në aktivin dhe pasivin e bilancit për këto formate dhe llogari:

1. Totali në *pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit* (formatet 3/1 e 3/2), në shumën 485,878,604 lekë;
2. Llogaria 63 *"Ndryshim i gjendjeve të inventarit"*, evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 584, 272 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 "Gjendja e inventarit" (kolona nr.28) në aktivin e bilancit. *Pra,* janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 1,346,327 lekë.

3. Llogaria 841 "Transferimi i ndryshimit të gjendjes" në Formatin nr. 3/2 "Të ardhura të ushtrimit", rezulton e barabartë sa llogaria 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit" në Formatin nr. 3/1 prej 1,346,327 lekë.
Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

4. Auditimi i barazisë në vlera të Formatit nr. 3/2 me Formatin nr. 3/1, si:
Formati nr. 3/2 është i barabartë me Formatin nr. 3/1 nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 441,5 milionë lekë në v.2015 dhe 485,9 milionë lekë për v. 2016.
Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

5. Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 4** "Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet":
llogaria 212 "Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara" në zërin ndërtesa (kolona nr.38, në Formatin nr. 4) janë 5,699,482 lekë më 31 dhjetor 2016 dhe nga shqyrtimi i të dhënave të pasqyruara mbi gjendjen e nën llogarisë për shtesat gjatë vitit (në formatin nr.6, kolona nr.8), këto shtesa janë të barabarta me shumën e mësipërme.
Llogaria 232 "Shpenzime për transferimet kapitale" në Formatin nr. 4, rakordon me llogarinë 232 në aktivin e bilancit, barazi me vlerën zero, pasi nuk ka asnjë ndryshim në këto zëra të aktiveve.
Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

6. Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 5,** "Pasqyra e lëvizjes (CASH)" :
Rubrika "Teprica në mbyllje të ushtrimit" tek Formati nr. 5/kolona 26, e pasqyrës së lëvizjes së CASH-it është e njëjtë me tepricën e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar", në kolonën nr.58, llogaritë financiare, në aktiv të bilancit kontabël, barazi me 108,974,273 lekë.

7. U audituan të dhënat mbi vlerat bruto të aktiveve, sa pasqyruar në aktiv të bilancit (formati nr.1) dhe gjendjen e ndryshimin e AQT në vlerën bruto, (formati nr.6), sipas periudhave dhe nuk rezultoi ndonjë parregullsi.

	AQT (kolona nr.9 + amortizimi i akumuluar nga kolona 19). *-sipas Formularit nr.1 të Pasqyrave Financiare Vjetore-*	Gjendja në fund të vitit e AQT, për vlerën e tyre bruto *-sipas Formularit nr. 6 të Pasqyrave Financiare Vjetore -*
Viti 2016	393,098,801 + 2,399,778 +195,189,313	
		590,687,892
Viti 2017	417,900,825 +2,904,016 +216,256,045	
		637,060,886

Auditimi i llogaritjes së amortizimit:
"Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara" (llog. nr. 219) është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. "Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara" për 590,687,892 lekë . Amortizimi është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 "Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit", ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji

aktual "Për tatimin mbi të ardhurat" ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur. Normat janë:

15 % për studime dhe kërkime;
1.3 % për ndërtesat dhe konstruksionet;
3% për inventarin ekonomik;
25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
5.8% për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla; dhe
13.8% për mjetet e transportit.

Bazuar në Kreun II, të UMF nr. 14, datë 18.12.20016 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe njësitë e menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj", u kryen disa testime të artikujve të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, mbi aplikimin e rregullt të amortizimit vjetor. Nga testimi i kryer, nga grupi i auditimit rezulton se shumat e llogaritura janë referuar sipas normave të miratuara.

Konstatohet se nga ana e Degës së Financës janë aplikuar normat e miratuara të amortizimit për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, dhe kuotat vjetore të amortizimit u janë ngarkuar shpenzimeve në bilancin kontabël të këtij institucioni**.**

Amortizimi i akumuluar në çelje të vitit 2016 (referuar formatit nr.7 të deklaratave financiare vjetore 2017), ishte pasqyruar për 197,589 mijë lekë, është shtuar më llogaritjen e normave vjetore dhe shtesat e tjera për 21,799 mije lekë dhe pakësuar (për nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve) prej 228,3 mijë lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2017 në shumën 219,160,061 lekë. Konstatohet se kjo vlerë është e barabartë më shumën e amortizimit të evidentuar në kolonat 7 dhe 19, përkatësisht për llogarinë nr. 209 "Amortizimi AQPT" për 2,904 mijë lekë dhe llogarinë nr. 219 "Amortizimi AQT" për 216,256 mijë lekë.

- Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat me datën **30.12.2016**, nënshkruar nga ish-kancelarja [redacted]. dhe specialistja e degës së thesarit znj. [redacted] Në këtë dokument sipas rakordimeve të kryera, është shënuar shuma e papërdorur e të ardhurave të vitit 2016 , të cilat janë trashëguar në vitin 2017 prej 16,187,156 lekë.
- Në formatin nr. 9 për **numrin e punonjësve dhe fondin e pagave** janë të pasqyruara të gjitha lëvizjet në lidhje me rekrutimin e punonjësve si dhe fondi i pagave, shpërblime të tjera dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të cilat janë të barabarta me pasqyrën 3/1 me zërin paga e shpërblime të tjera personeli (për 266,092,674 lekë)-, me kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kontributi për sigurimet shoqërore e shëndetësore për v.2017 është 38,653,693 leke dhe rakordon në dy formatet (nr.9 dhe nr.3/1).

Aspekte të veçanta për bilancin kontabël të vitit 2017

Konstatohen të njëjtat situata si në pasqyrat financiare të vitit 2016. Në këtë periudhë kontabiliteti është mbajtur sipas parimit të të drejtave të konstatuara dhe llogaritë sintetike në pasqyrat financiare përgjithësisht përputhen me ato analitike.

Edhe në fund të vitit 2017 janë mbajtur aktet e **rakordimit për të ardhurat**, nënshkruar nga Përgjegjësja e degës së Financës [redacted]. dhe Administrator znj.[redacted] dhe specialistja e degës së thesarit znj. [redacted]. Gjithashtu, është mbajtur me datën 10.01.2018 akt-rakordimi midis Administratorit znj[redacted]. dhe specialistes së degës së thesarit znj. [redacted] mbi shumën e papërdorur të të ardhurave të vitit 2017, të cilat janë trashëguar në vitin 2018 prej 66,787,442 lekë.

Të dhënat e referuara në akt rakordim për llogarinë 711 dhe 720 janë të njëjta me të dhënat e pasqyruara në bilanc.

iv. Dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare:
U audituan me zgjedhje tre katër mujorë në lidhje me dokumentacionin e bankës për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2017. Urdhër shpenzimet janë shoqëruar me dokumentacionin justifikues, janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara nga dega e thesarit. Në ditarin e bankës të çdo muaji ishin kryer artikujt kontabël të mbylljes, ku ishin prerë fletë kontabilizimet e brendshme për pagesat e bankës, konformë ligjit mbi kontabilitetin.
U auditua likuidimi nga banka i detyrimeve UFSNK ndaj Postës, Telekomit, Ujësjellësit dhe OSHEE-së nga ku rezultoi se këto pagesa kishin bashkangjitur faturën përkatëse për likuidimet e kryera për faturat dhe kontratat e nënshkruara, por duhet të nënshkruhen nga një punonjës i caktuar duke kryer kështu dhe rakordimet për shumën e faturuar.
Dokumentacioni është regjistruar në mënyre kronologjike. Mbajtja e regjistrimeve kronologjike është kryer nëpërmjet ditarëve të arkës, bankës, ditari i magazinës, etj. Është bërë rakordimi i vazhdueshëm me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Ditarët ishin regjistruar në centralizator ku dhe kanë rezultuar shifrat që janë hedhur në bilance.
U audituan veprimet e mbylljes së bilancit për vitin 2016 e 2017 dhe në përgjithësi është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël" si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, në programin Excel, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse. Veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, i ndryshuar.

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.
U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për 6 mujorin e parë 2016 dhe 6 mujori i dytë i vitit 2017. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar. Çdo fletë dalje është e pajisur me urdhër dorëzimi ose me plan shpërndarje përkatëse, të nënshkruar nga ana e Drejtorit Ekonomik z.[redacted].. Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.
Për periudhën e kohës objekt auditimi, njësia shpenzuese ka kryer rregullisht regjistrimin dhe dokumentimin e veprimeve kontabile në ***ditarin e bankës***, dhe ka transferuar shumat e ditarëve në pasqyrat e bilancit të vitit 2016 dhe 2017. Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Dokumentacioni është kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe sistematike në ditarin e bankës. Urdhër shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Konfermat e bankës janë kuadruar për çdo muaj dhe janë nënshkruar e vulosur nga Dega e Thesarit Korçë.

V. REGJISTRIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME TË UNIVERSITETI NE ZVRPP

Nga ana e UFSNK, për periudhën nga viti 2012 e në vijim, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurve të paluajtshme të Universitetit, janë kryer këto praktika sipas institucioneve përgjegjëse, si më poshtë vijon:

I. Nga ana e ish-rektorit të universitetit, [redacted]., me shkresën nr. 7/7 prot, datë 20.03.2012**,** i është kërkuar MASH (Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit) si dhe për dijeni Ministrisë së Brendshme (Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike), me objekt "Kërkesë për inventarizimin dhe transferimin e pronave të universitetit "F.S.Noli" Korçë". Në bazë të kësaj kërkesë kërkohet aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit. Nuk ka asnjë përgjigje në dosje për këtë kërkesë.

II. Nga ana e ish-rektorit të universitetit, z[redacted]., me shkresën nr. 7/20 prot, datë 06.11.2012, i është kërkuar MASH (Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit), me objekt "Kujtesë për inventarizimin dhe transferimin e pronave të universitetit "F.S.Noli" Korçë", ku ndër të tjerë është kërkuar te merret në shqyrtim për miratim lista e pronave sipas formularit tip nr.1. Bashkëlidhur ësaj kërkese janë dërguar dhe lista e inventarit më 13 pronat e pretenduara nga ana e UFSNK si për ndërtesat, trojet, rrugët, në bazë të zonave kadastrale respektive. Nuk ka asnjë përgjigje në dosje për këtë kërkesë.

III. Nga ana e ish-rektorit të universitetit, z. [redacted]., me shkresën nr. 7/20 prot, datë 06.11.2012, i është kërkuar MAS (Drejtorisë së Shërbimeve Juridike) dhe për dijeni Ministrisë së Punëve të Brendshme (Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike", me objekt "Kërkesë për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme të Universitetit "F.S.Noli" Korçë", ku ndër të tjerë është kërkuar te merret në shqyrtim për miratim lista e pronave sipas formularit tip nr.1. Bashkëlidhur kësaj kërkese është ridërguar dhe lista e inventarit më 13 pronat e pretenduara nga ana e UFSNK si për ndërtesat, trojet, rrugët, në bazë të zonave kadastrale respektive. Nuk ka asnjë përgjigje në dosje për këtë kërkesë.

IV. Me shkresën nr. 6153/3 prot, datë 31.08.2016, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për përfundimet e misionit të auditimit , nënshkruar nga ministrja [redacted]., në pikën nr.1 është lënë rekomandim që, UFSNK në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës pranë MAS të ndjekë procedurat për regjistrimin e pronave të universitet pranë ZVRPP.

Konstatim:

Ndonëse nga ana e Universitetit është zbatuar detyrimi i pikës nr.10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, meqenëse është përgatitur dhe dërguar në AITPP i inventarit të pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, ende nga kjo e fundit nuk është përgatitur lista e inventarit për t'iu dërguar për miratim Këshillit të Ministrave.

Auditimi konstaton se thjeshtë janë dërguar akte administrative shkresore nga UFSNK drejtë Ministrisë dhe anasjelltas, por pa finalizuar këtë proces me miratimin e listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP. Konstatohet se ka mosveprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji**.**

***Sa më sipër*, në kushtet që nga ana e UFSNK nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme":**

- Nenit 2 , pika 10, që përcakton se: **"Pasuri e paluajtshme"** është toka, burimet ujore, ndërtesat, objektet dhe çdo gjë tjetër e paluajtshme, sipas përcaktimit të Kodit Civil.
- Nenit 24, "**Regjistrimi fillestar"**, "Regjistrimi fillestar i çdo pasurie të paluajtshme përfshin pasqyrimin e saj në hartën kadastrale dhe përgatitjen e një kartele, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti, që përcakton pronësinë ose të drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme."
- Nenit 45/1, "**Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ"**, "në rastet kur shteti, personi juridik/fizik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin juridik/fizik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë."
- Nenit 46/1, "**Regjistrimi i lejes së ndërtimit"**, "Leja e ndërtimit dhe/ose leja e zhvillimit, e lëshuar nga autoriteti përgjegjës, përcillet për regjistrim nga organet e pushtetit vendor në zyrën përkatëse vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Regjistruesi bën regjistrimin e lejes së ndërtimit në një regjistër të veçantë, të ndryshëm nga ai ku është kryer regjistrimi i truallit, por duke kryer lidhjen me truallin, i cili përbën sheshin e ndërtimit, për të cilin është lëshuar leja e ndërtimit.

Konstatim:

Pronat e Universitetit të Korçës, në vlerën 333,639 mijë lekë, (të tilla sipas pasqyrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2017, për zërin "ndërtesa", në vlerën 316,4 milionë lekë; "rrugë, rrjete e vepra ujore" në vlerën 16,7 milionë lekë, si dhe zëri "toka, troje e terrene" në vlerën 576 mijë lekë), nuk janë të regjistruara në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe për to nuk zotërohet certifikatë pronësie. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.

Rekomandim:

1. Administratori i Universitetit, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.
2. Të ri-aplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017, duke përfshirë dhe efektet e situacionit prej 46,748 mijë lekë që

reflekton vlerën e rikonstruksionit të objektit "Konvikti i shkollës mekanike", nën administrim të UFSNK), për të cilin nuk janë kryer procedurat e transferimit dhe pasqyrimit në AQT, në zërin "Ndërtesa" për UFSNK.

VI. INVENTARIZIMI I PRONËS SHTETËRORE, VLERËSIMI, NXJERRJET JASHTË PËRDORIMIT DHE ASGJESIMI I AKTIVEVE:

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyre të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustifikuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2015-2018. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Inventarizimi i v.2015:
Gjatë periudhës janar-prill 2015 kanë dalë tre urdhra të ish-rektorit të Universitetit, të lidhura me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të Universitetit, si vijon:

- me urdhrin nr. 35, datë 23.02.2015, të ish-rektorit [redacted]., është *ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve*", i përbërë nga [redacted]. [redacted]., [redacted] dhe [redacted].. Këtij komisioni i janë atashuar dhe personat e ngarkuar për inventarizimin pranë çdo fakulteti.
- me urdhrin nr.65, datë 26.03.2015, të ish-rektorit [redacted] është *ngritur Komisioni i vlerësimit të aktiveve afatgjata e afatshkurtra materiale për dalje jashtë përdorimit*", i përbërë nga [redacted]..
- [redacted]me urdhrin nr. 79. prot, datë 17.4.2015, është *ngritur Komisioni për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit*, i përbërë nga [redacted]

Të tre këto urdhra mbajnë si referencë ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventaret e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile.
Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me datën 28 shkurt 2015 nga Komisioni i inventarizimit është hartuar procesverbali i titullar "***procesverbal për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale",*** ku në kuadër të inventarizimi dhe vlerësimit të aktiveve, pas vlerësimit në vend në ambientet e rektoratit apo fakulteteve ka konkluduar se janë jashtë përdorimit, dhe *<u>në kolonën "vërejtje", janë vënë shënimet "amortizuar", konsumuar", "dhuruar", djegur", "thyer", etj</u>*
- Me datën 30 mars 2015, Komisioni i ngarkuar për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit ka hartuar ***"procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale"***, e ndarë në aktive afatgjata materiale dhe inventarit ekonomik . Në këtë procesverbal, tek *<u>kolona "kriteri për vlerësim", është vënë shënimi "të papërdorshëm" dhe tek kolona "vlerësimi" është vënën shënimi "**të asgjësohet" për të gjithë artikujt**</u>***.** Ky procesverbal është nënshkruar si nga personat materialisht përgjegjës të inventarit, ashtu dhe nga anëtarët e komisionit si dhe është miratuar nga ish-rektori [redacted].
- Me vendimin e **Këshillit të Administrimit nr. 3, datë 17.4.2015** është dhënë ***miratimi paraprak*** për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe

vlerësuara nga komisioni i vlerësimit, sipas procesverbaleve që i janë bashkëlidhur atij vendimi

- Procesverbali i asgjësimit të artikujve më sipër, është mbajtur me datën 20.04.2015 të artikujve, ndarë në aktive afatgjata materiale dhe inventar ekonomik, sipas listës së propozuar nga komisioni i inventarizimit të aktiveve dhe komisioni i vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit. Procesverbali është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, të ngarkuar me asgjësimin e vlerave materiale të nxjerra jashtë përdorimit.

Konstatime:

1. Në procesverbalin e mbajtur me datën 28.02.2015, për inventarizimin e vlerave materiale në dy institucione, për 5 raste dhe me vlerën 37 mijë lekë, (përkatësisht në zyrat e Rektoratit dhe të FEF), konstatohet se komisioni ka vënë shënimin se ka materiale të cilat tërhiqen nga titullarët dhe dhurohen në raste vizitash apo aktivitete të përfaqësuesve të huaj dhe propozohen për jashtë përdorimi. *Më hollësisht:*

- **Në zyrat e Rektoratit,** konstatohet se komisioni ka vënë shënimin se ka materiale të cilat tërhiqen nga titullarët dhe dhurohen në raste vizitash apo aktivitete të përfaqësuesve të huaj dhe propozohen për jashtë përdorimit, respektivisht artikujt me nr.7, 8 dhe 21 si vijon:

Llogaria 32:

Nr.rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	çmimi	vlera	Personi përgjegjës	**vërejtje**
7	Kornizë	copë	1	3,000	3,000	[redacted]	**Dhuruar**
8	Pjatë argjendi	"	1	5,000	5,000	"	**Dhurur**
21	Pjatë argjendi	"	1	6,000	6,000	"	**Dhuruar**

Në procesverbalin e komisionit të vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit, datë 30.3.2015 është ky trajtim:

Nr.rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	vlera	**kriteri**	**vlerësimi**	Personi përgjegjës
7	Kornizë	copë	1	3,000	**I papërdorshëm**	**Të asgjësohet**	[redacted]
8	Pjatë argjendi	"	1	5,000	**I papërdorshëm**	**Të asgjësohet**	"
21	Pjatë argjendi	"	1	6,000	**I papërdorshëm**	**Të asgjësohet**	"

Nga shqyrtimi i procesverbaleve te mbajtura nga komisioni i asgjësimit, datë 20.4.2015, për këto artikuj të përshirë në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit, vlerë e cila është reflektuar si e tillë në kontabilitet, (shumë e tyre është në përmbledhësen e artikujve të nxjerrë jashtë përdorimit), tek destinacioni është vënë shënimi "dhuruar"....

Nr.rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	çmimi	vlera	**Destinacioni**
7	Kornizë	Cope	1	3,000	3,000	**Dhuruar**
8	Pjatë argjendi	"	1	5,000	5,000	**Dhurur**
21	Pjatë argjendi	"	1	6,000	6,000	**Dhuruar**

- **E njëjta situatë paraqitet dhe sipas procesverbalit të mbajtur me 28.2.2015 në Fakultetin e Edukimit, ku për artikujt e numëruar me nr. 5 dhe 7, në inventar të Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, nga komisioni i inventarizimit është vënë shënimi dhuruar dhe propozohen për dalje jashtë përdorimit:**

Llogaria 32:

Nr.rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	cmimi	vlera	**Destinacioni**

5	Pjatë argjendi	"	3	6,000	18,000	**Dhurur**
7	Pjatë argjendi	"	1	5,000	5,000	**Dhuruar**

2. Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 shkurt 2015 në Fakultetin e Edukimit, në llogarinë 32, midis të tjerash janë **7 artikuj sportiv (artikujt e numëruar me nr. 8 deri 14 në procesverbal), në vlerën 94,590 lekë, në ngarkim të znj. Mariana Burda,** është vënë shënimi "***dhuruar"*** dhe propozohen "***për dalje jashtë përdorimi***". Më hollësisht:
Llogaria 32:

Nr. rendor	Emertimi	njësia	çmimi	Sasia	vlera	**Destinacioni**
8	Litar gjimnastike	"	250	3	750	**Dhuruar**
9	Flamur me hark	"	384	10	3,840	**Dhuruar**
10	Çanta	"	2500	10	25,000	**Dhuruar**
11	Veshje sportive	"	3000	10	30,000	**Dhuruar**
12	Raketa tenisi	"	1200	10	12,000	**Dhuruar**
13	Top tenisi	"	400	20	8,000	**Dhuruar**
14	Top futbolli	"	1500	10	15,000	**Dhuruar**
	Shuma				**94,590**	

3. Në listën e artikujve të propozuar nga Komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit rezultojnë artikuj dhe vlera materiale (artikuj magazine), të nxjerra jashtë përdorimit në sasi dhe vlerë të konsiderueshme, për të cilat nuk është kryer asnjë analizë dhe nxjerrje përgjegjësie, *si vijon:*
Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 shkurt 2015 në Magazinën e institucionit, në llogarinë 35, midis të tjerash janë **18 artikuj që përfshijnë 86 copë bojëra printerësh dhe fotokopjesh, në vlerën 471,082 lekë, në ngarkim të znj.** [redacted] të propozuara për ti nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto bojëra janë *"tharë"*. **Mungon analiza e hollësishme mbi vitin e blerjes, sasitë e prokuruara dhe arsyet e mospërdorimit që kanë sjellë këtë situatë të keq menaxhimit të këtyre aktiveve materiale.** *Më hollësisht:*

Nr.	**Emertimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Sasia**	**Vlera**	**Vërejtje**
10	Bojë printer color	copë	5,500	1	5,500	**Tharë**
13	Bojë fotokopje sharp	copë	6,180	11	67,980	"
14	" printer HP 3325	"	1,500	4	6,000	"
15	" " HP 710	"	2,000	6	12,000	"
16	" Epson C 900	"	19,020	3	57,060	"
17	" HP laserjet1100A	"	5,000	5	25,000	"
18	" HP 1410 color	"	2,401	1	2,401	"
19	Bojë print Epson C900	"	7,160	2	14,320	"
20	Bojë print Epson C901	"	12,040	2	24,080	"
21	Bojë print HP deskjet	"	2,260	9	20,340	"
22	Bojë print HP deskjet	"	3,730	2	7,460	"
23	Bojë HP office jet 7100	"	2,330	3	6,990	"
24	Bojë HP office jet 7101	"	2,810	3	8,430	"
25	Bojë print HP1200	"	4,040	5	20,200	"
26	Bojë print Canon LBP	"	6,371	1	6,371	"
27	Bojë print office jet 1410	"	1,830	13	23,790	"
28	Bojë print 1200 col	"	4,040	4	16,160	"
29	Bojë Epson acual C900	"	7,080	4	28,320	"
30	Bojë Epson acual C901	"	19,780	6	118,680	"
	Përmbledhje	***copë***	***Xxx***	***86 cope***	**471,082 lekë**	

4. Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 shkurt 2015 në mjediset e Rektoratit, në llogarinë 218, artikulli me nr. rendor 2, në kolonën e emërtimit është vënë **"Instalim fizik konfigurimi", në vlerën 696,000 lekë, dhe propozuar për t'u nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin *"punë, projekt"*. Nuk ka në këto procesverbale asnjë shpjegim dhe arsyetim tjetër, se çfarë përfshin ky zë dhe cilat janë arsyet e fshirjes së tij nga kontabiliteti, viti i krijimit, historiku, kontabilizimi etj.**
Nga sqarimi me punonjësin e Drejtorisë së Financës, rezulton se kjo vlerë është puna e shpenzuar për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit, vlerë e cila i është ngarkuar me fletëdaljen nr. 7, pa datë, nënshkruar nga magazinieri dhe z[redacted]
Nga shqyrtimi i procesverbalit për vlerësimin (28.2.2015) i përbërë nga [redacted] është propozuar **"nxjerrja jashtë përdorimit" nga llogaria nr.218 me shënimin "punë/projekt"** . Me datën 20 prill 2015, në kuadër të artikujve të nxjerrë jashtë përdorimit është përfshirë dhe artikulli "instalim fizik konfigurimi" , në shumën 696,000 lekë, nënshkruar nga [redacted]., ku në kolonën e destinacionit është vënë shënimi **"u groposën".**

5. Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 shkurt 2015 në magazinën e institucionit, në llogarinë 214, midis të tjerash janë **disa kompjuterë, printerë, projektorë dhe fotokopje,** të propozuara për ti nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto janë prishur, por pa dhënë hollësi. *Më konkretisht:*

Nr.	**Emërtimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Sasia**	**Vlera**	**Vërejtje**
Llog 214, **Rektorati,** nr.1	Kompjuter komplet,	copë	65,000	1	65,000	Djegur mother boardi
5	Kompjuter HPMNMN	"	105,000	1	105,000	prishur
15	Kompjuter komplet	"	79,261	1	79,261	prishur
24	Desktop kompjuter	"	9,900	15	148,500	prishur
25	Kompjuter i vjetër	"	125,000	1	125,000	prishur
FEF		"				
23	Projektor	"	64,500	1	64,500	djegur

Inventarizimi i v.2016:
Gjatë periudhës janar-prill 2016 kanë dalë tre urdhra të ish-rektorit të Universitetit, të lidhura me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të Universitetit, si vijon:

- me urdhrin nr. 9, datë 12.01.2016, të ish-rektorit [redacted]., është *ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve*", i përbërë nga [redacted] Këtij komisioni i janë atashuar dhe personat e ngarkur për inventarizimin pranë çdo fakulteti.
- me urdhrin nr. 58 prot, datë 15.4.2016, të ish-rektorit [redacted] është *ngritur Komisioni për vlerësimin e aktiveve*.
- me urdhrin nr. 65, datë 29.03.2016, të ish-rektorit [redacted] është *ngritur Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit*", i përbërë nga [redacted]

Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike

të mallrave e materialeve dhe ato kontabile. Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me datën 28 shkurt 2016 është hartuar procesverbali për inventarizimin e aktiveve dhe vlerave materiale.
- Me datën 1 prill 2016 është hartuar procesverbali për asgjësimin e vlerave materiale të nxjerra jashtë përdorimit, që për gjithë fakultetet, rektoratin dhe magazinën në shumën 5,425,479 lekë, e ndarë në materiale dhe inventarit ekonomik (llogaritë 32, 35, 202, 212, 213, 214 dhe 218.
- Me vendimin e Këshillit të Administrimit nr.3, datë 29.03.2016 është dhënë miratimi paraprak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisioni i vlerësimit sipas procesverbaleve që i janë bashkëlidhur atij vendimi.

Konstatime:
Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 shkurt 2016 në Magazinën e institucionit, në llogarinë 35, midis të tjerash janë **15 artikuj që përfshijnë 132 copë bojëra printerësh dhe fotokopjesh dhe tonerë printerësh e fotokopjesh, në vlerën 634,565 lekë, në ngarkim të administratores së magazinës, [redacted]** të propozuara për ti nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto bojëra janë *"tharë"*. **Mungon analiza e hollësishme mbi vitin e blerjes, sasitë e prokuruara dhe arsyet e mospërdorimit që kanë sjellë këtë situatë të keq menaxhimit të këtyre aktiveve materiale.** *Më hollësisht:*

Nr.	Emertimi	Njësia	Çmimi	Sasia	Vlera	Vërejtje
10	Toner fotokopje sharp	copë	4,110	16	65,760	**Tharë**
11	toner printer epson	"	1190	2	2,380	"
12	" " lex E 250 D	"	7350	21	154,350	"
14	" " fotokopje Sharp 5320	"	6350	1	6,350	"
15	" " fotokopje Sharp 5420	"	4235	2	8,470	"
16	Bojë epson D78	"	1260	4	5,040	"
17	Bojë HP officejet 1410	"	1540	18	27,720	"
18	Bojë HP officejet 1410	"	1830	1	1,830	"
19	Bojë fotokopje samsung 4100	"	9800	3	28,400	"
20	Bojë fotokopje sharp	"	4235	34	143,990	"
21	Bojë fotokopje 5320	"	6350	23	146,050	"
22	Bojë printer HP 1005	"	7410	2	14,820	"
25	Bojë printer 1410 color	"	1540	1	1,540	"
26	Bojë printer 1410 black	"	1945	1	1,945	"
27	Bojë fotokopje sharp 5816	"	6840	3	25,920	"
	Përmbledhje	***copë***		***132***	***634,565***	

Sipas procesverbalit të mbajtur me datën 01.04.2016 këto artikuj janë groposur.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e administratores së Magazinave [redacted] këto artikuj janë blerë dhe bërë hyrje gjatë viteve 2010 dhe 2011.

Referuar procesverbalit të mbajtur për asgjësimin e vlerave materiale, me datën 1 prill 2016, në llogarinë 213,214, midis të tjerash janë **disa kompjuterë, printera, projektorë dhe fotokopje,** të nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto janë prishur, dhe te groposur, por **pa dhënë asnjë shpjegim mbi vitin e prodhimit/ blerjes, mbi faktin nëse mund të riparohen, çfarë është dëmtuar, etj**. *Më konkretisht:*

Nr.	Emërtimi	Njësia	Çmimi	Sasia	Vlera	Personi përgjegjës	Vërejtje
Llog 213, **nr.1**	Laptop 15' HP 620	Copë	75,409	1	75,409	[redacted]	Prishur/u gropos
Llog 214, **nr.7**	Lap top	"	73,000	1	73,000		Gropos
Llog 218, **nr.4**	Kompjuter	"	205,306	1	205,306		Gropos
Llog 218, **nr.7**	Kompjuter PC 84	"	99,300	1	99,300		Gropos
Llog 218, **nr.8**	Kompjuter tunsim 62904	"	150,000	1	150,000		Gropos
Llog 218, **nr.9**	Video projektor	"	67,000	1	67,000		Gropos
Llog 214, **nr.14**	Laptop HP 620	"	75,409.2	1	75,409.2	Kthim [redacted]	Gropos

Nga shqyrtimi i relacionit të hartuar nga ana e komisionit të inventarizimit, të datës 11 mars 2016, rezulton se pas inventarizimit të aktiveve në përdorim, për dy ish-punonjës të UFSNK, paraqitet kjo situatë:

- Në fakultetin e Shkencave të Natyrës, në ngarkim të **z[redacted] ka kaluar një laptop me vlerë 98,462 lekë. Punonjësi është larguar**.
- Në fakultetin Ekonomik, në ngarkim të **znj. [redacted]. ka kaluar një laptop me vlerë 75,410 lekë. Punonjësi është larguar.**

Me vendimin e Këshillit të Administrimit nr.3, datë 29.03.2016 , (ose tre ditë para asgjësimit dhe mbajtjes së procesverbalit nga ana e Komisionit të Vlerësimit), është dhënë miratimi paraprak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisioni i vlerësimit.

Nga auditimi i kryer pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezulton se, në dosjet e personelit të personave të sipërcituar mungon procesverbali i dorëzimit të detyrës, bazës materiale e inventarit ne dorëzim.

✓ Bazuar në procesverbalin e datës 20.10.2015 dhe Urdhrin e Rektorit me nr.164, datë 30.10.2015, një komision ka hapur zyrën dhe inventarizuar artikujt e inventarit, për të cilat ka mbajtur dhe procesverbalin. Sipas procesverbalit të datës 20.10.2015, rezultojnë se mungojnë artikujt laptop dhe flash 8 Gb.

✓ Sipas një procesverbali që ka mbajtur Komisioni i Vlerësimit, (nënshkruar nga [redacted]), me datën **1 prill 2016, pajisja laptop 15 HP 620 i dorëzuar nga znj. [redacted]., është i dëmtuar fizikisht dhe jashtë funksionit** dhe sugjerohet dalja jashtë përdorimi.

✓ **Sipas shkresës së datës 26.04.2016, të nënshkruar nga Përgjegjësi i IT, z.[redacted]. dhe drejtuar kancelarit z.Ilir Sosoli, është evidentuar dorëzimi i laptopit të pedagoges znj.[redacted]., me datën 26.4.2016.**

✓ Nga shqyrtimi i procesverbaleve të asgjësimit, konstatohet se,

1. Me datën **1 prill 2016**, kompjuteri laptop 15" HP 620 ([redacted] me vlerën 75,409 lekë është asgjësuar (groposur),
2. Me datën **17 prill 2017**, kompjuteri laptop 15" HP 620 ([redacted].), me vlerën 75,409 lekë është asgjësuar (groposur),

Të intervistuar nga ana e grupit të auditimit, [redacted] pranojnë së kanë nënshkruar procesverbalin për dalje jashtë por ky laptop **është asgjësuar në vitin 2017** (!!!) **Ky laptop nuk është përfshirë në procesverbalin e Komisionit të Vlerësimit për jashtë përdorimi, dhe procedurat e nënshkruara nga komisioni i asgjësimit për këtë artikull janë procedura fiktive dhe jorealiste, gjë që i ngarkon këtë komisionin e asgjësimit të vitit 2016 me përgjegjësi.**

Nga ana tjetër, nuk është kthyer dhe bërë hyrje në UFSNK nga ana e z[redacted]. **një laptop me vlerë 98,462 lekë.**

Rekomandimi:1.

1. **Në përputhje me përcaktimet e paragrafit nr.93, të Kreut IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", të Udhëzimit të MF me nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, sipas të cilit,** *"Nëpunësi autorizues i njësisë jep* ***urdhër zhdëmtimin për mungesat e konstatuara*** *në ngarkim të personave me përgjegjësi materiale. Nëpunësi Zbatues ndjek procesin dhe kryen regjistrimet kontabël përfundimtarë",* **të hartohen urdhrat për mangësitë në vlerat e inventarit për [redacted] duke njoftuar zyrtarisht personat <u>përgjegjës debitor për këtë detyrim në shumën 98,462 lekë.</u>**
   Afati: menjëherë

2. **Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Universitetit, të marrin masa që të mos bëjnë shkëputjen e marrëdhënieve administrative dhe të marren masat për njoftimin e debitorit me qëllim kthimin dhe dorëzimin e inventarit ekonomik/ lap top 15" Asus, me vlerë 98,462 lekë, që ka në ngarkim z.[redacted]**
   Afati: në vazhdimësi

Nga shqyrtimi i procesverbaleve te mbajtura nga komisioni i asgjësimit, datë 01.04.2016, për këto artikuj të përshirë në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit, vlerë e cila është reflektuar si e tillë në kontabilitet, tek destinacioni është vënë shënimi "dhuruar"....

Nr. rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	çmimi	vlera	**Destinacioni**
95	Pjatë argjendi	"	3	5,000	15,000	**Dhuruar**

<u>Inventarizimi i v.2017:</u>

Gjatë periudhës janar- prill. 2017 janë kryer procedurat e inventarizimit të pasurisë së UFSNK. Për këtë kanë dalë tre urdhra të ish-Kancelarit të Universitetit, znj.[redacted] të lidhura me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të Universitetit, si vijon:

- me urdhrin nr. 22, datë 26.01.2017, është *ngritur "Komisioni i Inventarizimi*", i përbërë nga [redacted]. Këtij komisioni i janë atashuar dhe personat e ngarkuar për inventarizimin pranë çdo fakulteti.
- me urdhrin nr. 52/1, datë 7.04.2017, është *ngritur "Komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit*", i përbërë nga [redacted] dhe [redacted]
[redacted] me urdhrin nr. 55/1 prot, datë 14.4.2017, të ish-Kancelarit [redacted]., është *ngritur Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit"*, me këtë përbërje: [redacted]

Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile.
Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me datën 28.3.2017 është hartuar procesverbali për inventarizimin e aktiveve.
- Me datën 10.4.2017 është hartuar procesverbali për vlerësimin e aktiveve të propozuara për ti nxjerrë jashtë përdorimit.
- Procesverbali i asgjësimit të artikujve më sipër, është mbajtur me datën 17.4.2017

Nga shqyrtimi i procesverbaleve te mbajtura nga komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit, datë 28.03.2017, për këto artikuj të përshirë në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit, vlerë e cila është reflektuar si e tillë në kontabilitet, tek destinacioni është vënë shënimi "dhuruar"....

Nr. rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	çmimi	vlera	**Destinacioni**
59	Pjatë argjendi, Gj.Mero	"	1	5,000	5,000	**Dhuruar**

Referuar procesverbalit të mbajtur për inventarizimin me datën 26.1.2017 dhe asgjësimin e vlerave materiale, me datën 28 mars 2017, në llogarinë 213,214, midis të tjerash janë **disa kompjuterë, printerë, projektorë dhe fotokopje,** të nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto janë prishur, dhe te groposur, por **pa dhënë asnjë shpjegim mbi vitin e prodhimit/ blerjes (të cilat u nxorën dhe përpunuan me kërkesën e grupit të auditimit), mbi faktin nëse mund të riparohen, çfarë është dëmtuar, etj**. *Më konkretisht:*

Nr.	**Emërtimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Sasia**	**Vlera**	**Viti blerjes**	**Personi përgjegjës**	**Vërejtje**
Llog 214, **nr.5**	Kompjuter pentium	Copë	24,500	**10**	**245,000**	2010	Laboratori informatikës	Prishur/u gropos
Llog 214, **nr.99**	**Lap top**	**"**	**78,000**	**1**	**78,000**	**2011**	[redacted]	**Prishur/ Gropos**
Llog 214, **nr.11**	Lap top	"	160,000	1	160,000	2008	Kthyer nga [redacted]	Prishur/ Gropos
Llog 214, **nr.12**	Fax	"	120,000	1	120,000	2009	" "	Prishur/ Gropos
Llog 214, **nr.13**	Kompjuter 4 core 1600	"	74,143	1	74,143	2009	[redacted].	Prishur/ Gropos
Llog 218, **nr.1**	Kompjuter HP 500	"	57,000	1	57,000	2013	[redacted]	"
Llog 218, **nr.7**	**Lap top**	**"**	**139,000**	**1**	**139,000**	**2013**	[redacted]	**"**
Llog 218, **nr.9**	**Kompjuter Lenovo**	**"**	**117,600**	**1**	**17,600**	**2013**	**Kthyer** [redacted]	**"**
Llog 218, **nr.10**	Kompjuter komplet	"	74,143	1	74,143	2008	[redacted]	"
Llog 218, **nr.13**	Desktop Kompjuter	"	96,408	1	96,408	2004	Kthyr [redacted]	"
Llog 213, **nr.4**	**Lap top15' HP 620**	**"**	**75,409**	**1**	**75,409**	**2011**	[redacted]	**thyer**
Llog 214, **nr.4**	Kompjuter	"	120,000	1	120,000	2011	[redacted].	prishur
Llog 214,	Printer	"	24,000	1	24,000	2003	[redacted]	prishur

nr.2							[redacted]	
		"						

Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 mars 2017 në Magazinën e institucionit, në llogarinë 35, midis të tjerash janë **8 artikuj që përfshijnë <u>54 copë bojëra printerash dhe fotokopjesh dhe tonerë printerësh e fotokopjesh, në vlerën 265,844 lekë</u>, në ngarkim të administratores së magazinës, znj.**[redacted] të propozuara për ti nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto bojëra janë *"tharë"*. **Mungon analiza e hollësishme mbi vitin e blerjes, sasitë e prokuruara dhe arsyet e mospërdorimit që kanë sjellë këtë situatë të keq menaxhimit të këtyre aktiveve materiale.** *Më hollësisht:*

Nr.	Emërtimi	Njësia	Çmimi	Sasia	Vlera	Viti blerjes	Vërejtje
10	Toner Epson EPL6200	Copë	7500	10	75,000	2010	**Tharë**
11	" Lex E 260	"	5320	11	57,529	2010	"
12	" printer Lex E 250	"	8110	10	81,100	2010	"
14	" " printer Sharp 5317	"	4250	9	38,250	2011	"
15	" " printer epson D78	"	1265	9	38250	2011	"
16	" printer 7100 black	"	2472	3	7,416	2011	"
17	" printer officejet 7100	"	3120	1	3,120	**2012**	"
18	" printer officejet 7100	"	3384	1	3,384	**2012**	"
	Përmbledhje	***copë***		***54***	***265,844***		

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e administratores së Magazinave znj. [redacted] ***këto artikuj janë blerë dhe bërë hyrje gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2014.***

Konstatimi:

- Grupi i auditimi konstaton se, për daljet jashtë përdorimit të aktiveve dhe vlerave të inventarit për vitin 2017, në shumën **4,873,048 lekë nuk ka një miratim nga ana e Bordit të Administrimit, për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisioni i vlerësimit** sipas procesverbaleve që janë hartuar nga ana e komisioneve respektive. Në asnjë nga vendimet dhe mbledhjet e Bordit të Administrimit të kryera gjatë vitit 2017 nuk është trajtuar kjo çështje. Sa sipër, është vepruar në shkelje të përcaktimeve të UMF nr.30, 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- **Procesverbalet e vlerësimin nuk janë miratuar nga titullari i njësisë publike UFSNK**, në shkelje të përcaktimeve të paragrafit nr. 105, kreu IV të Udhëzimit të MF me nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, që përcakton se, "Procesverbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali **miratohet nga titullari i njësisë publike**", **dhe për mos miratimin ngarkohet me përgjegjësi ish-Kancelari znj**[redacted] **dhe Nëpunësi Zbatues znj.**[redacted]
- Mungon relacioni mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, **arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës**. Ky relacioni hartohet në tre kopje dhe sipas cilësimeve të pikës nr.106 të UMF nr.30/2011, i ndryshuar, duhej hartuar dhe nënshkruar nga kryetari i komisionit të vlerësimit, prandaj **ngarkohet me përgjegjësi Nëpunësi Zbatues znj**[redacted]

Inventarizimi i v.2018:

Gjatë periudhës janar-mars 2018 kanë dalë tre urdhra të Administratorit të Universitetit, znj.[redacted] të lidhura me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të Universitetit, si vijon:

- me urdhrin nr. 10, datë 12.01.2018, është *ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveveve*", i përbërë nga [redacted].. Këtij komisioni i janë atashuar dhe personat e ngarkuar për inventarizimin pranë çdo fakulteti.
- [redacted]me urdhrin nr. 160, datë 21.02.2018, është *ngritur Komisioni i vlerësimit të aktiveve afatgjata e afatshkurtra për dalje jashtë përdorimit*", i përbërë nga [redacted]

Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile.

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me datën 23.02.2018 është hartuar procesverbali për inventarizimin e aktiveve dhe vlerave materiale në magazinë.
- Me datën 26.02.2018. është hartuar procesverbali për nxjerrjen jashtë përdorimit të artikujve sipas llogarive 212, 204, 218,32 etj, ndarë në materiale dhe inventar ekonomik.
- Me vendimin e Bordit të Administrimit nr. 188, datë 26.02.2018, (bazuar në kërkesën e administratorit me nr. 396 prot, datë 26.02.2018), është dhënë miratimi paraprak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisioni i vlerësimit sipas procesverbaleve që i janë bashkëlidhur atij vendimi.

Nga shqyrtimi i procesverbaleve te mbajtura nga komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit, datë 23 shkurt 2018 në ambientet e Rektoratit, për këto artikuj të përshirë në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit, vlerë e cila është reflektuar si e tillë në kontabilitet, tek destinacioni është vënë shënimi "dhuruar".

Nr.rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	çmimi	vlera	Personi përgjegjës	Destinacioni
40	Medalje ari,	"	1	14,000	14,000	[redacted]	**Dhuruar**
41	Medalje ari,	"	5	14,000	70,000	[redacted]	**Dhuruar**
42	Pjatë e larë në argjend	"	9	5,000	45,000	[redacted]	**Dhuruar**

Referuar procesverbalit të mbajtur për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, me datën 23 Shkurt 2018, në llogarinë 218, 213, 214,etj., midis të tjerash janë **disa kompjuterë, printerë, projektorë dhe fotokopje,** të nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin se këto janë prishur, dhe te groposur, por **pa dhënë asnjë shpjegim mbi vitin e prodhimit/ blerjes (të cilat u nxorën dhe përpunuan me kërkesën e grupit të auditimit), mbi faktin nëse mund të riparohen, çfarë është dëmtuar, etj**. *Më konkretisht:*

Nr.	**Emertimi**	**Njësia**	**Cmimi**	**Sasia**	**Vlera**	**Viti blerjes**	**Personi përgjegjës**	**Vërejtje**
Llog 218, Rektorati **nr.2**	**Acer Mini Lap top**	**Copë**	**52,020**	**1**	**52,020**	**2013**	[redacted].	**Te asgjësohet /u gropos**
Llog 218, Rektorati **nr.6**	Printer disket 920C	"	21,889	1	21,899	2003	Kthyer në mag nga [redacted].	Prishur/ Gropos

Llog 218, Rektorati **nr.10**	Njësi kompjuteri Sempron	"	125,396	1	125,396	2010	Magazina, kthyer nga [redacted].	Prishur/ Gropos
Llog 213, **nr.10**	Kompjuter 4 core 1600	"	32,644	1	32,644	2009	Kthyer nga [redacted]	Prishur/ Gropos
Llog 214, Fak.Ekonomik **nr.5**	Kompjuter	"	309,840	1	309,840	2003	[redacted]	Prishur/ Gropos
Llog 214, **nr.2**	**Mininotebook**	**"**	**39,192**	**1**	**39,192**	**2012**	[redacted]**.**	**"**
Llog 218, **nr.3**	**Lap top**	**"**	**89,606.4**	**1**	**89,606.4**	**2014**	[redacted]**.**	**"**
Llog 213, **nr.2**	Fotokopje	"	156,000	1	156,000	2009	[redacted].	"
Llog 213, **nr.2**	**Lap top**	"	**67,308**	**1**	**67,308**	**2012**	[redacted]**.**	**Gjendje pune**
Llog 213, **nr.5**	Kompjuter komplet	"	65,000	1	65,000	2010	Ktthyer nga [redacted].	Prishur/
Llog 213, **nr.6**	Printer Lex E 120	"	9600	1	9,600	2010	Kthyer nga [redacted].	Gropos
Llog 214, Fak.Mësuesi **nr.2**	Videoprojektor	"	162,000	1	162,000	???	[redacted].	Prishur/
Llog 218, **nr.2**	**Printer Lex 610 dn**	**"**	**33,360**	**1**	**33,360**	**2015**	[redacted]	**Të riparohet**
Llog 218, **nr.4**	**Videoprojektor**	**"**	**162,000**	**1**	**162,000**	**???**	[redacted]	Prishur/
Llog 218, Fak.infermierisë **nr.2**	**Kompjuter komplet**	**"**	**40,000**	**2**	**80,000**	**2013**	[redacted]	Gropos
Llog 218, Fak.SHNH **nr.1**	Printer Lex E 250	"	25,627	1	25,627	2008	[redacted]	**Të riparohet**
Llog 214, Fak.Bujqësisë **nr.41**	**Lap top**	**"**	**67,308**	**1**	**67,308**	**2011**	[redacted]	asgjësohet
Llog 218, **nr.1**	Printer Lazer	"	17,500	1	17,500	2008	[redacted]	''

Pra, vetëm në dy raste komisioni ka konkluduar për riparim të këtyre pajisjeve (të blera në vitin 2015 dhe 2008) dhe ka konstatuar se një laptop i blerë në vitin 2012 është në gjendje pune. **Pra, në shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi, janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit dhe janë asgjësuar kompjuterë, laptop dhe minilaptop dhe video projektorë, në vlerën 490,126 lekë, të blerë gjatë periudhës 2011-2015, duke krijuar shumë dyshime mbi një proces të drejtë e të ndershëm të vlerësimit dhe asgjësimit të këtyre aktiveve.**

Nga shqyrtimi i procesverbaleve te mbajtura nga komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit, datë 23 shkurt 2018 në ambientet e Magazinës së UFSNK, për këto artikuj të përshirë në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit, pa dhënë asnjë arsye dhe shpjegim në asnjë relacion.

Nr.rendor	Emërtimi	njësia	Sasia	çmimi	vlera	Personi pergjegjes	Destinacioni
Llog 35,	Letër faksi	"	22	250	5,500	[redacted]	

Nr.2							
Llog 35, Nr.5	Letër faksi	"	10	150	1,500		
Llog 35, Nr.2	Letër celuloid	"	79	3400	286,600		
Llog 35, Nr.2	Letër faksi	"	86	810	69,660		
	shuma						

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/5 prot, datë 06.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit)", *janë bërë komentet dhe shpjegimet si më poshtë:*
"...për inventarët e vitit 2017 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas UMF nr. 30 të vitit 2011.... Nga ana e komisionit të vlerësimit janë kryer konstatimet përkatëse në datën 25.2.2018 për cdo artikull dhe është mbajtur një relacion përfundimtar nga komisioni me datën 26.2.2018, në përputhje me UMF nr. 30, datë 26.12.2011.
Per kete, administratori ka miratuar listën e materialeve te vlerësuara për ti nxjerrë jashtë përdorimit, të hartuar nga komisioni përkatës në datën 26.2.2018 shoqëruar me raportin përfundimtar të hartuar nga ky komision dhe nëpunësi zbatues për inventarizimin fizik të aktiveve, kushtet e ruajtës, gjendjen fizike, konstatimet e dëmtimeve, arsyet e dëmtimeve etj. Ky p/v është miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.188, datë 26.2.2018 dhe mban nr. 397, datë 26.2.2018.Po ashtu, nga Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit ... është mbajtur procesverbal me datën 11.4.2018 i shoqëruar me relacionin përmbledhës dhe me foto shoqëruese gjatë asgjësimit"..

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se praktikat e referuara nga ana e Administratorit nuk i janë disponuar grupit të auditimit gjatë punës në terren. Këto aspekte ne do ti vlerësojmë në kuadër të auditimit të radhës në UFSNK

Për sa sipër, grupi i auditimit merr në konsideratë objeksionet që lidhen me hapat e fundit të këtij procesi që ka të bëjë me inventarizimin e pasurisë për vitin 2017, (procedura të kryera gjatë v.2018), por theksojmë faktin se për vitin 2015 dhe 2016, parregullsitë në procedurat e inventarizimit kanë shoqëruar gjithë procesin, sa vepruar në shkelje me kërkesat e ligjit nr. nr.9228/2004 i ndryshuar, ligjit nr.10296/2010 dhe akteve te dala në zbatim te tyre.

Mbështetur në relacionin e hartuar nga Kryetarja e Komisionit të Inventarizimit të plotë periodik të aktiveve afatshkurtra e afatgjata materiale, znj.[redacted] , nga krahasimi i të dhënave kontabile dhe fizik të inventarit, rezultojnë mungesa për personat e mëposhtëm:

- **Në ambientet e rektoratit, mungon një vendroje me vlerë 151,500 lekë, në ngarkim të [redacted]** dhe
- **Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, nuk janë bërë dorëzimet e inventarit në ngarkim të znj[redacted] prej tre artikujsh, më një vlerë totale prej 58,500 lekë,** (e përbërë nga një mininotebook me vlerën 48,000 lekë, i libër me autor U.E me çmim 350 lekë x 10 fish= 3500 lekë dhe 1 libër me autor z.A.J. me çmim 700 lekë x 10 fish=7,000 lekë).

Rekomandimi:

1. **Në përputhje me përcaktimet e paragrafit nr.93, të Kreut IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", të Udhëzimit të MF me nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, sipas të cilit,** *"Nëpunësi autorizues i njësisë jep* ***urdhër zhdëmtimin për mungesat e konstatuara*** *në ngarkim të personave me përgjegjësi materiale. Nëpunësi Zbatues ndjek procesin dhe kryen regjistrimet kontabël përfundimtarë",* **të hartohen urdhrat për mangësitë në vlerat e inventarit për [redacted] për 151,500 lekë dhe znj. Alma Pogoni për shumën 58,500 lekë, duke njoftuar zyrtarisht personat përgjegjës debitor për këtë detyrim.**
   Afati: menjëherë

2. **Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Universitetit, të marrin masa që të mos bëjnë shkëputjen e marrëdhënieve administrative dhe të marren masat për njoftimin e debitorëve, me qëllim kthimin dhe dorëzimin e inventarit në magazinë, ose për mangësitë në vlerat e inventarit për z.Aurel Pelteku për 151,500 lekë dhe znj. [redacted] për shumën 58,500 lekë të procedohet ligjërisht.**
   Afati: në vazhdimësi

Konstatime për gjithë procesin e inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve materiale:

1. Referencat e vëna në këto urdhra administrativë mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita të shfuqizuara, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, mirëpo nga analiza e praktikave të mësipërme rezulton se nuk zbatohen siç duhet dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
2. Procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit, si dhe asgjësimi janë kryer **katër herë radhazi nga i njëjti komision**, veprime këto në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, që shpreh se, "***Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision".***
3. Në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit lëvizja e aktiveve nuk është shoqërur me dokumentacion të rregullt. Kështu, nuk janë prerë fletëdalje për mallrat dhe materialet e dala jashtë përdorimit, (pasi artikujt e inventarit shkarkohen menjëherë sapo u kalojnë përdoruesve), duke shkelur kërkesat e pikës 34, të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", që përcakton se, "*Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen* ***kurdoherë*** *në dokumentet përkatëse dhe* ***menjëherë*** *pasi kryhet veprimi".* Ky fakt evidentohet si për botimet e ndryshme, për pjatat e argjendit, kostumet sportive, etj, artikuj që (sipas shpjegimeve të zyrtarëve të subjektit) janë sistemuar, shpërndarë në konferenca, dhuruar, etj, dhe në fakt i kalojnë për veprim komisionit të asgjësimit....
4. Inventarizimi ka përfshirë vetëm gjendjen e aktiveve në magazinë dhe inventarin e zyrave dhe jo gjendjen e AQT "Ndërtesa", në kundërshtim me *paragrafin* nr. 74 të UMF nr 30/ 2011 që përcakton se, *"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e* ***aktiveve afatgjata materiale*** *dhe jo materiale, aktiveve*

afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës". ***Ky fakt ka sjellë konfuzionin dhe parregullsinë e pasqyrimit në kontabilitet të godinave që më VKM janë hequr nga përgjegjësia e administrimit të UFSNK.***

5. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2015 dhe 2016 ***nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë***, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e UFSNK për vitet 2015,2016,2017 dhe 2018, në kundërshtim me *paragrafin* nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Të përpilojë* ***një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave*** *e dëmtimeve te konstatuara, për* ***shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës****, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzoje për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues".* Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve.
6. Procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, sic përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr.30, që përcakton se *"ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit* ***të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përftimi*** *bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale"*, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.
7. Nuk ka gjetur zbatim paragrafi nr. 100, i UMF nr. 30/2010 i ndryshuar, për numrin e personave në komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit: *"Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se* ***5 vetë****, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari, në vartësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi".*
8. Si mangësi për realizimin e procedurave të inventarizimit për vitet 2015 dhe 2016 rezulton se komisioni **nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj.,**
9. Në disa raste, janë nxjerrë jashtë përdorimit pajisje që kanë patur në ngarkim anëtarët e komisionit ([redacted] etj), dhe pa kaluar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit.
10. Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", që sanksionon se, Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kritereve :

    a. kur është *plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;*
    b. *kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;*
    c. *kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit,*
    d. *kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm.*
    e. *kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;*
    f. *kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;*

g. *kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmbytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;*
h. *kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.*

Inventarizimi i aktiveve duke qenë se është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë shpenzuese, i cili kryhet për të vërtetuar **saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficensë të tyre**, që kryhet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues sipas procedurave të miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ndryshuar, **nuk është marrë me seriozitetin e duhur nga këto nëpunës**, pasi:
-Nuk ka hartim të listave nga Nëpunësi Zbatues të aktiveve për kryerjet e inventarizimeve, sipas pikës 81, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë shpenzuese;
-Komisionet e kryerjeve të inventarizimeve fizike **nuk kanë përpiluar raportet lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, për kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës,** dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, siç cilëson pika 85/ c e Udhëzimit.

Meqenëse komisionet e kryerjeve të inventarizimeve fizike kanë sugjeruar aktive të qëndrueshme për nxjerrje jashtë përdorimit apo aktive qarkulluese e gjendje inventari, atëherë kjo njësi shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues duhej të studionin konkluzionet e tyre dhe të vepronin konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011, si për: procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; procesin verbal të vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuara për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme, duke marrë si reference paragrafin 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrit të Financave.

Konkluzioni i grupit të auditimit mbi kryerjet e analizimi i rezultateve të inventarizimit të aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit e asgjësimit të tyre, është se ka mangësi e parregullsi në kryerjen e proceduarve të inventarizimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve që u përkasin viteve 2015 (proces i kryer gjatë vitit 2016) dhe 2016 (proces i kryer gjatë vitit 2017), në kundërshtim me kërkesat e nenit 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", ku përcaktohet se:

Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse;

si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", Kapitulli V, Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve, Inventarizimi i Aktiveve, pika 74, ku përcaktohet:

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli III *"Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre",* pika 30 që formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, ka përfshirë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

VII. ADMINISTRIMI I KARBURANTIT

U konstatua se, **gjatë periudhës objekt auditimi (2016, 2017), janë kryer shpenzime dhe janë bërë dalje karburante për gjithë veprimtarinë mësimore dhe ndihmese, në sasinë 99,984 litra dhe në vlerën 15,059,295 lekë pa asnjë dokumentacion justifikimi të këtyre shpenzimeve. Sa sipër, është vepruar në shkelje të parimeve dhe kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004** " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 26.12.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe UMF nr.30. 20111 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar dhe shuma prej **15,059,295 lek konsiderohet si shpenzim i kryer pa efektivitet.**

Në mënyrë të detajuar paraqitet kjo situatë sipas kategorive të shpenzimeve të karburanteve:

i. Administrimi i karburantit në përdorim nga automjetet

Për automjetet janë shpenzuar **9651 litra karburant për automjetet, me vlerë 1,516,641 lekë, të konsideruara shpenzime pa efektivitet në vlerën** e ndarë në periudha si vijon:

- në sasinë 5,095 litra, me vlerën **819,367 lekë** lekë për vitin 2016,
- në sasinë 6,049 litra, me vlerën **931,696 lekë** për vitin 2017,

për 3 automjetet në dispozicion të Universitetit, **por pa u shoqëruar me dokumentacion të nënshkruar rregullisht, që të konfirmojë kryerjen e shërbimit dhe të justifikojë realizimin efektivisht të këtyre shpenzimeve**. Për sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07..2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe në kundërshtim me paragrafin nr. 36, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30/ 2011, ku përcaktohet se:

*"Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për **shkakun e veprimit**, **datën dhe vendin** e kryerjes, objektin, **treguesit sasiore dhe ato të vlerës**, personat që kanë urdhëruar dhe **ekzekutuar veprimin** dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një **prove ligjore ose administrative".***

Për sa sipër, përgjegjësia bie mbi drejtuesit e automjeteve dhe urdhëruesin e tyre, administratorin dhe rektorin e UFSNK.

ii. Administrimi i karburantit në përdorim nga EDE

Sipas analizës së fletëdaljeve dhe kërkesave të paraqitura nga anan e përgjegjësit të EDE, z. [redacted] miratuar nga dekani i Fakultetit të Bujqësisë e më pas nga Kancelari, janë kryer shpenzime për procese të ndryshme si plugim, frezim, transport materialesh, hapje kanali, mbjellje, që për v. 2016 arrijnë në **750 litra** x 160 lek/litri dhe për v. 2017 në **743 litra** karburant x 154 lek/litri. **Nuk ka në asnjë rast procesverbale apo situacioneve të punimeve të kryera, për të dokumentuar dhe justifikuar shpenzimin prej 1493 litra me vlerë 234,422 lekë, ndaj kjo vlerë përbën shpenzim pa efektivitet të fondeve publike.**
Sa më sipër, përgjegjësia bie mbi drejtuesin e EDE, z. [redacted]

iii. Administrimi i karburantit në përdorim nga kaldaja:
Nga auditimi rezulton se për dy vitet 2016 dhe 2017, vetëm për katër kaldajat e UFSNK janë bërë dalje 88,840 litra naftë x 149,7 lekw= 13,308,232 lekw.
Nuk ka asnjë dokument për justifikimin e karburantit për kaldajën, , asnjë regjistër për dokumentimin e kohës së punës së kaldajave, oraret e ndezjes së tyre etj, **Ka rezultuar se, nuk është dokumentuar konsumi i karburantit për kaldajën, duke mos dokumentuar ndezjen e sajë, nga Përgjegjësi për Infrastrukturën dhe Asistencën Teknike Z.[redacted] dhe (çdo ditë dhe monitorimi të konfirmohej me mbajtjen e një proces verbali ditor).**
-Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 janë bërë **dalje kaldajave** sipas Fakulteteve gjithsej **51,840 litra karburant**, përkatësisht:

- Fakulteti i Shkencave..... 8,930 litra,
- " i Edukimit .....19,160 litra,
- " Ekonomik.....15,530 litra,
- " Infermierisë.....8,220 litra

-Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017 janë bërë dalje kaldajave sipas Fakulteteve gjithsej **37,000 litra** karburant, përkatësisht:

- Fakulteti i Shkencave.....7,980 litra,
- " i Edukimit .....12,550 litra,
- " Ekonomik.....13,770 litra,
- " Infermierisë.....2,700 litra.

Gjetje nga auditimi:

1. **Nuk ka asnjë dokument për justifikimin e karburantit për kaldajën,** , asnjë regjistër për dokumentimin e kohës së punës së kaldajave, oraret e ndezjes së tyre etj, **Ka rezultuar se, nuk është dokumentuar konsumi i karburantit për kaldajën, duke mos dokumentuar ndezjen e sajë, nga Përgjegjësi për Infrastrukturën dhe Asistencën Teknike Z[redacted] dhe (çdo ditë dhe monitorimi të konfirmohej me mbajtjen e një proces verbali ditor). Nuk kishte një grafik të miratuar për ndezjen e kaldajës nga strukturat menaxhuese të universitetit**, në shkelje të:

✓ pikës nr. 6, kreu II, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, që shpreh se:

"Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes."

✓ pikës nr.3/8 të tij

"Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë.
a) Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik;
b) dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë;
c) regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese"

- ✓ paragrafi 35, kreu III, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30,2011,

"Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. ***Dokumente autorizues -*** *janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.*
b. ***Dokumente vërtetues -*** *vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.*

Dhe paragrafi nr.36:

"Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative[12]*. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve. "*

2. **Nuk është kryer për periudhën objekt auditimi inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit në çdo fund viti** apo në çdo proces të inventarizimit të kryer, në shkelje të kërkesave të pikës 74, kreu IV, të UMF nr. 30/ 2011, sipas të cilit, *"çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*
3. **Nuk ka normativa të përditësuar e miratuara** për sasitë e karburantit që konsumohet për një orë pune **për secilën nga kaldajat**. Grupit të auditimi i janë vënë në dispozicion normativat e harxhimit të miratuara me urdhrin nr.3, datë 28.1.2008 nga ana e Zv/rektores [redacted] pra para 10 vjetësh dhe nuk janë rishikuar. **Nuk ka procesverbal për matjen e normativave të harxhimit të karburantit për secilën kaldajë, meqenëse ato janë ndërtuar në vite të ndryshme.**

Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit dhe përdorimit të tij në tre kaldajat e Fakulteteve të UFSNK rezultuan **se ka shkelje te kërkesave të** Nenit 6,"**Evidenca mbështetëse",** të **ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar**, ku përcaktohet se:

"1. Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.

2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes."

të ligjit nr.10296/ dhe kërkesave të paragrafit 41, të kreut III, të UMF nr.30, datë

"Në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi te përdoruesi (p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe ***bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë*** *(p.sh. në magazinën qendrore të njësisë publike).* ***Në këtë rast duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive.*** *Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve.*

4. Në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit 41, kreu III të UMF nr. 30, nuk ka një procedura të shkruar për gjurmën e auditimit,mbi mënyrën e furnizimit me sasinë e karburantit lëng, ngarkimin e magazinës me tollonat dhe si bëhet dalja e tollonave nga magazina, meqenëse administruesja e vlerave materiale pret f/dalje për çdo kaldajë dhe ***nuk ka veprim si dokumentohet dalja e tollonave nga magazina për operatorin ekonomik fitues të tenderit. Në komisionin e marrjes në dorëzim të karburantit nuk është magazinieri*** , e cila nuk është as e pranishme kur kryhet ky proces furnizimi.
"*Në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi te përdoruesi (p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (psh. në magazinën qendrore të njësisë publike). Në këtë rast duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve. "*

5. Fakti që ka **oscilacione të mëdha** të këtyre sasive tregon se ky proces është krejtësisht jashtë kontrollit të strukturave menaxheriale

Nga verifikimi i ciklit të furnizimit dhe shpërndarjes së karburantit, procedura është e tillë: personi i ngarkuar me administrimin material furnizohet nga operatori ekonomik me tollonat për sasinë e karburantit të fituar në tender. Procesi i furnizimit i nënshtrohet urdhër dorëzimeve që lëshohen nga drejtori ekonomik, dhe për sasinë e furnizuar (për të cilën sasia e karburantit merret në dorëzim nga komisioni me tre anëtarë), nga magazina i kthehen subjektit privat sasitë e tollonave për sasinë e furnizuar. **Përveç një urdhri të ish-Kancelares, nuk ka procedura të qarta të lëvizjes, që të jenë miratuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike, ku të përcaktohen përgjegjësitë respektive, sic kërkohet në pikën 41 të UMF nr. 30/2011.**

Nga vlerësimi i këtij procesi, evidentohet se, janë shpenzuar vlera të konsiderueshme materiale në kundërshtim me kërkesat e administrimit financiar e material, duke mos dokumentuar kryerjen e shpenzimit, kohën e kryerjes etj. ***Më konkretisht*****, për periudhën 2016 dhe 2017 janë shkarkuar nga operatori ekonomik që ka fituar tenderin, direkt tek kaldajat, dhe janë marrë në dorëzim nga një komision, i cili nuk ka mbajtur asnjë dokument për të justifikuar sasinë e litrave të lëndës djegëse, në ngarkim të tyre., gjithsej <u>88,840 litra naftë</u> për v. 2016 dhe vitin 2017. Pra, është veprim në shkelje të disiplinës financiare dhe përdorimi i fondeve publike në këtë zë shpenzimi konsiderohet pa efektivitet.**

Pra, nuk janë mbajtur kartelat e shfrytëzimit të kaldajave për çdo muaj dhe kjo ngarkon me përgjegjësi kaldajistët e evidentuar më sipër.

Në rregullën e brendshme te aparatit të Rektoratit është përcaktuar se Drejtori Ekonomik ka për detyrë të ndjek dhe kontrolloje fletë-udhëtimet e shoferëve, konsumin e karburantit sipas normativave dhe i krahason ato me furnizimin e tyre nga magazina dhe në bazë fletë-udhëtimeve të plotësohet evidenca e harxhimit të vajit, të pjesëve të këmbimit dhe gomave duke bashkëpunuar dhe me specialistë të tjerë të cilët disponojnë të dhënat e nevojshme, dhe hap urdhër, me plotësimin e kilometrazhit, për ndërrimet e tyre. ***Për sa sipër,* përgjegjësia bie mbi secilin prej personave të ngarkuar me administrimin e kaldajave pranë fakulteteve, [redacted].**

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/5 prot, datë 06.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit)", *janë bërë komentet dhe shpjegimet si më poshtë*:

"jemi dakord me konstatimet tuaja që nuk është ndjekur e monitoruar (moskryerja e inventarit të gjendjes së sasisë fizike të karburantit dhe për mungesën e përditësimit të normativave të konsumit".
Administratori për këtë ka nxjerrë urdhrin nr.19, datë 19.1.2018 për normativat e konsumit të karburantit për mjetet dhe lëndës djegëse të kaldajave. Për v. 2018 janë nxjerrë normativat e konsumit për çdo kaldajë dhe çdo automjet."

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se praktikat e referuara nga ana e Administratorit nuk i janë disponuar grupit të auditimit gjatë punës në terren. Këto aspekte ne do ti vlerësojmë në kuadër të auditimit të radhës në UFSNK

Lidhur me pikën "i" të projekt raportit , faqe 53, administrimi i karburantit në përdorim nga automjetet, *në të cilën citoni: "Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative", ju sqarojmë se: në momentin që lind nevoja për udhëtim sipas destinacionit ftesa, aktivitete, takime, mbledhje, ekspedita etj., për drejtuesit dhe stafin e institucionit paraqitet kërkesa...etj. në kërkesë vendoset data, itinerari i lëvizjes, sasia e karburantit, mjeti i cili do të udhëtojë etj. Pas kryerjes së shërbimit drejtuesi i mjetit ose personi i autorizuar plotëson urdhër shërbimin, i cili përmban datën e nisjes, kthimit, destinacionin dhe nënshkruhet nga titullari.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se dokumentacioni që ju referoni, të tilla si: *kërkesë për dërgim me shërbim ku shënohet data e nisjes dhe e kthimit, itinerari i lëvizjes, sasia e karburantit, mjeti i cili do të udhëtojë, etj janë dokumente autorizuese, që nuk konfirmojnë kryerjen e këtij procesi, por vetëm e autorizojnë atë. N1 asnjë rast, edhe pse hartohen urdhërat e shërimit, ato justifikojnë pagesën për dieta e shpenzime të tjera të akomodimit, por nuk zëvendësojnë fletët e udhëtimit, ku evidentohet*

distanca dhe itineraret e kryera efektivisht, të cilat mund të mos përkojnë në mënyrë të plotë me autorizimin e dërgimit me shërbim. **Hartimi dhe nënshkrimi i fletëve të udhëtimit do ti shërbejë jo vetëm saktësimit të kilometrave të përshkruara brenda dhe jashtë qyteteve për efekt të shërbimeve dhe riparimit të mjeteve, por edhe justifikimit të karburantit për çdo lëvizje dhe në kohë**. Megjithatë, zbatimi i normativave dhe rregullsisë së dokumentimit të karburantit p1r mjetet dhe kaldajat do ti nënshtrohen vlerësimeve në kuadër të auditimit të radhës në UFSNK.

Për sa sipër, grupi i auditimit merr në konsideratë objeksionet që lidhen me administrimin material, sa vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10296/2010 dhe akteve te dala në zbatim të tij.

VIII. PAGESA E BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Sipas nenit 5 ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", **Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi**. Në zbatim të këtij neni, Bordi i Administrimit të UFSNK cakton në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe përcakton pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.
Për sa më lart, ndonëse ligji i jep autonomi, por kjo pavarësi është e kushtëzuar nga të ardhurat financiare, pasi për realizimin e misionit të tij, ky universitet financohet nga buxheti i shtetit me rreth 68 % të fondeve dhe në këto kushte nuk mund të caktojë vetë pagat pa u mbështetur në dispozita të tjera nënligjore që duhet të rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. **Konstatohet se, deri në hartimin e këtij raporti nuk kanë dalë dispozita rregulluese, e për rrjedhojë është krijuar vakum ligjor në interpretimin dhe funksionimin e autonomisë së Universitetit.** Mungesa e dispozitave të tjera ligjore në përcaktimin e kritereve të shpërblimit të Bordit të Administrimit, ka lejuar vendimmarrje te gabuara të këtij organizmi.
Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht nga ky kusht, Bordi i Administrimit me vendimin e tij ka miratuar masën e shpërblimit për kryetarin dhe anëtarët e Bordit të Administrimit.
Procedura e caktimit të shpërblimit të anëtarëve dhe krytarit të Bordit të Administrimit
është si vijon:

- Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) **nr. 16, datë 27.07.2017,** është vendosur të shpërblehen për çdo muaj anëtarët e BA me nga **35 mijë lekë** dhe kryetari i BA me **40 mijë lekë**. Këtu përfshihet dhe rimbursimi i shpenzimeve dhe trajtimi financiar me dieta. Në këtë vendim thuhet se "**vendimi i shtrin efektet nga muaji dhjetor 2016."**
- Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) **nr. 25/1, datë 12.12.2017,** është vendosur të **pezullohet Vendimi i BA** me nr. 16, datë 27.07.2017 nga data 1.1.2018.
- Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) **nr. 27, (nr. 576 prot), datë 22.12.2017,** masa e shpërblimit mujor është ndryshuar, duke përcaktuar nivelin me nga **25 mijë lekë** për anëtarët dhe me **30 mijë lekë/ muaj për kryetarin e BA**.

Konstatimi:

i. **Pagesa e mësipërme është në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik"** ku është përcaktuar se, *tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.*
Në pikën nr. 3 të VKM nr 418/2012, i ndryshuar, përcaktohet që,:
"Emërtesa e çdo këshilli, bordi apo komisioni, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së kryetarit dhe anëtarëve për çdo këshill, bord ose komision përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me përjashtim të rastit kur ligji specifik parashikon ndryshe".

ii. Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore" lidhja nr. 1, **por përbën edhe konflikti interesi, pasi Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjor të përcaktojë tarifat e shpërblimit për vetveten**, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht se:

> *"Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga, të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre".*

Nga shqyrtimi i urdhër shpenzimeve të vitit 2017, rezulton se Bordi i Administrimit për periudhën Dhjetor 2016-Tetor 2017, është shpërblyer sipas këtyre 4 (katër) urdhër shpenzimeve të mëposhtme:

Nr.	Emër, mbiemër	Periudha	Tarifa	Nr. mbledh.	Pagesa bruto
1	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	40000	11	440000
2	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	35000	4	140000
3	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	35000	11	385000
4	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	35000	11	385000
5	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	35000	11	385000
6	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	35000	4	140000
7	[redacted]	Dhjetor 2016 deri ne Tetor 2017	35000	11	385000
	Shuma				**2,260,000**

Pasqyra e detajuar për pagesat e anëtarëve të bordit të administrimit:

Nr.	Emër, mbiemër	Periudha	Urdhër shpenzimi		Tarifa	Nr. mbledh.	Pagesa bruto
			Nr.	Data			
1	[redacted]	dhjetor-shkurt	**189**	21.08.2017	40000	3	120000

2	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	2	70000
3	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	3	105000
4	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	3	105000
5	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	3	105000
6	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	2	70000
7	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	3	105000
	Shuma						**680,000**
1	[redacted]	Mars-Maj	**199**	15.09.2017	40000	3	120000
2	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	1	35000
3	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	3	105000
4	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	3	105000
5	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	3	105000
6	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	0	0
7	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	3	105000
	Shuma						**575,000**
1	[redacted]	Qershor-Gusht	**231**	17.10.2017	40000	3	120000
2	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000		0
3	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	3	105000
4	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	3	105000
5	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	3	105000
6	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	0	0
7	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	3	105000
	Shuma						**540,000**
1	[redacted]	Shator - Tetor	**272**	01.12.2017	40000	2	80000
2	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	1	35000
3	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000
4	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000
5	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000
6	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000
7	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000
	Shuma						**465,000**

i. Pagesa për anëtaret e brendshëm të Bordit të Administrimit:

Llogaritja e diferencës te pagesës Dhjetor 2016- Shkurt 2017

Nr	EMRI MBIEMRI	Tarifa	Dhjetor-shkurt 2017 Nr. mbledh.	Shuma BRUTO	Te ardhurat mujore	Te ardhura mujore plus bord	Tatimi gjithesej	Te Ardhurat neto Duhet te merte	Te Ardhurat neto paga (Jane mare)	Te Ardhurat neto bordi (Jane mare)	Te Ardhurat neto gjithesej (Jane mare)	Diferenca neto bordi

1	**2**	**3**	**4**	**5**	**8**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**	**16**
1	[redacted]	8000	**3**	**24000**	**113090**	**137090**	14631	**122459**	60806	105000	**165806**	**43347**
2	[redacted]			**0**		**0**	0	**0**		0	**0**	
3	[redacted]	8000	**3**	**24000**	**113090**	**137090**	14631	**122459**	60806	105000	**165806**	**43347**
		shuma	**6**	**48000**	**226180**	**274180**	**29261**	**244919**	**121612**	**210000**	**331612**	**86693**

Llogaritja e diferencës te pagesës Mars-Maj 2017

Nr	EMRI MBIEMRI	Tarifa	Mars-Maj 2017 Nr. mbledh.	Shuma BRUTO	Te ardhurat mujore	Te ardhura mujore plus bord	Tatimi gjithsej	Te Ardhurat neto Duhet te merrte	Te Ardhurat neto paga (Janë marrë)	Te Ardhurat neto bordi (Janë marrë)	Te Ardhurat neto gjithsej (Janë marrë)	Diferenca neto bordi
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**8**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**	**16**
1	[redacted]	8000	**3**	**24000**	**113090**	**137090**	14631	**122459**	85050	89250	174300	51841
2	[redacted]		**0**	**0**		**0**	0	**0**			0	
3	[redacted]	8000	**3**	**24000**	**113090**	**137090**	14631	**122459**	85050	89250	174300	51841
		shuma	**6**	**48000**	**226180**	**274180**	**29261**	**244919**	**170100**	**178500**	**348600**	**103681**

Llogaritja e diferencës te pagesës Qershor - Gusht 2017

Nr	EMRI MBIEMRI	Tarifa	Qershor-Gusht 2017 Nr. mbledh.	Shuma BRUTO	Te ardhurat mujore	Te ardhura mujore plus bordi	Tatimi gjithsej	Te Ardhurat neto Duhet te merrte	Te Ardhurat neto paga (Jane mare)	Te Ardhurat neto bordi (Jane mare)	Te Ardhurat neto gjithesej (Jane mare) (13+14)	Diferenca neto bordi (12-15)
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**8**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**	**16**
1	[redacted]	8000	**3**	**24000**	**113090**	**137090**	14631	**122459**	85050	89250	174300	51841
2	[redacted]	8000	**0**	**0**		**0**	0	**0**			0	
3	[redacted]	8000	**3**	**24000**	**113090**	**137090**	14631	**122459**	85050	89250	174300	51841
		shuma	**6**	**48000**	**226180**	**274180**	**29261**	**244919**	**170100**	**178500**	**348600**	**103681**

Llogaritja e diferencës te pagesës Shtator- Tetor 2017

Nr	EMRI MBIEMRI	Tarifa	Shtator-Tetor 2017 Nr. mbledh.	Shuma BRUTO	Te ardhurat mujore	Te ardhura mujore plus bordi	Tatimi gjithsej	Te Ardhurat neto	Te Ardhurat neto paga (Jane mare)	Te Ardhurat neto bordi (Jane mare)	Te Ardhurat neto gjithesej (Jane mare)	Diferenca neto bordi
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**8**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**	**16**
1	[redacted]	8000	**2**	**16000**	**128090**	**144090**	16241	**127849**	82845	59500	142345	14496

2	[redacted]	8000	**2**	**16000**	**112073**	**128073**	12749	**115324**	74442	59500	133942	18618
3	[redacted]	8000	**2**	**16000**	**128090**	**144090**	16241	**127849**	82845	59500	142345	14496
				0		**0**	0	**0**			0	0
		shuma	**6**	**48000**	**368253**	**416253**	**45231**	**371022**	**240132**	**178500**	**418632**	**47610**

PERMBLEDHESE

Nr	EMRI MBIEMRI	Tarifa	Numuri I mbledhjeve	Shuma BRUTO	Te ardhurat mujore	Te ardhura mujore plus bordi (4+8)	Tatimi gjithesej	Te Ardhurat neto	Te Ardhurat neto paga (Jane mare)	Te Ardhurat neto bordi (Jane mare)	Te Ardhurat neto gjithesej (Jane mare)	Diferenca neto bordi
1	[redacted]	35000						**372768**	**252945**	**238000**	**490945**	**161524**
2	[redacted]	35000						**115324**	**74442**	**59500**	**133942**	**18618**
3	[redacted]	35000						**372768**	**252945**	**238000**	**490945**	**161524**
4				**0**		**0**	0					
		shuma	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**860859**	**580332**	**535500**	**1115832**	**341,666**

Burimi: Drejtoria e Financës, UFSNK..

Për sa më lartë, ***anëtarët e brendshëm të Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej <u>341,666 lekë</u>, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe pasqyrohet sipas përfituesve në tabelën e mëposhtme***:

ii. Pagesa për anëtaret e jashtëm të Bordit të Administrimit:

Për periudhën Dhjetor-Shkurt 2017 pagesa është bere me tarifën e vendosur nga Bordi I Administrimit , ndërsa tatimi është llogaritur me te ardhurat mujore gjithsej .

Ne pasqyrën e mëposhtme është llogaritur pagesa me tarifën 8 000 leke dhe tatimi ne burim, si dhe është nxjerre diferenca neto.

Nr.	Emër, mbiemër	Periudha	Urdhër shpenzimi		Tarifa	Nr. mbledh.	Pagesa bruto	Tatim Burim	Pagesa neto	Tarifa	Pagesa bruto	Tatim Burim	Pagesa neto	Diferenca
			Nr.	Data										
									pagur gusht		(7*11)	(12*15%)	(12-13)	(10-14)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	40000	3	120000		96205	8000	24000	3600	20400	**75805**
2	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	2	70000		52710	8000	16000	2400	13600	**39110**
3	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	3	105000		81605	8000	24000	3600	20400	**61205**
4	[redacted]	dhjetor-shkurt	189	21.08.2017	35000	3	105000		80315	8000	24000	3600	20400	**59915**
	Shuma						**400000**		**310835**		**88000**	**13200**	**74800**	**236035**

Për periudhën Mars- Maj 2017 pagesa është bere me tarifën e vendosur nga Bordi i Administrimit , ndërsa tatimi është llogaritur me te ardhurat mujore gjithsej .

Ne pasqyrën e mëposhtme është llogaritur pagesa me tarifën 8 000 leke dhe tatimi ne burim, si dhe është ndjere diferenca neto.

Nr.	Emer, mbiemer	Periudha	Urdhër shpenzimi		Tarifa	Nr. mbledh.	Pagesa bruto	Tatim Burim	Pagesa neto	Tarifa	Pagesa bruto	Tatim Burim	Pagesa neto	Diferenca
			Nr.	Data										

									pagur shtator		(7*11)	(12*15%)	(12-13)	(10-14)
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**
1	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	40000	3	120000		96205	8000	24000	3600	20400	**75805**
2	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	1	35000		26355	8000	8000	1200	6800	**19555**
3	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	3	105000		81605	8000	24000	3600	20400	**61205**
4	[redacted]	Mars-Maj	199	15.09.2017	35000	3	105000		80315	8000	24000	3600	20400	**59915**
	Shuma						**365000**		**284480**	**8000**	**80000**	**12000**	**68000**	**216480**

Për periudhën Qershor-Gusht 2017, paguar ne muajin Tetor pagesa është bere me tarifën e vendosur nga Bordi i Administrimit dhe tatimi

është mbajtur ne burim.

Ne pasqyrën e mëposhtme është llogaritur pagesa me tarifën prej 8 000 leke dhe diferenca.

Nr.	**Emer, mbiemer**	**Periudha**	**Urdher shpenzimi**		**Tarifa**	**Nr. mbledh.**	**Pagesa bruto**	**Tatim Burim**	**Pagesa neto**	**Tarifa**	**Pagesa bruto**	**Tatim Burim**	**Pagesa neto**	**Diferenca**
			Nr.	**Data**										
							(6*7)	**(8*15%)**	**(8-9)**		**(7*11)**	**(12*15%)**	**(12-13)**	**(10-14)**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	40000	3	120000	18000	102000	8000	24000	3600	20400	**81600**
2	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000		0	0	0	8000	0	0	0	**0**
3	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	3	105000	15750	89250	8000	24000	3600	20400	**68850**
4	[redacted]	Qershor-Gusht	231	17.10.2017	35000	3	105000	15750	89250	8000	24000	3600	20400	**68850**
	Shuma						**330000**	**49500**	**280500**	**8000**	**0**	**0**	**0**	**280500**

Për periudhën Shtator -Tetor 2017, paguar ne muajin Dhjetor pagesa është bere me tarifën e vendosur nga Bordi i Administrimit dhe tatimi

është mbajtur ne burim.

Ne pasqyrën e mëposhtme është llogaritur pagesa me tarifën prej 8 000 leke dhe diferenca.

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Periudha**	**Urdhër shpenzimi**		**Tarifa**	**Nr. mbledh.**	**Pagesa bruto**	**Tatim Burim**	**Pagesa neto**	**Tarifa**	**Pagesa bruto**	**Tatim Burim**	**Pagesa neto**	**Diferenca**
			Nr.	**Data**										
							(6*7)	**(8*15%)**	**(8-9)**		**(7*11)**	**(12*15%)**	**(12-13)**	**(10-14)**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	40000	2	80000	12000	68000	8000	16000	2400	13600	**54400**
2	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	1	35000	5250	29750	8000	8000	1200	6800	**22950**
3	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000	10500	59500	8000	16000	2400	13600	**45900**
4	[redacted]	Shator - Tetor	272	01.12.2017	35000	2	70000	10500	59500	8000	16000	2400	13600	**45900**
	Shuma						**255000**	38250	216750	8000	0	0	0	**216750**

PERMBLEDHESE

Nr.	**Emer, mbiemer**	**Periudha**	**Urdher shpenzimi**		**Tarifa**	**Nr. mbledh.**	**Pagesa bruto**	**Tatim Burim**	**Pagesa neto**	**Tarifa**	**Pagesa bruto**	**Tatim Burim**	**Pagesa neto**	**Diferenca**
			Nr.	**Data**										
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**
1	[redacted]	Mars-Maj												**287610**
2	[redacted]	Mars-Maj												**81615**
3	[redacted]	Mars-Maj												**237160**

4	[redacted]	Mars-Maj												**234580**
	Shuma						**0**		**0**		**0**	**0**	**0**	**840,965**

Burimi: Drejtoria e Financës, UFSNK..

Për sa më lartë, ***anëtarët e jashtëm të Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej <u>840,965 lekë</u>, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe pasqyrohet sipas përfituesve në tabelën e mëposhtme***:

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/2 prot, datë 04.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Kryetarit të Bordit të Administrimit të Universitetit)", *janë* ***ridërguar <u>komentet dhe shpjegimet e bëra dhe për aktkonstatimet , duke ritheksuar se:</u>***

<u>"... po ritheksojmë ashtu si dhe ju, se ka vakum ligjor në interpretimin dhe funksionimin e universitetit pasi nuk kanë dalë aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet financiare të anëtarëve të Bordit të Administrimit"</u> .

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:</u>
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pavarësisht sa pretendohet për autonominë institucionale të Universitetit, e-mailit te dërguar nga zv/ministri, ku orientohen nivele te pagesave, ky nuk është një akt ligjor apo nënligjor. UFSNK duhet të kishte kërkuar nga MASR të kryheshin përmirësimet e duhura në dispozitat nënligjore.
Ne objeksion është shënuar se "nuk përbën konflikt interesi përcaktimi i shpërblimit për veten i anëtareve të bordit pasi këtë liri dhe autonomi ia jep ligji për arsimin e lartë, nr. 80/2015, neni 3, pika 4, germa "ç".

Pagesa e Bordit të Administrimit është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik" ku është përcaktuar se, *tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.* Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore" lidhja nr. 1, por përbën edhe **konflikti interesi**, pasi **Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjor të përcaktojë tarifat e shpërblimit për vetveten**, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar. Për sa më lartë, anëtarët e Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej **<u>1,182,631 lekë</u>** (nga këto 341,666 lekë nga anëtaret e zgjedhur nga Universiteti dhe 840,965 lekë nga anëtaret e zgjedhur nga MASR), **që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblyer sipas përfituesve.**
Për sa sipër, është vepruar në shkelje me kërkesat e kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore " si dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

Pas shqyrtimit të komenteve të dërguara me objeksionet mbi projektrportin, ky objeksion i Bordit të Administrimit të UFSNK nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

Rekomandimi:
Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, në bazë të përcaktimeve të nenit 7, "Ministria përgjegjëse për arsimin", të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhëe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në RSH", ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për fushën e përgjegjësisë shtetërore.
Për sa sipër, MASR duhet të propozojë ndryshimet e nevojshme në VKM nr. 418, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik", duke shënuar "Bordin e Administrimit" dhe duke propozuar tarifat e shpërblimit për pjesëmarrjen në këto borde për anëtarët e brendshëm dhe të jashtëm, që do të angazhihen në këto funksione administrimi.
Afati: Brenda 3 muajve.

Në zbatim të pikës III/B të programit të auditimit "nr. 202/1, datë 23.02.2018" i ndryshuar, u shqyrtuan regjistrimet në ditarin e bankës dhe mbi bazë risku, me zgjedhje u vlerësua dokumentacioni justifikues i përgatitur nga ana e drejtuesve të UFSNK dhe rezultoi si më poshtë:

BANKA 2016:

Nga auditimi i shpenzimeve operative konstatohen mangësi e shkelje, e konkretisht:

I. Me urdhër shpenzimin nr. 136 , datë 24.05.2017, të nënshkruar nga NA z.[redacted] dhe NZ znj.[redacted] është kryer likuidimi i faturës tatimor te shitjes për shoqërinë private "[redacted]" sh.p.k për pjesëmarrje në panairin e Arsimit të lartë në shumën prej **139,205 lekë.**
Kjo pagesë është kryer sipas shkresës së ish -Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 5232/1, datë 20.05.2016, më e objekt "Ftesë për pjesëmarrje", nënshkruar nga ish Sekretar i Përgjithshëm i MAS. Sipas kësaj shkrese, ***"MAS me datat 26, 27 dhe 28 maj 2016 do të organizojë panairin e Arsimit të Lartë në ambientet e [redacted] pranë [redacted] për informimin e maturantëve mbi programet që ofrohen si dhe njohjen e kritereve të pranimit të maturantëve në këto institucione për vitin akademik 2016-2017".***
Shkresa e mësipërme është dërguar për zbatim nga 14 Universitet Shtetërore, për të lidhur kontratës me subjektin "[redacted]" me objekt "*Organizimin e panairit pranë [redacted] për njohjen e kritereve të pranimit të maturantëve në vitin akademik 2016-2017*".

Dokumentacioni i përdorur për likujdim përfshin:

- Urdhër i Ministrit të MAS, me nr. 261, datë 20.05.2016, "Për organizimin e aktivitetit "Panairi i Edukimit". Në bazë të pikës nr.2 të këtij urdhëri, aktiviteti zhvillohet me pjesëmarrjen e Ministrisë së AS dhe të Institucioneve të Arsimit të Lartë publik e privat, nga data 26-28 maj 2016.
- Urdhër i Rektorit z.[redacted] me nr. 98, datë 23.05.2016, në bazë të të cilit, urdhërohet të kryhet pgesa për pjesamërrje në panair nga data 26-28 maj 2016.

- Fatura tatimore e shitjes, e lëshuar nga [redacted] sh.p.k Tiranë, me nr. 354, datë 20.05.2016 për shumën 840 EURO x 168= 139,205 lekë dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i [redacted] sh.p.k Tiranë si dhe nga z.[redacted], përfaqësuës i UFSNK.
- Po e njëjta faturë tatimore e shitjes, e lëshuar nga [redacted] sh.p.k Tiranë, me nr. 354, datë 20.05.2016 për shumën 840 EURO x 168 = 139,205 lekë dhe enënshkruar nga përfaqësuesi i [redacted] sh.p.k Tiranë si dhe nga znj.E. C. dhe znj[redacted] përfaqësues të UFSNK.
- Marrëveshje për pjesëmarrje në panair, e lëshuar nga [redacted] sh.p.k Tiranë, me datë 23.05.2016 për stendë standarde prej 12,7 m2 x 70 EURO/m2, baras me 840 EURO, nënshkruar nga përfaqësuesi i [redacted] sh.p.k Tiranë si dhe nga znj.[redacted] dhe znj.Eni Keqja, përfaqësues i UFSNK.

Si gjetje u konstatua:
Pagesa e kryer me tarifën 70 Euro/m^2 për stendën e vendosur nga Universiteti "F.S.Noli" Korçë në "Expo City", është kryer pa procedure prokurimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, pagesë e cila përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike, pasi për kryerjen e këtij aktiviteti, ish Ministria e Arsimit dhe e Sporteve duhej të përdorte ambientet e çdo Universiteti, si dhe publikimin e kritereve në faqen zyrtare të MASH dhe të 14 Universiteteve të vendit, apo mënyra të tjera komunikimi me medien e shkruar dhe elektronike.

II. Me urdhër shpenzimin nr. 317, datë 15.12.2016, të nënshkruar nga NA znj.[redacted]. dhe NZ znj[redacted]., është kryer likuidimi faturës së thjeshtë tatimore me nr. 10, datë 02.12.2016 për z. [redacted]. dhe në këtë kuadër janë bërë dhe pagesat pajisje kompjuterike në vlerën neto prej **1,382,000 lekë.** Në përshkrimin e kësaj faturë (bërë hyrje në UFSNK me nr. 78, date 2.12.2016) janë artikujt e mëposhtëm:

- ✓ Desktop kompjuter, copë 8 x 125,000= 1,000,000 lekë,
- ✓ Printer/skaner/fotokopje, copë 2 x 115,000= 230,000 lekë,
- ✓ Video projektor, copë 2 x 63,000 = 126,000 lekë,
- ✓ Ekran projeksioni EPAC, copë 1 x 26,000 = 26,000 lekë.

Shuma totale = **1,382,000 lekë**.

Blerja e këtyre pajisjeve është konsideruar si pjesë e nje projekti kërkimor-shkencor, në kuadër të programit "Për kërkim shkencor dhe ekselencë", të hartuar në muajin Qershor 2016 nga ana e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe që ka për titull projekti "Krijimi i Laboratorit Gjeo-Historik", me afat realizimi Korrik-Dhjetor 2016. Ky projekt është përgatitur nga drejtuësi i projektit/përgjegjësi i departamentit Prof. [redacted] dhe bashkëpunëtorët Prof.Ass [redacted] dhe [redacted]
Në pjesën "B" të punimit është lista e plotë ë pajisjeve dhe materialeve që do te blihen, ku përveç artikujve të mësipërm përfshihen dhe artikujt: soft kompjuterik, copë 1, vlera 69,000 lekë, harta fizike e Shqipërisë, harta e rrezikut Gjeologjik, harta e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, harta Hidro-gjeologjik e Shqipërisë, harta Gjeologjike, harta Pasurive Minerare, Atlas i botës, Glob i botës, fond librash etj. Shuma totale që do të financohet është 2,000,000 lekë.

Bashkëlidhur kësaj pagese, si dokumentacion justifikues janë:

- Urdhër i Rektorit z.[redacted] me nr.176, datë 06.12.2016, , që në bazë të Udhëzimit të MAS me nr.19, datë 31.5.2011 urdhëron të kryhet realizkmi i shpenzimeve për projektin ***"Krijimi i Laboratorit Gjeo-Historik".***
- Urdhër i Administratorit znj.[redacted] me nr.111, datë 07.12.2016, ku përcaktohet shprehimisht se,(citojmë):

Në mbështetje të udhëzimit të MASH nr.19, datë 31.5.2011**"Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të institucioneve arsimore të arsimit të lartë për kërkim fondamental dhe ekselencë, pika 14; në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 7, pik "d",** *" shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e të cilave* ***shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme*** *dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet kontraktor",* **nuk i nënshtrohen proceduravë të prokurimit publik , të kryhet realizmi për shpenzimet e kryera prej drejtuesit të projektit, në kuadër të projektit *"Krijimi i Laboratorit Gjeo-Historik", në programin 097-70.***

<u>Si gjetje u konstatua:</u>

- 1.Nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për blerje kompjuterësh dhe pajisjesh t tjera kompjuterike në shumën totale prej **1,382,000 lekë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi është pranuar fatura e thjeshtë tatimore e lëshuar nga subjekti privat [redacted] në vlerën 1,382,000 lekë pa asnjë procedura prokurimi, për artikujt:** desktop kompjuter, copë 8 x 125,000=1,000,000 lekë; printer/ skaner/ fotokopje, copë 2 x 115,000= 230,000 lekë; video projektor, copë 2 x 63,000 = 126,000 lekë; ekran projeksioni EPAC, copë 1 x 26,000 = 26,000 lekë.
- 2.Ndonëse projekti i kërkimit shkencor është paraqitur nga Departamenti që në muajin qershor të vitit 2016, miratimi për realizimin e fondeve është dhënë më datën 2 dhjetor 2016, **pra pas afro 6-muajsh.** Sipas Urdhrit të Rektorit me nr. 176, datë 06.12.2016, drejtuar administratorit, urdhërohet " të kryhet realizimi për shpenzimet e realizuara prej drejtuesit të projektit". Mungon bashkëlidhur pagesës vlerësimi i projektit nga Grupi i Vlerësimit të projekteve, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 11 dhe 12 të Udhëzimit të MASH me nr. 19, datë 31.05.2011, "Për detajimin e buxhetit ë IAL në programin "Për kërkim fondamental dhe ekselencë".
- 3**. Përfitimet e projektit, i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme,** (përndryshe sa ka shkruar Kancelarja në shkresën me nr.111, datë 07.12.2016), Më konkretisht, në faqen nr.8 të Projektit, në pikën A, është shkruar qartë se përfituesit nga projekti janë (citojmë):

1.Përfituesit direkt: *Studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit "Histori-Gjeografi" dhe*
2. Përfituesit indirekt: *Stafi akademik dhe ndihmës akademik i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.*

Për rrjedhojë, nuk duhet shmangur realizimi i procedurës së prokurimit publik, dhe për veprimet e mosveprimet hallkat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi.

- 4.**Mungon ngritja e komisionit për marrjen në dorëzim të këtij projekti, ku të vlerësohej niveli i realizimit të çdo komponenti të tij, si dhe akti i marrjes në dorëzim të projektit si një i tërë; bërje hyrje dhe kontabilizimi i projektit si AQPT**.

Sa sipër, është vepruar në shkelje të dispozitave të UMF nr.30, datë 2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", por janë bërë hyrje vetem një pjesë e komponentëve të tij: pajisjet kompjuterike.

III. Me urdhër shpenzimin nr. 330, datë 15.12.2016, të nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted] është kryer ***likuidimi për pritje e përcjellje zyrtre, në kuadër të kremtimit të 45 vjetorit të themelimit të UFSNK,*** për subjektin privat "[redacted] SHPK. Pagesa ësht kryer në bazë të faturës tatimore me nr. 587, datë 21.11.2016 për shumën prej **314,040 lekë.** Në vlerën e kësaj fature janë përfshirë këto komponentë:

- akomodimi për **38 persona**, me vlerën gjithsej 114,000 lekë;
- darkë zyrtare për **49 persona**, me vlerën gjithsej 76,440 lekë;
- shërbim koktej për **150 persona**, me vlerën gjithsej 123,600 lekë, (në kuadër të konferencës jubilare për festimet e 45 vjetorit të Universitetit)

Auditimi vëren se janë realizuar procedurat e prokurimit nëpërmjet SPE, për shpenzime të konferencës jubilare me fondin limit 275 mijë lekë pa TVSH.
Bashkëlidhur kësaj pagese, si dokumentacion justifikues janë:

- Urdhër Prokurimi i nënshkruar nga ana e Kancelarit znj.[redacted] me nr.90, datë 07.11.2017, ku kërkohet të prokurohen shërbimet e mëposhtme për 45 vjetorin e UFSNK; **për darkë zyrtare për 50 persona, kokteil për 150 persona dhe akomodim në hotel për 40 persona.**
- ***Kërkesa pa numër protokolli, pa datë dhe pa nënshkrim nga ana e rektorit z.Ali Jashari, me objekt kërkesë për prokurim me vlerë të vogël.***
- Program për festimet e 45 vjetorit të krijimit të UFSNK, nënshkruar nga ana e Rektorit z.[redacted] pa numër protokolli, datë 15 korrik 2017, në bazë të të cilit, përcaktohet programi i aktiviteteve. Në këtë dokument është përcaktuar ***"ngritja e grupit organizator për për festimin e 45 vjetorit të krijimit të Universitetit, qe do të kryesohet nga zv/rektorja znj. [redacted]". Bashkëlidhur këtij programi është një shkrese me tre rreshta e quajtur preventiv shpenzimesh, por që nuk pasqyron asnjë kosto financiare të përllogaritur por ka të evidentuar vetëm numrin e personave që mund të ftohen:*** **akomodim në hotel për 1 natë 30 persona. Darka zyrtare për 50 persona, kokteil për 150 persona**.
- Lista e 49 personave që morën pjesë në darkën zyrtare të organizuar me datën 17 nëntor 2017 dhe 38 personave që janë akomoduar në [redacted] Korça me këtë datë.

<u>Si gjetje u konstatua:</u>

1. Në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 3, të VKM nr.243, datë 15.5.1995, "Për pritjet, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhen delegacioneve të huaja", ndryshuar me VKM nr. 327 datë 26.6.1995, VKM me nr. 118, datë 26.2.1996 dhe VKM me nr. 258, datë 03.6.1999, nga titullari i institucionit (rektori i Universitetit), **në programin e miratuar nuk është përcaktuar numri i punonjësve të UFSNK dhe konfirmuar lista e personave që do të shoqërojnë delegacionin për realizimin e festimeve dhe konferencës jubilare**.
2. Në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 12 të këtij vendimi, që përcakton se (citojmë): " Pagesa e shpenzimeve të kryera do të bëhet në bazë të programit të miratuar për këtë qëllim, preventivit të shpenzimeve, dhe dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e tyre". Grupi i auditimit sjell në vëmendje se, **mungon nënshkrimi i çdo pjesëmarrësi në këtë event; nuk ka një preventiv të hollësishëm të shpenzimeve;**

nuk ka një analizë dhe pasqyrim të kostove financiare dhe të mënyrës se si është llogaritur fondi për këto aktivitete; kërkesa e rektorit që i është bashkëlidhur pagesës nuk ka as ekstremitetet shkresore dhe as nënshkrimet; Ndonëse sipas programit të aktiviteteve të datës 15 korrik 2017, ku është përcaktuar ***"ngritja e grupit organizator për festimin e 45 vjetorit të krijimit të Universitetit, që do të kryesohet nga zv/rektorja znj. [redacted]", nuk ka asnjë procesverbal dhe dokument që të vërtetojë aktivizimin dhe funksionimin e këtij komisioni dhe evidentimin e shpenzimeve të kryera.***

3. ***Fatura e lëshuar nga subjekti privat nuk pasqyron në mënyrë të detajuar listën e artikujve të shpenzuar, të pijeve dhe ushqimeve të konsumuara si dhe nuk ka kasë fiskale të printuar bashkëlidhur pagesës.***
4. Nga ana e auditimit konstatohet se janë respektuar normativat financiare për darkat zyrtare dhe akomodimin në hotel, **mirëpo nuk janë zbatuar normativat dhe janë shkelur kuotat maksimale për pritjet zyrtare për kategorinë/grupin e dytë të delegacioneve**. *Më konkretisht, nga 450 lekë/personi janë shpenzuar 824 lekë/person. Për pasojë është paguar padrejtësisht (824 -450)= 374 x 150=* ***56,100 lekë***

Tabela nr.... *(çmimet dhe vlera: Në lekë)*

	Kuotat sipas VKM			*Kuotat e shpenzuara në fakt*		
Përshkrimi i artikullit	***Persona***	***Normativa Financiare sipas VKM***	***Vlera e duhur***	***persona***	***Normativa e zbatuar***	***Paguar efektivisht***
Hotel	40	3000	120,000	38	3000	114,000
Darkë zyrtare	50	3500	175,000	49	1560	76,440
Pritje zyrtare	150	**450**	67,500	150	**824**	123,600

Burimi: *Përpunuar nga grupi i auditimit.*

Sa më sipër, bazuar në përcaktimet e pikës nr. 12 të këtij vendimi, që përcakton se (citojmë): "Tejkalimi i normativave financiare konsiderohet shkelje e disiplinës financiare dhe personat përgjegjës detyrohen të kthejnë vlerën e dëmit të shkaktuar", **shuma prej 56,100 lekë është dëm i arkëtueshëm nga rektori z. [redacted]**

IV. Me urdhër shpenzimin nr. 349, datë 29.12.2016, të nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted], është kryer likuidimi faturës tatimore të shitjes me nr. 784, datë 20.12.2016 për subjektin privat [redacted] SHPK në shumën **4,848,370 lekë.** Në përshkrimin e kësaj faturë (bërë hyrje në UFSNK me nr. 90, date 28.12.2016) është vënë përshkrimi : libra sipas listës bashkëngjitur. Edhe fatura tatimore ka të njëtin përshkrim "shitje sipas listës bashkëngjitur", por pa përcaktuar numrin e teksteve të shitura.

- Grupi i auditimit vëren se titullari i Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhërin e prokurimit me nr. 88, datë 28.10.2016, me fond limit 5,000,000 lekë pa TVSH, me proceduran "Kërkesë për propozim". Njësia e prokurimit përbëhet nga [redacted]. NJP sipas procesverbalit të së njëjtës ditë, (datë 28.10.2016), referuar udhërprokurimit, vendosi të ftojë për të marrë pjesë në tender të paktën pesë operatorë ekonomikë, aktiviteti i të cilëve ka lidhje me këtë objekt prokurimi, si më poshtë vijon: [redacted] ***dhe*** [redacted]
- Njoftimi i tenderit dhe formulari i njoftimit të kontratës së datës 22.11.2016 është botuar në buletinin e APP datë 30 nëntor 2016, ku operatori "[redacted]" sipas raportit përmbledhës të

hartuar nga Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, (i përbërë nga [redacted] dhe [redacted]) **<u>është shpallur fitues për vlerën 5,000,000 lekë, ose 100 % të fondit limit sipas urdhërit të prokurimit, duke e konsideruar "çmimi më i ulët".</u>**Në cilësinë e titullarit të AK, raporti përmbledhës është miratuar nga Kancelari znj.[redacted]

- Kontrata për furnizim të mallrave është lidhur dhe nënshkruar me datën 24.11.2016 midis kancelarit znj.[redacted] dhe përfaqësuesit të autorizuar të "[redacted]", zj.[redacted]. Komisioni i ngritur nga kancelari, me urdhërin nr.107, datë 02.12.2016, i përbërë nga [redacted]. ka nënshkruar akt-marrjen në dorëzim, dukë e nënvizuar se ***"mbas verifikimit të librave dhe krahasimit me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, rezultoi se librat e dorëzuara sipas faturës nr. 784, datë 20.12.2016 <u>janë dorëzuar në përputhje me të gjitha specifikimet teknike dhe përcaktuara nga AK dhe konform kushteve të kontratës</u>".***

<u>Konstatimet:</u>

1. **Çmimi total i ofertës financiare të paraqitur** në kuadër të kërkesës për propozim, nga ana e operatorit të vetëm pjesëmarrës **është në shumën 5,000,000 lekë pa TVSH, (ose kjo e barabartë me 100 % të vlerës së fondit limit sipas urdhër prokurimit). Po kështu, vlera e kontratës së nënshkruar nga OE me AK është në të njëjtën shumë prej 5,000,000 lekë, (ose e barabartë me 100 % të fondit limit)...**
2. Nga ana e AK nuk ka gjetur zbatim pika nr.4, e Nenit 39, "Kërkesa për propozim" e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku specifikohet se:*"Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë."*. **Nuk ka asnjë argumentim nga ana e NJP përse janë ftuar dy shtypshkronja dhe si mund të ofronin ato këtë nomenklaturë kaq të shtrirë të titujve të teksteve, një pjëse e madhe e tyre nga ente prodhuese të huaja.**
3. **Fatura tatimore e lëshuar nga subjekti privat, për palën e UFSNK është nënshkruar nga kancelari znj.[redacted], e cila është njëkohësisht në cilësinë e titullarit të AK,** në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014.
4. **Në DST janë listuar dhe kërkuar të prokurohen 607 tituj librash, të cilat janë bazuar në listat e "Kërkesave për botime për fondin e bibliotekës së fakultetit", të nënshkruara nga ana e dekanëve të fakulteteve. Nga ana e Fakulteteve nuk janë dërguar vetëm lista e titujve të librave që u nevojiten, por krahas janë shënuar sasitë, çmimet dhe vlerat e tyre. Grupi i angazhimit vëren se, çmimeve të vendosura nga dekanët dhe ato të vënë në ofertën e vetme/ fituese të paraqitura nga operatori ekonomik si në tituj, sasi, çmimet për njësi dhe në vlerë janë absolutisht të njëjta. Ky fakt krijon premisa për risk dhe procedura jorealiste të këtij prokurimi.** Mund të përmendim:

Lista dhe çmimet sipas fakulteteve dhe çmimet sipas OE:

Fakulteti Ekonomik:

Nr. Rendor në ofertë	*Kërkesa e Fakultetit*			*Oferta e OE*		
	Titulli	Sasi x çmim	vlera		Sasi x çmim	vlera

Nr.1	The dynamics of socio-economic development	1 copë x11,500	11,500		1 copë x11,500	11,500
Nr.22.	Kontabiliteti i kostos	5 copë x 3,500	17,500		5 copë x 3,500	17,500
Nr.23	Kontabiliteti i drejtimit	5 x3500	17,500		5 x3500	17,500
Nr.24	Bazat e biznesit,	30 x 1500	45,000		30 x 1500	45,000
Nr.25,	Administrim dhe menaxhim publik	30x 1500	45,000		30x 1500	45,000

Fakulteti Bujqësisë:

Nr. Rendor në ofertë	***Kërkesa e Fakultetit***				***Oferta e OE***	
	Titulli	Sasi x çmim	vlera		Sasi x çmim	vlera
Nr.1	Modelime Ekologjike	5 x 500	2,500		5 x 500	2,500
Nr.4.	Metodat e statistikës	5x2000	10,000		5x2000	10,000
Nr.10	Investime	5x1,000	5,000		5x1,000	5,000
Nr.12	Kontabiliteti	2x1,500	3,000		2x1,500	3,000
Nr.20	Mikroekonomia	3x1,800	5,400		3x1,800	5,400
Nr.35	Drejtim agrobiznesi	25 x1,250	31,250		25 x1,250	31,250
Nr.37	Kooperimi dhe integrimi në bujqësi	25x1,000	25,000		25x1,000	25,000
Nr.38	Drejtimi i biznesit bujqësor	25 x1,000	25,000		25 x1,000	25,000

Fakulteti Edukimit dhe Filologjisë:

Nr. Rendor në ofertë	***Kërkesa e Fakultetit***				***Oferta e OE***	
	Titulli	Sasi x çmim	vlera		Sasi x çmim	vlera
Nr.269	Studime linguistike	5x600	3,000		5x600	3,000
Nr.279.	Language and power	1x9,184	9,184		1x9,184	9,184
Nr.280	Hiroshima	1x21,173	21,173		1x21,173	21,173
Nr.281	Studing at university	1x11,359	11,359		1x11,359	11,359
etj	etj					

1. Nga ana e personit të ngarkuar me administrimin material **librat janë bërë hyrje me 28 dhjetor, ose 8 ditë pas akt-marrjes në dorëzim të lëshuar nga KMDM** dhe i janë bërë dalje bibliotekës së UFSNK.
2. **Nuk është respektuar furnizimi me 607 tituj të librave të prokuruar**, për të cilin OE ka fituar të drejtën e furnizimit në vlerën 5,000,000 lekë, por **ka furnizuar 596 tituj ose 11 tituj më pak duke mos realizuar kontratën për 151,630 lekë,** (vlera e faturës është 4,848,370 lekë). Ky fakt nuk është evidentuar nga Komisioni i marrjes në dorëzim të librave, por është shënuar se **"**mbas verifikimit të librave dhe krahasimit me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, **rezultoi se librat e dorëzuara sipas faturës nr. 784, datë 20.12.2016 janë dorëzuar në përputhje me të gjitha specifikimet teknike dhe përcaktuara nga AK dhe konform kushteve të kontratës"** dhe ky mosveprim i ngarkon ato me përgjegjësi. **Konstatohet se një numër titujsh janë ndryshuar me synimin për të siguruar botime më të fundit, por këto veprime nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe DST.**

3. Konstatohet nga shqyrtimi i pasqyrave që shoqërojnë bilancin, se në vitin 2016 që është bërë blerje me fond **5 milionë lekë** për krijim biblioteke, janë dhuruar libra sipas procesverbaleve të nënshkruara (mungojnë fletëdaljet) për institucionin Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja Korçë në shumën prej **1,163,800 lekë**, ose kjo sa 24 % e vlerës së shpenzuar efektivish për blerjen, gjë që tregon për një shpenzim pa efektivitet të kryer nga ana e UFSNK për këtë vlerë prej 1,163,800 lekë. *(Më hollësisht kjo çështje trajtohet tek kapitulli mbi daljen e aktiveve, në drejtimet e auditimit të kontabilitetit).*

V. Me urdhrin e Ministrit të MAS, me nr. 389, datë 15.07.2016, është shkarkuar nga detyra Administratori i UFSNK z.Ilir Sosoli, bazuar në rezultatet e raportit të kontrollit të Njësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion (NJKBA) në Kryeministri, dërguar me shkresën nr. 2470/1, datë 27.06.2016.

a. Në pikën nr.2 të këtij urdhri është përcaktuar sa vijon, (citojmë):
"**Funksionet e Kancelarit të Universitetit "F.S.Noli" Korçë të kryhen nga një punonjës i Universitetit i zgjedhur nga Këshilli i Administrimit** të Arsimit të Lartë deri në përzgjedhjen e Administratorit me konkurs të hapur sipas nenit 51 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH".

b. Bazuar në sa sipër, ish- Kryetare e Këshillit të Administrimit znj.[redacted] ka nënshkruar Vendimin nr.5 të Këshillit të Administrimit, datë 20.07.2016.Në pjesën përshkruese nënvizohet se KA i mbledhur me datën 20.7.2016 bazuar në urdhërin e mësipërm dhe "propozimin e Rektoratit të Universiteti për caktimin e punonjëses së universitetit, znj.[redacted], për kryerjen e funksioneve të Kancelarit të Universitetit, deri në zgjedhjen e Administratorit me konkurs, vendosi:
"1.Të emërojë në pozicionin e kancelarit punonjësen e Universiteti znj.[redacted] për kryerjen e funksioneve të kancelares së universitetit "F.S.Noli" deri në përzgjedhjen e Administratorit me konkurs të hapur sipas nenit 51, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH".

Nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjes së personelit, në dosjen e znj.[redacted], është administruar Vendimi nr.5 i Këshillit të Administrimit, datë 20.07.2016. Në pjesën përshkruese nënvizohet se KA i mbledhur me datën 20.7.2016 bazuar në urdhrin e mësipërm dhe "propozimin e Rektoratit të Universiteti për caktimin e punonjëses së universitetit, znj[redacted], për kryerjen e funksioneve të Kancelarit të universitetit, deri në zgjedhjen e Administratorit me konkurs, vendosi:
"1.Të ngarkojë në ushtrimin e funksionit të Kancelarit, në Universitetin "F.S.Noli" Korçë, punonjësen e Universiteti znj.[redacted] , deri në emërimin në këtë emision të Administratorit sipas kuadrit ligjor në fuqi".

c. Me shkresën nr.18/33 prot, datë 21.07.2016, rektori i UFSNK z.[redacted] i është drejtuar Ministrisë së Financave (DPHKBFP), **për konfirmimin e znj.[redacted] si nëpunës autorizues** të universitetit, konfirmuar nga ana e asaj Ministrie me nr. 10604 prot, datë 28.07.2016

d. Me Urdhrin nr.130, datë 26.07.2016, rektori i UFSNK z.[redacted], me propozim të Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, të datës 26.7.2016, nënshkruar nga Kryetari i Degës z.[redacted], ka caktuar pagën e znj.[redacted] si Kancelare të Universitetit, duke

përcaktuar se **do të paguhet me pagë sipas VKM nr.545, datë 11.08.2011 , i ndryshuar; sipas pikës 1/3 b, pikës 2/a,2/b,2/d të lidhjes nr.1 dhe grupit të diplomës 1 sipas lidhjes nr. 2, në kategorinë II-b, me pagë grupi 14,000 lekë, shtesë pozicioni 91,700 lekë dhe 2% shtesë mbi pagën e grupit për vjetërsi pune**.

Si gjetje u konstatua:

1. Kërkesa e MAS për caktimin e një personi për ushtrimin e funksionit të Kancelarit të UFSNK është në shkelje të nenit 51 të ligjit nr 80/2015, pasi funksioni i Kancelarit nuk parashikohet dhe rregullohet nga ky ligj i ri, por nga ligji i mëparshëm me nr.9741,datë 21.5.2007, i shfuqizuar. Prandaj, menjëherë duhet të hapej procedura për përzgjedhjen e Administratorit me konkurs të hapur.
2. Në bazë të përcaktimeve të germës "g", të nenit 49, "**Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ligjit nr. 80/2015, Bordi i Administrimit** "emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit";
1. Nga auditimi i praktikave shkresore (vendimeve të Këshillit të Administrimit), rezulton se në dosjen e vendimeve, ndodhet:
   - Vendimi i KA nr. 5, datë 20.7.2016, i cili në pjesën përshkruese nënvizohet se KA i mbledhur me datën 20.7.2016 bazuar në urdhërin e mësipërm dhe "propozimin e Rektoratit të Universiteti për caktimin e punonjëses së universitetit, znj.[redacted], për kryerjen e funksioneve të Kancelarit të universitetit, deri në zgjedhjen e Administratoit me konkurs, vendosi:

"1.Të ngarkojë në ushtrimin e funksionit të Kancelarit, në Universitetin "F.S.Noli" Korçë, punonjësen e Universiteti znj.[redacted] deri në emërimin në këtë emision të Administratorit sipas kuadrit ligjor në fuqi".

   - Bashkëlidhur këtij vendimi është shkresa e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me nr. 7596/1 prot., datë 24.08.2016, nënshkruar nga Ministri, drejtuar rektorit të Universitetit z.[redacted] (protokolluar në UFSNK me nr. 24/7 datë 25.08.2016), me objekt: "***Kthim përgjigje***", referuar shkresës së dërguar nga ana e rektorit me nr. 24/6 prot, datë 20.07.2016 "Propozim për kancelarin e universitetit".

Në këtë përgjigje Ministri i Arsimit dhe Sporteve është shprehur sa vijon (citojmë):
"Bazuar në VKM nr.875, datë 18.6.2008 "Për përcaktimin e të drejtave dhe detyrave dhe për procedurën e përzgjedhjes dhe të emërimit të kancelarit të institucioneve publike të arsimit të lartë" dhe ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH", **znj.[redacted] nuk emërohet në pozicionin e kancelarit të Universitetit, por ngarkohet me ushtrimin e funksionit të kancelarit në këtë Universitet,** deri në emërimin në këtë pozicion të administratorit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi".

2. Pas marrjes së këtij qëndrimi, nga ana e Rektorit të UFSNK nuk është kryer anulimi i pagës së caktuar me Urdhrin nr.130, datë 26.07.2016,veprim që ngarkon me përgjegjësi rektorin e UFSNK z.[redacted] dhe Përgjegjësin e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës z.[redacted], që kanë caktuar e miratuar pagën e znj.[redacted] si Kancelare të Universitetit, pa miratim të organit të emërtesës.
3. Pagesa e kryer për Administratoren e e komanduar në detyre, të caktuar për të ushtruar funksionet, nuk është e bazuar ligjërisht. Për pasojë, pagesa e kryer për znj.[redacted] për periudhën 20 Korrik 2016 deri më 4 Prill 2017, në shumën **331,221 lekë gjithsej** është **shpenzim i kryer në shkelje të disiplinës financiare, me dëm ekonomik për fondet publike**. Në kohën e caktimit për të kryer këto përgjegjësi të

ushtrimit të funksionit, znj.[redacted] kryente detyrën e specialistit në Drejtorinë e Financës pranë Rektoratit (emëruar me Urdhrin e Kancelarit z.[redacted], datë 30/4/2014, ku është paguar me pagë bruto prej 65400 lekë, pozicion në të cilin (Specialist në Degën e Financës të rektoratit është ri caktuar me urdhrin e rektorit nr. 55, datë 19.4.2017. "Për emërim personeli administrativ".

Në mënyrë të përmbledhur për gjithë periudhën që znj.[redacted] ka ushtruar funksionin e kancelares, është trajtuar padrejtësisht sa vijon:

				Te ardhurat sipas emerteses Kancelar				Te ardhurat sipas emerteses Specialist				
Emer, mbiemer	**Muaji**	**Emertim**	**Klasa**	**Paga bruto**	**Sig. Shoq**	**Tatim**	**Paga neto**	**Paga bruto**	**Sig. Shoq**	**Tatim**	**Paga neto**	**Diferenca**
[redacted]	7	Specialiste	IV-a	82091	9194	6772	66125	65400	7325	4602	53473	12652
[redacted]	8	Kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	9	Kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	10	Kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	11	Kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	12	Kancelare		111300	11280	11869	88151	65400	7325	4602	53473	34678
[redacted]	1	Kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	2	Kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	3	Kancelare		119600	11110	10569	97921	68600	7683	5018	55899	42022
[redacted]	4	Kancelare	IV-a	101055	10936	9237	80882	68600	7683	5018	55899	24983
Shuma				**1081845**	**109179**	**101861**	**870805**	**660400**	**73964**	**46852**	**539584**	**331,221**

Analizuar sipas viteve 2016 dhe 2017 paraqitet kjo situatë:

Viti 2016

Emer, mbiemer	**Muaji**	**Emertim**	**Klasa**	**Paga bruto**	**Sig. Shoq**	**Tatim**	**Paga neto**	**Paga bruto**	**Sig. Shoq**	**Tatim**	**Paga neto**	
[redacted]	1	specialiste	IV-a	65400	7325	4602	53473	65400	7325	4602	53473	0
[redacted]	2	specialiste	IV-a	65400	7325	4602	53473	65400	7325	4602	53473	0
[redacted]	3	specialiste	IV-a	65400	7325	4602	53473	65400	7325	4602	53473	0
[redacted]	4	specialiste	IV-a	65400	7325	4602	53473	65400	7325	4602	53473	0
[redacted]	5	specialiste	IV-a	65400	7325	4602	53473	65400	7325	4602	53473	0
[redacted]	6	specialiste	IV-a	65400	7325	4602	53473	65400	7325	4602	53473	0
[redacted]	7	specialiste	IV-a	82091	9194	6772	66125	65400	7325	4602	53473	12652
[redacted]	8	kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	9	kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	10	kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	11	kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	12	kancelare		111300	11280	11869	88151	65400	7325	4602	53473	34678
Shuma				**1030991**	**108863**	**88529**	**833599**	**784800**	**87898**	**55224**	**641678**	**191921**

Viti 2017

[redacted]	**Muaji**	kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	2	kancelare		111300	11110	10569	89621	65400	7325	4602	53473	36148
[redacted]	3	kancelare		119600	11110	10569	97921	68600	7683	5018	55899	42022
[redacted]	4	kancelare	IV-a	101055	10936	9237	80882	68600	7683	5018	55899	24983
[redacted]	5	specialiste finance	IV-a	68600	7683	5018	55899	68600	7683	5018	55899	0
[redacted]	6	specialiste finance	IV-a	68600	7683	5018	55899	68600	7683	5018	55899	0
[redacted]	7	specialiste finance	IV-a	68600	7683	5018	55899	68600	7683	5018	55899	0
Shuma												**139300**

Burimi: Drejtoria e Financës, UFSNK

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/6 prot, datë 06.06.2018, "Objeksione", (nënshkruar nga ana e Rektorit të Universitetit dhe Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe promocionit)", *janë* ***dërguar shpjegimet ku është theksuar se:***

"... pagesa e znj.[redacted] është bërë mbi bazë e vendimit nr.5 datë 20.7.2016 të Këshillit të Administrimit që emëronte atë në pozicionin e Kancelares.Ky vemdim u ndryhuar me "ngarkohet në ushtrimin e funksionit të kancelarit, pas kthimit të përgjigjes nga MAS me shkresën nr. 7596/1 datë 24.08.2016, pra pas më shumë se 1 muaj"

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se nuk janë ndërmarrë nga ana e Rektorit dhe Drejtorisë së Burimeve Njer1zore veprimet e duhura për korrigjimin e vendimit për caktimin e pagës, ashtu siç është shprehur MAS, e cila ka komanduar specialisten në atë detyrë.

Pretendimet e subjektit të audituar nuk qëndrojnë, ndaj nuk merren parasysh.

BANKA 2017:

Nga auditimi i shpenzimeve operative konstatohet:

I. Me urdhër shpenzimin nr. 168, datë 25.07.2017, të nënshkruar nga NA [redacted] dhe NZ znj.[redacted], është kryer ***likuidimi i shpenzimeve për aktivitet, në kuadër të kremtimit të Ditës Akademike të Universitetit,*** për subjektin privat "[redacted]". Pagesa ësht kryer në bazë të faturës së thjeshtë tatimore me nr. 8, datë 18.07.2017 për shumën prej **45,000 lekë.** Në vlerën e kësaj fature është shënuar **"Katering, për 100 persona gjithsej, në vlerën prej 45,000 lekë".** Praktika e prokurimit është zhvilluar në rrugë shkresore.

Bashkëlidhur kësaj pagese, si dokumentacion justifikues janë:

- Urdhër Prokurimi i nënshkruar nga ana e Kancelarit me nr.40, datë 03.07.2017, ku kërkohet të prokurohen **kokteil për 100 persona** si aktivitet për personelin me fndin limit 450 mijë lekë pa TVSH..
- Kërkesa e datës12 qershor 2017 e nënshkrim nga ana e rektorit z.[redacted], me objekt "Kërkesë për përgatitjen e ditës Akademike dhe fillimin e vitit të ri akademik"
- Kërkesa e datës3 korrik 2017 e rektorit z.[redacted] për prokurim me vlerë të vogël dhe fond 45,000 lekë.

- Procesverbali i prokurimit me vlerë nën 100 mijë lekë, nënshkruar nga [redacted], ku komisioni pas testimit te tregut dhe vlerësimit të ofertave të tre ofertuesve "[redacted]", "[redacted]" dhe "[redacted]", ka përzgjedhur ofertën e subjektit [redacted] me 450 lekë/person.

Si gjetje u konstatua:

1. Në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 3, të VKM nr.243, datë 15.5.1995, "Për pritjet, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhen delegacioneve të huaja", ndryshuar me VKM nr. 327 datë 26.6.1995, VKM me nr. 118, datë 26.2.1996 dhe VKM me nr. 258, datë 03.6.1999, nga titullari i institucionit (rektori i Universitetit), **në programin e miratuar nuk është përcaktuar dhe konfirmuar lista e personave të UFSNK që do kanë marrë pjesë në Ditën Akademike.**
2. Në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 12 të këtij vendimi, që përcakton se (citojmë): " Pagesa e shpenzimeve të kryera do të bëhet në bazë të programit të miratuar për këtë qëllim, preventivit të shpenzimeve, dhe dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e tyre". Grupi i auditimit sjell në vëmendje se, **nuk ka një preventiv të hollësishëm të shpenzimeve; nuk ka një analizë dhe pasqyrim të kostove financiare dhe të mënyrës se si është llogaritur fondi për këto aktivitete;**
3. **Kërkesa e rektorit është për zhvillim koktej, dhe sipas faturës, është realizuar "katering".**
4. ***Fatura e lëshuar nga subjekti privat nuk pasqyron në mënyrë të detajuar listën e artikujve të shpenzuar, të pijeve dhe ushqimeve të konsumuara si dhe nuk ka kasë fiskale të printuar bashkëlidhur pagesës.***
5. Nga ana e auditimit konstatohet se janë respektur normativat financiare për pritjet zyrtare për kategorinë/grupin e dytë të delegacioneve.

II. Në muajin Janar 2017, në bazë të Urdhër shpenzimit me nr. 7, datë 20.01.2017, (nënshkruar nga ish-Kancelarja [redacted] dhe Përgjegjësja e Degës së Financës [redacted] është likuiduar Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), në shumën prej 1,965,000 lekë me objekt "Vlerësimin e akreditimit të Universitetit "Fan S.Noli", Korçë". Kjo pagesë është kryer sipas urdhrit nr.3, datë 13.01.2017, të Kancelares znj.[redacted] . Dokumentacioni justifikues i paraqitur bashkëlidhur kërkesës me nr. 8 prot, datë 13.01.2017 të **Drejtorit të APAAL znj.[redacted], e cila është njëkohësisht dhe anëtare e Bordit të Administrimit të këtij Universiteti**, për kryerjen e pagesës me emërtimin ***"Faturë arkëtimi"***, është një fletë formati e printuar në A4, jo sipas modelit të miratuar me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 101 "Përmbajtja e faturës", pasi nuk ka të dhëna të detyrueshme identifikuese të tilla si: numrin serial të faturës tatimore, numrin e identifikimit të TVSH-së të personit të tatueshëm që kryen furnizimin e mallrave apo shërbimeve, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji, me ndryshimet.
Rezulton se, kjo pagesë është bazuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave nr. 29/1, datë 16.08.2016 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë". Ky udhëzim mbështetet në nenin 62, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", **aktualisht i shfuqizuar**. Kjo pagesë nuk ka mbështetje ligjore dhe është e pajustifikuar.

III. Me urdhër shpenzimin nr. 175, datë 01.08.2017, të nënshkruar nga NA znj.[redacted].e dhe NZ znj.[redacted]., është kryer likuidimi i pagave dhe në këtë kuadër janë bërë dhe pagesat për orët jashtë orarit të punonjësve të Universitetit në vlerën neto prej **712, 421 lekë.**
Bashkëlidhur kësaj pagese, si dokumentacion justifikues janë:

- Urdhër i Rektorit z.[redacted] me nr.27/1, datë 01.02.2017, në bazë të të cilit, për periudhën Shkurt-Qershor 2017 ***"një pjesë e punonjësve ne Rektorat dhe të EDE-së, do të angazhohen për të kryer punë masive në rikonstruksionin e EDE-së, në transportin e tjegullave nga godina e re e universitetit dhe magazinimin e tyre pranë EDE-së, si dhe përgatitjen e tyre me rastin e akreditimit të institucionit".***
- Urdhër i Administratorit znj.[redacted] me nr.110, datë 26.07.2017, "Për pagesën e orëve jashtë orarit të punonjësve të Universitetit". Në pikën nr. 1 të këtij Urdhri përcaktohet ***kryerja e pagesës për punë të kryer jashtë kohës normale të punës, për periudhën Shkurt-Qershor 2017, në zbatim të Urdhrit të Rektorit z.[redacted] me nr.27/1, datë 01.02.2017.***

<u>Si gjetje u konstatua:</u>
Për vitet 2017, janë kryer pagesa për punë të kryer jashtë kohës normale të saj për vlerën. 712,421 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 463, datë 16.6.2011"Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore ", të ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr. 16, datë 20.7.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011".
Pagesa e kryer është e pajustifikuar dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.463, date 16.06.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimit nr. 511, date 24.10.2002, te Këshillit te Ministrave, "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit ne institucionet shtetërore", pika 5 e Kreut I dhe pika 2 e Kreut II;

5. *Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohet të kryejë orë shtesë.*
Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, orët shtesë në punë i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.
Nëpunësi apo punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari operacionale, orët shtesë në punë, si rregull, i kompensohen me pushim, të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00-6:00.
Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuesit këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë.
Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page, ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00-6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtesë të kësaj page.
*Rregullat mbi procedurën e kryerjes së pagesës së orëve shtesë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. (**ndryshuar me VKM nr.463, dt.16.06.2011**)*

Si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr.16, datë 20.07.2011,"Mbi zbatimin e Vendimit nr. 463,datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave", ku specifikohet se,

"Për te kryer një detyre te caktuar jashtë kohës normale te punës për te gjithë punonjësit e administratës, titullari i institucionit miraton urdhrin përkatës për detyrën qe duhet te kryhet, kohëzgjatjen e saj dhe punonjësit qe ngarkohen ne kryerjen e kësaj detyre. Njësitë e personelit ne bashkëpunim me eprorin e punonjësit qe caktohet te punoje jashtë kohës normale te punës, marrin masat e duhura për te siguruar realizimin e detyrës se caktuar, si dhe për te përcaktuar kohen e kryerjes se pushimit te përllogaritur sipas pikës 1 te këtij udhëzimi. ***Në asnjë rast, punonjësi i administratës publike që kryen veprimtari administrative nuk kompensohet financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por kompensohet vetëm me orë/ditë pushimi.***

3. Nëpunësi dhe ***punonjësi i administratës që kryen veprimtari operacionale****, si rregull, kompensohet me ore/dite pushimi. Mund te kompensohen financiarisht punonjësit qe kryejnë veprimtari te drejtpërdrejtë operacionale vetëm kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme:*

a) kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtese te punuara, për shkak te natyrës së veprimtarisë operacionale, ndërprerja e së cilës cenon funksionalitetin e institucionit,

b) kur institucioni ka fonde te miratuara për këtë qellim në buxhetin vjetor te tij.

4. Me veprimtari operacionale, ne kuptim te këtij vendimi konsiderohen ato veprimtari te cilat kane një kohëzgjatje te pandërprerë (sistem 24 orësh/sistem gatishmërie) si dhe veprimtaria e mësimdhënies ne arsimin e larte universitar. Ne raste specifike, merret miratimi i Ministrit te Financave."

Parregullsitë:

1. Nuk ka asnjë produkt dhe këto pagesa janë kryer pa asnjë dokumentim ligjor për të argumentuar dhe konfirmuar natyrën dhe volumin e punës së kryer nga këto punonjës. Është e pashpjegueshme pagesa për disa kategori të referua në urdhërshpenzim, që nuk kanë asnjë lidhje me procesin e punës të referuar në urdhrin e Rektorit, ku autorizohet kryerja e kësaj pune jashtë orarit me qëllim **"transportin e tjegullave nga godina e re e universitetit dhe magazinimin e tyre pranë EDE-së,** si dhe përgatitjen e tyre me rastin e akreditimit të institucionit". Nuk ka asnjë dokument si preventiv, situacion apo procesverbal që të tregojë produktin dhe punën e kryer, sa shënuar në këto kohë shënues.
2. Konstatohen orë pune të pa justifikuara e të paargumentuara. *Më konkretisht për v.2017 janë llogaritur e kryer pagesat në shumën* **712,421 lekë**:
   - ✓ Në **dy raste** këto pagesa janë kryer për punonjës të administratës së Rektoratit, ***(përkatësisht z[redacted] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të infrastrukturës dhe Asistencës Teknike dhe znj[redacted] me detyrë administratore e vlerave materiale)*** janë kryer për **180 orë në një periudhë shtrirje prej 5-muajsh (shkurt - qershor),** dhe paguar përkatësisht në shumën bruto **107,386 lekë dhe 81,307 lekë**;
   - ✓ Në **katër raste** këto pagesa për punonjës të **EDE,** ***me detyrë elektricist, marangoz, kaldajist dhe punëtor fushe***, për **110 orë në një periudhë shtrirje prej 5-muajsh;**

- ✓ **Në një rast** këto pagesa për dy punonjës të administratës së Rektoratit janë kryer për **180 orë në një periudhë shtrirje prej 5-muajsh.** Kjo situatë jo vetëm që nuk vërtetohet kontabilisht dhe në planin dokumentar, por edhe fizikisht i është e pamundur, pasi janë konsideruar vetëm 4 ditë pushim në 40 ditë qe janë ditët e pushimit javor (e shtunë dhe e diele për këtë periudhë)...

3. Natyrat e punëve nuk janë te natyrës se veprimtarisë operacionale, ndërprerja e se cilës cenon funksionalitetin e institucionit, nëse do te jepej leje e pagueshme. Nuk ka asnjë dokument që te justifikojë kryerjen e këtij shpenzimi.

4. Bazuar në buxhetin e miratuar për v.2017, të miratuar, rezulton se institucioni nuk ka fonde te miratuara për këtë qellim ne buxhetin vjetor te tij, kërkesë kjo e pikës 3/b të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 16, datë 20.07.2011, "Mbi zbatimin e Vendimit nr. 463, datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave".

5. Pagesa për orët shtesë nuk është kryer çdo muaj, në shkelje të pikës 5, të UMF nr.16, datë 20.07.2011, "Mbi zbatimin e Vendimit nr. 463, datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave", ku specifikohet se, ***"Masa e kompensimit përfshihet ne listë pagesën e muajit kur janë kryer oret shtese".*** Në fakt, orët e pretenduara si të kryera në muajin shkurt, mars, prill, maj dhe qershor janë shlyer në listë pagesën e muajit korrik 2017.

6. Pagesat e kryera janë të pa bazuara dhe të paargumentuara sa paguar gjatë muajit gusht 2017 për këto përfitues, është si vijon:

Nr	Emri dhe mbiemri I punonjësit	Emertesa sipas struktures se miratuar	Paga Bruto mujore	ore kohe punes jashte orarit	tarife per ore pune	pagesa kohe e punes jashte orarit	pagesa bruto
1	[redacted]	adm.vl.materiale	53000	180	452	81307	81307
2	[redacted]	P..Sek. Shërbim.& Blerjeve	70000	50	597	29830	29830
3	[redacted]	Punonj. Sherbimi (pastruese)	42840	90	365	32860	32860
4	[redacted]	Punonj. Sherbimi (pastruese)	42840	80	365	29209	29209
5	[redacted]	Punonj. Sherbimi (pastruese)	42840	85	365	31035	31035
6	[redacted]	Punonj. Sherbimi (kaldajist)	42751	**105**	364	38257	38257
7	[redacted]	Punonj. Sherbimi (kaldajist)	37407	**110**	319	35069	35069
8	[redacted]	puntor fushe	33400	**30**	285	8540	8540
9	[redacted]	Punonj. Sherbimi (marangoz)	39745	**110**	339	37261	37261
10	[redacted]	Punonj. Sherbimi (elektricist)	36072	**110**	307	33818	33818
11	[redacted]	puntor fushe	40080	**110**	342	37575	37575
12	[redacted]	Punonj. Shërbimi (pastruese)	42840	**50**	365	18256	18256
13	[redacted]	pergjegjesi sek infras asistek	70000	180	597	107386	107386
14	[redacted]	Pergjegjes Sektori E.D.E	82000	30	699	20966	20966
15	[redacted]	Magazinjere	44063	30	376	11266	11266

16	[redacted]	PUNONJES SHERBIMI	43085	50	367	18360	18360
17	[redacted]	puntor fushe	41750	30	356	10675	10675
18	[redacted]	Punetor fushe	41750	30	356	10675	10675
19	[redacted]	Punetor fushe	41750	30	356	10675	10675
20	[redacted]	PUNONJES SHERBIMI	42240	50	360	18000	18000
21	[redacted]	PUNONJES SHERBIMI	42840	75	365	27384	27384
22	[redacted]	kaldajist	38743	50	330	16510	16510
23	[redacted]	PUNONJES SHERBIMI	42840	50	365	18256	18256
24	[redacted]	PUNONJES FUSHE	34736	30	296	8881	8881
25	[redacted]	PUNONJESE SHERBIMI	39840	60	340	20373	20373
	SHUMA			**1805**		**712,421**	**712,421**

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/5 prot, datë 06.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit)", *janë* ***ridërguar komentet dhe shpjegimet e bëra dhe për aktkonstatimet , duke ritheksuar se:***

"... ka patur arsye për kryerjen e punës jashtë kohës normale nga punonjësit e universitetit dhe kryerjen e pagesave"
Gjatë periudhës ***shkurt 2018-Qershor 2018****, institucioni UFSNK ka kryer një sërë veprimtarish. Këto veprimtari janë kryer në funksion të:*
1.Akreditimit të Universitetit ;

2.Marrja në administrim të institucionit , të godinës ish-konvikti i shkollës mekanike dhe përshtatja e tij në mjediset aktuale

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pavarësisht sa pretendohet për autonominë institucionale të Universitetit,**mungojnë rregulloret e miratuara financiare nga ana e strukturave të tij drejtuese mbi mënyrën e administrimit të të ardhurave.** Grupi i auditimit,**analizoi gjithë sistemin e dokumentacionit të administruar me objeksionet proceset e shënuara në observacion lidhur me aktivitetet dhe operacionet e kryera gjatë periudhës shkurt- prill 2017 dhe prill- qershor 2017, janë punë dhe operacione të vitit 2017, sipas urdhër shpenzimit nr. 175, datë 01.08.2017.**
Për sa sipër, vlera e pagesës, ne kushtet kur pagesa nuk eshte kryer sipas muajve kur orët jashtë orarit janë realizuar, konsiderohet **shpenzim pa efektivitet** dhe shkelje me kërkesat e VKM nr. 463, datë 16.6.2011"Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore ", të ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr. 16, datë 20.7.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011".

Për sa më siper rekomandojmë:
Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **712,421 lekë** , konsideruar si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit

IV. Me **urdhër shpenzimin nr.184, datë 10.08.2017**, nënshkruar nga NA znj[redacted] dhe NZ znj.[redacted], është likuiduar subjekti privat "[redacted]" në shumën **594,480** lekë, me objekt "***Shërbime të tjera***", sipas faturës tatimore nr..140, datë 31.07.2017. Për palën blerëse, Universitetin, kjo faturë është konfirmuar e nënshkruar nga z.[redacted], [redacted] dhe [redacted]. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit jusitifkues bashkëlidhur:

- Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr.29. datë 15.05.2017, me fondin limit 505,200 lekë pa TVSH, nënshkruar nga Administratori me objekt: ***"Dezinfektim, deratizim dhe deinsektizim "*** **me 7 (shtatë) zëra dhe me sipërfaqe të përgjithshme prej 10,600 m2, si më poshtë:**

Nr.	Ambientet	Sipërfaqja m2
1.	Godina e Fak.Ekonomik	2,000
2.	Godina e Fak.Bujqësisë	1,400
3.	Godina e Fak.SHNH	2,000
4.	Godina e Fak.FEF	1,800
5.	Ambiente të jashtme	1,400
6.	Godina e Dep.Infermierisë	1,000
7.	EDE (ambjente të jashtme dhe te brendshme)	1,000
	Sipërfaqe gjithsej	10,600 m2

Të njëjtat zëra, me të njëjtën vlerë dhe sasi m2 përmban dhe kërkesa e datës 15.5.2017, e hartuar nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Infrastrukturës dhe asaj teknike z.[redacted]. ***Ky dokument është i pa nënshkruar nga z.***[redacted]

- Ftesa për ofertë që është publikuar në faqen zyrtare të APP-së, njofton kryerjen e procedurës së prokurimit publik me vlera të vogla me datën 24.05.2017, për fondin limit 505,200 lekë, duke vendosur tek pjesa e specifikimeve ambientet ku do të kryhen shërbimi ***"DDD"*** **me 8 (tetë) zëra dhe me sipërfaqe të përgjithshme prej 11,800 m2, si më poshtë:**

Nr.	Ambientet	Sipërfaqja m2
1.	Godina e Fak.Ekonomik	2,000
2.	Godina e Fak.Bujqësisë	1,400
3.	Godina e Fak.SHNH	2,000
4.	Godina e Fak.FEF	1,800
5.	Godina e ish¬Shtëpia Ushtarkëve	1,200
6.	Ambiente të jashtme	1,400
7.	Godina e Dep.Infermierisë	1,000
8.	EDE (ambjente të jashtme dhe te brendshme)	1,000
	Sipërfaqe gjithsej	11,800 m2

- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, i datës 10.7.2017 , (formulari nr.6), për rastet e mosrealizimit të procedurës së prokurimit në sistem), nënshkruar nga z.[redacted]. Sipas këtij procesverbali, është parashikuar kryerja nga një herë e secilit prej këtyre proceseve: dezinfektim, deratizim dhe deinsektizim. Rezulton sipas këtij p/v se për fondin e përllogaritur prej 550, 000 lekë pa TVSH, janë marrë treguesit e çmimeve nga operatorët ekonomikë për këtë shërbim si vijon:

1. [redacted]*, me vlerë 495,400 lekë;*

2. [redacted], *me vlerë 503,200 lekë;*
3. [redacted], *me vlerë 505,120 leke;*

Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, pasi ka shqyrtuar treguesit e Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, pasi ka shqyrtuar treguesit e çmimit, ka vendosur të përcaktojë fitues subjektin privat "[redacted]

- Situacion punimesh në vlerën **594,480** lekë me TVSH, me objekt **"*Dezinfektim, deratizim dhe deinsektizim* "** (DDD), nënshkruar nga Administratori znj.[redacted] dhe sipërmarrësi [redacted]
- Akt- marrje në dorëzim punimesh, datë 31.07.2017, në vlerën **594,480** lekë, me objekt "Dezinfektim, deratizim dhe deinsektizim ". nënshkruar nga nga z.[redacted] dhe [redacted]. Sipas këtij akti marrje në dorëzim, përfaqësuesit e Universitetit janë shprehur se "sipërmarrësi i ka kryer të gjitha shërbimet e DDD, në të gjithë sipërfaqen sipas planimetrisë. Në këtë akt marrje në dorëzim janë specifikuar sipërfaqet sipas ambienteve ku është kryer ky shërbim:

Nr.	Ambientet	Sipërfaqja m2
1.	Godina e Fak.Ekonomik	2,000
2.	Godina e Fak.Bujqësisë	1,400
3.	Godina e Fak.SHNH	2,000
4.	Godina e Fak.FEF	1,800
5.	Godina e ish¬Shtëpia Ushtarkëve	1,200
6.	Ambiente të jashtme	1,400
7.	Godina e Dep.Infermierisë	1,000
8.	EDE (ambjente të jashtme dhe te brendshme)	1,000
	Sipërfaqe gjithsej	11,800 m2

- Me vendimin nr.89, datë 5.6.2017, Administratori ka anuluar prokurimin me vlerë të vogël dhe fondin limit prej 505,200 lekë pa TVSH, për arsye tërheqje dhe mospjesëmarrje nga operatorët ekonomik (OE) të zhvilluar me 24.5.2017.
- Me vendimin nr.96, datë 12.6.2017, Administratori ka anuluar prokurimin me vlerë të vogël dhe fondin limit prej 505,200 lekë pa TVSH, për arsye tërheqje dhe mospjesëmarrje nga operatorët ekonomikë (OE) të zhvilluar me 7.6.2017.

Si gjetje u konstatua:

Pagesa e kryer **për 1200 m2 fiktivisht për shërbimin e DDD** në ambientet Godina e ish-Shtëpia Ushtarakëve, **zë 10,16% % të sipërfaqes së përgjithshme prej 11,800 m2 dhe në vlerën e përgjithshme të shlyer prej 594,480 lekë x 10,16%= 60,455 lekë,** për të cilën është nënshkruar akt marrje në dorëzim e këtij shërbimi është procedurë fiktive, në kundërshtim me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe kërkesat e ligjit nr. 9228, "Për kontabilitetin" i ndryshuar. **Kjo pagesë, e cila lidhet me një objekt, mbi të cilin UFSNK në periudhën e kryerjes së prokurimit, nuk ka patur asnjë të drejtë pronësie e përdorimi, pasi kanë ndodhur këto transferime të kësaj pasurie si vijon:**

- ✓ Me **VKM nr. 530, datë 07.08.2012,** "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te MASH për Universitetin "F.S.Noli" Korçë, të pronës nr. 549 me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...". Për sa sipër, është mbajtur akt dorëzimi i pronës, nga anëtarët e

komisioneve respektive dhe është nënshkruar akt dorëzimi me nr. 286 prot., datë 27.12.2012 të MM dhe me nr. 323 prot datë 15.01.2013 të MASH

- ✓ Me **VKM nr. 76, datë 28.01.2015,** "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MAS te MMSR për Drejtorinë Rajonale të SHKP Korçë, të aneksit të godinës me emërtimin "Ish Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...". Ka kaluar sipërfaqja prej 219 m2 për DRSHKP.
- ✓ Me **VKM nr. 152, datë 29.02.2016,** "Për kalimin në pronësi nga MAS te Bashkia Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë". ***Sipas pikës nr.2 të këtij vendimi, VKM nr.530, datë 7.8.2102 i ndryshuar, shfuqizohet.***
- ✓ Me **VKM nr. 193, datë 15.03.2017,** "Për një ndryshim në VKM nr. 152, datë 29.2.2016 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga MAS te MMSR për Drejtorinë rajonale të SHKP Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...dhe për kalimin në përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me sipërfaqe 348 m2.

***Sa më sipër*, nga data 19.2.2016 UFSNK nuk ka asnjë të drejtë pronësore e administrimi mbi objektin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë". Përfshirja në situacion e këtij shpenzimi prej <u>60,455 lekë</u> dhe nënshkrimi si shpenzim i kryer përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për fondet publike, për zhdëmtim nga subjekti "[redacted] ose përndryshe nga komisioni marrjes dorëzim.**

V. Për marrjen në dorëzim të punimeve dhe shërbimeve për automjetet që disponon Universiteti , për disa raste u konstatuan pagesa te pajustifikuara për 95.880 lek si vijon:

A.Me urdhër **shpenzimin nr. 150, datë 07.07.2017**, nënshkruar nga NA znj[redacted] dhe NZ znj.[redacted] është likuiduar subjekti privat "Josif Deliu" SHPK në shumën 32,400 lekë me TVSH, me objekt **"*Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti*"**, sipas faturës tatimore nr.422, datë 22.06.2017 , dhe fletëhyrjes së magazinës së UFSNK me nr. 17, datë 6.7.2017. Për palën blerëse, Universitetin, fatura është nënshkruar nga shoferi [redacted]. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr.37 datë 13.06.2017, me fondin limit 29,400 lekë pa TVSH, nënshkruar nga Administratori znj.[redacted] me objekt: **"*Shërbime për autobuzin* [redacted]**", bazuar në kërkesën e shoferit [redacted] datë 13.6.2017.
- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, për zhvillimin e procedurës së blerjes në sistem elektronik me datën 15.6.2017, ku oferta e operatorit "[redacted] " SHPK është 27 mijë lekë pa TVSH.

B. Me urdhër **shpenzimin nr. 256, datë 14.11.2017**, nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted], është likuiduar subjekti privat [redacted]" SHPK në shumën 27,600 leke me TVSH, me objekt **"*Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti*"**, sipas faturës tatimore nr.1, datë 31.10.2017, dhe fletëhyrjes së magazinës së UFSNK me nr. 38, datë 8.11.2017. Për palën

blerëse, Universitetin, fatura është nënshkruar nga shoferi Fedi Qirjo. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr.61, datë 25.10.2017, me fondin limit 25,200 lekë pa TVSH, nënshkruar nga Administratori znj.[redacted] me objekt: **"*Shërbime për automjetin AA 272 AT*"**, bazuar në kërkesën e shoferit [redacted] datë 25.10.2017.
- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, për zhvillimin e procedurës së blerjes në sistem elektronik me datën 15.6.2017, ku oferta e operatorit "[redacted]" shpk" " shpk është 23 mijë lekë pa TVSH.
- Mungon situacioni për punimet e kryera, të tilla si Vaj motorri 8 litra x 2500, filtër vaji 1 copë, filtër ajri 1 copë, filtër nafte 1 copë, antifrizë 5 litra, ferrota para dhe prapa 1 komplet.

C. Me urdhër **shpenzimin nr. 2880, datë 11.12.2017**, nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted], është likuiduar subjekti privat "Shkëlqim Kurti" SHPK në shumën 35,880 leke me TVSH, me objekt **"*Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti*"**, sipas faturës tatimore nr.109, datë 24.11.2017, dhe fletëhyrjes së magazinës së UFSNK me nr. 42, datë 06.12.2017. Për palën blerëse, Universitetin, fatura është nënshkruar nga shoferi [redacted]. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit jusitifkues bashkëlidhur:

- Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr.62, datë 30.10.2017, me fondin limit 30,000 lekë pa TVSH, nënshkruar nga Administratori znj.[redacted] me objekt: **"*Shërbime për traktorin Agrifarm-55*"**, për korone + pinion diferenciali të traktorit.
- Kërkesa e përgjegjësit te EDE z.[redacted] me datë 30.10.2017 për konstatimin e defektit të traktorit, kërkesë e miratuar dhe nga dekani i Fak.Bujqësisë z. [redacted].
- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, për zhvillimin e procedurës së blerjes në sistem elektronik të prokurimeve (SPE) me datën 01.11.2017, ku oferta e operatorit "[redacted]" SHPK është 23 mijë lekë pa TVSH.
- Oferta e paraqitur nga subjekti fizik "[redacted]" SHPK është në shumën 29,900 lek2 pa TVSH ose 35,880 lekë me TVSH. **Fatura nuk ka asnjë nënshkrim. Nuk ka situacion dhe akt-marrje në dorëzim të artikujve/shërbimeve të kryera.**

Si gjetje u konstatua:

- ✓ Në kundërshtim me ligjin nr.10296/2010 i ndryshuar, këto pagesa konsiderohen si **shpenzime të pajustifikuara dhe pa efektivitet të fondeve publike**, pasi për kryerjen e këtij shërbimi nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të punimeve.
- ✓ Nuk ka asnjë nënshkrim nga asnjë përfaqësues i autoritetit kontraktor.
- ✓ Nuk ka garanci për punimet e kryera dhe pjesët e vendosura
- ✓ ***Fatura tatimore e shitjes është firmosur vetëm nga shitësi dhe jo nga blerësi si dhe nga transportuesi. Situacioni i punimeve është firmosur vetëm nga Administratori i servisit, firma [redacted] më datën 22.06.2017 dhe nuk është konfirmuar me nënshkrim nga asnjë përfaqësues i subjektit. Ndërsa në rastin e operatorit "[redacted] SHPK mungon situacioni për furnizim dhe vendosje të këtyre artikujve.***
- ✓ **Nuk ka asnjë procesverbal në përfundim të servisit të bërë që konfirmon se punimet janë kryer, pjesët e kërkuara janë ndërruar dhe se mjeti funksionon. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës**

54, të Udhëzimit të Ministrit te Financave nr.30, datë 27.12.2011,*"Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe vërteton marrjen ne dorëzim te aktiveve sipas kushteve te kontratës si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj"*

si dhe pikat 41 e 42 të këtij udhëzimi që përcakton se,

"Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale. "

VI. Me urdhër shpenzimin nr. 158, datë 13.07.2017, nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted] janë kryer likuidimet për shpenzime ekspedite duke kryer pagesat për llogari të pedagogëve dhe studentëve të Fakultetit të Ekonomisë, programi "Administrim biznesi në Turizëm", kursi i III-të, sipas listës së hartuar nga pedagogu Greda Kreshova dhe miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit znj.[redacted] me 18 studentë; si dhe ekspedita për programin e studimit Histori-Gjeografi, kursi I-rë, hartuar nga përgj,departamentit z.[redacted] dhe miratuar nga Dekani i Fak.Edukimit dhe Filologjisë z.[redacted]. ku përfshihen 40 studentë dhe dy pedagogë. Programit të miratuar përfshin ekspeditat në zonën e veriut dhe atë të jugut. Urdhër shpenzimin është në shumën 95,990 lekë u referohen këtyre dokumenteve:

- ✓ Lista emërore e studentëve që do te ndjekin ekspeditën, e financuar me fondet e buxhetit të shtetit;
- ✓ Bashkëlidhur pagesës janë fatura tatimore të lëshuara nga hotele të ndryshme në qytetet Berat, Valbonë, Prizren etj. Pagesat e hoteleve janë mbuluar nga Universiteti, në bazë të përcaktimeve të pikës VI të VKM nr.997/2010, i ndryshuar, sipas të cilit *" Studentët dhe nxënësit, si dhe trupa shoqëruese pedagogjike, që kryejnë praktika mësimore, ekspozita apo veprimtari jashtë qendrës së institucionit arsimor publik, nuk përfitojnë dietë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes së tyre përballohen nga institucionet përkatëse të arsimit, sipas dokumenteve përkatëse tatimore...".*
- ✓ Në disa raste, (përkatësisht fatura nr.124, datë 18..5.2017 e lëshuar nga hotel [redacted] Durrës për shumën 12,000 lekë për pagesë hoteli për 4 profesorë; fatura me nr. 21, datë 20.05.2017 e lëshuar nga hotel [redacted] Lezhë, për akomodimin e 4 profesorëve për dy netë në shumën 24,000 lekë; fatura me nr.30, datë 20.05.2017 e lëshuar nga hotel [redacted]" Lezhë, për akomodimin e 56 personave për një natë në shumën 84,000 lekë; fatura me nr.29, datë 20.05.2017 e lëshuar nga hotel [redacted] Lezhë, për akomodimin e 56 personave për një natë në shumën 84,000 lekë; fatura me nr.123, datë 18.05.2017 e lëshuar nga hotel [redacted] Durrës, për akomodimin e 65 studentëve për një natë në shumën 84,000 lekë; fatura me nr. 82, datë 23.05.2017 e lëshuar nga hotel [redacted] Gjirokastër, për akomodimin e 15 personave për një natë në shumën 22,500 lekë, etj, nuk kanë asnjë nënshkrim të pedagogëve apo personave të tjera që vërtetojnë fjetjen në hotel.

<u>Si gjetje u konstatua</u>:

- ✓ Bashkëlidhur pagesës janë përllogaritur shpenzimet e fjetjes në EURO për fjetje në Hotel Gjakovë, për znj. [redacted] dhe znj. [redacted] sipas faturës me nr. 60018942, datë 5.6.2017, së lëshuar nga Hotel [redacted], Gjakovë/Kosovë., në **shumën 40 (dyzetë) EURO**. **Nuk ka asnjë urdhërshërbimi dhe autorizim për dërgim jashtë shtetit që të konsiderojë te rregullt pagesën**.
- ✓ Janë përllogaritur shpenzimet e fjetjes në EURO për znj.[redacted] dhe znj.[redacted] me **13,8 EURO secila**, por nuk ka asnjë dokument bashkëlidhur pagesës për **shumën 27,6 (njëzetë e shtatë pikë gjashtë) EURO**, me kursin e këmbimit 133 lekë/Euro. Nuk ka asnjë urdhërshërbimi dhe autorizim për dërgim jashtë shtetit që të konsiderojë te rregullt pagesën

Sa sipër, pagesa është kryer me dokumentacion të paplotë, të pa nënshkruar rregullisht, dhe për pasojë, është vepruar në shkelje të Vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 30/2011. Shumat prej 40 + 27,6 = 67,6 EURO konsiderohen të paargumentuara dhe duhet të zhdëmtohen.

VII. Me urdhër shpenzimin nr. 277, datë 06.12.2017,.nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted], janë likuiduar shpenzime për gjobë, në adresë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë në shumën **7,200 lekë**, sipas urdhrit të lëshuar nga Administratori znj.[redacted] me nr. 173 datë 05.12.2017 **"Për pagesë gjobe",** ku në pikën nr. 1 të tij, përcaktohet se, "të kryhet pagesa për kundërvajtje administrative për automjetin me targë [redacted] në pronësi të UFSNK në masën 80% të saj"..
Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Vendimi nr. 40238 datë 04.12.2017 i Drejtorisë vendore të Policisë Tiranë ndaj z.[redacted] mbi shqyrtimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes me nr. 7244507, datë 24.11.2017, ku është caktuar gjoba për shtetasin [redacted] në shumën 9 mijë lekë.
- Fatura e lëshuar nga Drejtoria Vendore të Policisë Tiranë, me nr. 40328, datë 04.12.2017 për shumën 9,000 lekë.

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/5 prot, datë 06.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit)", *janë* ***ridërguar komentet dhe shpjegimet e bëra dhe për akt-konstatimet , duke ritheksuar se:***

"... vendimi i Drejtorisë së Policisë Vendore Tirane që drejtuesi i mjetit qarkullon me mjet me xhama të ri veshur nuk qëndron, pasi këtë e vërteton leja e qarkullimit lëshuar nga DPSHTRR të mjetit me targë AA 272 AT, në rubrikën karakteristika të mjetit, shënime: Është përcaktuar :"Xhamat e pasmë të homologuar".

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pavarësisht sa pretendohet, për këtë çështje duhet të ishte kryer ankim pranë DVP Qarkut Tiranë.

Si përfundim:

Pagesa e kryer për pagesë gjobe / kundërvajtje administrative nuk duhet të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit, por duhet të ishte ankimuar kjo gjobë për kundërvajtje administrative sa pretendohet si e pa mbështetur .
Në kushtet e moskundërshtimit dhe ankimimit, shuma prej 7,200 lekë konsiderohet në shkelje të disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet nga drejtuesi i mjetit, ose personi që ka urdhëruar mos likuidimin e saj.

VIII. Me urdhër shpenzimin nr. 284, datë 12.12.2017, nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted], janë kryer likuidimet **dieta për shërbim jashtë vendit në Kosovë**, në shumën 123, 708 lekë, sipas autorizimit për shërbim jashtë vendit me nr. 442 prot., datë 21.11.2017, nënshkruar nga rektorit z.[redacted]. Objekti i shërbimit është pjesëmarrja në workshopin me temë "Kompetencat kurikulare për arsimin e lartë".
Pagesat u referohen këtyre dokumenteve:

- ✓ Autorizimet dhe urdhërshërbimet e nënshkruara rregullisht nga personat udhëtues dhe nga NA znj.[redacted] e NZ znj.[redacted]
- ✓ Bashkëlidhur pagesës janë fotokopje e pasaportave me vulat e kalimit të kufirit shtetëror, faturat tatimore të lëshuara nga hotel [redacted] Prishtinë me datë
- ✓ Nje program që mban logon e UFSNK dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Prishtinë, i cili nuk është i nënshkruar dhe pa shkesë përcjellëse që të konfirmojë njoftimin apo ftesën dhe pjesën takuese të shpenzimeve.

Si gjetje u konstatua:

1. **Autorizimi me nr. 442 prot., datë 21.11.2017 vetëm ka të përcaktuar përbërjen e delegacionit prej 6 (gjatë) personash që do marrin pjesë në workshop, dhe në autorizim thuhet se periudha do të jetë dy ditë, por nuk specifikohet data e nisjes dhe data e kthimit/ (ditët e pjesëmarrjes në këtë konferencë);**
2. **Nuk ka asnjë përcaktim se kush i mbulon shpenzimet pasi nuk ka një urdhër të mirëfilltë administrativ.**
3. **Janë lëshuar gjashte fatura hoteli, por nuk ka në asnjë rast kasën fiskale të printuar.**
4. **Të gjithë autorizimet për shërbim jashtë shteti mbajnë nënshkrimin e çdo personi udhëtues dhe jo të titullarit apo nëpunësit autorizues;**
5. **Përllogaritjet e hotelit nuk i referohen faturës së lëshuar nga hoteli por janë shumëzuar me dy.** *Më konkretisht:*

Zyrtari udhëtues	Fatura e hotelit nr / datë	Dhoma nr.	Vlera sipas faturës	Vlera sipas urdhër shërbimit	Sa përfituar padrejtësisht
[redacted]	356/11/17 Datë 24.11.2017	Nr.107	35 EURO	70 EURO	**35 EURO**
[redacted]	357/11/17 Datë 24.11.2017	Nr.103	35 EURO	70 EURO	**35 EURO**
[redacted]	356/11/17 Datë 24.11.2017	Nr.106	35 EURO	70 EURO	**35 EURO**
[redacted]	359/11/17 Datë 24.11.2017	Nr.204	35 EURO	70 EURO	**35 EURO**

[redacted]	358/11/17 Datë 24.11.2017	Nr.105	35 EURO	70 EURO	**35 EURO**
[redacted]	xx	xx	**Nuk ka faturë hoteli**	70 EURO	**70 EURO**
	Përmbledhur:				**245 EURO**

Sa sipër, pagesa e kryer prej 245 EURO x 133,38 Lekë/ EURO = <u>32,671 lekë</u> sa paguar padrejtësisht dhe sa likuiduar pa dokumentacionin e plotë, të pa nënshkruar rregullisht, dhe për pasojë, është vepruar në shkelje të Vendimit nr. 870 datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin E punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", të ndryshuar dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 22, datë 10.7.2013 dalë në zbatim të këtij vendimi.

IX. Me urdhër shpenzimin nr. 292, datë 13.12.2017, nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted], është paguar **për honorarë për 16 profesorë, anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit, në shumën neto prej 408,000 lekë**, referuar Urdhrit të Administratorit me nr. 170, datë 04.12.2017. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Shkresa e nënshkruar nga ana e Rektorit, ku evidentohen 5 (pesë) mbledhjet e realizuara nga ana e Senatit Akademik, për periudhën qershor-nëntor 2017. Konstatohet se janë zbatuar përcaktimet e VKM nr. 418, datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve, ose komisioneve të njësive të qeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM nr. 621, datë 24.09.2014 për pagesën 8 mijë lekë për mbledhje.
- Për çdo pagesë në shumën bruto 32,000 lekë është mbajtur tatimi në burim prej 15%, në vlerën 4800 lekë.

<u>Si gjetje u konstatua:</u>
Llogaritjet e kryera për tatimin mbi të ardhurat janë kryer në kundërshtim me nenin 8, "E ardhura e tatueshme", të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar , që përcakton se:
"Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës" dhe nenit 9/1 "Tarifat tatimore", sipas të cilit, *" Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të tatohen sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij."*

dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 20.01.2016 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, që në pikën nr. 2.3 "Të ardhurat e tatueshme", specifikon që:

"2.3.1 Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi). Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblime të tjera në vlerë që lidhen me punësimin aktual të individit. Në të ardhura nga pagat përfshihet paga bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm si shtesat për vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të bëra me akte të tjera ligjore e nënligjore.
Termi "shpërblime të tjera" përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të

ardhurat që merr individi në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statusorë të shoqërive, si pagë e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre.
Në grupin "shpërblime të tjera" përfshihen gjithashtu të ardhura që realizohen nga pjesëmarrja e individit në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse, etj. Në këto raste mënyra e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do të jetë si më poshtë:
a) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj., paguhet jashtë qendrës efektive të punës së individit*, këto të ardhura tatohen në masën **15 përqind**":*

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30.000	Zero për qind
30.001	130 000	+13 për qind të shumës mbi 30 000 lekë.
130 001	Më tepër	13 000 lekë + 23 përqind të shumës mbi 130 000 lekë.

Nga **Dega e Financës** është llogaritur tatim për pagën në shumën 17,666 dhe për pjesëmarrjen në Senat është llogaritur tatimi në burim ne masën 15 %, barazi me 4,800 lekë. Pra, kryer ndalesat për tatime në shumën **22,466 lekë**.

Nga **llogaritjet e kryera nga ekipi i auditimit** për rektorin z[redacted] rezulton se paga bruto është 150, 285 lekë + 32,000 lekë pagesë për pjesëmarrje në Senatin e UFSNK = 182,285 lekë. Mbi këtë bazë duhet të llogaritet tatimi, si vijon:

- ✓ 13 000 lekë + 23 përqind të shumës mbi 130 000 lekë, ose 13,000 lekë + (23% e shumës mbi 130 mijë është 52,285 lekë = 12,025). Shuma 13,000 +12,025= **25,025 leke**.

Nga llogaritjet e kryera nga ekipi i auditimit rezulton si gjetje tatimi i pa mbajtur për diferencën për rektorin z.[redacted] 25,025 lekë - 22,466 lekë= 2,559 lekë.
Nga përllogaritjet për gjithë anëtarët e Senatit Akademik për pagesat e kryera rezulton detyrim për tu kthyer, sa paguar padrejtësisht shuma 37,149 lekë.

		struktures se miratuar	SENAT 4 mbledhje	Shuma BRUTO	TATIM ne burim	Shuma neto	mujore	mbajtur ne page	mujore plus senati (4+8)	gjithesej	diferenca (11-9-6)
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**
1	[redacted]	Rektor prof.dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**244893**	39425	**276893**	46785	**2560**
2	[redacted]	prof.as.dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**128090**	12752	**160090**	19921	**2369**
3	[redacted]	prof.as.dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**128090**	12752	**160090**	19921	**2369**
4	[redacted]	pro,as,dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**127038**	12615	**159038**	19679	**2264**
5	[redacted]	Dekan fak ekon Prof.as.dr.	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**157115**	19236	**189115**	26596	**2560**
6	[redacted]	dekan prof.as.dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**196919**	28391	**228919**	35751	**2560**
7	[redacted]	Dekan fak.shnat,hum	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**157115**	19236	**189115**	26596	**2560**

		profesor									
8	[redacted]	pergjegjes njesie prof	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**148085**	17160	**180085**	24520	**2560**
9	[redacted]	pergjegjes njesie prof	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**148085**	17160	**180085**	24520	**2560**
10	[redacted]	Prof.as.	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**128090**	12752	**160090**	19921	**2369**
11	[redacted]	Prof.as.dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**0**	0			
12	[redacted]	zevendes dekan prof	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**145075**	16467	**177075**	23827	**2560**
13	[redacted]	pergjegjes njesie prof	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**148085**	17160	**180085**	24520	**2560**
14	[redacted]	dekan prof	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**157115**	19236	**189115**	26596	**2560**
15	[redacted]	prof.as.dr	**32000**	**32000**	**4800**	**27200**	**128090**	12752	**160090**	19921	**2369**
16	[redacted]	as.prof.dr	**32000**	**32000**	**4800**		**128090**	12752	**160090**	19921	**2369**
		shuma	**512000**	**512000**	**76800**	**408000**	**2269975**	**269845**	**2749975**	**378994**	**37,149**

XI . Me urdhër shpenzimin nr. 206, datë18.09.2017, nënshkruar nga NA znj.[redacted] dhe NZ znj.[redacted],, është likuiduar subjekti privat "[redacted] SHPK për shumën 24,836 lekë pa TVSH dhe 29,804 lekë me TVSH, me objekt **"*Shërbim servisi për automjetin AA 520 OR*"**, sipas faturës tatimore nr. 560, datë 4.9.2017. Për palën blerëse, Universitetin, ky dokument është nënshkruar nga z.[redacted] dhe për furnitorin nga z.[redacted]. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Urdhër i Administratores nr.121, datë 14.09.2017, për pagesën e shërbimeve të automjetit, ku thuhet se, "në zbatim të kushteve të kontratës së lidhur me datën 31.10.2017, me objekt "Blerje automjeti", midis UFSNK dhe [redacted] SHPK, urdhërohet të kryhet pagesa për shërbimet e kryera nga [redacted] SHPK për automjetin e Universitetit me targë AA520OR".
- Fatura e shitjes me nr.1934, datë 04.09.2017, me përshkrimet filtër ajri, filtër vaji, filtër nafte, filtër kondicioneri, dhe zëri "njësi kohe", duke dhënë vlerën e faturës pa TVSH prej 24,836 lekë dhe me TVSH prej 29,804 lekë. Kjo faturë është nënshkruar vetëm nga përfaqësuesi i subjektit privat qa ka realizuar shitjen.

Si gjetje u konstatua:

Pagesa e kryer sa më sipër është në kundërshtim me :

- Pikën **41 e 42 të Udhëzimit të Ministrit te Financave nr.30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektori publik"**, i ndryshuar, pasi nuk ka komision të marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve, kur kriteri përcakton se,

"Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

- Nuk është mbajtur Procesverbali nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla sipas formatit nr.4, te Udhëzimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 3, datë 27.01.2015 "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, datë 24.04.2017, sipas të cilit:**

"7. *Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një* ***nevojë emergjente****, apo për kryerjen e shërbimeve* ***të paparashikueshme*** *me kusht që vlera e përllogaritur e mallrave dhe shërbimeve nuk është më e madhe se 100.000 (njëqindmijë) lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihet TVSH-ja.*
Në të tilla raste emergjente, ose ku prania e komisionit është pamundur, blerja apo shërbimi do kryhet në vend pa u respektuar procedura e parashikuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, ***në prani të personave (përfaqësues të institucionit) që ndodhen në vend dhe që mbajnë një procesverbal midis tyre për ngjarjen e ndodhur.***
Mënyra e pagesës kur përdoret prokurimi me vlerë të vogël në të tilla raste emergjence do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave, apo shërbimeve duhet të jenë të rregullta, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duhet të nënshkruhen nga të gjithë personat (përfaqësues të institucionit) të pranishëm. ***Procesverbali i mbajtur midis personave të pranishëm së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohen komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, të cilët mbajnë procesverbalin, sipas formularit Nr.4, bashkëlidhur, këtij udhëzimi, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyrës së Financës për likuidim."***

RAPORTET E MONITORIMIT DHE AKTET E RAKORDIMIT:

Është hartuar raporti i monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 dhe 2017 i cili është dërguar në Ministrinë e Arsimit shkresën nr. 325, dt.27.2.2017. Raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera edhe për programin "*Planifikim, menaxhim, administrim*" të cilat **nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë** në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.
- Raportet e monitorimit të buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të DAR dhe nuk shfaqen as në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit apo Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Sa më lart është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 1, dt. 15.01.2016 udhëzim plotësues "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016*" dhe UMF nr. 15881/1, dt. 18.11.2016 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ*"

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Me përjashtim të konstatimeve të referuara më lartë, në përgjithësi ka një sistem të azhurnuar të llogarisë dhe të dhënave të bankës në institucionin e UFSNK, por për përmirësimin e punës në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për korrigjimin e mangësive të referuar më lartë.

B. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Analiza e funksionimit të komponentëve të modelit COSO:
Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi e komunikimi, monitorimi.

Në zbatim të pikës III/B të programit të auditimit "nr. 202/1, datë 23.02.2018" i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

1. Universiteti "Fan S.Noli" Korçë (UFSNK), është institucion publik i arsimit të lartë, i organizuar në bazë të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe gëzon statusin e personit juridik publik. Ai përbëhet nga një njësi shpenzuese, ku janë inkuadruar Fakultetet dhe Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE), që është në funksion të Fakultetit të Bujqësisë.
Organet e drejtimit të UFSNK për periudhën objekt auditimit (2016-2017) në aspektin financiar janë Këshilli i Administrimit, Bordi i Administrimit dhe Administratori. Përgjegjësitë dhe rolet e Bordit të Administrimit dhe të Administratorit janë rregulluar përkatësisht nga kreu V, seksioni 2, nenet 47-50 të ligjit nr. 80/ 2015. Krijimi i këtyre strukturave (për periudhën objekt auditimi), është kryer sipas këtyre akteve të referuara më poshtë:

i. Këshilli i Administrimit:

- ✓ Me Urdhrin e Ministrit të MASH nr. 114, datë 26.03.2012 janë caktuar anëtarët e Këshillit të Administrimit të Universitetit të Korçës, në përputhje me përcaktimet e nenit 5 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 me këtë përbërje: [redacted] dhe [redacted]
- ✓ Me Urdhrin e Ministrit të MASH nr. 178, datë 27.04.2012 janë bërë këto ndryshime: në vend të z.[redacted] është caktuar z.[redacted] dhe në vend të znj.[redacted] është vënë znj. [redacted].
- ✓ Sipas procesverbaleve të mbajtur nga Komisioni i Zgjedhjeve të Institucionit datë 21.02.2012, janë zgjedhur përfaqësuesit për në këtë këshill: Prof. [redacted], Prof[redacted], Prof.as [redacted] Prof.as [redacted],
- ✓ Me Urdhrin e Ministrit të MAS nr. 114, datë 01.04.2014, është shfuqizuar urdhri nr.114/2012 i ndryshuar dhe është krijuar KA me këtë përbërje: [redacted].

Në përputhje me nenin 16 të ligjit nr. 9741/2007 i ndryshuar, numri i anëtarëve të KA nga 9 që është vendosur në fillim në Statutin e Universitetit, paraqitet me 7 anëtarë (nga data 4.2.2016), në nenin 15/2 të po këtij dokumenti.

ii. Bordi i Administrimit

[redacted]Me shkresën nr. 12359 prot, datë 12.12.2016, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, znj.Lindita Nikolla, në përputhje më përcaktimet e nenit 48/2 të ligjit nr. 80/ 2015, janë caktuar 4 (katër), përfaqësuesit e MAS në Bordin e Administrimit: [redacted]

- ✓ Nga ana tjetër, me vendimin nr. 21, date 06.07.016 të Senatit Akademik të Universitetit janë zgjedhur me votim të fshehtë përfaqësuesit e Universitetit për në Bordin e Administrimit: Prof.As.dr.[redacted], Prof.As.dr.[redacted] dhe dr.[redacted]

iii. **Kancelari**:

- ✓ Deri më datën 15.7.2016 këtë detyre e ka mbajtur Z.[redacted] i cili është shkarkuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit nr. 389, datë 15.07.2016.

- ✓ Me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr.5, datë 20.07.2016, dhe në bazë të shkresës së MAS me nr. 7596/1 prot, datë 24.08.2016, është ngarkuar me ushtrimin e funksionit të kancelares së Universitetit, znj. [redacted]

iv. **Administratori**:

Nga data 3.4.2017 e ne vijim, sipas Vendimit të Bordit të Administrimit, me nr. 10, datë 03.04.2017, është zgjedhur znj. [redacted]) në detyrën e Administratorit të UFSNK, përmes procedurës së konkurrimit të hapur.

Strukturat përgjegjëse të Universitetit kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Manualin për MFK-në,(miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010) dhe Manualin e ri, (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale janë bazuar në Strategjinë e zhvillimit të Arsimit. Nga ana e tij, Bordi i Administrimit, me Vendimin nr.8, datë 03.04.2017 ka miratuar Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit, dokument i propozuar nga Senati Akademik.

2. Nga ana e **Rektorit të** Universitetit, me Urdhrin nr. 25/1 datë 25.04.2017, bazuar në kërkesën e administratorit dhe referuar Udhëzimit të MF nr. 16, datë 20.7.2016 "Për përgjegjësitë dhe koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për v.2017 me 7 anëtarë ,** në cilësinë e një Komiteti që duhet të këshillojë titullarin dhe evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, duk vepruar në përputhje me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit "Për MFK". Më konkretisht:

Manuali i MFK, ka përcaktuar se:

Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.

Gjithashtu, pika 4.2.9 e Manualit *(faqe 84)* **nënvizon se**: *"Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë….Grupi për Menaxhimin Strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë.*

Edhe në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

> *"GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike".*

Intervistuar nga ekipi i auditimit, anëtarët e GMS shprehen se janë diskutuar mbi aspektet e akreditimit, planifikimin e PBA-së, deklaratat e politikës së programeve, numrin e studentëve sipas programeve, ecurinë e shpenzimit të fondeve dhe janë mbajtur minutat e takimit, sipas procesverbaleve datë 26.4.2017; 22.5.2017; 5.7.2017 dhe 10.8.2017 , etj

3. Nga auditimi i kryer në lidhje me plotësinë e kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet e politikat vijuese të dala në zbatim të tij, konstatohet se ekzistojnë disa mangësi:

UK për periudhën objekt auditimi ka ushtruar veprimtarinë dhe funksionet me akte nënligjore dhe dokumentacionin bazë, të mbështetur në **ligjin nr. 9741**, **datë 21.05.2007**, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", **i shfuqizuar nga ligji nr. 80/ 2015, datë 22.07.2015**; **Statutit** si dhe **Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit te sektorëve, degëve dhe aparatit të rektoratit**, në fuqi për periudhën objekt auditimi dhe aktualisht.

Grupi i auditimit të KLSH-së, sjell në vëmendje se, në nenin 33, "**Statuti dhe rregullorja e institucioneve të arsimit të lartë", të ligjit nr. 80/2015,** është përcaktuar se,

1. Statuti i një institucioni të arsimit të lartë përmban **normat bazë**, që rregullojnë veprimtarinë e tij.
2. Statuti hartohet dhe ndryshohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe aktet nënligjore në fuqi. Ai miratohet nga Senati Akademik i institucionit të arsimit të lartë dhe Bordi i Administrimit. Statuti i dërgohet ministrit përgjegjës për arsimin, i cili, brenda dy muajve, kryen kontrollin e ligjshmërisë së tij. Kur konstatohen mospërputhje të tij me ligjin, ministri ia kthen statutin për ripunim institucionit të arsimit të lartë. Kur ministri nuk ka vërejtje për ligjshmërinë e statutit ose nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, statuti konsiderohet i miratuar.

Konkretisht:

- Universiteti i Korçës është themeluar me VKM nr. 5, datë 07.01.1992 "Për krijimin e Universitetit të Korçës".
- Statuti i Universitetit është miratuar nga Senati Akademik me vendimin e datës 09.05.2008.
- Rregullorja e brendshme e funksionimit të degëve, sektorëve, administratës së UFSNK, është miratuar me Vendimin nr.13 të Senatit Akademik, datë 30.03.2009, ku përcaktohen dhe trajtohen misioni, qëllimi, përbërja e degëve, veprimtaria, kompetencat, organizimi i sektorëve, bibliotekës, dhe kriteret e rregullat e disiplinës së punës, etj.

U konstatuan mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor, pas daljes së Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", pasi ndonëse kanë kaluar afro 3 vjet nga miratimi i këtij ligji Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave**, nuk kanë hartuar dhe miratuar një pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore (VKM dhe Udhëzime) si derivate të ligjit të mësipërm, pasi mos miratimi i tyre ka krijuar një ngërç në funksionimin e institucionit, në aspektin organizativ**.

Nga auditimi rezultoi se, **akreditimi i UFSNK**, është realizuar me Vendimin nr. 65, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, dhe për sa sipër është lëshuar Certifikata e Akreditimit nga Drejtori i ASCAL, znj.[redacted]
Urdhri për pagesën e APAAL nga Administratori në shumën 1,960 mijë lekë është mbështetur në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i shfuqizuar, si dhe në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe

Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, nr.29/1, datë 16.08.2011 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë". Ky veprim financiar është realizuar në zbatim të ligjit të mëparshëm, i cili aktualisht është shfuqizuar me daljen e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH", ***fakt që tregon se kjo pagesë është mbështetur në një udhëzim të nxjerrë mbi bazën e një ligji të shfuqizuar***.

Në referencë të ligjit nr.9741/2007, është hartuar dhe miratuar **rregullorja e brendshme**, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore për çdo sektor, sipas strukturës dhe organikës së institucionit, në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Por, konstatohet se, në këtë akt**, nuk janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në fushën e menaxhimit të financave, kontrollit të brendshëm financiar publik, etj**. Duke analizuar përmbajtjen e ligjit që rregullon fushën e arsimit universitar, si dhe rregulloren e brendshme të institucionit, konstatohet se UFSNK ka funksionuar mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore si dhe të strukturave, të cilat **nuk janë sjellë në koherencë me legjislacionin e sistemit buxhetor dhe ligjin organik që rregullon funksionimin e tyre, ligjin nr. 80/2015.**

Konstatime:
3.1. Këto akte nuk janë në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015. Këto akte nuk janë të harmonizuara midis tyre edhe për faktin se, Statuti dhe Rregullorja janë hartuar në bazë dhe në detyrim të ligjit nr. 9741/2007, që është dispozitë e shfuqizuar.

3.2. Statuti i universitetit, si dokumenti ku rregullohen normat kryesore të veprimtarisë akademike e administrative për këtë institucion shtetëror, ka përfshirë deri më 31.12.2017 emërtesa dhe funksione administrative të rëna nga fuqia ligjore. Kështu, mund të përmendim:

- **Në nenin nr.8 të Statutit**, ku trajtohen Fakultetet, ato janë renditur: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore e Humane, **Filiali i Universitetit "Fan S. Noli", në Pogradec", (**që në fakt është mbyllur sipas Urdhrit të ministrit të MAS me nr. 440, datë 12.11.2014, "Për mbylljen e filialit të Universitetit "F.S.Noli" Korçë në qytetin e Pogradecit").
- **Në nenin nr.12 të Statutit**, ku trajtohen organet drejtuese dhe administrative të Universitetit, janë shënuar Senati, Rektorati, Këshilli i Profesorëve dhe **Këshilli i Administrimit, institucion i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015.**
- **Në nenin nr.12 të Statutit**, ku trajtohen organet drejtuese përcaktohet se, Këshilli i Administrimit përbëhet nga **nëntë anëtarë**, ndërsa në përcaktimet e nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, është përcaktuar se *"Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga* **shtatë anëtarë***, të punësuar me kohë të pjesshme."*.

Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë ka miratuar Statutin e ri te UFSNK me Urdhrin nr. 65, datë 08.02.2018.

a. Rregullorja e degëve dhe sektorëve në rektorat është e vitit 2009 dhe nuk është përditësuar me normat dhe dispozitat e reja ligjore në fuqi.

- **Në nenin nr.13 të rregullores për degët, sektorët dhe administratën**, ku trajtohen detyrat e Degës Ekonomike, janë shënuar referenca të dispozitave ligjore të shfuqizuara, si të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", shfuqizuar nga ligji nr. 10296/2010, etj.

Përfundimi:
Për periudhën objekt auditimi, kuadri nënligjor dhe aktet normative themelore për organizimin dhe mirëfunksionimin e Universitetit të Korçës , të tilla si Statuti i Universitetit dhe rregullorja e degëve, sektorëve dhe administratës së rektoratit, **janë hartuar në referencë te legjislacionit të vjetër e të shfuqizuar**, si dhe **janë konstatuar vonesa të pajustifikuara në zhvillimin e procedurave për miratimin e dokumenteve të reja** dhe **ngritjes se organeve të funksionimit të Universitetit**, në përputhje më kërkesat e ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Për sa sipër rekomandohet:
Të merren gjithë hapat për rishikimin dhe përditësimin e rregullores së orgnizimit dhe funksionimit të brendshëm, duke mbajtur në vëmendje faktin se janë krijuar drejtoritë e reja dhe është kompozuar njësia e auditimit të brendshëm, të cilat duhet të gjejnë reflektim në këtë dokument që duhet miratuar nga Senati Akademik.

4. Për periudhën objekt auditimi 2016 dhe 2017, rezultoi se:
-Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 4, germa "b", ku përcaktohet se "*Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë*", ky institucion *nuk ka rishikuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik për periudhën objekt auditimi*. Pra, janë hartuar dhe paraqitur për miratim plani strategjik 2016-2018 si dhe planin strategjik 2017-2019, të cilët përmbajnë objektivat strategjikë, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale.

5. Në kuadër të funksionimit të Bordit të Administrimit, vërehet se nuk kanë gjetur zbatim detyrimet që burojnë nga përcaktimet e nenit 49, germa "e" dhe "f", në bazë të të cilave Bordi miraton rregulloren financiare të institucionit si dhe përcakton rregullat mbi shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë,

e) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

6. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar **nëpunësi autorizues (NA) dhe zbatues (NZ) për UFSNK**, *si vijon:*
Caktimi i nëpunësit autorizues dhe zbatues është kryer për çdo vit. Me shkresën e DPHKBFP ne MF me nr. 10604 prot, datë 28.7.2016, i është dërguar Degës së Thesarit dhe Rektorit të

Universitetit, konfirmimi si NA e znj. [redacted] kancelar, ndërsa me shkresën e MF me nr. 5411 prot, datë 26.4.2017 është konfirmuar znj.[redacted] si NA e Universitetit.
Ndryshimet në caktimin e NZ, i janë referuar kërkesës së Universitetit nr.278 dtë 13.2.2018, duke konfirmuar si nëpunës zbatues të institucionit z. [redacted], me detyrë drejtor i Drejtorisë së Financës dhe këto informacione i janë dërguar Degës së Thesarit Korçë.
Në funksion të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, (neni 12), nëpunësi zbatues, është niveli menaxherial në vartësi direkte të drejtorit të institucionit. Në funksionet e tij, Drejtori i Finances mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Aktualisht, z.Petrika Petro kryen funksionet e përcaktuara më sipër dhe sipas përcaktimeve të **Udhëzimit të Ministrit të MASR me nr. 27, date 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të larte", është në vartësi direkte të Administratorit.** Kjo sipas bllok skemës/ organigramës që shoqëron Statutin e ri të Universitetit, miratuar nga MASR.
Sa më sipër, janë përmbushur kërkesat e Nenit 12/1, "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues" të ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar, ku cilësohet se:

> *1. Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë, dhe që ka përfunduar **studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të**, me përvojë pune **jo më pak se pesë vjet në profesion**. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike*
> *2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së:*
> *a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike;*
> *b) raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave".*

7. Nga ana e institucionit janë përgatitur **Pyetësorët e Vetëvlerësimit**, **Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm** për vitin 2015 (dërguar MASR me shkresën nr. 149 prot., datë 29.01.2016. Për v.2017 afati i plotësimit dhe dërgimit të tyre sipas Manualit të MFK është deri me datën 28 shkurt 2018. Këto akte janë nënshkruar nga administratori i UFSNK dhe i janë dërguar Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si vijon:

Për vitin 2016:
Është hartuar pyetësori i vetëvlerësimit për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në përgjigje të shkresës së MAS, nr.12414/1 prot, datë 30.12.2016, dhe me shkresën nr.23/1 prot, datë 30.01.2017 nga ana e ish-Kancelares znj.[redacted] i është përcjellë Drejtorisë së Financës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, krahas Deklaratës së nëpunësit autorizues për cilësinë e sistemit të kontrollit, në bazë të përgjegjësive të kreut III, pika 3.3 e Manualit MFK dhe cilësimeve të nenit 18 të ligjit nr.10296, që përcakton se:

> *"**Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm:***

1.Nëpunësi autorizues i njësisë publike sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, ***jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual****. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji".*

Nuk është hartuar raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike UFSNK për vitin 2016, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar.

<u>Për vitin 2017</u>:

Është hartuar pyetësori i vetëvlerësimit për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në përgjigje të shkresës së dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MAS, me nr. 12673/1 prot, datë 28.12.2017, dhe me shkresën nr. 88 prot, datë 24.01.2018 të Administratores Znj.[redacted], i është përcjellë Drejtorisë së Buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, krahas Deklaratës së nëpunësit autorizues.

Nga misioni i auditimit vërehet se Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm është dorëzuar brenda afatit ligjor, përcaktuar në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se *"deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit* shkurt të çdo viti *tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave"*

Raporti mbi sistemet e kontrollit të brendshëm është më i plotë dhe ka respektuar strukturën e parashikuar sipas manualit të MFK dhe detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.11.2008, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".

Nga analiza e hollësishme e këtij dokumenti vërejmë se:

-Ky raport është përgatitur nga ana e NA, në koordinim me hallkat e tjera të këtij institucioni.

-Raporti ka sintetizuar arritjet dhe mangësitë e konstatuara në procesin e MFK duke listuar dhe disa rekomandime për përmirësim gjatë periudhave të ardhshme. **Raporti ka pasqyruar gjetjet dhe rekomandimet e raportit të auditimit të brendshëm të MAS.**

Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, vlerësojmë se vlerësimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm (skb) & Menaxhimit Financiar (mf) janë kryer me pikë (1-3), por për vitin **2015 dhe 2016**, **nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e Njësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion në Kryeministri, për angazhimin e kryer sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr. 2470, datë 13.04.2016 dhe raportit më të fundit të auditimit të jashtëm (KLSH) si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër parashikohet në këtë udhëzim**:

" Raporti duhet të strukturohet sipas formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi, i cili përbëhet nga:

(a) Përmbledhja ekzekutive;

(b) Vlerësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë;
(c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;
(ç) Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan-veprimin për të ardhmen;
(d) Rekomandime të përgjithshme për Ministrinë e Financave, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit."

Grupi i auditimit të KLSH u fokusua në realizimin e objektivave të institucionit dhe përdorimin me efektivitet të fondeve të tij, për të gjithë komponentët si "mjedisi i kontrollit", "menaxhimi i riskut", "aktivitetet e kontrollit", "informimi dhe komunikimi" dhe "monitorimi". Nga shqyrtimi i ***plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit*** kanë rezultuar disa mangësi, pasi nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e kapitullit V, të Manualit për MFK. Analiza e të dhënave të pyetësorëve tregon se, nëpunësi autorizues dhe zbatues janë mjaftuar vetëm me vendosjen e pikëve sipas kritereve të vetëvlerësimit (numrat nga 1-4për çdo çështje), **pa i shoqëruar rubrikat e pyetësorit që kanë vlerësimin më të dobët me shpjegimin e arsyeve dhe me komentet respektive**, siç cilësohet në Kapitullin III, Hapi III, kreu "Procesi i Implementimit të MFK" dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.
Nga analiza mbi vetëvlerësimin e kryer nga ana e NA dhe NZ të UFSNK, vërejmë se elementet më me vlerësimin më të dobët paraqiten të strukturuar kundrejt modelit COSO si më poshtë:

- **Për komponentin e parë të COSO, "Mjedisi i kontrollit", nën komponenti "Politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore",** për kriterin "politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore garantojnë mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aftësive profesionale të stafit", është dhënë vlerësimi në pyetësor me 1 pikë.
- **Për komponentin e dytë të COSO, "Menaxhimi i riskut", ku për ekzistencën e strategjisë së riskut (kolona nr.12 e pyetësorit),** ekzistencën e regjistrit të riskut, përfshirjen e drejtuesve të të gjitha niveleve në hartimin e regjistrit të risqeve, janë dhënë vlerësimet në pyetësor me 1 pikë.
- **Për komponentin e tretë të COSO, "Aktivitetet e kontrollit", ku për ekzistencën e *sistemit rezervë të back up* (kolona nr.29 e pyetësorit),** janë dhënë vlerësimet në pyetësor me 1 pikë.

8. Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të UFSNK, (parashikuar në pikën 8, neni 8, të ligjit nr.10296), konstatohet se, kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:
-hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të Institucionit, të planeve vjetore dhe plan-veprimet për arritjen e objektivave;
-miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.
-miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre;
Shërbimet audituese janë kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të MAS. Auditimi i fundit i Ministrisë, është realizuar sipas programit nr. 6153/1 prot, datë 17.06.2016, ndërsa përfundimet janë dërguar nga Ministri i Arsimit me shkresën nr. 6153/3 prot, datë 31.08.2016. Ky angazhim ka përfshirë periudhën 01.06.2014 deri më 31.05.2016.

Universiteti për periudhën objekt auditimi nuk ka themeluar funksionin e auditimit të brendshëm. Me ndryshimet e strukturës, në përputhje me nenin 86 të Statutit të ri të Universitetit është krijuar pozicioni i NJAB, në varësi të Bordit të Administrimit, ku shprehet se, "Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UK dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të UK-së".



Rekomandim:
Të kompozohet NJAB në përputhje me kriteret e VKM nr.83, datë 03.02.2016, i ndryshuar, të kryhen procedurat e rekrutimit dhe të përcaktohet mënyra e funksionimit të kësaj njësie në rregulloren përkatëse të saj, e cila duhet të miratohet nga Bordi i Administrimit.

- ***Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:***

Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në dispozitat ligjore të buxhetit të shtetit. Treguesit e detajuar buxhetorë të hartuar nga Universiteti i Korçës janë diskutuar e analizuar në MASH dhe MF. Procedurat për hartimin e projekt-buxhetit i janë referuar akteve ligjore për hartimin dhe zbatimin e buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrit të Financave. *Nga auditimi u konstatua se:*

- Nga institucioni për periudhën objekt auditimi është dërguar vetëm faza e dytë e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, duke mos dorëzuar në MAS fazën e I të planifikimit të buxhetit afatmesëm, në kundërshtim me Kapitullin III, të udhëzimit të MF nr. 23, datë 22.11.2016 "*Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm*".
- Raporti i monitorimit për periudhën objekt auditimi si dhe raportet periodike që UFSNK i ka dorëzuar MAS, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtarë, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, në kundërshtim me kreun IV "*Monitorimi*" të Udhëzimit plotësues të MF nr. 1, datë 15.01.2016 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016*".

- ***Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:***

Janë hartuar rregullat bazë për organizmin kontabël dhe administrimin e pasurisë. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti. Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël nuk është mbështetur në parimin e

kontabilitetit rrjedhës, pra mbi bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara. Procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit si dhe asgjësimi janë kryer katër herë radhazi nga i njëjti komision, në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

9. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se ka munguar regjistri i risqeve për periudhën 2015 dhe 2016, veprim që është korrigjuar ne vitin 2017. Ne v.2017 janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e **Regjistrit të Risqeve, duke e kompozuar këtë dokument dhe të nënshkruar nga koordinatori i riskut z. [redacted] , me detyrë Drejtori Ekonomik i UFSNK dhe Nëpunësi Autorizues znj. [redacted] me detyrë Administratore.**
Ne funksion të këtij regjistri është hartuar dhe një plan veprimi për minimizimin e risqeve.
Në institucionin UFSNK është hartuar regjistri i riskut dhe zotëruesit e këtyre risqeve, si për Degën e Financës, Degën Ekonomike, KVO, Degën e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivin, Sektorin e Standardeve dhe Karrierës së Studentëve, etj.

Konstatohet se:

1. **Ky dokument nuk është hartuar për vitin 2015 dhe 2016, është hartuar për v.2017 dhe nuk është dokument i protokolluar dhe tu jetë komunikuar degëve apo sektorëve.**
2. **Nuk janë pjesë e këtij regjistri aktivitet që realizon Sektori Juridik, Njësia e prokurimit, problemet e brendshme të vlerësimit të cilësisë, (Sektori i Kurikulave dhe Vlerësimit Institucional), etj., për kërcënimin e objektivave themelore dhe angazhimeve të marra përsipër.**
3. **Regjistri nuk identifikon shkallën e risqeve para dhe pas kontrolleve, por thjeshtë pasqyron monitorimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave** dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
4. **Nuk i janë dërguar kopje të tij MAS dhe MF .**
5. **Nuk parashikohet niveli i ri i risqeve pas aplikimit të kontrolleve, referuar programit buxhetor afatmesëm, etj.**

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/5 prot, datë 06.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Rektorit dhe Administratorit të Universitetit)", *janë* ***dërguar komentet dhe shpjegimet , duke theksuar se:***
"... po sqarojmë se regjistri i risqeve i hartuar për v.2017, pavar1sisht se nuk është protokolluar, u është shpërndarë dhe bërë i njohur të gjitha degëve dhe sektorëve dhe kopje e tyre është përcjellë në ministri".

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se është bërë një hap pozitiv me hartimin e regjistrit të risqeve për v.2017, dokument që nuk ka ekzistuar në periudhat e mëparshme. Ky dokument duhet përditësuar, miratuar dhe tu shpërndahet gjithë drejtorive të institucionit.

Rekomandim:
Të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitet, regjistri i riskut për UFSNK, të bëhet përditësimi dhe miratimi i tij, dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin**.**

9. Për periudhën objekt auditimi, **nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve**, detyrimi i **neneve 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2),** të ligjit nr. 10296. Në mënyrë më të detajuar, përgjegjshmëria e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, rregullohet nga kjo dispozitë ligjore si më poshtë vijon:

> *"Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:*
> *a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e **objektivave të njësive** publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë **strategjinë e menaxhimit të riskut** dhe të **plan-veprimeve për arritjen e objektivave**;*
> *b) ngritjen e **grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike**, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;*
> ***Neni 21. Menaxhimi i riskut:***
> *2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e trajtuara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton **një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.** Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*

si dhe përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdherin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016:

> *"Çdo NjQQ dhe NjQV duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut që përditësohet rregullisht (çdo tre vjet) ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme. Strategjia duhet të përgatitet nga NA në cilësinë e KR. Titullari i njësisë miraton strategjinë e menaxhimit të riskut. NA analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit".*

Rekomandim:
Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut së bashku me planin e veprimit për arritjen e objektivave të programit, e cila të përditësohet rregullisht (çdo tre vjet), ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme.

10. Grupi i auditimi konstaton se në institucion nuk ka dhomë të serverëve, administrimi i të dhënave kryhet nga Sektori i TIK. **Sistemi i teknologjisë së informacionit siguron** një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (back up) vetëm për programet e sekretarive të fakulteteve. "Detyrat e sektorit të TIK" janë parashikuar në rregulloren e brendshme. Për sa i takon mbrojtjes së

informacionit të përdoruesve dhe kontrollit periodik të pajisjeve dhe sistemeve të instaluara, institucioni zbaton udhëzimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për këtë qëllim.

11. Nga ana e UFSNK zbatohen rregullat dhe **procedurat për mbrojtjen e aktiveve**, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa "ç", të ligjit nr. 10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, administratori ka miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, nuk është hartuar regjistri i aseteve, si detyrim nga pika nr. 26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e **inventarizimit të pasurisë** dhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrave të veçantë të kancelarit apo administratorit, trajtuar tek kapitulli mbi kontablilitetin dhe bilancin kontabël vjetor.

12. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 16, të ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për **përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit,** ku shprehimisht përcaktohet:

> *"Titullarët e njësive publike **miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë** dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit".*

Nga ana tjetër, u verifikuar zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016), mbi **përgatitja e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës**. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se, ka një **moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së <u>përshkrimit të proceseve të punës</u>.** *Jo vetëm kaq,* **por përshkrimi i procesit të punës <u>konfondohet me përshkrimin e pozicionit të punës</u>.** Për të bërë të mundur që çdo institucion të përgatisë manualin e proceseve të punës. struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave ka përgatitur dhe një format standard për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces në vazhdimësi.
Nga auditimi dhe intervistat me Drejtorin e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit z.[redacted] u verifikua respektimi i kërkesave ligjore në **hartimin e formularit të përshkrimit të punës,** në mbështetje të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të ndryshuar. Në pikën 14, të Kreut IV, "Procedura dhe formati i përshkrimit të punës", të VKM-së nr.142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, përcaktohet se: ***"Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit***

specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni". Nga sa më sipër, nga zyrtarët e UFSNK si institucion i administratës shtetërore dhe e rregulluar me dispozitat e Kodit të Punës**, nuk janë hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e punës, sipas afateve të përcaktuara në aktin nënligjor**.

Konstatohet se:

1. Ka një ndarje dhe ndjekje të detyrave sipas pozicionit të emërimit të çdo punonjësi.
2. **Nuk janë hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet dhe personat, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi**.
   Grupi i auditimit analizoi se si është pasqyruar ky fakt në pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2016 dhe 2017, (Komponenti "Mjedisi i Kontrollit", nënkomponenti "Politikat dhe praktikat BNJ" dhe rezulton se është vlerësuar me 3 pikë, duke e konsideruar të realizuar këtë proces, gje që tregon se vetëvlerësimi për disa zëra nuk është realist dhe i mbështetur.
3. Nuk ka një inventarizim të dosjeve të personelit me gjithë sistemin dokumentar përbërës;
4. Mungon vlerësimi i performancës në punë te çdo punonjësi, që të shërbejë për efekt promovimi dhe ngjitje në karrierë;
5. **Në Rregulloren e brendshme vetëm janë vendosur në formë të përgjithshme detyrat e çdo dege, ku brenda së cilës mund të jenë përfshirë sektorë dhe qendra me detyra dhe përbërje të ndryshme , por ka vetëm një përshkrim shumë të përgjithshëm të detyrave të degës, pa i precizuar ato sipas personave përgjegjës.**

Përfundimi:
Nuk ka asnjë përcaktim mbi **miratimin e përshkrimit** të punës për secilin pozicion punësimi dhe për çdo punonjës. Në rregullore mund të vëresh vetëm përshkrimin e vendit të punës së përgjegjësit të sektorit dhe detyrat e sektorit në mënyrë të sintetizuar.

Rekomandim:
Rektori i Universitetit, Administratori dhe Njësia përgjegjëse për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të koordinojë veprimet për të hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës, akteve të dala në zbatim të tij si dhe VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" .

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, UFSNK ka funksionuar në bazë të ligjit për sistemin arsimor universitar. Në nenin 2 të Statutit të miratuar me Urdhrin nr.56, datë 08.02.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është vendosur "Misioni i universitetit". Deklarata e misionit të njësisë është në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Sa sipër, konstatohet se kanë gjetur zbatim kërkesat e Manualit të MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, (i ndryshuar), ka përcaktuar në kapitullin e III, faqe 52, detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit. Shprehimisht, ne Statutin e rishikuar është vendosur që:

"UK-ja në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Këtë mision ai e realizon përmes këtyre synimeve:

- *të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale, duke përmbushur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës.*
- *të formojë shkencëtarë të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimet kryesore të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese ;*
- *si promotor i formës më të lartë të arsimimit, synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike për ta bërë individin jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.*
- *të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë;*
- *të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.*

1. t'u sigurojë punonjësve akademikë pavarësinë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij statuti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. të lëshojë diploma dhe të japë certifikata e tituj të tjerë në përputhje me nivelin e formimit të kryer.

3. të garantojë shprehjen e lirë të ideve dhe t'i sigurojë personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim."

b. Etika personale dhe profesionale.

Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren ("Kodi i Etikës për UK"), i miratuar me Vendimin e Senatit Akademik me nr. 19, datë 29.05.2009, si dhe në zbatim të përgjegjësive të nenit 44, të ligjit nr. 80/2015, është ngritur Këshilli i Etikës, ku diskutohen procedura të shkruara e të raportuara të shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për rastet e konstatuara.

c. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Për periudhën 01.01.2016-31.12.2017, njësia ka funksionuar dhe është e organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me Vendimin e Senatit/ Bordit të Administrimit. Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar numrin e punonjësve gjithsej, pozicionin e vendit të punës si dhe kategorinë për çdo pozicion. E analizuar sipas fakulteteve dhe njësive te tjera ndihmëse kjo çështje trajtohet në akt-konstatimin e mbajtur mbi buxhetin.
Struktura ofron vija të qarta të përgjegjësive dhe të kalimit të informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Administratori deri tek specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje. **Këtij procesi i ka ndihmuar dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit me nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet Publike të Arsimit të Lartë", ku është përcaktuar përfundimisht struktura administrative dhe struktura e stafit akademik.**

Administratori është dhe nëpunësi autorizues i njësisë. Sipas strukturës së njësisë, Drejtori i Drejtorisë së Financës është nëpunësi zbatues dhe përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor me synim arritjen e qëllimeve dhe politikave të programit. Drejtuesit, drejtorët apo përgjegjësit e sektorëve janë në varësi direkt të nëpunësit autorizues.
"*Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" në lidhje me "ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin"*
UFSNK për periudhën objekt auditimit, ka funksionuar me strukturën organike të miratuar në Këshillin Administrativ, ndërsa me vendimin e Bordit të Administrimit me nr.3, datë 09.01.2018 "Për miratimin e numrit të punonjësve në të gjitha nivelet", si dhe vendimin e Senatit Akademik me nr. 12, datë 12.01.2018 janë bërë përmirësimet e duhura strukturore. Krijimi i drejtorive si Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Kurikulave dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Financës, **janë organizuar në përputhje me kërkesat e Vendimit nr.474, datë 16.6.2011,** pika 21, ku citohet: "*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*", si dhe, pika 20 ku citohet: *"Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçante kur në të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës....."*.
Konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore Komunikimit dhe Promocionit, është kaluar në varësi të rektorit të Universitetit.
Dosjet e materialeve mbi procedurat e punësimit të personelit akademik janë arkivuar, por **duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit** nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumenteve. Dosjet **nuk janë administruar me indeks të veçantë**, si dhe **mungojnë vlerësimet e performancës në punë,** sipas kërkesave të Kapitullit V, Formati Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.
Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me dispozitat e kodit të punës. Në bazë të ligjit për kodin e punës dhe dispozitave të tjera ligjore si, ligji për buxhetin e shtetit, ligji për arsimin e lartë dhe aktet e dala në zbatim të tij, ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj., Administratori i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave, ka ndërmarrë hapat e duhura dhe dhënë masa disiplinore për punonjësit. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo Administratori.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.
Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, janë përcaktuar përgjegjësitë për çdo zyrë dhe punonjës

Manuali i MFK, **miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010,** ka përcaktuar në kreun II, faqe 21 në lidhje me strukturat organike ka vendosur si parakushte :

• *Një procedure **transparente për rekrutimin** dhe emërimin e punonjësve;*
• ***Kritere dhe kërkesa të përshtatshme** në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;*
• *Një sistem **trajnimi dhe kualifikimi** që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;*
• *Një **sistem për vlerësimin e performancës** që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;*

Njësia ka programin buxhetor, drejtues i të cilit është Titullari i institucionit, që është dhe nëpunësi autorizues. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

Nga ana e kësaj njësie publike për periudhën 2016 - 2017, **rezulton se nuk janë jenë kryer vlerësime vjetore dhe periodike (6-mujore) të punës për punonjësit,** lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e **Kodit të Punës dhe akteve të dala në zbatim të tij mbi vlerësimin e performancës së punonjësve**.

- **Grupi i auditimit analizoi se si është pasqyruar ky fakt i vlerësimeve periodike të performancës, në pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2016 dhe 2017, (Komponenti "Mjedisi i Kontrollit", nën komponenti "Politikat dhe praktikat BNJ"), rubrika me nr. 15, " a ka vlerësime periodike të punonjësve", dhe rezulton se përgjigja është shënuar po është vlerësuar me 3 pikë, duke e konsideruar të realizuar këtë proces, gjë që tregon se, vetëvlerësimi për disa zëra nuk është realist dhe i mbështetur.**

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia **nuk disponon plane të trajnimeve (sidomos në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit), dhe mungon një data-base mbi trajnimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik,** për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikës nr. 3/1 , nën çështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016. Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni **nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor,** me qëllim rritjen e efikasitetit dhe eficencës së punës dhe menaxhimin e fondeve publike, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

- Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fusha të ndryshme të cilat lidhen me veprimtarinë e punës së secilës Drejtori edhe pse në regjistrin e riskut, referuar listës së risqeve të evidentuara si prioritare për institucionin, është renditur ndër të parët trajnimi i stafit në lidhje më procesin e menaxhimit të riskut. Ky institucion *nuk ka program specifike për trajnimin* e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 "Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë", paragrafët "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore" dhe "Profesionalizmi i stafit".

Gjatë vitit 2015 - 2017, referuar të dhënave mbi realizimin e treguesve të buxhetit, të UFSNK, rezulton sa më poshtë vijon:

- **për vitin 2015** janë programuar për trajnime e seminare (llogaria 602011) shuma prej 100,560 lekë dhe janë realizuar vetëm 19,020 lekë, **ose 18.9 % e kësaj shume**;
- **për vitin 2016** janë programuar për trajnime e seminare (llogaria 602011) shuma prej 880,000 lekë dhe janë realizuar vetëm 19,020 lekë, **ose 2% e saj**;
- **për vitin 2017** janë programuar për trajnime e seminare (llogaria 602011) shuma prej 200,000 lekë dhe janë realizuar vetëm 173,520 lekë, **ose 87% e saj.**

Për këtë rekomandojmë:
Nga UFSNK në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të merren masa në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kryerjen e trajnimeve dhe seminareve, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) apo dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për mënyrën e analizës së Menaxhimit të Riskut, si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve në dispozicion, prokurimin publik elektronik, eetj. duke siguruar një pjesëmarrje në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, si dhe specialistëve të tjerë.

2.Vlerësimi i riskut *(a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar ne analiza etj).*
- Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e UFSNK, **nuk ka patur në vitin 2016 regjistër të risqeve dhe nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese** dhe nevojave për kontrolle të reja, ***por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një strategji me planin e veprimit për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.*** **Ky proces është korrigjuar në vitin 2017.**
Auditimi konstaton se:
Vlerësimi i riskut është një **proces pak i zhvilluar** në metodologjitë e zbatuara në praktikë nga audituesit. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë sporadike dhe jo praktika të zakonshme të punës. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i "Menaxhimit të Riskut" dhe vendosjes së kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e UFSNK..
Rekomandim
Në zbatim të neneve 10 dhe 21, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", UFSNK të hartojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioriteteve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion.

Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 11 "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë", pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 "Menaxhimi i Riskut", ky institucion *për periudhën objekt* ***nuk kanë hartuar***

Strategjinë e Menaxhimit të riskut në UFSNK. *Gjithashtu, në lidhje me regjistrin e riskut, të miratuar nga nëpunësi autorizues,* duhen bërë rivlerësime vjetore dhe ri kontroll i risqeve, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave. Punonjësit e për vitin 2016 dhe 2017, *nuk kanë zhvilluar asnjë trajnim* për drejtuesit e lartë apo stafin që është përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimet lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm, hartimin e regjistrit te riskut si dhe të nxitjen ndaj parregullsive, t'i raportojnë ato si dhe hartimi mbi masat për parandalimin e këtyre risqeve edhe pse referuar listës së risqeve të evidentuara si prioritare për njësinë, institucioni ka renditur zhvillimin e trajnimeve/ seminareve në fushën e menaxhimit të riskut, hartimit të dokumenteve si dhe regjistrit apo strategjisë së tij për shkak të njohurive të pamjaftueshme në lidhje me këto procese, por këto trajnime nuk janë realizuar.

3.Aktivitetet e kontrollit: ***(a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të pa pajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plota, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).***
Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësive lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat. U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve, inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, etj.
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Në UFSNK proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e institucionit. Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i nënshkrimit të dyfishtë.
Njësia ka një strukturë të posaçme të IT, (Sektori të Teknologjisë Informacionit), e ngarkuar me mirëmbajtjen dhe kontrollimin e sistemit të IT. Është hartuar rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale dhe miratuar nga Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.
Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit Excel dhe nuk ka ndonjë soft financiar, që të përdoret nga ana e Degës së Financës.
Janë miratuar në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" si të "Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor të fond krijuesit, etj. Universiteti është krijuar me VKM nr.5, date 7.1.1992 dhe nuk janë dërguar në arkiv nga fond krijues për këto 25 vjet .

4. Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato).
Administratori Kryetarët e degëve dhe NZ i njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar. Rektori i Universitetit dhe Këshilli i Administrimit janë informuar nga Administratori dhe përgjegjësit e sektorëve, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. NZ, ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme tek nëpunësi autorizues, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.
Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, ndjekjes së çështjeve të deleguara, etj.
Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive.
Në këtë institucion sistemi i IT-së, afron informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi dhe të strukturave të veçanta të saj, duke plotësuar nevojat e domosdoshme të punonjësve nëpërmjet komunikimit online, sigurimin e informacioneve në web-site, etj.
Sistemi i IT-së, është i pajisur me një sistem rezervë (back-up) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ri përfitimin e tyre, në rast aksidenti. Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore.

5. Monitorimi *(a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuara se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).*
Nga auditimi u verifikua se si është zbatuar neni 32, "Raportimi" i ligjit nr. 80/2015, ku përcaktohet se: *"1. Institucionet e arsimit të lartë paraqesin,* ***për çdo vit akademik****, pranë ministrisë përgjegjëse,* ***raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit*** *për vitin në vijim, informacion për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës,*
2. Afatet për raportim përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin."

Nga auditimi rezultoi se, në bazë të kërkesave për mallra, shërbime ose punë, të paraqitura nga administrata e Rektoratit (AK) për vitet buxhetore, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, është përgatitur regjistri i parashikimeve, brenda datës 15 janar të çdo viti, por nga ana e KA (Këshillit Administrues), tashmë i emërtuar Bordi i Administrimit (BA) krijuar në bazë të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH", detajimi i fondeve është miratuar me vonesë dhe janë dërguar **jashtë afateve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike**. respektivisht:

- **Për vitin 2015**, sipas **Vendimit të** KA, **nr.1, datë 04.02.2016,** "Vendim për miratimin e raportit vjetor financiar të Universitetit "Fan S. Noli" për vitin 2015";
- **Për vitin 2016**, **nuk rezulton të jetë hartuar, marrë në analizë raporti vjetor i UFSNK dhe nuk rezulton të jetë dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.**

Konstatimi:
Nuk janë kryer analizat vjetore të veprimtarisë për vitin 2016, dhe për rrjedhojë mungon shqyrtimi e analiza e këtyre raporteve të veprimtarisë në Bordin e Administrimit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe

Udhëzimin e APP nr. 2, datë 27.01.2015, si dhe **me përcaktimet e nenit 49, germa "h", të ligjit nr. 80/ 2015 sipas të cilit, Bordi i Administrimit *"miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati".*** Në fakt, vetëm raporti i veprimtarisë për vitin 2015 **është shqyrtuar nga ana e Bordit të Administrimit, i cili është miratuar nga ky bord me Vendimin e tij nr.1, datë 04.02.2016.**

Nga ana e UFSNK për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, me shkresën e UFSNK nr.1041/2 prot, datë 04.06.2018, "Objeksione për Projekt raportin dërguar me shkresën nr. 202/5, datë 12.5.2018", (nënshkruar nga ana e Kryetarit të Bordit të Administrimit të Universitetit)", *janë* ***ridërguar komentet dhe shpjegimet e bëra dhe për aktkonstatimet , duke ritheksuar se:***

"... UNIKO analizën vjetore, referuar udhëzimit të sipërcituar , e harton për vit akademik. Sqarojmë se për vitin akademik 2016-2017 raporti është hartuar dhe dorëzuar në Ministri. Për vitin akademik 2017-2018 është kryer analiza vjetore nga Bordi i Administrimit dhe po përgatitet analiza vjetore nga ana e senatit dhe brenda afateve të përcaktuara në udhëzim do të dorëzohet në ministri".

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se marrim parasysh objeksion dhe konsiderojmë raportin e dërguar për analizën e vitit 2017, megjithatë, **nuk ka një të tillë për vitin 2016** dhe nuk ka asnjë vendimmarrje te BA për miratimin e tij, **sikundër është kryer për vitin 2015**, (Vendimi nr.1, datë 04.02.2016). Gjithashtu, sjellim në vëmendje se referenca e vënë nga ana juaj, është e datës 19.2.2018 dhe nuk mund të shërbejë si referencë për raportet vjetore të periudhave 2016 dhe 2017.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, ky koment i zyrtarëve të UFSNK merret pjesërisht në konsideratë nga grupi i auditimit.

Për sa sipër rekomandojmë:
Bordi i Administrimit, në përmbushje të misionit të tij, duhet të kryejë në përputhshmëri, me rregullshmëri dhe në kohë, funksionet e tij konform dispozitave ligjore, për të mos shkaktuar vonesa për parashikimet dhe realizimet e procesit të prokurimeve, sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Në UFSNK, titullari i njësisë informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e zyrave mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, dhe sistemit të evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike (javore, mujore dhe tremujore).
Menjëherë dhe në vazhdimësi

Në UFSNK është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike (me përjashtim të analizave vjetore) që institucioni i ka paraqitur në MARS, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, nëpërmjet lidhjes së vendosur në faqet zyrtare të UFSNK dhe MASR.
Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paragrafi 257, nënpika 63 "Raportet e monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave

nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ku shprehimisht përcaktohet që:

> *"Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive.*

Konkluzion:
Nga auditimi u konstatua se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, dhe disa komisione apo kategori të punonjësve që nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion, argumentuar me shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara sipas këtij raporti auditimit, ndaj për përmirësimin e punës në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për korrigjimin e mangësive të referuara më lartë.

C. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit. Planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

C.1- Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Auditimi u krye *për vitet 2016 dhe 2017,* duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:
- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015;
- Ligjin nr. 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016";
- Ligji nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017";
- VKM nr. 285, datë 01.04.2015 "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016-2018";
- VKM nr. 696, datë 31.07.2015 "Për tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018";
- Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2014 "Për Përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2015-2017";
- Udhëzimi Standard i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 02.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm";
- Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm";
- Udhëzimi nr.4, datë 29.02.2016"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019";
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 16.01.2015;
- Udhëzim nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore";
- Ligji nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017".

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, është institucion publik i arsimit të lartë me status të personit juridik publik. Ai është i organizuar dhe funksionon si një strukturë e centralizuar, përbëhet nga një njësi shpenzuese, e cila përbëhet nga katër Fakultete Fakulteti Edukimit dhe Filologjisë, Fakulteti Ekonomisë, Fakulteti Bujqësisë, Fakulteti Shkencave të Natyrës dhe Humane si dhe Administrata e Rektoratit. Procedurat e prokurimit për mallra, punë dhe shërbime realizohen në mënyrë të përqendruar nga Administrata e Rektoratit, me të njëjtin kod buxhetor. Të gjitha veprimet financiare që kryejnë, bëhen direkt me thesarin nëpërmjet Administratës së Rektoratit dhe programit buxhetor 1011046.
Në buxhetin e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, përfshihen këto komponentë kryesore:
-Transferta e pakushtëzuar (për funksionim)
-Të ardhurat e kushtëzuara të institucionit (për funksionim dhe investime)
Nga auditimi konstatohet se programimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016 dhe vitin 2017 "Programimi buxhetit dhe i shpenzimeve është bërë duke u bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, financohet nga MASR me fonde buxhetore të pakushtëzuara, të cilat sipas kritereve të ligjit nr. 80/2015, janë në dispozicion të Universitetit për t'i detajuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit. Në fakt fondet e çelura nga Ministria, Universiteti i ka detajuar dhe përdorur për të mbuluar shpenzimet për fond page, sigurime shoqërore, bursa për studentët të cilat mbulojnë rreth 75 % të këtyre zërave dhe pjesa tjetër rreth 25 % financohet nga të ardhurat dytësore, gjithashtu me të ardhurat dytësore mbulohen edhe zëra të tjerë të shpenzimeve.
Sipas ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 3, përcaktohet se: "Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi". Bordi i Administrimit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, cakton në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit".
Për sa më lart terminologjia për autonomisë nuk mund të zbatohet pasi Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, duke qenë se përfiton fonde buxhetore rreth 70 % të nevojave të saj nuk mund të caktojë vetë pagat pa u mbështetur në dispozita të tjera ligjore, të cilat deri sot nuk kanë dalë e për rrjedhojë është krijuar vakum ligjor në interpretimin dhe funksionimin e autonomisë së Universitetit.
Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 2 programe buxhetore të cilat janë:
1. Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrimi"(09450), është programi i cili mbulon formulimin e politikave dhe strategjive të njësisë ku përfshihet dhe aparati. Në këtë program përfshihen pagat (artikulli 600), sigurimet shoqërore e shëndetësore (artikulli 601), transferta tek individët, bursat e studentëve (artikulli 606). Në këtë program nga të ardhurat janë mbuluar pagesat e honorarëve për orët mësimore, pagesa e orëve mësimore me kohë të pjesshme, orët mbi ngarkesë të stafit akademik, pagës për orët mësimore të kryera nga punonjësit akademikë të ftuar si dhe pagesat për pedagogët e jashtëm. Programi përmban shpenzimet operative (artikulli 606) pagesat e energjisë, ujit, telefoni, buletini shkencor, kancelari, karburant për ngrohje, shërbimet postare etj.
2. Programi "Kërkimi shkencor" (09770), në këtë program përfshihen shpenzimet e planifikuara për projektimin e godinës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (artikulli 230)

si dhe investimet e kryera për makineri dhe agregate bujqësore, laboratorin e fizioterapisë dhe gjuhëve të huaja, mjete kompjuterike, pasurimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj etj., (artikulli 231).

Mbi programimin afatmesëm të buxhetit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë,

Programimi i shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm 2016-2017, fondet e çelura nga Buxheti i shtetit në formën Grand i pakushtëzuar së bashku me të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, paraqiten sipas tabelës nr.1:

Tabela nr. 1 Fondet buxhetore dhe të ardhurat *Në mijë lekë*

Nr	EMERTIMI	2016		2017	
		Programuar	Celur	Programuar	Celur
1	Paga, art. (600)	308,967	266,391	283,245	272,000
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	36,386	35,553	34,618	40,816
3	Shpenzime operative, art. (602)	54,400	64,656	73,245	67,000
4	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-	-	-	-
5	Bursa per studentet, art. (606)	25,000	22,000	24,850	24,000
6	Investime, art. (230)	3,850	2,700	1,960	2,300
7	Investime , art. (231)	44,202	77,692	56,720	108,980
TOTAL BUXHETI		**472,805**	**468,992**	**474,638**	**515,096**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga tabela e mësipërme rezulton se për vitet 2016 dhe 2017, Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, ka programuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore sipas nivelit të pagave të miratuara bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, sipas numrit të punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm dhe tabelës së pagave për punonjësit akademike dhe punonjësit e tjerë të administratës mbështetëse.

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, konstatohet se ka një planifikim jo real të shpenzimeve midis Programimit të shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm PBA 2016-2017, planifikimit vjetor dhe çeljes së fondeve, konkretisht:

- Shpenzime operative, artikulli (602) në PBA është programuar në vlerën 54,400 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja është në vlerën 64,656 mijë lekë, +10,256 mijë lekë.
- investime, artikulli (231) në PBA është programuar në vlerën 44,202 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja është në vlerën 77,692 mijë lekë, +33,490 mijë lekë.
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, artikulli (601) është programuar në vlerën 34,618 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe celja është në vlerën 40,816 mijë lekë, +4,198 mijë lekë.
- Investime, artikulli (230) është programuar në vlerën 1,960 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 2,300 mijë lekë, +340 mijë lekë.
- Investime, artikulli (231) është programuar në vlerën 56,720 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 108,980 mijë lekë, +952,260 mijë lekë.

Shpenzimet operative janë miratuar nga Këshilli i Administrimit për vitin 2016 dhe Bordi i Administrimit për vitin 2017, sipas projekt buxhetit afat mesëm mbështetur në realizimet e viteve para ardhës. Realizimi i treguesve të shpenzimeve krahasuar me faktin, paraqitet në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2 Krahasimi i planifikimit të shpenzimeve vjetore me faktin *Në mijë lekë*

Nr.	EMERTIMI	2016		2017	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Paga, art. (600)	266,391	232,314	272,000	264,272
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	35,553	34,750	40,816	37,751
3	Shpenzime operative, art. (602)	64,656	52,125	67,000	50,368
4	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-		-	
5	Bursa per studentet, art. (606)	22,000	17,873	24,000	21,953
6	Investime, art. (230)	2,700	79	2,300	71
7	Investime , art. (231)	77,692	37,909	108,980	50,241
TOTAL BUXHETI		**468,992**	**375,050**	**515,096**	**424,664**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga krahasimi i treguesve të programuar dhe të çelur në fakt konstatohen disferenca të cilat përfaqësojnë ndryshime në pakësim të artikujve për çdo vit ushtrimor nga Ministria e Financave. Treguesit e mësipërm janë të rakorduar me degën e thesarit për çdo muaj dhe në fund të çdo viti.
Fondet e çelura nga buxheti i shtetit për periudhën objekt auditimi dhe të ardhurat e realzuara nga taksa e regjistrimit dhe shkollimit janë përdorur përgjithësisht me efektivitet për realizimin e objektivave të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.

Realizimi i buxhetit për vitin 2016

Në muajin janar 2016 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është çelur grandi për Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, <u>në shumën prej 251,944 mijë lek.</u> Me shkresën nr.5, datë 05.01.2016 Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, ka dërguar në Ministrisë së Financave dhe MAS detajimin e këtij grandi. Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar detajimet sipas zërave të shpenzimeve përkatësisht me shkresat nr.17761/145, datë 11.01.2016 dhe 1403/3, datë 21.01.2016.
Këshilli i Administrimit, bazuar në të ardhurat e pritshme të vitit 2016, me Vendimin nr. 12, datë 26.12.2015, ka miratuar ndarjen e grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit si dhe detajimin e përdorimit të të ardhurave të institucionit, parashikuar për vitin 2016.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave dhe krahasimi me planin për vitin 2016, paraqiten në tabelën nr.3:

Tabela nr. 3 *Në mijë lekë*

Nr.	EMERTIMI	Fonde te grantit qendror (MASH)		Fonde nga të ardhurat e kushtezuara		Totali i fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	

1	Paga, art. (600)	261,391	201,298	50,000	31,016	266,391	232,314	87%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	35,553	34,480	-	-	35,553	34,480	97%
3	Shpenzime operative, art. (602)	-	-	64,665	52,125	64,656	52,150	81%
4	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-	-	-	-	-	-	0%
5	Bursa per studentet, art. (606)	22,000	17873	-	-	22,000	17,873	81%
6	Investime, art. (230)	-	-	2,700	79	2,700	79	3%
7	Investime , art. (231)	-	-	77,692	37,909	77,692	37,909	49%
TOTAL BUXHETI		273,944	**253,651**	**195,048**	**121,129**	**468,992**	**374,780**	80%

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga tabela e mësipërme rezulton se në total shpenzimet janë realizuar në masën 80 %.
Në raport me totalin e shpenzimeve të programuar financimi nga buxheti i shtetit është në masë prej 58 %, e konkretisht fondet e çelura nga grandi i pakushtëzuar kap shumën prej 253,651 mijë lekë, dhe të ardhurat e institucionit kapin shumën prej 121,129 mijë lekë. Të ardhurat në fakt krahasuar me planin janë përdorur sipas realizimit në masën 80.6 %.
Në mënyrë analitike financimet dhe lëvizjet e fondeve sipas programit për "Planifikim menaxhim dhe administrim" dhe "Kërkim Shkencor" për vitin 2016, zërat e buxhetit paraqiten në tabelën nr.4.

Tabela nr. 4 *Në lekë*

Emetimi		**600**	**601**	**606**	**602**	**230**	**231**
		Paga	**Sig. shoq**	**Transferta tek individët**	**Mallra dhe shërbime**	**Projektime**	**Investime**
Planifikim Menaxhim Administrim (nga buxheti I)	Plan	216,391,000	35,553,000	22,000,000			
	Fakt	201,298,392	34,479,583	17,872,632			
	%	**93 %**	**97 %**	**81 %**			
Planifikim Menaxhim Administrim (nga të ardhurat II)	Plan	50,000,000			64,655,780	700,000	75,840,000
	Fakt	31,015,579			52,125,322	79,200	36,526,795
	%	**62 %**			**80 %**	**11 %**	**48 %**
SHUMA I+II	**Plan**	266,391,000	35,553,000	22,000,000	64,655,780	700,000	75,840,000
	Fakt	232,313,971	34,479,583	17,872,632	52,125,322	79,200	36,526,795
	%	**87 %**	**97 %**	**81 %**	**80 %**	**11 %**	**48 %**
Kërkimi Shkencor	Plan			3,852,000			
	Fakt			1,382,000			
	%			**35%**			
TOTALI	**Plan**	**266,391,000**	**35,553,000**	**25,852,000**	**64,655,780**	**700,000**	**75,840,000**
	Fakt	**232,313,971**	**34,479,583**	**19,254,000**	**52,125,322**	**79,200**	**36,526,795**
	%	**87 %**	**97 %**	**74 %**	**80 %**	**11 %**	**48 %**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Fondet nga Buxheti për programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 201,298,392 lekë ose në masën 93% kundrejt planit fillestar 216,391,000 lekë me një diferencë prej 15,092,608 lekë, *sigurimet shoqërore* (601), janë realizuar në vlerën 34,479,583 lekë ose në masën 97% kundrejt planit fillestar 35,553,000 lekë, me një diferencë prej 1,073,417 lekë. *Shpenzime për transferta tek individët*

(606) janë realizuar në vlerën 17,872,632 lekë ose në masën 81% kundrejt planit fillestar 22,000,000 lekë me një diferencë prej 4,127,368 lekë. Në zbatim të VKM nr. 911, datë 11.11.2015 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e pagesave dhe për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte, për nxënësit dhe studentët në Institucionet Arsimore Publike", në transfertat tek individët (606) për vitin akademik 2016-2017, kanë përfituar gjithsej 464 persona nga të cilët me ndihmë ekonomike 457 studentë, persona me aftësi të kufizuar 6 studentë, për rezultate të larta nga viti paraardhës 1 student.
Në programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" janë akorduar fonde për paga (llogaria 600) nga të ardhurat dytësore të institucionit të cilat janë realizuar në vlerën 31,015,579 lekë ose 62 % me një diferencë 18,984,421 lekë nga planifikimi 50,000,000 lekë.
Fondet nga të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni për programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" janë realizuar: Për mallra dhe shërbime në vlerën 52,125,322 ose në masën 80% kundrejt planit fillestar 64,655,780 lekë me një diferencë 12,530,458 lekë, për projektime janë realizuar në vlerën 79,200 lekë ose në masën 11 % me një diferencë 620,800 lekë nga planifikimi, investimet janë realizuar në vlerën 36,526,795 lekë ose në masën 48% me një diferencë 39,313,205 lekë nga planifikimi.
Në total i gjithë buxheti për vitin 2016 është realizuar në vlerën 374,779,503 lekë ose 80% kundrejt buxhetit të planifikuar dhe çelur me vlerë 468,991,780 lekë (-94,212,277 lekë).
Në total, në zëra rezultojnë, shpenzimet për paga (600) janë realizuar në vlerën 232,313,971 lekë ose në masën 87 %, sigurimet shoqërore (601) në vlerën 34,479,583 lekë ose në masën 97 %, transfertat tek individët (606) në vlerën 19,254,000 lekë ose në masën 74 %, mallra dhe shërbime (602) në vlerën 52,125,322 ose në masën 80 %, projektime (230) në vlerën 79,200 lekë ose 11%, investime (231) në vlerën 36,526,795 lekë ose 48 %.
Krahasuar me vitin 2015, shpenzimet sipas zërave të buxhetit për vitin 2016 paraqiten në tabelën nr.5.

Tabela nr.5 *Në 000/lekë*

Nr.	EMERTIMI	Fakt 2015	Fakt 2016	Në %
1	Paga, art. (600)	229,449	232,314	101 %
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	33,147	34,480	104 %
3	Shpenzime operative, art. (602)	47,523	52,150	110 %
4	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-	-	-
5	Bursa per studentet, art. (606)	17,779	17,873	101 %
6	Investime, art. (230)	-	79	
7	Investime , art. (231)	5,136	37,909	738 %
TOTAL BUXHETI(1+7)		**333,034**	**374,780**	**113 %**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se realizimi i buxhetit të vitit 2016 është 13% me i larte se realizimi i buxhetit të vitit 2015. Krahasuar me vitin e kaluar shpenzimet për paga janë realizuar 101 % ose 1% më tepër se një vit më parë si rrjedhojë e disa ndryshimeve në numrin e punonjësve.

Për vitin 2016, shpenzimet operative janë financuar në masën mbi 100 % nga të ardhurat dytësore të institucionit, të cilat janë realizuar 10 % më shumë krahasuar me vitin 2015 dhe

zënë të 43 % të të ardhurave të realizuara. Bursat për studentët janë realizuar 1 % më tepër si rrjedhojë e regjistrimit të studentëve përfitues nga zbatimi i VKM nr.911, datë 11.11.2015 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave dhe për kuatat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte, për nxënësit dhe studentët në Institucionet Arsimore Publike". Për vitin 2016 realizimi i fondeve për zërin projektime (artikulli 230) është realizuar 79 mijë lekë, ndërkohë që në vitin 2015 nuk ka financime të kësaj natyre. Ky zë i krahasuar me planifikimin për vitin 2016 është realizuar 11 %
Realizimi i fondeve në zërin e investimeve (artikulli 231) për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 janë realizuar 738 % më shumë se fakti i vitit 2015, por në krahasim me planifikimin për vitin 2016 është realizuar 48 %. Për vitin 2016 fondi i investimeve është krijuar nga të ardhurat e vetë institucionit.

Nga të dhënat e tabelës nr.6 (në anekset e raportit) rezulton se zëri shpenzime operative për vitin 2016 është realizuar në masën 81 %. Peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative e zënë shpenzimet për honorarë (Pagesat për punonjësit e angazhuar në kryerjen e oponencave teknike, analizave të tekstilit, pagesat për anëtarë të KAD, Senat, Këshilla Fakulteti e Këshilla të Profesorëve), që zënë 8.3 % të shpenzimeve totale vjetore, shpenzimet për ruajtjen e objekteve që në plan dhe fakt zënë rreth 28.4% të shpenzimeve totale, shpenzime për lëndë djegëse karburant dhe vaj që në plan dhe fakt zënë 15.7 % të shpenzimeve totale, shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit dhe brenda vendit, që në plan dhe fakt zënë rreth 2.8 % te shpenzimeve totale. Peshë specifike të madhe në shpenzimet e vitit, zënë edhe shpenzime e drejtpërdrejta si energji, ujë, telefon, karburant që përbëjnë rreth 14.6 % të shpenzimeve vjetore.
Për vitin 2016 janë tenderuar dhe likuiduar, blerjet e materialeve të kancelarisë, materialeve elektrike dhe hidraulike, materialeve të pastrimi, bojëra printerëve e fotokopjeve, shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike, blerje karburanti, mirëmbajtje të mjeteve të transportit, shërbimi i sigurimit të ndërtesave dhe pajisjeve etj. Nga viti 2016 nuk janë mbartur detyrime për tu paguar në vitin 2017.
Artikulli 602 (shpenzime korente). Për vitin 2016, fondi i planifikuar për pagesa në zërin e shpenzimeve operative në total është 64,655 mijë lekë. Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për këtë artikull nuk janë akorduar fonde. Fondi i planifikuar për pagesa në zërin e shpenzimeve operative është financuar me fonde nga të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2016. Në vitin 2016 likuidimi i kreditorëve për shpenzime operative në afatet e përcaktuara nuk ka patur probleme për arsye të mbledhjes së të ardhurave në mënyrë periodike.
Realizimi i shpenzimeve për vitin 2016 dhe krahasimi me vitin 2015 , realizimi i detajuar sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.7, në anekset e raportit.

Nga të dhënat e tabelës nr.7 (në anekset e Raportit) rezulton se zëri shpenzime operative në nivel krahasimi mes dy viteve, konstatohet se në total si dhe disa nën zëra realizimi i vitit 2016 është më i madh se viti 2015. Në total për vitin 2015 është shpenzuar vlera 47,532,538 lekë ndërsa për vitin 2016 është shpenzuar vlera 52,125,322 lekë me rritje në vlerën + 4,592,784 ose 10% më shumë.
Në zërin shpenzime për blerje kancelari dhe letër (6020100) për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 kemi një realizim të shpenzimit në masën 193 %, në nën zërin blerje dokumentacioni (6020500) për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 kemi një realizim të shpenzimit me 133% pasi janë kryer shpenzime për riprodhimin e tyre sipas kërkesave në rritje, siç mund të përmendim diploma, libreza, regjistra etj.

Në zërin furnizime dhe materiale të tjera zyre e të përgjithshme (6020900) për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 kemi një rritje të ndjeshme në vlerë 856,173 lekë shpenzime më shumë se një vit më parë, ose 1327 %, pasi janë bërë mobilime në pajisje për zyrat.
Në zërin shpenzimet për honorare (6029005) kanë një rritje me 8% në krahasim me vitin 2015 ose në vlerë (+ 309,266 lekë)
Në zërin shpenzimet për konsum të energjisë elektrike, ujë, shërbime telefonike dhe postare (6022001, 6022002, 6022003, 6022004) kemi një rritje me 13 % ose në vlerën 900,267 lekë më shumë se viti 2015.
Në zërin shpenzime për mirëmbajtje objekteve specifike (6025200) kemi një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2015 në vlerën 338,160 lekë, shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit (6025600) kemi rritje krahasuar me një vit më parë në vlerën 47,950 lekë.
Në zërin shpenzime për mirëmbajte pajisje zyre (6025800) kemi rritje krahasuar me një vit më parë në vlerën 112,200 lekë ose 229 % realizim.
Në zërin shërbime të sigurimit dhe ruajtjes (6022008) kemi rritje krahasuar me një vit më parë në vlerën 2,690,090 lekë ose 22 % më shumë. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë rritjes së pagës minimale për punonjësit e shërbimit.
Në zërin Shpenzime te tjera transporti (6023900) kemi një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2015 në vlerën 532,560 lekë më shumë ose 9476 %, rritje e cila ka ardhur si pasojë e kryerjes së praktikave dhe ekspeditave mësimore kryesisht në fakultetin e edukimit dega histori filologji.

Realizimi i investimeve për vitin 2016, sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.8.

Tabela nr. 8 *Në 000 lekë*

Nr.	Nr Llogari 230 - 231	Objekti i prokurimit	Plani 2016	Fakt 2016	Realizimi ne %
I	**230**	Shpenzime Studime kerkime 9770	2,000		
1	230	Shpenzime per Studim e projektim	960	79.2	8%
II	**231**				
1	2312101	Shpenz ndertesa administrative	33,000		0%
2	2312118	Shpenzime te tjera ndertimore	960	850.5	89%
3	2312112	Shpenz per krijim fondi biblioteke	5,000	4848.3	97%
4	2313400	Konstruksion rrjeti	475.2		0%
5	2314130	Shpenz pajisje dhe instrumenta laboratorike	19,800	17354.3	88%
7	2314320	Shpenzime mjete e pajisje te tjera teknike	960	743.9	77%
8	2315120	Blerje automjeti	4,000	3996	100%
9	2318100	Shpenzime per orendi zyre	960	610.8	64%
10	2314320	pajisje per kopshtarine	3,000	2814	94%
11	2318600	Shpenzime per blerje pajisje kompjuterike	7,852	6662	85%
13	2318700	Shpenzime per pajisje zyre	960	28	3%
Shuma			**79,927**	**37,987**	**48%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se investimet për vitin 2016 janë realizuar në masën 48 %. Ky mosrealizim vjen si rezultat i moskryerjes së

investimeve të planifikuara në zërin rikonstruksion i godinës ish shtëpia e oficerëve Korçë, e cila me VKM nr.530, datë 07.08.2012, ka kaluar nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nën përgjegjësi administrimi të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, që me VKM nr.201, datë 04.03.2015, kati i parë i objektit i kaloi nën përgjegjësi dhe administrim të Qendrës Rinore Korçë dhe me VKM nr. 152, datë 29.02.2016, i kaloi pjesa tjetër nën përgjegjësi dhe administrim të Bashkisë Korçë. Vlera e moskryerjes së këtij investimi e llogaritur projektim, rikonstruksion godine dhe rrjeti është 34,356 mijë lekë. Me mos realizimin e rikonstruksionit të godinës është i lidhur edhe mos realizimi i investimit shpenzime per pajisje zyre e cila nga 960 mijë lekë i planifikuar është realizuar 28 mijë lekë ose 3%. Gjithashtu në investimet e vitit 2016, mos realizim ka edhe në nën zërin shpenzime studime kërkime (9770) të planifikuara 2,000 mijë lekë.

Ralizimi i investimeve gjatë vitit 2016, dhe krahasimi me vitin 2015, sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqitet në tabelën nr.9:

Tabela nr.9 *Në 000 lekë*

Nr.		Investimet	Fakt 2015	Fakt 2016	Në %
I	**230**				
1		Shpenzime Studime kerkime		79.2	
II	**231**				
1	2312101	Shpenz ndertesa administrative	717		
2	2312118	Shpenzime te tjera ndertimore	657	850	129 %
3	2312112	Shpenz per krijim fondi biblioteke	689	4,848	703 %
	2313400	Konstruksion rrjeti	475		
4	2314130	Shpenz pajisje dhe instrumenta laboratorike	857	17,354	2024 %
	2314170	Shpenz pajiisje instalim kondicioner	346		
5	2314320	Shpenzime mjete e pajisje te tjera teknike	414	743	179 %
6	2315120	Blerje automjeti		3,996	
7	2318100	Shpenzime per orendi zyre	909.6	610	67 %
8	2314320	Pajisje per kopshtarine	69.1	2,814	4072 %
9	2318600	Shpenzime per blerje pajisje kompjuterike		7,690	
		T O T A L I	**5,136**	**37,987**	739 %

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Për vitin 2016 investimet krahasuar me vitin 2015 janë realizuar 739 % ose 32,851 mijë lekë më shumë. Investimet (llogaria 230,231) për vitin 2016 janë realizuar me fondet nga të ardhurat dytësore të realizuara nga vetë universiteti. Për çdo vit ushtrimor buxheti ka përcaktuar prioritete sipas kërkesave të paraqitura nga njësitë vartëse, si dhe kërkesat per investime janë më të mëdha se fondet që janë në dispozicion.
Në investimet e vitit 2015 i është dhënë prioritet plotësimit të kërkesave më të domosdoshme, që kane të bëjnë me shpenzime te tjera ndërtimore, shpenzime ndërtesa administrative, shpenzime për krijim fondi biblioteke, shpenzime për pajisje dhe instrumente laboratorike, shpenzime për orendi zyre etj.

Ndërsa investimet e vitit 2016 kanë patur si prioritet plotësimin e kërkesave, që kanë të bëjnë me blerjen e bazës materiale orendi zyre e pajisje kompjuterike, pajisje për kopshtarinë, blerje automjeti, shpenzime për krijim fondi biblioteke që sigurojnë përmirësimin e kushteve për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.

Krijimi i të ardhurave gjatë vitit 2016, në vlerën 123,746 mijë lekë është realizuar sipas tabelës nr.10.

Tabela nr.10 *Në lekë*

Nr	Art	Emërtimi i te ardhurave	Plan viti 2016	Realizim viti 2016	%
1	7110103	Tarifa e shkollimit (regjistri)	46,000,000	44,727,629	97%
2	7110109	tarife Regjistrime me pagese	78,000,000	74,765,654	96%
3	7113001	Shitje prodhimi E.D.E.	600,000	542,500	90%
4	7110110	Tarifa nga konkurset	25,000	10,000	40%
5	7111003	Te ardhura te tjera	10,000	5,000	50%
6	7109600	Qira klubi e te tjera	560,000	542,045	97%
7	7111099	Arketim nga shpen(K.Fakulteti)		108,889	
8	7113099	te tjera te ardhura sekondare	3,200,000	3,044,400	95%
Totali			**128,395,000**	**123,746,117**	**96%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se të ardhurat e institucionit për vitin 2016, janë realizuar në vlerën 123,746,117 lekë ose në masën 96 % (-4,648,883 lekë). Në zëra të veçantë tarifa e shkollimit (regjistrimi) është realizuar në vlerën 44,727,629 lekë ose 97%, tarifa e regjistrimi me pagesë në vlerën 74,765,654 lekë ose 90 %, shitje prodhime EDE në vlerën 542,500 lekë ose 90 %, tarifa nga konkurset, qera, të ardhura të tjera në vlerën 3,710,334 lekë ose 97.7 % .
Të ardhurat e përdorura për vitin 2016 kapin vlerën 121,128,896 lekë. Janë trashëguar për vitin 2017 të ardhurat të pa çelura në vlerën 92,787 mijë lekë .
Realizimi i të ardhurave të krijuara ne vitin 2016 dhe krahasimi me vitin 2015. paraqiten në tabelën nr.11.

Tabela nr. 11 *Në lekë*

Nr	Art	Emertimi i te ardhurave	Realizim Viti 2015	Realizim Viti 2016	%
1	7110103	Tarifa e shkollimit (rregjistri)	110,990,545	44,727,629	40%
2	7110109	tarife Regjistrimeme pagese	11,129,906	74,765,654	672%
3	7113001	Shitje prodhimi E.D.E.	602,248	542,500	90%
4	7110110	Tarifa nga konkurset		10,000	
5	7111003	Te ardhura te tjera		5,000	
6	7109600	Qira klubi e te tjera	790,414	542,045	69%
7	7111099	Arkëtim nga shpen(K.Fakulteti)	1,660,272	108,889	7%
8	7113099	te tjera te ardhura sekondare	7,006,725	3,044,400	43%

9	7113013	Shitje dokumenta tenderi	7,000		0%
10	7207010	Sponsorizime nga Organizata	1,200,048		0%
Totali			**133,387,158**	**123,746,117**	**93%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Referuar të dhënave të mësipërme konstatohet të ardhurat e krijuara nga institucioni për vitin 2016, në krahasim me realizimin e vitit 2015 janë realizuar në vlerën 93% ose 9,641,041 lekë më pak se realizimi i një viti më parë. Ulje të ndjeshme ka tarifa e shkollimit e cila është realizuar 60 % më pak se një vit më parë ose në vlerën - 66,262,916 lekë, vlerë e cila ka ndikuar direkt në uljen e të realizimit të të ardhurave të realizuara për vitin 2016.

Buxheti Viti 2017

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, me shkresën nr.6/16, datë 15.08.2016, i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe MAS projekt buxhetin për periudhën 2017-2019 dhe detajimin e tij, të miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr. 22, datë 12.08.2016 dhe Këshilli i Administrimit, me Vendimin nr. 6, datë 12.8.2016.
Këshilli i Administrimit, bazuar në të ardhurat e pritshme të vitit 2017, me Vendimin nr. 1, datë 14.1.2017, ka miratuar ndarjen e grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit si dhe detajimin e përdorimit të të ardhurave të institucionit, parashikuar për vitin 2017.
Në muajin janar 2017 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është çelur grandi për Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, <u>në shumën prej 515,095 mijë lekë.</u>
Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar detajimet sipas zërave të shpenzimeve përkatësisht me shkresat nr.17911/68, daë 19.01.2017 dhe nr. 460, datë 20.01.2017.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave dhe krahasimi me planin për vitin 2017 paraqitet në tabelën nr.12.

Tabela nr.12 *Në 000 lekë*

Nr.	EMERTIMI	Fonde te grantit qendror (MASH)		Fonde nga të ardhurat e kushtezuara		Totali i fondeve		Në %
		Plan	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	
1	Paga, art. (600)	232,000	225,006	40,000	39,274	272,000	264,279	97%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	40,816	37,751	-	-	40,816	37,751	92%
3	Shpenzime operative, art. (602)	5,000	2,608	62,000	47,760	67,000	50,368	81%
4	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-	-	-	-	-	-	0%
5	Bursa per studentet, art. (606)	24,000	21,953	-	-	24,000	21,953	91%
6	Investime, art. (230)	-	-	2,300	71	2,300	71	3%
7	Investime , art. (231)	-	-	108,980	50,241	108,980	50,241	46%
	TOTAL BUXHETI	**301,816**	**287,318**	**213,280**	**137,346**	**515,096**	**424,664**	**82 %**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga tabela e mësipërme rezulton se në total shpenzimet janë realizuar në masën 82 %.
Në raport me totalin e shpenzimeve të programuar financimi nga buxheti i shtetit është në masë prej 58 %, e konkretisht fondet e çelura nga grandi i pakushtëzuar kap shumën prej

287,318 mijë lekë, dhe të ardhurat e institucionit kapin shumën prej 137,346 mijë lekë. Të ardhurat në fakt krahasuar me planin janë përdorur sipas realizimit në masën 82 %.

Në mënyrë analitike financimet dhe lëvizjet e fondeve sipas programit për "Planifikim menaxhim dhe administrim" dhe "Kërkim Shkencor" për vitin 2017, zërat e buxhetit paraqiten në tabelën nr.13.

Tabela nr.13 *Në lekë*

Emetimi		600	601	606	602	230	231
		Paga	Sig. shoq	Transferta tek individët	Mallra dhe shërbime	Projektime	Investime
Planifikim Menaxhim Administrim (nga buxheti I)	Plan	232,000,000	40,815,690	24,000,000	5,000,000	-	-
	Fakt	225,005,569	37,750,967	21,953,457	2,608,434	-	-
	%	**97 %**	**92 %**	**91 %**	**52 %**	-	-
Planifikim Menaxhim Administrim (nga të ardhurat II)	Plan	40,000,000	-	-	62,000,000	800,000	107,480,000
	Fakt	39,273,696	-	-	47,760,061	70,800	50,241,008
	%	**98 %**	-	-	**77 %**	**8.8 %**	**46.7 %**
SHUMA I+II	**Plan**	272,000,000	40,815,690	24,000,000	67,000,000	800,000	107,480,000
	Fakt	264,273,696	37,750,967	21,953,457	49,368,495	70,800	50,241,008
	%	**97 %**	**92 %**	**91 %**	**73.7 %**	**8.8 %**	**46.7 %**
Kërkimi Shkencor	Plan	-	-	-	-	1,500,000	1,500,000
	Fakt	-	-	-	-	-	-
	%	-	-	-	-	-	-
TOTALI	**Plan**	**272,000,000**	**40,815,690**	**24,000,000**	**67,000,000**	**2,300,000**	**108,980,000**
	Fakt	**264,273,696**	**37,750,967**	**21,953,457**	**49,368,495**	**70,800**	**50,241,008**
	%	**97 %**	**92 %**	**91 %**	**73.7 %**	**3 %**	**46 %**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Fondet nga Buxheti për programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" janë realizuar: Shpenzimet për pagat (600) janë realizuar në vlerën 225,005,569 lekë ose në masën 97% kundrejt planit fillestar 232,000,000lekë me një diferencë prej 6,994,431lekë, *sigurimet shoqërore* (601), janë realizuar në vlerën 37,750,967 lekë ose në masën 92% kundrejt planit fillestar 40,815,690lekë, me një diferencë prej 3,064,732 lekë. *Shpenzime për transferta tek individët* (606) janë realizuar në vlerën 21,953,457 lekë ose në masën 91% kundrejt planit fillestar 24,000,000 lekë me një diferencë prej 2,046,543 lekë. Në zbatim të VKM nr. 911, datë 11.11.2015 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e pagesave dhe për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte, për nxënësit dhe studentët në Institucionet Arsimore Publike", në transfertat tek individët (606) për vitin akademik 2017-2018, kanë përfituar gjithsej 491 persona nga të cilët me ndihmë ekonomike 487 studentë, persona me aftësi të kufizuar 2 studentë, për rezultate të larta nga viti paraardhës 2 student.
Për mallra dhe shërbime në vlerën 2,608,434 ose në masën 52% kundrejt planit fillestar 5,000,000 lekë me një diferencë 2,391,566 lekë.
Në programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" janë akorduar fonde për paga (llogaria 600) nga të ardhurat dytësore të institucionit të cilat janë realizuar në vlerën 39,273,696 ose 98 % me një diferencë 726,304 lekë nga planifikimi 40,000,000 lekë.
Fondet nga të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni për programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" janë realizuar: për projektime janë realizuar në vlerën 70,800 lekë ose në masën 8.8 % me një diferencë 729,200 lekë nga planifikimi me vlerë 800,000 lekë,

investimet janë realizuar në vlerën 50,241,008 lekë ose në masën 46.7% me një diferencë 57,238,992 lekë nga planifikimi me vlerë 107,480,000 lekë.
Në total i gjithë buxheti për vitin 2017 është realizuar në vlerën 424,664,422 lekë osë 82% kundrejt buxhetit të planifikuar dhe çelur me vlerë 515,095,690 lekë (-90,431,268 lekë).
Në zëra rezulton, shpenzimet për paga (600) janë realizuar në vlerën 264,273,696 lekë ose në masën 97 %, sigurimet shoqërore (601) në vlerën 37,750,967 lekë ose në masën 92 %, transfertat tek individët (606) në vlerën 21,953,457 lekë ose në masën 91 %, mallra dhe shërbime (602) në vlerën 49,368,495 ose në masën 73.7 %, projektime (230) në vlerën 70,800 lekë ose 3%, investime (231) në vlerën 50,241,008 lekë ose 46 %.
Krahasuar me vitin 2016, shpenzimet sipas zërave të buxhetit për vitin 2017 paraqiten në tabelën nr.14.

Tabela nr.14 *Në 000/lekë*

Nr.	EMERTIMI	Fakt 2016	Fakt 2017	Në %
1	Paga, art. (600)	232,314	264,279	114 %
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	34,480	37,751	109 %
3	Shpenzime operative, art. (602)	52,150	50,368	96 %
4	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)	-	-	-
5	Bursa per studentet, art. (606)	17,873	21,953	123 %
6	Investime, art. (230)	79	71	90 %
7	Investime , art. (231)	37,909	50,241	132 %
TOTAL BUXHETI(1+7)		**333,034**	**424,664**	**127 %**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se realizimi i buxhetit për vitin 2017 është 27% me i lartë se realizimi i buxhetit për vitit 2016. Krahasuar me vitin e kaluar shpenzimet për paga janë realizuar 114 % ose 14% më tepër se një vit më parë si rrjedhojë e disa ndryshimeve në numrin e punonjësve në strukturën organike.

Për vitin 2017, shpenzimet operative janë financuar nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat dytësore të krijuara nga vetë institucionit. Realizimi i shpenzimeve operative me financim nga buxheti i shtetit është në masën 52 % dhe realizimi nga të ardhurat dytësore në masën 77 %. të cilat janë realizuar 4 % më pak krahasuar me vitin 2016 dhe zënë të 36 % të të ardhurave të realizuara. Bursat për studentët janë realizuar 23 % më tepër si rrjedhojë e regjistrimit të studentëve përfitues nga zbatimi i VKM nr.911, datë 11.11.2015 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave dhe për kuatat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte, për nxënësit dhe studentët në Institucionet Arsimore Publike". Për vitin 2017 realizimi i fondeve për zërin projektime (artikulli 230) është realizuar 71 mijë lekë osë 10 % më pak se një vit më parë, në vitin 2016 është realizuar 79 mijë lekë . Ky zë i krahasuar me planifikimin për vitin 2017 është realizuar 3 %.
Realizimi i fondeve në zërin e investimeve (artikulli 231) për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 është realizuar 132 %, në vlerë leku + 12,332 më shumë se fakti i vitit 2016, por në krahasim me planifikimin për vitin 2017 është realizuar 46 %. Për vitin 2017 fondi i investimeve është krijuar nga të ardhurat e vetë institucionit.

Realizimi i shpenzimeve sipas planit dhe faktit sipas të nënzërave përkatës për vitin 2017, paraqitet në tabelën nr.15, (në anekset e raportit).

Nga të dhënat e tabelës nr.15 rezulton se zëri shpenzime operative për vitin 2017 është realizuar në masën 76 %. Peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve që në plan dhe fakt zënë rreth 21.8% të shpenzimeve totale, shpenzime për lëndë djegëse karburant dhe vaj që në plan dhe fakt zënë 12.2 % të shpenzimeve totale, shpenzimet për honorare (Pagesat për punonjësit e angazhuar në kryerjen e oponencave teknike, analizave të tekstilit, pagesat për anëtarë të KAD, Senat, Këshilla Fakulteti e Këshilla të Profesorëve), që zënë 9 % të shpenzimeve totale vjetore, shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit dhe brenda vendit, që në plan dhe fakt zënë rreth 3.4 % te shpenzimeve totale. Peshë specifike të madhe në shpenzimet e vitit, zënë edhe shpenzime e drejtpërdrejta si energji, ujë, telefon, karburant që përbëjnë rreth 7.6 % të shpenzimeve vjetore.

Për vitin 2017 janë tenderuar dhe likujduar, blerjet e materialeve të kancelarisë, materialeve elektrike dhe hidraulike, materialeve të pastrimi, bojëra printerëve e fotokopjeve, shërbimi i ruajtjes së sigurisë fizike, blerje karburanti, mirëmbajtje të mjeteve të transportit, shërbimi i sigurimit të ndërtesave dhe pajisjeve etj. Nga viti 2017 janë mbartur detyrime për tu paguar në vitin 2018 me vlerë 428,760 lekë, të cilat i përkasin likuidimit të faturës për blerje dokumenti me vlerë 389,400 lekë dhe mirëmbajtje mjeti në vlerën 39,360 lekë, likuidime të cilat janë anuluar nga Dega e Thesarit Korçë për mosfunksionim të sistemit.

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2017 dhe krahasimi me vitin 2016 , të detajuara sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.16, (anekset e raportit).

Nga të dhënat e tabelës nr.16 rezulton se zëri shpenzime operative në nivel krahasimi mes dy viteve (2016 dhe 2017) konstatohet se në total realizimi i vitit 2017 është më i vogël se realizimi në vitin 2016. Në total për vitin 2017 është shpenzuar vlera 50,797,255 lekë ndërsa për vitin 2016 është shpenzuar vlera 52,125,322 lekë me ulje në vlerën - 1,328,067 ose i shprehur në përqindje 97.4 %.

Në zërin shpenzime për blerje kancelari dhe letër (6020100) për vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 kemi një realizim të shpenzimit në masën 102 %, në nënzërin blerje dokumentacioni (6020500) për vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 kemi një realizim të shpenzimit me 326% pasi janë kryer shpenzime për riprodhimin e tyre sipas kërkesave në rritje, siç mund të përmendim diploma, libreza, regjistra etj.

Në zërin shpenzimet për honorarë (6029005) ka një realizim me 139 % në krahasim me vitin 2016 ose në vlerë (+ 1,724,987 lekë).

Në zërin shpenzimet për konsum të energjisë elektrike, ujë, shërbime telefonike dhe postare (6022001, 6022002, 6022003, 6022004) kemi një ulje të shpenzimeve me 23 % ose në vlerën 1,695,329 lekë më pak se viti 2016.

Në zërin Shpenzime te tjera transporti (6023900) kemi një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2016 ne vlerën 177,440 lekë më shumë ose 133 %, rritje e cila ka ardhur si pasojë e kryerjes së praktikave dhe ekspeditave mësimore kryesisht në fakultetin e edukimit dega histori filologji.

Në zërin shpenzime për udhëtime jashtë vendit (6024100) kemi një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2016 ne vlerën 698,187 lekë më shumë ose 402 %,

Në zërin shpenzime kosto trajnim e seminare (6022011) kemi një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2016 ne vlerën 154,500 lekë më shumë ose 912 %,

Në zërin shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve (6025600) të transportit kemi një rritje me 116,048 lekë ose 238 % krahasuar me vitin 2016.
Në zërin shpenzime për pjesëmarrje ne konferenca (6029007) kemi një rritje me 611,137 lekë ose 346 %.

Realizimi i investimeve për vitin 2017, sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.17:

Tabela nr.17 *Në mijë lekë*

Nr.	Nr Llogari 230 - 231	Objekti i prokurimit	Plani 2017	Fakt 2017	Realizimi ne %
I	**230**				
1	230	Shpenzime Studime kerkime 9770 &r Studim e projektim	2100	70.8	3%
II	**231**				
1	2312101	Shpenz ndertesa administrative	62276	46747.8	75%
2	2312118	Shpenzime te tjera ndertimore	960	687.1	72%
3	2312112	Shpenz per krijim fondi biblioteke	160		0%
7	2314320	Shpenzime mjete e pajisje te tjera teknike	960	286.8	30%
9	2318100	Shpenzime per orendi zyre	7500		0%
10	2314320	pajisje per kopshtarine	50	47.4	95%
11	2318600	Shpenzime per blerje pajisje kompjuterike	2500	2471.8	99%
12	2318700	Shpenzime per pajisje zyre	910		0%
13	2314110	Pajisje interneti, etj	16800		0%
14	231	Shpenzime Kërkim Shkencor (Kap 9770)	1500		0%
Shuma			**95,716**	**50,312**	**53%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se investimet për vitin 2017, janë realizuar në masën 53 % ose në vlerë leku me një diferencë – 45,404 mijë lekë nga planifikimi. Nga analiza e bërë nen zërave të veçantë rezultojnë mosrealizim në Shpenzime Studime kërkime 9770 &r Studim e projektim nga 2,100 mijë lekë i planifikuar është realizuar 70.8 mijë lekë ose 3 %, shpenzime për krijim fondit të bibliotekës nga 160 mijë lekë i planifikuar është realizuar 0 lekë, shpenzime për orendi zyre nga 910 mijë lekë i planifikuar është realizuar 0 lekë, Pajisje internet nga 16,800 mijë lekë i planifikuar është realizuar 0 lekë, Shpenzime Kërkim Shkencor (Kap 9770, llog. 231) nga 1,500 mijë lekë i planifikuar është realizuar 0 lekë.

Ralizimi i investimeve gjatë vitit 2017, dhe krahasimi me vitin 2016, sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.18.

Tabela nr. 18 *Në 000 lekë*

Nr		Investimet	Fakt 2016	Fakt 2017	Në %
I	**230**				
1		Shpenzime Studime kerkime	79.2	70.8	89.39%
II	**231**				

1	2312101	Shpenz ndertesa administrative		46,747.8	
2	2312118	Shpenzime te tjera ndertimore	850.5	687.1	81 %
3	2312112	Shpenz per krijim fondi biblioteke	4848.3	-	
4	2314130	Shpenz pajisje dhe instrumenta laboratorike	17,354.3	-	
5	2314320	Shpenzime mjete e pajisje te tjera teknike	743.9	286.8	38 %
6	2315120	Blerje automjeti	3996	-	
7	2318100	Shpenzime për orendi zyre	610.8	-	
8	2314320	pajisje për kopshtarinë	2,814	47.4	2 %
9	2318600	Shpenzime për blerje pajisje kompjuterike	5,280	2471.8	47 %
10	2318600	Shpenzime për blerje pajisje kompjuterike	1,382	-	
11	2318700	Shpenzime për blerje pajisje kompjuterike	28	-	
		T O T A L I	**37987.0**	**50311.7**	**132.4%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

<u>Për vitin 2017 investimet krahasuar me vitin 2016</u> janë realizuar në masën 132.4 % ose 12,324 mijë lekë më shumë. Investimet (llogaria 230,231) për vitin 2017 janë realizuar me fondet nga të ardhurat dytësore të realizuara nga vetë universiteti. Për çdo vit ushtrimor buxheti ka përcaktuar prioritete sipas kërkesave të paraqitura nga njësitë vartëse, si dhe kërkesat për investime janë më të mëdha se fondet që janë në dispozicion.
Për vitin 2017 pavarësisht se realizimi i investimeve është 134 % krahasuar me vitin 2016, zëri I cili ndikon në ngritjen e përqindjes së realizimit është shpenzimet për rikonstruksionin e ndërtesës administrative, për të cilën në vitin 2017 janë shpenzuar 46,747.8 mijë lekë, ku në vitin 2016 shpenzimi i planifikuar për këtë investim nuk është realizuar. Njëkohësisht në investimet e vitit 2017, ka zëra të cilët kanë planifikim por që nuk janë realizuar si për krijim fondi biblioteke, shpenzime pajisje dhe instrumente laboratorike, shpenzime për orendi zyre, shpenzime për internet dhe kërkimi shkencor.

Krijimi i të ardhurave në vlerën 95,158,736 lekë për vitin 2017, paraqitet sipas zërave në tabëlën nr.19.

Tabela nr.19 *Në lekë*

Nr	Art	Emertimi i te ardhurave	Plan viti 2017	Realizim viti 2017	%
1	7110103	Tarifa e shkollimit	3,400,000	2,888,820	85%
2	7110109	tarife Regjistrime me pagese	90,000,000	85,272,486	95%
3	7207010	Sponsorizime nga organizata	2,800,000	2,645,663	94%
4	7111003	Te ardhura te tjera	20,000	5,000	25%
5	7109600	Qira klubi e te tjera	400,000	363,155	91%
6	7111099	Arketim nga shpen.projekti	380,000	340,413	90%
7	7113001	Shitja e produkteve bujqesore dhe pyjore	550,000	495,600	90%
8	7113099	te tjera te ardhura sekondare	3,200,000	3,147,600	98%
Totali			**100,750,000**	**95,158,736**	**94%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Referuar të dhënave si më sipër rezulton se tarifa e shkollimit (regjistrimi) është realizuar në vlerën 2,889,820 lekë ose 85 %, tarifa e regjistrimi me pagesë në vlerën 85,272,486 lekë ose 95 %, sponsorizime nga organizatat 2,645,663 lekë ose 94 %, të ardhura të tjera qera 408,660 lekë, shitje prodhime nga EDE 495,600 lekë ose 90 %, arkëtim nga shpenzime projekti 340,413 lekë, tarifa nga konkurset, të tjera 3,147,600 lekë 93 %.
Të ardhurat e papërdorura sipas akt rakordimit datë 10.01.2018, janë në vlerën 66,787,442 lekë të cilat janë trashëguar për vitin 2018.
Realizimi i të ardhurave për vitin 2017 dhe krahasimi me vitin 2016 paraqiten në tabelën nr. 20.

Tabela nr. 20 *Në lekë*

Nr	Art	Emertimi i te ardhurave	Realizimi Viti 2016	Realizimi Viti 2017	%
1	7110103	Tarifa e shkollimit	44,727,629	2,888,820	6.4 %
2	7110109	tarife Regjistrime me pagese	74,765,654	85,272,486	114 %
3	7207010	Sponsorizime nga organizata	542,500	2,645,663	487 %
4	7111003	Te ardhura te tjera	10,000	5,000	50 %
5	7109600	Qira klubi e te tjera	5,000	363,155	7263 %
6	7111099	Arkëtim nga shpen.projekti	542,045	340,413	63 %
7	7113001	Shitja e produkteve bujqësore dhe pyjore	108,889	495,600	450 %
8	7113099	te tjera te ardhura sekondare	3,044,400	3,147,600	103 %
Totali			**123,746,117**	**95,158,736**	**78 %**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike

Referuar të dhënave të mësipërme konstatohet të ardhurat e krijuara nga institucioni për vitin 2017, në krahasim me realizimin e vitit 2016 janë realizuar në vlerën 78% ose 28,587,381 lekë më pak se realizimi i një viti më parë. Ulje të ndjeshme ka tarifa e shkollimit e cila është realizuar 93.6 % më pak se një vit më parë ose në vlerën - 41,838,809 lekë, vlerë e cila ka ndikuar direkt në uljen e të realizimit të të ardhurave për vitin 2017.

Nga auditimi i raportimeve të monitorimit të buxhetit rezultoi se:
Raportet vjetore të monitorimit për periudhën objekt auditimi që Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, ka paraqitur në Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me realizimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, mungojnë argumentet e plota në lidhje më mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre, në kundërshtim me kreun IV "*Monitorimi*", të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, dt. 15.01.2016 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016*" si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrisë së Financës i cili citon se " *Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet të përmbajë:*
- *Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;*
Institucioni për periudhën objekt auditimi ka ngritur ekipin për menaxhimin e programit në zbatim të pikës 45, të udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 "*Për procedurat standarde te*

përgatitjes se programit buxhetor afatmesëm" i cili citon se "*Drejtuesit e programeve kanë përgjegjësi për propozimin e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit të tyre, për t'u miratuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Titullari si Kryetar i këtij grupi*".
-Hartimi i PBA-ve për periudhën objekt auditimi ka mangësi në trajtimin e tyre, të tilla si përshkrimi i misionit të njësisë, përshkrimi i programeve dhe veprimtarive të njësisë, paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës së performancës, në kundërshtim me pikën 6 të udhëzimit nr 23, Datë 22.11.2016 i cili citon se "*kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme duhet ë përmbajnë:*

a) misionin e njësisë;
b) përshkrimin e programeve dhe veprimtarive të kësaj njësie;
c) paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës;
d) planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve.
e) treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore;
f) projektin e planit të arkës vjetor dhe të ndarë në muaj, si pjesë e projektbuxhetit vjetor dhe përfshin:
    i. *Planin e prokurimeve dhe angazhime të tjera të planifikuara;*
    ii. *Pagesat e parashikuara që rrjedhin nga angazhimet."*

<u>C/2. - Mbi pagesën e orëve mësimore mbi normën vjetore</u>

Pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, për vitin akademik 2015-2016, është kryer në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Gjatë këtij viti mësimor kanë përfituar punonjësit efektivë të personelit akademik, gjithsej 10,327 orë mësimore, nga të cilat Fakulteti i Bujqësisë 1,614 orë, i Edukimit 3,346 orë, i Ekonomisë 2,216 orë, i Shkencave të Natyrës dhe Humane 3,151 orë.

Pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore mbi 30 % deri në 70 %, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, për vitin akademik 2016-2017, është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me pikën 20 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar.
Me vendim marrje e tyre, Rektorati i Universitetit, Senati Akademik, Këshilli i Administrimit kanë kapërcyer kompetencat që ju jep legjislacioni i sipër cituar, dhe konkretisht:
- Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008, të MASR, Rektorati i Universitetit, referuar ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me shkresën nr. 44/6 prot. datë 12.10.2016, i propozon Këshillit të Administrimit që ngarkesa e pagueshme mbi normën vjetore për pedagogët efektivë, pavarësisht nga pozicioni dhe titulli, të jetë deri në 200 orë të konvertuara.
- Në kundërshtim me VKM nr. 748, datë 11.06. 2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë" si dhe VKM nr. 268, datë 29.03.2017 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748, datë 11.06.2009", Rektorati

i Universitetit është shprehur me vendimin nr. 75, datë 18.07.2017, për pagesën e orëve mbi normë të pedagogëve efektivë që: Orët mbi normë të pedagogëve efektivë të paguhen 50 % në zbatim të VKM nr. 748, datë 11.06. 2009 dhe 50 % në zbatim të VKM nr. 268, datë 29.03.2017.
- Senati Akademik me Vendimin nr. 27, datë 18.10.2016, ka miratuar ngarkesën e pagueshme mbi normën vjetore për pedagogët efektivë, pavarësisht nga pozicioni dhe titulli, të jetë deri në 200 orë të konvertuara. Senati Akademik, është shprehur me vendimin nr. 27, datë 18.10.2016, që ngarkesa e pagueshme mbi normën vjetore për pedagogët efektivë, pavarësisht nga pozicioni dhe titulli, të jetë deri në 200 orë të konvertuara, gjashtë ditë mbas propozimit të Rektoratit të Universitetit drejtuar Këshillit të Administrimit si dhe nuk i referohet se në cilin propozimin është mbështetur për marrjen e këtij vendimi.
- Këshilli i Administrimit në mbledhjen e datës 20.10.2016, pasi ka shqyrtuar kërkesën e Rektoratit të Universitetit dërguar me shkresën nr. 44/6 prot. datë 12.10.2016 si dhe vendimin e Senatit Akademik nr.27, datë 18.10.2016 është shprehur në Vendimin nr. 9, datë 20.10.2016, për miratimin e ngarkesës të pagueshme mbi normën vjetore deri në 200 orë të konvertuara për pedagogët efektivë, pavarësisht nga pozicioni.
- Administratori i Universitetit, në zbatim të vendimit nr. 27, datë 18.10.2016 të Senati Akademik dhe të vendimit nr. nr. 9, datë 20.10.2016 të Këshillit të Administrimit, ka nxjerrë Urdhrin nr. 111, datë 26.07.2017 për drejtorinë e financës, për kryerjen e pagesës për orët e kryera mbi normën vjetore të pedagogëve efektivë, deri në 200 orë të konvertuara, për vitin akademik 2016-2017, pagesa të kryhet në përputhje me vendimin e Rektoratit nr. 75, datë 18.07.2017.

Marrja e vendimit nr. 27, datë 18.10.2016, nr. 75, datë 18.07.2017 nga Senati Akademik si dhe i vendimit nr. 9, datë 20.10.2016, i Këshilli të Administrimit në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, ka sjellë si pasojë kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore (nga 30% deri në 70 %) të pedagogëve efektivë pa miratimin nga MASR. Janë paguar gjithsej 26,266 orë mësimore, me vlerë 22,385,780 lekë; nga të cilat Fakulteti i Bujqësisë 3,578 orë vlera 3,513,140 lekë; i Edukimit 7,096 orë vlera 6,301,850 lekë; i Ekonomisë 5,790 orë vlera 5,377,760 lekë; i Shkencave të Natyrës dhe Humane 9,802 orë, vlera 7,193,030 lekë.

C/3. - Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin

Në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, marrëdhëniet e punës për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, rezulton se janë rregulluar sipas dispozitave të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI "Personeli i institucioneve të arsimit të lartë", neni 57 pika 1, ku përcaktohet se "*Personeli i institucionit të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrative*". Nga auditimi i kryer mbi strukturën organizative për periudhën objekt auditimi rezultoi se, për këtë periudhë, Universiteti ka funksionuar me strukturën organike të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 12, datë 26.12.2015 dhe nr. 11, datë 19.12.2016 me propozim të Senatit Akademik i shprehur në vendimin nr. 48, datë 18.12.2015 si dhe nr. 28, datë 19.12.2016 "Për miratimin e strukturës dhe numrin e punonjësve", në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, neni 38, pika 1, germa "ç" në të cilën citohet "Senati Akademik

harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet" si dhe nenin 49, pika 1, germa "ç" ku citohet "Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet".
Për periudhën objekt auditimi institucioni *nuk ka përditësuar Statutin dhe Rregulloren e brendshme me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni mbi arsimin e lartë*, konkretisht ligjin nr. 80/2015 datë 17.09.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa "c" në të cilën citohet "Senati miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë.....". Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, ka vijuar të funksionojë me Statutin e miratuar nga Senati në datën 09.05.2008, ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 04.02.2016 si dhe Rregulloren e Brendshme, miratuar nga Senati me vendimin nr. 13, datë 30.03.2009, ndryshuar me vendimin nr. 8, datë 16.03.2010 të Senatit. Për rrjedhojë detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kështu edhe kriteret për punësim për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ duhet të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme. Konstatohet se Universiteti nuk ka hartuar rregullore të veçante mbi procedurat e punësimit të personelit akademik dhe personelit administrativ pas ndryshimeve që ka pësuar LAL. Po kështu edhe Rregulloret e brendshme të fakulteteve duhet të rishikohen për tu përshtatur kërkesave të kuadrit të ri ligjor, konkretisht ligjit 80/2015, datë 17.09.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin për periudhën 01.10.2016 deri më 31.12.2017.
Struktura e personelit për Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, për periudhën objekt auditimi
Tabela nr.1

VITI	Numri i punonjësve efektivë				Numri i punonjësve me kontratë			
	Plan BA	Fakt (31.12)			Plan BA	Fakt		
	Punonjes gjithsej	Punonjes gjithsej	Punonjes akademik	Punonjes ndihmes administrate	Punonjes gjithsej	Punonjes gjithsej	Punonjes akademik	Pedagogë të jashtëm
Viti 2016								
Rektorat	45	45	-	41 (-4)		-	-	-
Fakulteti Bujqësisë	40	34	22	12		5	-	5
Fak. i Edukimit & Filologji	59	54	48	6		42	-	42
Fak. i Shk. Natyrore &Hum	60	60	53	7		74	-	74
Fak. i Ekonomisë	42	39	33	6		7	-	7
Gjithsej 2016	**246**	**232**	**156**	**72**	**160**	**128**	**-**	**128**
Viti 2017								

Rektorat	46	49	-	49 (+3)		-	-	-
Fakulteti Bujqësisë	42	34	22	12		6	-	6
Fak. i Edukimit & Filologji	61	56	50	6		28	-	28
Fak. i Shk. Natyrore &Hum	65	60	52	8		57	-	57
Fak. i Ekonomisë	44	39	33	6		5	-	5
Gjithsej 2017	**258**	**238**	**157**	**81** (+3)	**95**	**96**	**-**	**96**

(Burimi i Informacionit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore)

Tabela: Punonjës akademikë efektive sipas gradës shkencore

Nr.	Emërtimi	Viti akademik 2016-2017 (30.09.2016)	Viti akademik 2017-2018 (30.09.2017)
1	Profesor	5	5
2	Profesor i asociuar	33	34
3	Lektor i parë (lektor)	44	57
4	Asistent lektor (asistent lektor)	66	54
5	Docent	7	7
6	Kërkues i parë	-	-
7	kërkues	-	-

(Burimi i Informacionit: Drejtoria Burimeve Njerëzore)

Në Strukturën Organike të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën vitin 2016, nuk është plotësuar dhe as tejkaluar numri i miratuar i punonjësve si për rektoratin ashtu dhe në total me fakultetet. Për vitin 2017 konstatohet se rektorati ka në strukturë tre punonjës më shumë, **Rektori është pasqyruar si Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë por pagesën e ka marrë si Rektor dhe dy Zëvendës Rektorët janë pasqyruar si pedagogë në fakultetet Ekonomik dhe në fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, por pagesën e kanë marrë si Zëvendës Rektorë.**
Për vitin 2016, numri i punonjësve efektivë të miratuar është 246 gjithsej dhe realizimi 232 (-14 punonjës) dhe njëkohësisht konstatohet se numri i punonjësve akademikë me kontratë për këtë vit kalendarik është 128. Po i njëjti fenomen konstatohet edhe për vitin 2017, numri i punonjësve efektivë të miratuar është 238 gjithsej, numri i punonjësve akademikë efektivë të 157, dhe njëkohësisht janë punësuar 96 pedagogë me kontratë, një punonjës më shumë se miratimi.
Konstatohet se struktura e miratuar nga Senati me vendimin nr. 48, datë 18.12.2015 si dhe nr. 28, datë 19.12.2016 "Për miratimin e strukturës dhe numrin e punonjësve", për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, është në kundërshtim me Vendimin nr.474, datë 16.6.2011, "*Për përcaktimin e Standardeve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike".* Në strukturë evidentohet krijimi i degëve dhe jo drejtorive në kundërshtim me pikën 21 ku citohet: "*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*". Po kështu sektorët në përbërje të degëve kanë funksionuar në kundërshtim me kërkesat e pikës 20 ku citohet: *"Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçante kur në të, të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës....."*. Po kështu universiteti nuk ka krijuar Sektorin e Auditit të Brendshëm si njësi organizative e veçantë, me përbërje 1 punonjës, në pozicionin e përgjegjësit të sektorit dhe dy specialistë.

Në zbatim të pikës III germa C të programit të auditimit Nr. 202/1, datë 23/02/2018 "Planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime."

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik konstatohet se:

Për vitet 2016 – 2017, nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, te realizuara ne Universitetin " Fan S. Noli" Korçë, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e zbatimin e kontratës, u konstatua se :
Autoriteti Kontraktor UFSNK në disa tendera *nuk ka zbatuar dhe respektuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.9643 datë " Për Prokurimin Publik" i ndryshuar , VKM nr. 914 datë 29.12.2014 " Për rregullat e prokurimit publik" e ndryshuar, nuk ka siguruar frymën dhe parimet bazë të ligjit për prokurimin publik lidhur me efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera, të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

- Nga Autoriteti Kontraktues, argumentimi dhe llogaritja e fondit limit nuk rezulton të jetë kryer në respektim të nenit 59 të Ligjit për prokurimin publik, pasi nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në fondin e prokuruar, nuk ka të argumentuar mënyrën se ku është bazuar në marrjen e çmimeve kur ka llogaritur fondin limit, nuk ka asnjë referencë mbi çmimet e tregut, apo çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore, nuk janë marrë të dhëna nga organet statistikore, organet doganore dhe referencat të ndryshme ndërkombëtare, dhe analiza kostosh duke bërë që fondi limit të mos jetë real ;

-Njësia e Prokurimit në procedurat *kërkesë pr propozim* , procedurë e cila zë rreth 70% të llojit të procedurave të tenderimit nga ky Universitet, lidhur me përzgjedhjen e OE ka dokumentuar me proces verbal përzgjedhja e tyre, por ***në asnjë rast nuk ka argumentuar përse ka përzgjedhur këto operatorë, mënyrën dhe selektimin për tu dërguar ftesën për ofertë,*** në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar (neni 39, 56, 57 pika 1 dhe 2).

-Kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP nuk janë kritere që kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në disa procedura ose nuk kërkohen , dhe në disa procedura të tjera, ***kërkesat për kualifikim apo certifikatat të cilat kërkohen janë tejet të ekzagjeruar dhe jo në raport të drejtë me objektin e prokurimit duke krijuar kushte për trajtim jo të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik,*** veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 29.12.2006 Neni 23 Specifikimet teknike.

-Gjithashtu konstatohet se NJP në rastet kur ka marrë përsipër hartimin e specifikimeve teknike për mobiliet dhe orenditë, në dokumentacionin e ndodhur në dosje, nuk argumentohet se cilit standardi teknik i referohen, nëse ka një parashikim nga arkitekti i miratuar nga

titullari, mbi një projekt ide mbi mobilimin e ambienteve, etj. Hartimi i këtyre specifikimeve nga NjP kur në përbërje të tij mungon specialisti i fushës është në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 61, pika 1 dhe 2 .

-Konstatohet se komisionet e ngarkuara për hartimin e specifikimeve teknike për pasijet elektronike, apo makineri, mobilie, etj, pra për objekt specifik prokurimi, në shumicën e e tyre nuk kanë në përbërje të tyre specialist të fushës përkatëse, inxhinier elektronik ose informatike, arkitekt, mekanik sipas objektit që prokurohet, veprime këto në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar ,neni 61, pika nr.1 dhe 2.

III.C. Planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime

III.C. Planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime

Planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë shërbime për vitin 2016

Me shkresën nr. 9289/2 prot, datë 19.09.2016 MAS ka dërguar pranë Universitetit shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrin e parashikimeve të prokurimit për vitin 2016, sipas ndryshimeve të kërkuara nga AK, dërguar dhe në formë elektronike.

Tabela me të dhënat për vitin 2016

Nr.	Prokurime planifikuara	Lloji procedurës	Ndrysh/regjistr. planifik
1	3 procedura	Prokurim me negocim	3 procedura
2	42 procedura	Prokurime blerje e vogël	42 procedura
3	4 procedura	Tender i hapur	6 procedura
4	7 procedura	Kërkesë për propozim	6 procedura
Total	**56**		

Referuar regjistrit të parashikimit me shtesa dhe pakësime u konstatua se është pakësuar zëri i planifikuar për investim:
Tenderi me objekt" Rikonstruksioni i godinës rektoratit ish "Shtëpia e ushtarakëve", lloji procedurës tender i hapur, financim i parashikuar për vitin 2016 në vlerën 33.000.000 lekë Burimi financimit të ardhurat e veta. ***Procedurë e parealizuar.*** **P**as komunikimit me Drejtorin Ekonomik, lidhur me argumentimin e mosrealizimit të kësaj procedure u konstatua se me VKM nr.152 datë 29.02.2016 "Për kalimin në Pronësi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Bashkia Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin "Shtëpia e ushtarakëve", ky objekt ka kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë.
Referuar regjistrit realizmit viti 2016 për nevoja të institucionit janë realizuar 11 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 63,330,780 lekë pa TVSH, ose 59,062,276 me TVSH (vlera e kontratës). 1 procedurë me negocim pa botim, 7 procedura kërkesë për

propozim, 3 procedurë e hapur. Referuar detajimit të planit të investimeve viti 2016 janë planifikuar 11 investime, në vlerë totale debiti 80.392 000 lekë.

Planifikimi dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë shërbime për vitin 2017.

Referuar regjistrit të parashikimit viti 2017 me shtesa dhe pakësime u konstatua se:
Me shkresën nr.4/4 prot datë 08.02.2017 AK i ka propozuar Bordit të Administrimit për disa ndryshime në regjistrin e prokurimeve publike dhe investimeve. Me vendimin nr.2 datë 10.02.2017, Bordi i Administrimit ka miratuar propozimin e rektoratit për disa ndryshime në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe planit të investimeve për vitin 2017, duke pakësuar 11 zëra, në vlerë totale të fondit limit 10.000.000 lekë, 7 prokurime vlera të vogla, 4 prokurime kërkesa për propozim. Me shkresën nr.301 prot, datë 31.10.2017, Universiteti ka dërguar sektorit prokurimit MAS vendimin nr.22, datë 26.10.2017 "Për miratimin e ndarjes së grantit buxhetor dhe ndryshimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2017". Me shkresën nr.302. prot, datë 31.10.2017, Universiteti i ka dërguar degës së Thesarit Korçë vendimin për miratimin e ndryshimeve të regjistrit të parashikimit viti 2017. Me shkresën nr.11400 prot, datë 03.11.2017, MAS ka dërguar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve me ndryshimet përkatëse., ku është ***shtuar zëri për prokurimin me objekt, Rikonstruksioni i godinës (ish konvikti i shkollës mekanike) me vlerë totale të fondit limit 10,000,000 lekë.***

Tabela për vitin 2017 me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Prokurime planifikuara	Lloji procedurës	Ndrysh/regjistr. planifik
1	3 procedura	Prokurim me negocim	3 procedura
2	42 procedura	Prokurime blerje e vogël	42 procedura
3	4 procedura	Tender i hapur	4 procedura
4	4 procedura	Kërkesë për propozim	4 procedura
Total	53		53

Referuar regjistrit realizmit viti 2017 vënë në dispozicion nga subjekti janë realizuar :
9 procedura prokurimi, 2 procedurë me negocim pa botim, 1 shërbim të sigurimit të ruajtjes (20% shtesë kontrate) dhe 1 procedurë Rikonstruksioni ish- konvikti Shkollës mekanike (20% shtesë kontrate (3 procedura tender i hapur , 3 procedura kërkesë për propozim.

<u>Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e zbatimin e kontratës.</u>

Me përzgjedhje u audituan procedurat si më poshtë:

1) Dosja e prokurimit me objekt "Blerje lëndë djegëse, karburant".2016
2) Dosja e procedurës së prokurimit me objekt "Makineri & Agregate Bujqësore". 2016
3) Dosja e procedurës së prokurimit me objekt "Pajisje dhe instrumente Laboratorike".
4) Dosja e procedurës së prokurimit me objekt "Laboratori i Gjuhëve te Huaja". 2016
5) Dosja e prokurimit me objekt "Blerje Kancelarie". 2016
6) Dosja e prokurimit me objekt "Blerje lëndë djegëse, karburant" viti 2017.
7) Dosja e prokurimit me objekt "Blerje Kancelarie" Viti 2017.
8) Dosja e prokurimit me objekt "Laboratori i Fizioterapisë " viti 2017.

9) Dosja e prokurimit me objekt "Blerje pajisje kompjuterike dhe audiovizale" viti 2017.
10) Dosja e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit..." viti 2017.
11) Dosja e procedurës së prokurimit me objekt "Mobileje, Orendi" 2017.

Nga shqyrtimi dhe auditimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e zbatimin e kontratës, për vitet 2016 – 2017 rezultoi se:
Autoriteti Kontraktor "Universiteti Fan S. Noli" Korçë në disa tendera *nuk ka zbatuar dhe respektuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimin Publik" i ndryshuar ,VKM nr.914 datë 29.12.2014 " Për rregullat e prokurimit publik" e ndryshuar, nuk ka siguruar frymën dhe parimet bazë të ligjit për prokurimin publik lidhur me efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera,të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

- Nga Autoriteti Kontraktues, argumentimi dhe llogaritja e fondit limit nuk rezulton të jetë kryer në respektim të nenit 59 të Ligjit për prokurimin publik, pasi nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në fondin e prokuruar, nuk ka të argumentuar mënyrën se ku është bazuar në marrjen e çmimeve kur ka llogaritur fondin limit, nuk ka asnjë referencë mbi çmimet e tregut, apo çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore, nuk janë marrë të dhëna nga organet statistikore, organet doganore dhe referencat të ndryshme ndërkombëtare, dhe analiza kostosh duke bërë që fondi limit të mos jetë real:
-Njësia e Prokurimit në procedurat *kërkesë për propozim* , procedurë e cila zë rreth 70% të llojit të procedurave të tenderimit nga ky Universitet, lidhur me përzgjedhjen e OE ka dokumentuar me proces verbal përzgjedhjen e tyre, por në asnjë rast nuk ka argumentuar përse ka përzgjedhur këto operatorë, mënyrën dhe selektimin për tu dërguar ftesën për ofertë në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik neni.2 "Parimet e përzgjedhjes", si dhe *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik*" i ndryshuar neni *39, 56,57 pika 1 dhe 2.*
-Kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP nuk janë kritere që kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në disa procedura ose nuk kërkohen , dhe në disa procedura të tjera, kërkesat për kualifikim apo certifikatat të cilat kërkohen janë tejet të ekzagjeruara dhe jo në raport të drejtë me objektin e prokurimit **duke krijuar kushte për** *trajtim jo të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik,* veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 29.12.2006 Neni 23 Specifikimet teknike.
- Gjithashtu konstatohet se NJP në rastet kur ka marr përsipër hartimin e specifikimeve teknike për mobiliet dhe orenditë, në dokumentacionin e ndodhur në dosje, nuk argumentohet se cilit standardi teknik i referohen, nëse ka një parashikim nga arkitekti të miratuar nga titullari, mbi një projekt ide mbi mobilimin e ambienteve.. etj hartimi i këtyre specifikimeve nga NjP kur në përbërje të tij mungon specialisti i fushës është në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 61Pika 1 dhe 2
.

Gjithashtu konstatohet se Komisionet e ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike për pajisjet elektronike, apo makineri, mobileje etj, pra objekt specifik prokurimi, në shumicën e rasteve nuk kanë në përbërje të tyre specialist të fushës përkatëse, inxhinier elektronik ose informatik, arkitekt, mekanik sipas objektit që prokurohet, veprime këto në kundërshtim me *VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 61 Pika 1 dhe 2.*

Konkretisht për cdo procedurë të audituar:

1)Nga auditimi i procedurës së prokurimit **me objekt "Blerje lëndë djegëse, karburant" viti 2016,** lloji procedurës " tender i hapur", u konstatua se për Lotin I Lëndë djegëse për kaldajë me vlerë të fondit Limit 6.218.741 lekë (pa TVSH), dhe për Lotin II Karburant (naftë për automjete) Fondi Limit 614.594 lekë (pa TVSH) është shpallur fitues OE [redacted] SHPK. Vlera e kontratës (me TVSH) Loti I-rë 7.462.490 lekë, për Lotin e II-të 737.510 lekë.
Nga auditimi i planifikimit të sasisë së kërkuar për tenderim për përmbushjen e nevojave të institucionit rezulton, se më datë 31.12.2015, Universiteti ka gjendje në magazinë sasinë prej 32 004 litra për kaldajat, sasi e konsiderueshme për të përballuar nevojat e tij, ndërkohë që sasia e kërkuar për tenderim është 59 000 litra lëndë djegëse vetëm për kaldajat, *duke krijuar një stok të lartë të gjendjes në magazinë, krahasuar me nevojat reale për shpenzim* **trajtuar hollësisht në pikën III.A të drejtimeve të auditimit*.
Nga verifikimi në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës deri në lidhjen e saj por gjatë verifikimit të dokumentacionit ligjor të dosjes në fazën e zbatimit të kontratës u konstatua se:
Për Lotin I lëndë djegëse për kaldajat AK ka urdhëruar ngritjen e një komisioni për të mbikëqyrur kontratën , ku janë mbajtur dhe procesverbalet në prani të komisionit dhe kaldajistit.
Për Lotin II Karburant(naftë për automjetet) u konstatuan mangësi dhe parregullsi si vijon:

- ✓ Në dosje mungon Urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës për Lotin II, Blerje Karburanti, për automjetet. Pas ballafaqimit me personin e ngarkuar nga titullari institucionit për kontakt me grupin e auditimit të KLSH Z.[redacted] u shpjegua se nuk ka urdhër titullari për ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës për Lotin II blerje karburanti, për automjetet, pasi furnizimi me karburant bëhet në pikat e karburantit me tollona.
- ✓ Proces Verbalet e mbajtura gjatë dorëzimit të mallit për Lotin I blerje Karburanti, për automjetet nuk janë mbajtur në formën e kërkuar nga ligji, si dhe nuk janë në inventarin e dosjes së tenderit, si pjesë integrale e saj. Mungon firma e magazinieres kur janë marrë në dorëzim.
- ✓ Mungon Raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.
- ✓ Kontrata e pa protokolluar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me *VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar neni 56, neni 77 në të cilët përcaktohet që:*

Neni 56: *Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit.*

Neni 77, Mbikëqyrja e Kontratës
1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe/ose organe të tjera shtetërore, të autorizuara me ligj, mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.
3.Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit.
4.Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

2) Nga auditimi i procedurës së prokurimit **me objekt "Blerje lëndë djegëse, karburant" viti 2017** lloji i procedurës tender i hapur u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës por u konstatuan mangësi dhe parregullsi në zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës si vijon:

- ✓ Në dosje mungon Urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës. Pas ballafaqimit me personin e ngarkuar nga titullari institucionit për kontakt me grupin e auditimit të KLSH u shpjegua se nuk ka urdhër titullari për ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës pasi mjeti furnizohet në pikën e karburantit me tollona.
- ✓ Proces Verbalet e mbajtura gjatë dorëzimit të mallit nuk janë pasqyruar në inventarin e dosjes së tenderit, si pjesë integrale e saj.
- ✓ Mungon Raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës
- ✓ Kontrata e pa protokolluar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me *VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar neni 56, neni 77 në të cilët përcaktohet që:*

Neni 56 *Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit.*

Neni 77 Mbikëqyrja e Kontratës
1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe/ose organe të tjera shtetërore, të autorizuara me ligj, mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.
3.Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit.
4.Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

3)Nga auditimi i procedurës së prokurimit **me objekt "Blerje materiale kancelarie, bojë, fotokopje, dhe printer"** viti 2016, lloji procedurës kërkesë për propozim, fondi limit në vlerën 3.600,000 lekë. Oferta (pa TVSH), fituese "[redacted]", në vlerën 2,257,247.11 lekë. Vlera e kontratës (me tvsh) 2,708,696.53 lekë.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës por gjatë auditimit u konstatua shkelje dhe mangësi nga NJP të legjislacionit prokurimit publik si vijon:

Njësia e prokurimit ngritur me Urdhrin e Prokurimit nr. 12, date 04.04.2016, me përbërje:
1.[redacted] ekonomist
2.[redacted] Juriste
3.[redacted] specialist IT

- ✓ Në përllogaritjen e fondit limit nuk ka argumentuar mënyrën se ku është bazuar në marrjen e çmimeve kur ka llogaritur fondin limit çmimet e tregut, apo çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
- ✓ Komisioni i Njësisë së Prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE ka dokumentuar me proces verbal përzgjedhja e 5 OE, por nuk ka argumentuar përse ka përzgjedhur këto operatorë, për tu dërguar ftesën për ofertë.
- ✓ Kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP nuk janë kritere që kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve

Veprime këto në mosrespektim të *Ligjit 9643 datë 29.12.2006 „"Për prokurimin publik" neni 1, neni 2 dhe neni 23, ku përcaktohet që:*

***Neni 1** Qëllimi ligjit për prokurimin publik është:*
Të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Neni 23
1.Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
*2.*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni,39, 59 përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a) çmimet e tregut
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

4)Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt **"Blerje materiale kancelarie, bojë, fotokopje, dhe printer"** viti 2017 lloji procedurës kërkesë për propozim, Fondi Limit (pa TVSH) 2,500,000 lekë. Oferta fituese pa TVSH nga "[redacted]" në vlerën 2, 257,247. 11 lekë pa TVSH.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës por gjatë auditimit u konstatua shkelje dhe mangësi nga NJP si vijon:
Njësia e prokurimit ngritur me Urdhrin e Prokurimit . 72, date 08.05.2017, me përbërje:
1.[redacted] ekonomist
2.[redacted] juriste
3.[redacted] specialist IT

- ✓ Në përllogaritjen e fondit limit nuk ka argumentuar mënyrën se ku është bazuar në marrjen e çmimeve kur ka llogaritur fondin limit çmimet e tregut, ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
- ✓ Komisioni i Njësisë së Prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE ka dokumentuar me proces verbal përzgjedhjen e 5 OE, por nuk ka argumentuar mënyrën përse ka përzgjedhur këto operatorë, për tu dërguar ftesën për ofertë.
- ✓ Kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve

Veprime në mosrespektim të Ligjit " Për prokurimin publik" neni 2 "Parimet e përzgjedhjes",

Neni 1 *Qëllimi ligjit për prokurimin publik është:*
Të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Neni 23
1.Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
*2.*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 39, 59, ku përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës *bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

Për sa më lartë ngarkohen me përgjegjësi nëpunësit e ngarkuar për kryerjen e kësaj procedure prokurimi.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës dhe publikimit në buletin por nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes u konstatuan parregullsi dhe mosrespektim të legjislacionit për prokurimin publik si vijon:
Në vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender KVO ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e operatorit ekonomik: "[redacted]" SHPK. Vlera: **2 324 177** lekë pa TVSH, ka s 'kualifikuar OE [redacted] **SHPK** me vlerën e ofertës më të ulët në vlerën **2 289 000** lekë pa TVSH. me arsyetimin se në shtojcën 7,.Kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti Teknik nuk plotësoni kërkesat DST si vijon:

- Ofertuesi duhet te ketë kryer furnizime te se njëjtës natyre, gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit ne një vlere jo me pak se 40% e vlerës se fondit limit në lekë. Për te vërtetuar plotësimin e pikës se mësipërme ofertuesi duhet te paraqesë:
- kontrata te ngjashme te realizuara shoqëruar me vërtetim për realizim kontrate, ose
- fatura tatimore shitjesh ku te jene te përcaktuara datat, shumat dhe sasitë e mallrave te furnizuara.
- Operatori ekonomik ditën e tenderit te paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, mostrat për bojërat e printerëve dhe fotokopjeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ndodhet në dosjen e tenderit u konstatua se:
Me shkresën nr.33/22 prot, datë 17.05.2017 OE Shoqëria "[redacted]" ka paraqitur ankesë pranë AK lidhur me kriteret e veçanta dhe kapacitetin teknik .
1.Kriteri i vendosur për autorizimin e lëshuar nga distributori i autorizuar i Rajonit e ka konsideruar **si diskriminues dhe situatë monopol, pasi atë e disponon vetëm një numër shumë i** kufizuar OE në treg.
2. Kriteri për origjinalitetin dhe cilësinë e produktit., ka një Vendim unifikues të Gjykatës së Lartë nr.42 datë 23.01.2015 i cili e ka konsideruar këtë kriter si diskriminues, si dhe Vendimi i KPP nr.585/2015, i cili shprehet se AK në asnjë rast nuk duhet të kufizojë operatorë të tjerë ekonomikë të cilët mund të ofrojnë produktet e kërkuara nga prodhues të ndryshëm nga prodhuesit e pajisjeve por që produktet e tyre përputhen me kërkesat e AK dhe që përmbushin specifikimet teknike dhe janë funksionale. ..
3.Paraqitja e mostrave për bojëra e printerëve dhe fotokopjeve ditën e tenderit kufizon pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit. AK kur kërkon cilësi të produkteve, mund të vendosi klauzolën e paraqitjes së mostrave nga OE të kualifikuar që pjesëmarrja e disa operatorëve mos të kufizohet nga ky kriter.
Me urdhrin nr.78 datë 18.05.2017 e lëshuar nga administratorja e Universitetit [redacted] është urdhëruar pezullimi i procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesës. Me urdhrin 79 datë 18.05.2017 e lëshuar nga administratorja e Universitetit [redacted] është ngarkuar punonjësja [redacted] për shqyrtimin e ankesës nr.33/22 prot datë 17.05.2017. Me vendimin e datës 19.05.2017 punonjësja e ngarkuar me shqyrtimin dhe dhënien e një vendimi për ankesën ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Me shkresën nr.33/23 prot, datë 19.05.2017 kthyer përgjigje ankesës firmosur nga administratorja [redacted].

- Kriteri për origjinalitetin e cilësinë e produktit është pranuar ankesa.
- Kriteri për mostrat e mallit nuk është pranuar ankesa duke ju referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" kreu III, seksioni II, neni 27, pika 6 ku citohet se " *AK ka të drejtë të kërkojë mostra të mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike*."
- Në lidhje me kërkesën për sqarim lidhur me kriterin nr.5 çertifikata e menaxhimit të cilësisë (ISO) dhe CE për cilësinë e produkteve (CE vetëm për tonerat) , ka sqaruar se çdo OE i interesuar duhet të paraqesë në rrugë elektronike ,në sistemin e prokurimit publik sipas nenit 42 LPP.

Me datë 19.05.2017 nga Njësia e prokurimit e përbërë nga [redacted] bazuar në ligjin 9643 datë 20.11.2006 " për prokurimin Publik" i ndryshuar neni 42, pika 2 dhe 2/1, VKM nr.914, datë 29.12.2014 " Për rregullat e prokurimit Publik", i ndryshuar neni 62 ka vendosur të bëjë ndryshimin në DST, heqjen e kriterit të veçantë të përcaktuar në DST, në shtojcën 7, pika 2, kriteret e veçanta të kualifikimit , kapaciteti teknik, pika 3 "Autorizimi i Distributorit të autorizuar për shitje me rajonin" duke shtyrë datën e zhvillimit të tenderit me 5 ditë. Data e fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, data 31.05.2017.

Me datë 02.06.2017 në zbatim të urdhrit nr.85 datë 31.05.2017 Komisioni i përbërë nga [redacted] specialsitë të fushës IT ka verifikuar parametrat e mostrave të paraqitura nga OE pranë KVO dhe ka sugjeruar marrjen në dorëzim të tyre.
Me shkresën nr.370 prot, datë 06/06/2017 të OE protokolluar në Universitet me nr.33/24 datë 07.06.2017, OE pjesëmarrës në tender [redacted] SHPK, ka paraqitur ankesë për vendim skualifikimi nga ana AK.
Nuk mund të skualifikohet një OE për një kriter të pa shprehur qartë , ose në rast të kërkesave të tilla duhet të shpjegohet dhe të kërkohet shprehimisht në DST.
Me urdhrin nr. 93 datë 07.06.2017 është urdhëruar pezullimi i procedurës së prokurimit " materiale kancelarie, bojë fotokopje& printera". Me urdhrin nr.94 datë 07.06.2017 me shqyrtimin e dhënien e vendimit për ankesën e paraqitur është ngarkuar punonjësja [redacted]
Me vendimin datë 12.06.2017 vendosur mospranimi ankesës.
Me shkresën nr.33/25 datë 12.06.2017, Universiteti Fan S. Noli ka kthyer përgjigje ankesës së paraqitur nga OE "[redacted] SHPK i s'kualifikuar, ku shprehet se:
Nuk jeni kualifikuar për arsye se:

- Mosparaqitjes së kontratave të ngjashme ose të faturave tatimore të shitjeve për materialet e kancelarive, duke paraqitur kontrata të ngjashme vetëm për tonerë bojë printerë dhe fotokopje.
- Mosparaqitje të mostrave për tonerë " bojëra e printera dhe fotokopje"

Me urdhrin nr.101 datë 23.06.2017 është urdhëruar heqja e pezullimit për procedurën e prokurimit dhe vijimësia e saj.
Gjithashtu nga auditimi i i kësaj procedure prokurimi për sa cituar konstatohet se:

✓ Mungon Urdhri i Titullarit për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim profesional lidhur me ankesën e paraqitur nga OE [redacted] " SHPK.

Për sa trajtuar më sipër referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", neni 27, përcaktohet që:

Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të
kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
*b)**dëshminë e origjinalitetit të mostrave përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike***

Pra dispozita e sipërcituar në pikën b, neni 27 sqaron qartë se nga ana e OE mund të dorëzohen **dëshmitë e origjinalitetit të mostrave përshkrimin ose fotografitë apo katalogjet teknike**, kriter i cili është plotësuar nga OE "[redacted]" SHPK, pasi ka dorëzuar së bashku me ofertën dhe katalogjet gjë të cilën e ka pretenduar si në ankesën para zhvillimit të

tenderit dhe në ankesën e dytë. Pra kjo pikë nuk është trajtuar drejt nga ana e punonjëses së ngarkuar nga ana e titullarit të AK për ankesën e bërë nga OE i s' kualifikuar.

- ✓ Nuk është respektuar kjo dispozitë nga ana e punonjëses të ngarkuar nga titullari i AK për shqyrtimin e një ankese që ka të bëjë me DST një punonjëse e cila është specialist finance dhe nuk mund të shprehet për një ankesë që ka të bëjë me Kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti Teknik.

Referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 78, në lidhje me shqyrtimin e ankesës pika 6, përcaktohet që:

> *"Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:*
> *a)Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.*
> *b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën*

AK nuk ka vepruar në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 56, në të cilin citohet se:

> *"Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.*

5) Dosja e prokurimit me objekt **"Rikonstruksioni i godinës së ish-Konviktit të Shkollës Mekanike**", viti 2017 lloji procedurës tender i hapur, fondi limit pa TVSH 85.000.000 lekë, OE fitues "[redacted] përfaqësuar prej "[redacted] SHPK me vlerën e ofertës 43.247.820, çmimi më i ulët. Nga ana e AK janë shqyrtuar disa ankesa dhe kërkesa për sqarim nga ana e OE pjesëmarrës në tender dhe ankesa e OE "[redacted]", e paraqitur datë 28.04.2017, e cila nuk është pranuar.

- ✓ Nga ana e administratorit të Universitetit, për shqyrtimin e ankesës është ngarkuar një specialiste finance për shqyrtimin e ankesës lidhur me kriteret e veçanta të DST, e cila nuk mund të shqyrtojë një ankesë për kritere të natyrës teknike, pasi kërkohen njohuri nga ana inxhinierike.
- ✓ Mungojnë Komisionet e ngritura për shqyrtimin e ankesave nga specialistë të fushës.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 78, në lidhje me shqyrtimin e ankesës pika 6, në të cilin citohet se:

> "*Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:*
> *a)Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në*

përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.
b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën

6) Dosja e prokurimit me objekt **"Laboratori i fizioterapisë"** viti 2016, lloji procedurës tender i hapur. Fondi Limit 7,333,330 pa TVSH ose 8.799.996 me TVSH. Oferta fituese "[redacted] CO", me vlerë oferte 6.971.100 pa TVSH. Çmimi më i ulët.
Me urdhrin nr.4 datë 05.02.2016 është ngarkuar Njësia e Prokurimit për zbatimin e urdhrit e përbërë nga:
1.[redacted], Ekonomist
2.[redacted], Juriste
3.[redacted], specialist IT
Me urdhrin nr.19 datë 05.02.2016 për llogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve teknike, janë angazhuar pedagogët e fushës:
1.[redacted], Pedagoge Fakultetit Infermierisë
2.[redacted], Pedagoge Fakultetit Infermierisë
3.[redacted], Pedagog Fakultetit Infermierisë

Nga auditimi u konstatua mangësi si vijon:
- ✓ Komisioni i ngritur me urdhrin nr.19 datë 05.02.2016 për llogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve teknike në përbërje të tij ka pedagogë të Fakultetit të Infermierisë dhe nuk ka në përbërje të tij asnjë Inxhinier biomedical, elektronik, pavarësisht se hartimi i specifikimeve teknike ishte tejet specifik lidhur me pajisjet që do prokuroheshin.
- ✓ Ky komision nuk është ngritur në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 61 Pika 1 dhe 2 ku përcaktohet që:

Neni 61, pika 2, Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit
Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre

- ✓ Në përllogaritjen e fondit limit nuk ka argumentuar mënyrën se ku është bazuar në marrjen e çmimeve kur ka llogaritur fondin limit çmimet e tregut, ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
- ✓ Komisioni i Njësisë së Prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE ka dokumentuar me proces verbal përzgjedhjen e 5 OE, por nuk ka argumentuar mënyrën përse ka përzgjedhur këto operatorë, për tu dërguar ftesën për ofertë.
- ✓ Kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve

Veprime këto jo në përputhje me Ligjin " Për prokurimin publik" neni.1 dhe neni 2 Parimet e përzgjedhjes, neni 23:

Neni 1, Qëllimi ligjit për prokurimin publik është:
Të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Neni 23:
1.Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
*2.*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Referuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 39 e 59, ku përcaktohet që:

Neni 39, pika 4, paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës *bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si përshembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

6) Dosja e procedurës së prokurimit me objekt **"Blerje pajisje kompjuterike dhe audio vizuale**"

viti 2017 lloji procedurës: Kërkesë për propozim, fondi limit 2.083.400 pa TVSH, ose 2500000 lekë me TVSH. Oferta fituese me [redacted] SHPK. Oferta në vlerën 2, 257,247.11 lekë pa TVSH. Çmimi më i ulët.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës por u konstatuan mangësi si vijon :
Me Urdhrin e Prokurimit nr. 102, date 30.06.2017 NJP e përbërë nga::
1. [redacted], ekonomist
2. [redacted], Juriste
3. [redacted] specialist IT

- ✓ Përllogaritja e fondit limit nga Komisioni nuk është kryer në respektim nenit 59 të Ligjit për prokurimin publik pasi nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës *bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

- ✓ Njësia e prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE të cilët janë përzgjedhur nga kjo njësi nuk ka asnjë argumentim ligjor lidhur me përzgjedhjen e tyre si mënyrën dhe selektimin, për tu dërguar ftesën për ofertë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik neni.2 Parimet e përzgjedhjes, si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 39, 56 57 pika 1 dhe 2 përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

7. Dosja e procedurës së prokurimit **me objekt "Pajisje dhe instrumente Laboratorike "** viti 2016, lloji procedurës kërkesë për propozim, fondi limit 6.0000.000 (gjashtë milion) leke me TVSH. Oferta fituese me çmimin më të ulët oferta e operatorit ekonomik [redacted] me vlerë 3.732.160) lekë pa TVSH.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës, por u konstatuan mangësi si vijon :

Nga ana e titullarit të AK me urdhrin nr.70 datë 29.03.2016 është urdhëruar për llogaritjen e fondit limit, përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve teknike krahas njësisë së prokurimit të angazhohen dhe pedagogë të fakultetit të Bujqësisë që kanë iniciuar kërkesën.
Komisioni i përbërë nga :
1.[redacted], Pedagog Fakulteti Bujqësisë
2.[redacted], Pedagog Fakulteti Bujqësisë
3.[redacted], Dekane Fakulteti Bujqësisë
4.[redacted]
5.[redacted]
Përllogaritja e fondit limit nga Komisioni është kryer në kundërshtim mëe nenin 59 të Ligjit për prokurimin publik dhe nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në dosje ekziston një dokument i cili është i firmosur nga komisioni dhe nuk ka asnjë argumentin mbi bazën e llogaritjes së tij, dhe kujt i referohen për përllogaritjen e tij.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

Me Urdhër Prokurimi nr.11 datë 29.03.2016 është ngarkuar NJP për zbatimin e urdhërit e përbërë nga:
1.[redacted],Ekonomist
2.[redacted], Juriste
3.[redacted] specialist IT
Njësia e prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE të cilët janë përzgjedhur nga kjo njësi nuk ka asnjë argumentim ligjor lidhur me përzgjedhjen e tyre si mënyrën dhe selektimin, për tu dërguar ftesën për ofertë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik neni.2 Parimet e përzgjedhjes, si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 39, 5657 pika 1 dhe 2 përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

8.Dosja procedurës së prokurimit **me objekt** "**Makineri & Agregate Bujqësore**", me Fond Limit 3.000.000 (tre milion) leke me TVSH, "Kërkesë për Propozim", viti 2016, lloji procedurës kërkesë për propozim, fondi limit 6.0000.000 (gjashtë milion) leke me TVSH.

Oferta fituese me çmimin më të ulët oferta e operatorit ekonomik [redacted] me vlerë: 2.345.000 (dy milion e treqind e dyzetë e pese mije) lekë pa TVSH.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës, por ,u konstatuan mangësi si vijon:
Përllogaritja e fondit limit nga Komisioni është kryer në kundërshtim me nenin 59, të Ligjit për prokurimin publik dhe nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në dosje ekziston një dokument i cili është i firmosur nga komisioni dhe nuk ka asnjë argumentin mbi bazën e llogaritjes së tij, dhe kujt i referohen për përllogaritjen e tij.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

Njësia e prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE të cilët janë përzgjedhur nga kjo njësi nuk ka asnjë argumentim ligjor lidhur me përzgjedhjen e tyre si mënyrën dhe selektimin, për tu dërguar ftesën për ofertë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik neni.2 Parimet e përzgjedhjes, si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 39, 5657 pika 1 dhe 2 përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu konstatohet se ky komision në përbërje të tij ka pedagogë të Fakultetit të Bujqësisë dhe nuk ka në përbërje të tij asnjë Inxhinier mekanik, pavarësisht se hartimi i specifikimeve teknike ishte tejet specifik lidhur me pajisjet që kërkohet, ky komision nuk është ngritur në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 61 Pika 1 dhe 2 ku përcaktohet që:

Neni 61 pika 2 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit
Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga strukt
ura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe

specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike i ka hartuar ato përciptazi, pa u thelluar dhe pa përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, **veprime këto jo në përputhje me** Ligjin nr. 9643, datë 29.12.2006 Neni 23 Specifikimet teknike, ku përcaktohet qartë:

Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate.

9. Dosja e procedurës së prokurimit **me objekt** "**Mobileje, Orendi**" 2017, me Fond Limit 7.500.000 (shtatë milion e pesëqind mijë) leke me TVSH, "Kërkesë per Propozim", shpallur fitues i Procedurës, operatorin ekonomik "[redacted]" **.** Vlera e ofertës *6.062.500 lekë* pa TVSH çmimi më i ulët.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës por u konstatuan mangësi si vijon: Me Urdhër Prokurimi nr.143 datë09.11.2017është ngarkuar NJP për zbatimin e urdhrit e përbërë nga:

1. [redacted] ekonomist
2. [redacted] Juriste
3. [redacted] specialist IT

Përllogaritja e fondit limit nga Komisioni është kryer në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për prokurimin publik dhe nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në dosje ekziston një dokument i cili është i firmosur nga komisioni dhe nuk ka asnjë argumentin mbi bazën e llogaritjes së tij, dhe kujt i referohen për përllogaritjen e tij.

Neni 59

1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

Njësia e prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE të cilët janë përzgjedhur nga kjo njësi nuk ka asnjë argumentim ligjor lidhur me përzgjedhjen e tyre si mënyrën dhe selektimin, për tu dërguar ftesën për ofertë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik neni.2 Parimet e përzgjedhjes, si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 39, 5657 pika 1 dhe 2 përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Me Urdhër Prokurimi nr.143 datë 09.11.2017 është ngarkuar NJP për zbatimin e urdhërit e përbërë nga:
1.[redacted] ekonomist
2.[redacted] Juriste
3.[redacted] specialist IT
Gjithashtu konstatohet se NJP ka marr përsipër hartimin e specifikimeve teknike për mobiliet dhe orenditë, në dokumentacionin e ndodhur në dosje, nuk argumentohet secilit standardi teknik i referohen, nëse ka një parashikim nga arkitekti të miratuar nga titullari, mbi një projekt ide mbi mobilimin e ambienteve.. etj hartimi i këtyre specifikimeve nga NjP kur në përbërje të tij mungon specialisti i fushës është në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 61, Pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:

Neni 61 pika 2 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit
Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike i ka hartuar ato jo si blerje malli por si prodhues, standardet e kërkuara janë tejet të ekzagjeruara lidhur me certifikatat dhe standardet e kërkuara dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, **duke krijuar kushte për** *trajtim jo të njëjtë për të gjithë kandidatët*

dhe ofertuesit dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, **veprime këto jo në përputhje me** Ligjin nr. 9643, datë 29.12.2006, Neni 23, Specifikimet teknike, ku përcaktohet qartë:
Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:
a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate.
4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

10.Dosja e procedurës së prokurimit me objekt "Laboratori i Gjuhëve te Huaja" me Fond Limit 6.0000.000 leke me TVSH, "Kërkesë për propozim shpallur fitues operatori ekonomik "[redacted]" me çmimin më të ulët . Vlera: 3.758.708 lekë pa TVSH.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor të dosjes tenderit, verifikimit në sistemin e APP në seksionin e AK për këtë procedurë prokurimi u konstatua se janë ndjekur hapat ligjor përsa i përket njoftimit të kontratës por u konstatuan mangësi si vijon:
Urdhri nr.38, datë 24.02.2016 për llogaritjen e fondit limit, përcaktimin e specifikimeve teknike komisioni :
1.[redacted] Pedagoge Fakulteti Gjuhëve të huaja
2.[redacted], Pedagoge Fakulteti Gjuhëve të huaja
3.[redacted], Pedagoge Fakulteti Gjuhëve të huaja

4. [redacted] , Dekan Fakulteti, (i cili ka firmosur si anëtar komisioni dhe si dekan fakulteti me cilësinë e titullarit AK).
Përllogaritja e fondit limit nga Komisioni është kryer në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për prokurimin publik dhe nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në dosje ekziston një dokument i cili është i firmosur nga komisioni dhe nuk ka asnjë argumentin mbi bazën e llogaritjes së tij, dhe kujt i referohen për përllogaritjen e tij.

Neni 59
1)Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.
2.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
a)çmimet e tregut;
b)ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
c) ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

Njësia e prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE të cilët janë përzgjedhur nga kjo njësi nuk ka asnjë argumentim ligjor lidhur me përzgjedhjen e tyre si mënyrën dhe selektimin, për tu dërguar ftesën për ofertë, *veprim ky në kundërshtim* me Ligjin për prokurimin publik neni.2 Parimet e përzgjedhjes, si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 39, 56, 57 (pika 1 dhe 2), ku përcaktohet që:

Neni 39 pika 4 paragrafi dytë.
Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Me Urdhër Prokurimi nr.143 datë09.11.2017është ngarkuar NJP për zbatimin e urdhërit e përbërë nga:
1.[redacted] ekonomist
2.[redacted] Juriste
3.[redacted] specialist IT
Gjithashtu konstatohet se ky Komision ka marr përsipër hartimin e specifikimeve teknike për pajisjet elektronike, hartimi i këtyre specifikimeve nga komisioni kur në përbërje të tij mungon specialisti i fushës inxhinier elektronik ose informatik është në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar neni 61, Pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:

Neni 61 pika 2 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit
Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre

Me urdhrin nr.8, është ngarkuar NJP për zbatimin e urdhrit komisioni i përbërë nga:

1.[redacted] ekonomist
2.[redacted] Juriste
3.[redacted] specialist IT

Me procesverbal datë 3.07.2017 kjo njësi ka bërë miratimin e Kushteve të veçanta të tenderit për tu plotësuar nga OE dhe të cilat janë të paplota pa u thelluar dhe pa përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë me objektin e prokurimit, **veprime këto jo në përputhje me** Ligjin nr. 9643, datë 29.12.2006, Neni 23, Specifikimet teknike, ku përcaktohet qartë:

Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:
a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Universiteti Fan S. Noli Korçë. Për vitet 2016 – 2017, nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e zbatimin e kontratës, u konstatua se: Autoriteti Kontraktor Universiteti Fan S. Noli Korçë në disa tendera *nuk ka zbatuar dhe respektuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr.9643"Për Prokurimin Publik" i ndryshuar , VKM nr. 914 datë 29.12.2014 " Për rregullat e prokurimit publik" e ndryshuar, nuk ka siguruar frymën dhe parimet bazë të ligjit për prokurimin publik lidhur me efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera,të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Njësia e Prokurimit,[redacted], Pedagogët NJHD**,**1.[redacted] **,** 2. [redacted], 3.[redacted] 4.[redacted] Pedagogët NJHD 1.[redacted], 2.[redacted] 3.[redacted], 4.[redacted]**,** 5. [redacted] Pedagogët NJHD 1 .[redacted] 2.[redacted]**,**3.[redacted]

Komente dhe shpjegime nga subjekti :

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar "Universiteti F. S. Noli", me shkresën nr.1041/5, dt. 06.06.2018, ka bërë komente dhe shpjegime, (që janë të njëjta si për akt-konstatimin Nr. 6, dhe projektraportin e auditimit), konkretisht:
Hartimi i specifikimeve teknike nga NJP, është bërë në kushtet kur në përbërjen e tij mungon specialist i fushës. Ju konstatoni se në komisionet e ngarkuara për hartimin e specifikimeve teknike për paisje elektronike ,makineri ,mobileje etj, në shumicën e rasteve nuk ka specialist të fushës përkatëse.
Ju sqarojmë se në çdo rast komisionet për përcaktimin e specifikimeve teknike kanë pasur në përbërjen e tyre një ose m shumë specialistë fushe, por tek specifikimet teknike për pajisje elektronike është vendosur në komision përgjegjësi IT [redacted], ose specialist [redacted],në komisioni i mobilieve është vendosur arkitekti [redacted], me komisioni i makinerive apo veglave është vendosur specialistja [redacted] Në përbërje të këtyre komisioneve janë vendosur dhe anëtarë të tjerë me profesion ekonomistë, juristë, sipas rastit. Kjo dhe për faktin që në përbërje të një komisioni nuk mund të vendosin tre arkitektë apo tre mekanike apo tre specialistë IT, për shkak të numrit të kufizuar të personelit administrativ. Por në çdo rast është vendosur të paktën një specialist fushe.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:
Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit konstaton se komentet dhe shpjegimet e dhëna reflektojnë të gjitha gjetjet e grupit të auditimit, dhe nuk përbëjnë argument për të ndryshuar opinionin dhe konkluzionet e arritura nga grupi i auditimit. Personat e përmendur nga ana juaj , bazuar në dokumentacionin e paraqitur Grupit të auditimit, asnjëherë nuk rezultojnë të kenë qenë pjesë e komisioneve të ngritura sipas urdhrave përkatës të Titullarit të Institucionit.

Mbi auditimin e ushtruar të dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve në objektin "***Rikonstruksioni i godinës ish konvikti i shkollës mekanike***" rezulton:

1. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:
Mbi objektin e Restaurimit së Godinës së ish konviktit të shkollës mekanike
-Për hartimin e projektit-preventivit AK ka hapur kontraktuar shoqëri projektimi dhe inxhinier me licencë përkatëse. Projekt-preventivi i mbrojtjes kundra zjarrit është realizuar nga shoqëria "[redacted]" me Ing. [redacted] Projekti elektrik është realizuar nga Ing. [redacted]. Instalimet Hidraulike janë realizuar nga Ing. [redacted] dhe projekt-preventivi arkitektonik është realizuar nga Ark. [redacted].
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, mbi përllogaritjen e fondit limit, ***nuk disponoheshin analizat e çmimeve*** për zërat jashtë manualit të ndërtimit në kundërshtim me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*".
Nga auditimi i zgjedhje i disa zërave të përllogaritjes së fondit limit prej 70,829,958 lekë pa TVSH, ka disa pasaktësi si më poshtë vijon:
Në kapitullin e punimeve të tavanit, suvatimi dhe veshjeve janë shtuar 2 zëra punime të suvatimit me fino (mure + soletë, trarë, parapet), në vlerën total prej 762,165 lekë pa TVSH (316,315 + 445,850), janë të përfshira në punimet e suvatimit në zërat e suvatimit të

brendshëm, kolonave, soletë dhe trarë. Megjithatë këto 2 zëra nuk janë likuiduar në gjatë zbatimit të punimeve në situacionin përfundimtar të sipërmarrësit.
Në përllogaritjen e fondit limit për punimet elektrike, janë llogaritur të gjitha pajisjet elektrike të kuadrove, çelësave, prizave, përcjellëseve etj, *për Furnizim Vendosje* dhe në mbyllje të preventivit është vendosur zë pune për instalimet elektrike (material + punë) në vlerën prej 30,000 lekë e cila është zë pune i mbivendosur dhe i pajustifikuar. Në përgjithësi zërat me më shumë volum punë janë në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, të cilat përdoren për përcaktimin e fondit limit të objekteve të ndërtimit.
Me Vendimin nr. 2841 datë 30.12.2016 të Bashkisë Korçë, miratohet kryerja e punimeve në ish konviktin e shkollës mekanike i cili do të shërbejë si Rektorat i Universitetit "Fan Noli".

-Objekti "***Rikonstruksioni i godinës ish konvikti i shkollës mekanike***", është kryer sipas kontratës për punë publike më datë 30.05.2017, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti "Fan S. Noli", përfaqësuar nga Administratori zj. [redacted] dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "[redacted] sh.p.k & "[redacted] " SHPK, përfaqësuar nga operatori "[redacted] " SHPK nga Administratori z. [redacted].
Vlera e kontratës bazë është 51,897,384 lekë me TVSH. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit 37.2* të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, ku kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit me çmimin në njësi për secilin zë punimesh.

-Kontrata shtesë, e punimeve shtesë të godinës së ish godinës së shkollës mekanike me nr. 243 prot. datë 20.10.2017, është lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti "Fan S. Noli", përfaqësuar nga Administratori zj. [redacted] dhe bashkimit të operatorëve ekonomik [redacted] sh.p.k & "[redacted] SHPK, përfaqësuar nga operatori [redacted] SHPK nga Administratori z. [redacted], në vlerën prej 10,379,013 me TVSH ose në masën 19.9 % të kontratës fillestare. Shtesa e kontratës përfshin ndryshime në volume të kontratës fillestare, zëra të rinj të ndryshuar, shtesa në punime elektrike, punime kompjuterike dhe të vëzhgimit.
-Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata me datë 23.05.2017 të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti "Fan S. Noli", përfaqësuar nga Administratori zj. [redacted] dhe Ing. [redacted] me NIPT L14306001V. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 25,600 lekë pa TVSH.

Mbi ekzekutimit të punimeve
Afati maksimal i përfundimit të punimeve sipas nenit 3 të kontratës, është përcaktuar 4 muaj, duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.
Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur me datë 30.05.2017, ku është konstatuar se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi merr në dorëzim sheshin e ndërtimit.
Më datë 30.05.2017 njoftohet fillimi i punimeve dhe mbahet procesverbali i fillimit të punimeve.
1. Me shkresën e AK datë 02.10.2017, drejtuar mbikëqyrësit të punimeve dhe sipërmarrësit, kërkohet përmirësim i objektit në lidhje me suvatimet, dyshemeja e bibliotekës të realizohet me pllakë, të mbyllet pjesa e xokolit të fasadës, të realizohet patinim vetëm në zyrave katit të tretë, të realizohet veshje e murit me MDF etj dhe kërkon rakordimin e zërave të punimeve elektrike, ku të realizohen llogaritjet përkatëse duke saktësuar volumet që hiqen dhe shtohen.
2. Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve datë 02.10.2017, drejtuar Universitetit Fan S. Noli, kërkon shtyrje të afatit të punimeve për shkak të përmirësimit të objektit të projekt-

preventivit të cilat kërkojnë kohën e tyre për zbatimin e punimeve, ku kërkohet shtyrja deri më 10.12.2017. Gjithashtu më datë 02.10.2017 mbikëqyrësi kërkon plotësimi i objektit me fond shtesë prej 10,379,013 lekë me TVSH.
3. Më datë 02.10.2017 sipërmarrësi paraqet propozimet për korrigjime, plotësime dhe përmirësime të projektit të zbatimit mbështetur në nenin 36 të kontratës, në ndryshimet e pronësisë dhe në LPP mbi shtesat e kontratave të ndërtimit. Më datë 04.10.2017 sipërmarrësi paraqet propozimet e ndryshimeve bashkëlidhur me tabelën e ndryshimit të volumeve të punës. Zërat e rinj të punimeve janë propozuar për negocim dhe janë miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Me procesverbalin e datës më 10.12.2017, nga palët deklarohet përfundimi i punimeve, ndërsa njoftimi i përfundimit të punimeve janë më datë 24.11.2017
Procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve është realizuar më 16.02.2018 midis palëve.
Akti i kolaudimit të punimeve është realizuar më datë 14.12.2016 nga kolaudatori Ing. [redacted] me licencë nr. MK 1545/1.

-Kontrata bazë dhe shtesë përbëhet prej 4 situacione pjesore progresive, *të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore,* veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "***Për zbatimin e punimeve të ndërtimit***", *Kreu II, pika 8.1* "*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës" dhe* Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "***Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 3.3*** ku përkatësisht përcaktohet se:

"*Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*".

Mbi realizimin e punimeve në dosjen teknike janë mbajtur procesverbalet e punimeve të maskuara të elementeve kryesorë të b/a në shtesën e kontratës, mbi punimet e hekurit, akt-kontrolle të ndryshme, libri i sigurimit teknik mbi instruktimin e punonjësve, test raporte dhe matje të ndryshme mbi elementët kryesorë. Gjithashtu dosja teknike përmban disa certifikata të origjinave, certifikatat e në zbatimit dhe dispozitave ligjore mbi disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

A. *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion i dosjes teknike për kontratës konstatohet se:*
Në dosjen teknike u konstatua se mungonin mbi 95 % të librezave të masave, të cilat nuk gjendeshin në dosjen teknike. Nga grupi i auditimit u kërkua plotësimi i dokumentacionit teknik nga mbikëqyrësi dhe AK, por përsëri nuk u plotësuan librezat e masave në mënyrë që të realizoheshin matjet me sondazhe në objekt. Pra argumentimet e rritjeve të volumeve të punimeve nuk justifikohen me llogaritje metrike me librezën e masave në përputhje me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "***Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit***", **pika 3.2** ku përkatësisht *përcaktohet se:*

"3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit".

Për përmirësimin, apo rritjet dhe zbritjet e volumeve të punës, duke mos saktësuar në fakt volumet në rritje apo në zbritje për punimet e prishjeve, punimet e suvatimit, punimet e muraturës, punimet elektrike, hidrosanitare etj, rrjedhimisht nuk justifikohet përdorimin e fondit shtesë rreth 20% të kontratës në vlerë 10,379,013 me TVSH.
Mungesa e dokumentacionit mbi justifikimet apo argumentimet e rritjes së sasive të volumeve të punimeve në vlerën prej ***10,379,013 lekë me TVSH, përbëjnë përfitime të padrejta nga sipërmarrësi.***

B. *Nga verifikimi i zërave të likuiduar në situacionin përfundimtar,* ***në mungesë të librezave të masave****, u konstatuan disa pasaktësi dhe mospërputhje, duke krahasuar volumet e proceseve të punës të cilat duhet të kenë të njëjtën sasi.*

1. Kapitulli i punime të dheut, zëri "Transport auto 4 km mbeturina + dhera".
Preventivi i punimeve për këtë zë ka pas parashikuar 503 m^3 dhe në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 1,358 m^3, pasi sipas argumentime në korrespondenca u rritën sasitë e prishjeve të suvatimit etj. Për këtë zë punimi ekzistonte libreza e masave dhe në llogaritje është marrë (gjatësia e të gjithë territorit prej 9,539.7 ml) me (gjerësi mesatare 12 ml) dhe (lartësi mbeturinash prej 1 ml) dhe ka nxjerrë një rezultat të *pakuptueshëm dhe fiktiv* prej 1,240.3 m^3. Pasi nëse do kryheshin veprimet drejt 9,539.7 m x 12 m x 1 m = 114, 476 m^3 dhe nëse gjatësia do të ishte 9.5 m, gjerësia 12m, lartësia 1m = 114 m^3.
Ndërkohë, në kapitullin e punimeve të trupit të rrugës janë likuiduar 2 zëra për zbarkim dheu + Tr. K.D 10m kIII (rrugë + shesh) në sasinë prej 1,820 m^3 dhe transport dheu me auto deri në 5km në sasinë prej 1,947.6 m^3, të cilat nuk disponoheshin llogaritjet metrike në librezën e masave. *Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht zërin e mbivendosur në volumin prej 1,240.3 m^3, në zërin e zbarkimit të dherave dhe zërin transportin e dherave me auto deri në 5 km.*

2. Kapitulli i punime të hidroizolimit dhe termoizolimit të tarracës, zëri "Hidroizolim me material baza poliuteretan".
Preventivi i punimeve për këtë zë ka pas parashikuar 790 m^2 dhe në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 790 m^2, dhe nuk disponohet libreza e masave. Duke krahasuar volumet e shtresës termoizoluese me polisterol tr. 20 cm dhe atë të lustrës çimento 1:2 tr. 2 cm prej 687 m^2, rrjedhimisht sasia e "hidroizolimit me material bazë poliuretani", duhej të ishte në sasinë prej 687m^2, ku sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej *103 m^2* (790 m^2 - 687 m^2), me çmimin përkatës prej 750 lekë, rezulton vlera prej 77,250 lekë pa TVSH.

3. Kapitulli i punime të shtresave, zëri "Shtresë termoizoluese me polisterol XPS 5 cm- kati Përdhe".
Preventivi i punimeve për këtë zë ka pas parashikuar 640 m^2 dhe në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 640 m^2, dhe nuk disponohet libreza e masave. Duke krahasuar volumin e Izolimit me dy shtresa bitum (ëc) por në fakt është për katin përdhe e cila është në sasinë prej 520 m^2, rrjedhimisht sasia e "Shtresë termoizoluese me polisterol XPS 5 cm- kati

Përdhe" duhej të ishte në sasinë prej 520 m^2, ku sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej *120 m^2* (640 m^2 - 520 m^2), me çmimin përkatës prej 300 lekë, rezulton vlera prej 36,000 lekë pa TVSH.

4. Kapitulli i Instalimet elektrike, zëri "Për Instalimet elektrike (material + punë)".
Në fund të preventivit është parashikuar zë punimi komplet në njësinë (lek) në vlerën prej 70,000 lekë pa TVSH. Ky zë punimi është i pajustifikuar edhe i mbivendosur në punimet e instalimeve elektrike pasi ç'do punim elektrik për kuadrot, kuti shpërndarëse, çelësa, priza, përcjellëse, tubo, ndriçues, automat etj, janë të gjitha zëra apo procese pune ***Furnizim Vendosje.***
Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht këtë zë punimi.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet efekti financiar i mospërputhjeve të punimeve

Zëri	Përshkrimi i punimit	Vlera sipas situacionit				Rillogaritjet midis punimeve			
		Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera	Dif.
				(Lekë)	(Lekë)		(Lekë)	(Lekë)	(Lekë)
	Punime ne trupin e rrugës								
8	Zbarkim dheu+ tr KD 10 m KIII (rruge + shesh) (-1,240.3 m3)	m3	1,820	320	582,400	580	320	185,568	396,832
9	Transport dheu auto deri 5 km, (-1,240.3 m3)	m3	1,947	250	486,750	707	250	176,675	310,075
	Punime Hidro dhe Termoizolimi Tarace								
17	Hidroizolim me material baza poliuretan	m2	790	750	592,500	687	750	515,250	77,250
	Punime Shtresash								
23	Shtresë termoizoluese me polisterol XPS 5 cm- kati Përdhe	m2	640	300	192,000	520	300	156,000	36,000
	Instalimet elektrike								
1	Për Instalimet elektrike (material + punë)	Lek	1	70,000	70,000	-	70,000	-	70,000
								Shuma:	**890,157**
								TVSH	**178,031**
								TOTAL	**1,068,188**

Si përfundim, nga BOE [redacted] sh.p.k & "[redacted] sh.p.k**,** janë përfituar padrejtësisht punime të pakryera dhe të mbivendosura**, duke i shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,068,188 lekë me TVSH.**

Në përgjigje të observacionit të projektraportit, të dërguar me shkresën nr. 9202/6 prot. datë 28.05.2018, në lidhje me pretendimet e paraqitura nga sipërmarrësi i punimeve, sqarojmë se objeksionet e paraqitura nga Subjekti dhe Operatori Ekonomik, nga ana e grupit të auditimit merren pjesërisht në konsideratë.

- Në lidhje me punimet shtesë e kontratës ku praktika e kërkuar dhe e miratuar me volumet e punimeve që hiqen dhe shtohen si dhe përdorimi i fondit rezervë, ripërsërisim faktin se në periudhën e auditimit ***mungonin mbi 95% të librezave të masave dhe gjithashtu situacionet pjesore progresive nuk disponinin libreza masash.*** *Në këto kushte* ***nuk mund të gjykohet mbi shpenzimet dhe vlerën përfundimtare të objektit, në përputhje me dispozitat ligjore të kontrollit dhe disiplinimit të punimeve.***

Ju sqarojmë gjithashtu ***se librezat e masave të paraqitura në observacion janë të ripunuara gjatë periudhës së përgatitjes së observacioneve, pasi nga grupi i auditimit administrohen***

***fotokopje të librezës së masave (të cilat ishin shumë pak në dosjen teknike), ku mungonte nënshkrimi dhe vula e sipërmarrësit të punimeve**, pra dokumentet e paraqitura në observacion janë dokumente të tjera në lidhje me dokumentet të cilat administroheshin në dosjen teknike. Lidhur me pretendimet e sipërmarrësit se, të gjitha punimet janë kryer në fakt, grupi i auditimit **nuk mund të gjykojë vetëm bazuar në pretendimet e ngritura nga OE pa u kryer verifikimi në vend i këtyre volumeve të punimeve pas situatës së re të paraqitur**, për të saktësuar pretendimet e ngritura nga sipërmarrësi dhe supervizori.Për këtë, kërkohet ngritja e një grupi të posaçëm për të vlerësuar përputhshmërinë e sasive të punimeve të kryera në terren me dokuemtnacionin teknik (situacione punimeve, libreza e masave, ditari i punimeve etj.,).*

*-Në lidhje me pretendimet e tjera të disa zërave të punimeve, sqarojmë se **nuk ka asnjë argumentim shtesë mbi to dhe ngelen të njëjta me të projektraportit, pasi grupit të auditimit në periudhën e auditimit nuk u vunë në dispozicion llogaritjet metrike të objektit**.*

Si përfundim konstatohet se:
Gjetja: Në auditimin e dosjes së prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të Shkollës Mekanike"* me fond limit 70,829,958 lekë pa TVSH, OE fitues [redacted]" SHPK, me vlerë të ofertës 43,247,820 lekë, ka rezultuar me çmimin më të ulët, rreth 39% më pak se fondi limit i llogaritur. Në procedurën e tenderimit kanë marrë pjesë 22 operatorë ekonomik, në të cilën janë kualifikuar 14 operatorë ekonomik. Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin teknik të zbatimit të punimeve të objektit u konstatua se kontrata është lidhur më datë 30.05.2017. Është nënshkruar kontratë shtesë më datë 20.10.2017, midis Autoritetit Kontraktor Universiteti "Fan S. Noli" dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "[redacted]" SHPK & "[redacted] SHPK, në vlerën prej 10,379,013 me TVSH, ose në masën 19.9 % të kontratës fillestare. Shtesa e kontratës përfshin ndryshime në volume të kontratës fillestare, zëra të rinj të ndryshuar, shtesa në punime elektrike, punime kompjuterike dhe të vëzhgimit. Në dosjen teknike u konstatua se mungonin mbi 95 % të librezave të masave, (të cilat nuk gjendeshin në dosjen teknike). Pra, argumentimet e rritjeve të volumeve të punimeve nuk justifikohen me llogaritje metrike me librezën e masave, siç përcaktohet në Udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM", pika 3.2, ku përkatësisht përcaktohet se *"Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*". Për pasojë, nuk justifikohen me dokumentacion përmirësimet e objektit, apo rritjet dhe zbritjet e volumeve të punës, duke mos saktësuar në fakt volumet në rritje apo në zbritje për punimet e prishjeve, punimet e suvatimit, punimet e muraturës, punimet elektrike, hidrosanitare etj,. Rrjedhimisht nuk justifikohet përdorimi i fondit shtesë rreth 20% të kontratës, në vlerë 10,379,013 me TVSH.
Sa më sipër, në pamje të parë duket se oferta fituese është ulur nga fondi limit në vlerën 43,247,820 lekë nga konkurrenca e lirë, por nga auditimi i zbatimit të punimeve vlera e kontratës është rritur në vlerën 8,649,177 lekë më shumë, e cila në total rezulton në vlerën 51,896,997 lekë pa TVSH. Gjithashtu, nga verifikimi i zërave të likuiduar në situacionin përfundimtar, *në mungesë të librezave të masave*, duke krahasuar volumet e proceseve të

punës, u konstatuan disa pasaktësi të pajustifikuara, mospërputhje të punimeve dhe mbivendosje të zërave, në vlerën 1,068,188 lekë.
Mungesa e dokumentacionit mbi justifikimet apo argumentimet e rritjes së sasive të volumeve të punimeve në vlerën prej **10,379,013 lekë me TVSH,** përbën përfitime të padrejta nga sipërmarrësi në dëm të buxhetit të shtetit, deri në momentin e justifikimit të sasive faktike të projektit.
Ndikimi/Efekti: Rritja e kostos së ndërtimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në mënyrë pajustifikuar në dëm të buxhetit të shtetit.
Rëndësia: I Lartë
Rekomandim:
-Universiteti "Fan S. Noli", të ngrejë një grup pune të veçantë, në përbërje të të cilit të ketë specialistë të fushës (inxhinierë ndërtimi), për kryerjen e verifikimeve dhe rakordimeve të punimeve të kryera në fakt në vlerën e përgjithshme prej **10,379,013 lekë me TVSH,** të pasqyruara në situacionin përfundimtar dhe të likuiduara, por të pa justifikuara me librezën e masave nga mbikëqyrësi i punimeve.
Në përfundim të këtij procesi, të ndiqen procedurat ligjore dhe administrative për shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën **10,379,013 lekë**, **ose të vlerës së dëmit që mund të shtojë apo pakësojë këtë vlerë**, kjo e argumentuar me rezultatet e dala nga grupi i punës që do të bëjë verifikimin dhe rakordimin e punimeve të kryera në fakt.
Afati për zbatimin e rekomandimit: *Menjëherë*

D. Vlerësim mbi aktivitetin e auditimit të brendshëm.

Për periudhën objekt vlerësimi nga ana e KLSH (1.1.2016-31.12.2017) dhe deri në datën e mbajtjes së këtij raporti, UFSNK nuk ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm.
Sipas përcaktimeve të VKM për kriteret e ngritjes së NJAB për periudhën objekt auditimi të KLSH-së, në strukturë nuk ishte parashikuar ngritja e funksioneve të auditimit të brendshëm të Universitetit. Për sa më sipër, është vepruar në shkelje të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, si një institucion që kryen funksione publike dhe që garantohet financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. Gjithashtu, nga ana e UFSNK janë plotësuar detyrimet e pikës 1/b të këtij vendimi , meqenëse të ardhurat janë mbi 400 milionë përgjatë tre viteve të fundit, respektivisht:

- 440 milion të ardhurat gjithsej në v.2015,
- 480 milionë lekë në v.2016 dhe 231 punonjës gjithsej,
- 493 milionë lekë të ardhurat gjithsej të v.2017 dhe 236 punonjës gjithsej.

Kjo mangësi mbi krijimin e strukturës së AB, është korrigjuar vetëm pas miratimit të Statutit të ri nga ana e Ministrit të MASR, me Urdhrin nr. 56, datë 08.02.2018.

*****

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

Titulli i Gjetjes 1:	**Nevoja për një shtesë/ përmirësim të akteve nënligjore në fuqi mbi kriteret dhe mënyrën e pagesës së Bordeve të Administrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, si përmirësim dhe plotësim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Njësive të Qeverisjes Qendrore"**
Situata:	Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) nr. 16, datë 27.07.2017, është vendosur të shpërblehen për çdo muaj anëtarët e BA me nga 35 mijë lekë dhe kryetari i BA me 40 mijë lekë. Këtu përfshihet dhe rimbursimi i shpenzimeve dhe trajtimi financiar me dieta. Në vendim thuhet se "vendimi i shtrin efektet nga muaji dhjetor 2016." Pagesa e Bordit të Administrimit është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik" ku është përcaktuar se, *tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.* Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore" lidhja nr. 1, por përbën edhe konflikti interesi, pasi Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjor të përcaktojë tarifat e shpërblimit për vetveten, pasi në nenin 5 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar. Në kolonën nr.6 "Arsimi i lartë publik", të lidhjes nr.1 që shoqëron Vendimin e KM nr. 418, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Njësive të Qeverisjes Qendrore", trajtohet "Këshilli Administrativ", institucion që buronte nga përcaktimet e ligji nr.9741, datë 21.5.2007 mbi arsimin e lartë, i shfuqizuar,. Aktualisht, Bordet e Administrimit të Universiteteve publike kanë përcaktuar vetë masën e shpërblimit të tyre, pa asnjë kriter dhe pa u bazuar në asnjë referencë ligjore.
Kriteri:	Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligji për funksionimin e organeve kolegjiale Vendim i KM nr. 418, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e masës së

	shpërblimit të anëtarëve të këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Njësive të Qeverisjes Qendrore". Në pikën nr. 3 të VKM nr. 418/2012, i ndryshuar, përcaktohet që: *"Emërtesa e çdo këshilli, bordi apo komisioni, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së kryetarit dhe anëtarëve për çdo këshill, bord ose komision përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me përjashtim të rastit kur ligji specifik parashikon ndryshe".*
Ndikimi/Efekti	Mos përcaktimi i kritereve rigoroze dhe rregullave mbi shpërblimin e këtyre organeve kolegjiale, numrin e mbledhjeve dhe sa prej tyre do të konsiderohen për efekt pagesash, ka krijuar precedentin e caktimit të këtyre niveleve të shpërblimit për Bordet e Administrimit nga vetë këto struktura dhe në kushtet e konfliktit të interesit.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Universiteti "Fan S. Noli" Korçë të propozojë pranë Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, referuar ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në RSH", ndryshimet dhe rregullimet e domosdoshme, si përmirësim në VKM nr. 418, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik", duke shënuar "Bordin e Administrimit" dhe duke propozuar tarifat e shpërblimit për pjesëmarrjen në këto borde për anëtarët e brendshëm dhe të jashtëm, që do të angazhohen në këto funksione administrimi.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda 3 muajve.

Titulli i Gjetjes 2:	**Nevoja për rishikim të Rregullores së Brendshme të degëve, sektorëve dhe aparatit të Rektoratit, si dhe rregullorja mbi shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë.**
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka vijuar të funksionojë me rregulloren e brendshme të miratuar nga Senati Akademik, me Vendimin e senatit nr. 13, datë 30.3.2009, i ndryshuar me Vendimin nr. 8, datë 16.3.2018 "*Rregullore e brendshme për degët, sektorët dhe administratën e rektoratit të UFSNK"* gjatë periudhës objekt auditimi. Kjo rregullore është bazuar në ligjin 9741, datë 21.5.2007, i shfuqizuar. Ndonëse ka pasur ndryshime në strukturë si, krijimi i pozicioneve të reja apo sektorëve të rinj, nga auditimi u konstatua se, këto ndryshime vijojnë të mos reflektohen në rregulloren e institucionit. Nuk është miratuar nga Bordi i Administrimit rregullorja financiare dhe ajo për shpërndarjen e të ardhurave. Në kuadër të funksionimit të Bordit të Administrimit, vërehet se nuk kanë gjetur zbatim detyrimet që burojnë nga përcaktimet e nenit 49,

	germa "e" dhe "f", në bazë të të cilave, Bordi miraton rregulloren financiare të institucionit si dhe përcakton rregullat mbi shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë, *e) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;* *ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;*
Kriteri:	Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.108, datë17.11.2016.
Ndikimi/ Efekti	Mos rishikimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbart risqe që lidhen me mos përcaktimin e rregullave dhe detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit dhe aspekte të adresimit të përgjegjësive, kërkesës së llogarisë, marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të ndryshme të punës, etj.
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandimi	**2.1**. Institucioni, në funksion të kryerjes së përgjegjësive ligjore dhe realizimit të objektivave, të marrë masa për të rishikuar dhe përmirësuar Rregulloren e Brendshme të rektoratit, duke reflektuar ndryshimet e ndodhura në kuadrin ligjor dhe aktet e tjera nënligjore. Përmirësimet e strukturës organike dhe organigramës së funksionimit të institucionit, ti shërbejnë ndihmesës së punonjësve të institucionit që të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me te drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre të punësimit. **2.2.** Nga ana e Bordit të Administrimit të miratohet rregullorja financiare dhe ajo për shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga përcaktimet e nenit 49, germa "e" dhe "f", të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në RSH".
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Brenda 3 muajve*

B. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>:

Titulli i gjetjes 1: *Mbi respektimin e strukturës organike*

Situata:	Struktura organike e miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 12, datë 26.12.2015 dhe nr. 11, datë 19.12.2016, për vitin 2017 është në kundërshtim me VKM nr.474, datë 16.6.2011, "*Për përcaktimin e Standardeve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike"*. Në strukturë evidentohet krijimi i degëve dhe jo drejtorive, në kundërshtim me pikën 21, të VKM nr.474, datë 16.6.2011, ku citohet: "*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*". Sektorët në përbërje të degëve kanë funksionuar në kundërshtim me kërkesat e pikës 20, të VKM nr.474, datë 16.6.2011, ku citohet: *"Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të, të jenë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës....."*. - Rektorati ka në strukturë tre punonjës më shumë, nga 46 që është numri i miratuar në vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Konkretisht, Rektorati ka funksionuar me 49 nëpunës duke pasqyruar Rektorin në pozicionin e Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, por pagesën e ka marrë si Rektor dhe dy Zëvendës Rektorët janë pasqyruar si pedagogë në fakultetin Ekonomik dhe në fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, por pagesën e kanë marrë për pozicionin e punësimit si Zëvendës Rektorë. - Për vitin 2016, numri i punonjësve efektivë të miratuar është 246 gjithsej dhe realizimi 232, (-14 punonjës) , por konstatohet se numri i punonjësve akademikë me kontratë për këtë vit kalendarik është 128. Po i njëjti fenomen konstatohet edhe për vitin 2017, ku numri i punonjësve efektivë të miratuar është 238 gjithsej, numri i punonjësve akademikë efektivë është 157, dhe njëkohësisht janë punësuar me kontratë 96 pedagogë nga 95 të miratuar në strukturë, ose një punonjës më shumë se struktura e miratuar.
Kriteri:	VKM nr.474, datë 16.6.2011 "Për përcaktimin e Standardeve të Procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", vendimin nr. 12, datë 26.12.2015 dhe nr. 11, datë 19.12.2016 të Bordit të Administrimit
Ndikimi/ Efekti	Mos zbatimi i kuadrit ligjor ka sjellë efekte financiare në pagesën e tre nëpunësve me shumë në administratën e rektoratit si dhe e një pedagogu me kontratë. Administrata e rektoratit ka funksionuar me strukturë të miratuar në kundërshtim me VKM nr.474, datë 16.6.2011.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në përmbushjen e misionit, arritjen e objektivave, rregullave të krijimit, organizimit, drejtimit dhe administrimit, të rishikojë dhe analizojë strukturën organizative dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet në përputhje me përcaktimet e VKM nr.474, datë 16.6.2011, të analizojë ngarkesën

	mësimore të stafit akademik, në të gjitha nivelet e mësimdhënies si dhe të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant të punonjësve akademikë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

Titulli i gjetjes 2: *Pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore.*

Situata:	Për vitin akademik 2016-2017, pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore mbi 30 % deri në 70 %, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe pikën nr. 20, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Në vendim marrje Rektorati i Universitetit, Senati Akademik, Këshilli i Administrimit kanë kapërcyer kompetencat që ju jep legjislacioni i sipër cituar. Marrja e vendimeve me nr. 27, datë 18.10.2016 dhe nr. 75, datë 18.07.2017 nga Senati Akademik, si dhe nr. 9, datë 20.10.2016 nga Këshilli i Administrimit në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, ka sjellë si pasojë kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore (nga 30% deri në 70 %) të pedagogëve efektivë pa miratimin nga MARS. Janë paguar gjithsej 26,266 orë mësimore me vlerë 22,385,780 lekë, nga të cilat Fakulteti i Bujqësisë 3,578 orë në vlerën 3,513,140 lekë; Fakulteti i i Edukimit 7,096 orë, vlera 6,301,850 lekë; Fakulteti i i Ekonomisë 5,790 orë, vlera 5,377,760 lekë; Fakulteti i i Shkencave të Natyrës dhe Humane 9,802 orë, vlera 7,193,030 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe pikën 20 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar.
Ndikimi/ Efekti	Mos zbatimi i kuadrit ligjor ka sjellë si pasojë kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore të pedagogëve efektivë pa miratimin nga MARS, duke shkaktuar efekt financiar në vlerë **22,385,780 lekë** .
Rëndësia	I lartë

Rekomandimi	Institucioni të marrë masa për vitin akademik 2017-2018, pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, të kryhet në përputhje të plotë më kërkesat e akteve ligjore në fuqi dhe vetëm pas marrjes së miratimit nga Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

Titulli i gjetjes 3: *Mbi mos funksionimin e sektorit të auditit të brendshëm*

Situata:	Në strukturën organike të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 12, datë 26.12.2015 dhe nr. 11, datë 19.12.2016, konstatohet se: Universiteti nuk ka krijuar Sektorin e Auditit të Brendshëm si njësi organizative e veçantë, me përbërje 1 punonjës, në pozicionin e përgjegjësit të sektorit dhe dy specialistë.
Kriteri:	ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Ndikimi/ Efekti	Mos ngritja e strukturës së auditimit të brendshëm ka sjellë efekte në mos evidentimin e problemeve nga vetë institucioni në drejtim të menaxhimit, përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në përdorimin me efektivitet dhe eficencë të fondeve publike.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Senati i UFSNK dhe Bordi i Administrimit, të marrin të gjitha masat për ngritjen e strukturës së auditimit të brendshëm, tre specialistë, të cilët duhet të jenë në funksion të përmirësimit të gjendjes menaxheriale të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, me qëllimin e përdorimit efektiv të fondeve publike dhe sigurimin e cilësisë së punës në Universitet.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i gjetjes 4: *Mangësitë në hartimin e PBA*

	Në analizën e zërave buxhetorë konstatohet se, ka një planifikim jo real të shpenzimeve midis Programimit të shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm PBA 2016-2017, planifikimit vjetor dhe çeljes së fondeve*, konkretisht:* - Shpenzime operative, artikulli (602) në PBA janë programuar në vlerën 54,400 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja

Situata:	është në vlerën 64,656 mijë lekë, +10,256 mijë lekë. - Investime, artikulli (231) në PBA është programuar në vlerën 44,202 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja është në vlerën 77,692 mijë lekë, +33,490 mijë lekë. - Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, artikulli (601) është programuar në vlerën 34,618 mijë lekë, ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 40,816 mijë lekë, +4,198 mijë lekë. - Investime, artikulli (230) është programuar në vlerën 1,960 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 2,300 mijë lekë, +340 mijë lekë. - Investime, artikulli (231) është programuar në vlerën 56,720 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 108,980 mijë lekë, +952,260 mijë lekë.
Kriteri:	Ligji nr.9936,datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar; Pika 6 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23 datë 22.11.2016 "*Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA*".
Ndikimi/ Efekti	Planifikimi jo real të shpenzimeve midis Programimit të shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm PBA 2016-2017, planifikimit vjetor dhe çeljes së fondeve ndikon në mos evidentimin në kohë të kërkesave buxhetore, si dhe mosrealizimin në kohë dhe me cilësisë së shërbimeve.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Institucioni të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-ve të sigurojë që, alokimet e buxhetit të reflektojnë prioritetet gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare), duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë midis alokimit të buxhetit dhe objektivave të politikës së programit, si dhe duke përcaktuar qartë prioritetet, objektivat, masat që do të merren për arritjen e këtyre objektivave si dhe kërkesat shtesë për secilin program buxhetor, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar; dhe pikës nr. 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23, datë 22.11.2016 "*Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA*".
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

Titulli i gjetjes 5: *Mangësitë në monitorimin Raportimeve Buxhetore*

Situata:	Raportet vjetore të monitorimit dërguar në Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me realizimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar. Mungojnë argumentet e plota në lidhje më mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre, në kundërshtim me kreun IV "*Monitorimi*", të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, dt. 15.01.2016 "*Për*

	zbatimin e buxhetit të vitit 2016" si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrisë së Financës. Hartimi i PBA-ve për periudhën objekt auditimi ka mangësi në trajtimin e tyre, të tilla si përshkrimi i misionit të njësisë, përshkrimi i programeve dhe veprimtarive të njësisë, paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës së performancës, në kundërshtim me pikën 6, të udhëzimit nr 23, datë 22.11.2016.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar; Pika 33, Kreu IV "*Monitorimi*", i Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22 datë 17.11.2016, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"*
Ndikimi/ Efekti	Hartimi i raporteve të monitorimit i ndihmon për të analizuar argumentet e plota në lidhje më mosrealizimin e zërave dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre,.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore gjatë hartimit të raporteve të monitorimit dhe raporteve periodike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhen ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre. Institucioni të marrë masa për dorëzimin e raporteve 4-mujore të monitorimit në Ministrinë e linjës si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare, referuar Udhëzimit të sipërpërmendur.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 6:	Kontabiliteti nuk është mbajtur sipas parimit të të drejtave të konstatuara

Situata:	Gjatë viteve që janë objekt auditimi, një pjesë e detyrimeve të lindura apo faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera, janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës. Vlera e detyrimit të mbetura pa u likuiduar, nuk është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të kontatuara. Vlerat e këtyre faturave janë likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse, por janë kontabilizuar dhe paraqitur si detyrim dhe në të njëjtën kohë edhe si likuidim i këtij detyrimeve në llogarinë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to". Si rrjedhim efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (*ka ndodhur kur vlerat ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen*) dhe të regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.

	Sa likuiduar në vitin 2016 detyrime të viti 2015 pa i paraqitur si detyrime në bilanc: • Me urdhër-shpenzimin nr.6, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e operatorit ekonomik [redacted] Korçë, për detyrime të muajit dhjetor 2015, në vleftën **154,900 lekë**; • Me urdhër-shpenzimin nr.7, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet për ruajtjen dhe sigurinë fizike të objekteve të kontraktura me operatorin ekonomik [redacted], për detyrime të faturës së lëshuar me nr. 616, datë 31.12.2015, në vleftën **1,140,390 lekë**; • Me urdhër-shpenzimin nr.8, datë 25.01.2016 janë likuiduar faturat e telefonit të ish-Kancelarit për periudhën 1-13 dhjetor 2015 në vlerën **2,420 lekë** dhe për faturat e telefonit të përdorur nga ana e Rektorit të Universitetit, në shumën **3,536 lekë** (likuiduar me Urdhër shpenzimin nr. 9, datë 25.01.2016); • Me urdhër-shpenzimin nr.10, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e internetit për operatorin ekonomik [redacted] për detyrime të lindura me kontratën e nënshkruar dhe sipas faturës me nr. 198017358, datë 16 dhjetor 2015, në shumën **96,000 lekë**; • Me urdhër-shpenzimin nr.14, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e operatorit ekonomik [redacted] Korçë, për detyrime të faturave të lëshuara për energjinë elektrike të konsumuar gjatë muajit dhjetor 2015, (faturat e datës 15 dhjetor, 29, 30 dhe 31 dhjetor), në vleftën e përgjithshme **241,352 lekë**; • Me urdhër-shpenzimin nr.15, datë 15.01.2016 janë likuiduar shpenzimet e operatorit ekonomik [redacted] SHA për detyrime të periudhës 1 dhjetor-31 dhjetor 2015, në vleftën **60,862 lekë**, (fatura e datës 31 dhjetor); • Me urdhër-shpenzimin nr.12, datë 25.01.2016 janë likuiduar shpenzimet postare ndaj [redacted] Korçë, për detyrime të lindura në bazë të faturës nr.1323, datë 31.12. 2015, në vleftën **7,128 lekë**, etj.
Kriteri:	Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", i ndryshuar. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit - Sipas Nenit 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", të Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, pika 13, ku përcaktohet se pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
Ndikimi/ Efekti	Edhe pse sa më sipër nuk ka impakt financiar, kontabiliteti rritës vlerësohet të jetë efektiv për menaxhimin financiar dhe aktivitetet e kontrollit. Mos raportimi mbi baza të kontabilitetit rritës rrezikon të cenojë cilësinë dhe koherencën e ndryshimit të gjendjes pasurore të subjektit të audituar kundrejt krijimit të të drejtave apo detyrimeve financiare, i cili më tej përdoret për qëllime vendimmarrjeje.
Rëndësia	E mesme

Rekomandimi	Nga ana e Drejtorisë së Financës të merren masat që, në mbajtjen e kontabilitetit, të aplikohen në mënyrë të drejtë rregullat kontabël, mbështetur mbi bazën e parimit të kontabilitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe standardeve të zbatueshme për mbajtjen e kontabilitetit mbi baza monetare. Në këtë mënyrë, pasqyrat financiare përmbushin objektivat e tyre për informimin e përdoruesve, jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë trajtë, ato do të paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara, të cilat u shërbejnë të tyre në marrjen e vendimeve ekonomike të arsyetuara.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 7:	Në kontabilitet është regjistruar vlera e ndërtesave të 11,791,000 lekë, e cila paraqet vlerën e godinës së "Bazës Prodhuese", e cila është transferuar sipas procesverbalit trepalësh, datë 15.04.2015 te Bashkia Korçë për llogari të SHMB "I.Terova".Gjithashtu, në kontabilitet është regjistruar vlera e truallit të objektit "Shtëpia e ushtarakëve", për 576,000 lek, cili është transferuar dhe efektivisht nuk ekzistojnë dhe për rrjedhojë këto regjistrime dëmtojnë treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël.

Situata:	Llogaria 212 "Ndërtime dhe konstruksione" në Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara (aktivi i bilancit) në të dhënat e bilancit të vitit 2017 ka të regjistruar vlerën **11,791,000 lekë**, e cila paraqet vlerën e godinës së "**Bazës Prodhuese"**, e cila sipas procesverbalit trepalësh, datë 15.04.2015 për dorëzimin nga UFSNK dhe marrjes në dorëzim të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra nga Bashkia Korçë dhe përfaqësuesit e SHMB "I.Terova " Korçë ka kryer transferimin e këtyre aktiveve. Pra, kjo vlerë prej 11,791,000 lekë, pasqyron objekte që efektivisht nuk ekzistojnë për periudhën objekt auditimi dhe për rrjedhojë këto regjistrime denatyrojnë treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël të këtij institucioni meqenëse janë transferuar. Nga ana e UFSNK është kryer transferimi dhe artikulli i çregjistrimit nga aktivet e Universitetit për godinën "**Shtëpia e Ushtarakëve**" transferuar tek bashkia e Korçës në bazë të VKM nr. 76, datë 28.01.2015, mirëpo rezulton se ende evidentohet ne kontabilitet vlera e truallit të saj, në vlerën **576,000 lekë.** Sipas pikës nr. 2 të VKM nr. 152, datë 29.02.2016, rezulton se, "VKM nr. 530, datë 7.8.2102 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te MASH për Universitetin "F. S. Noli" Korçë, të pronës nr. 549 me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", i ndryshuar, shfuqizohet". Pra, UFSNK nuk ka asnjë të drejtë pronësore mbi atë truall, për më tepër që ka ndryshuar edhe njëherë përgjegjësinë e administrimit, prandaj evidentimi i kësaj shume në këtë post të bilancit

	nuk është i drejtë, pasi këto objekte i janë kaluar me transferime dhe janë në përdorim nga ana e pushtetit vendor.
Kriteri:	Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006 dhe me ligjin nr. 10110, datë 02.04. 2009; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12. 2011,*"Për menaxhimin e aktiveveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;* UMF nr. 14, datë 28.12.2006, *"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre*", i ndryshuar.
Ndikimi/ Efekti	Vlera e kontabilizuar e ndërtesave së Bazës prodhuese prej 11,7 milionë lekë si dhe vlera e truallit të "Shtëpia e Ushtarakëve" prej 576,000 lek ka ndikuar në mos evidentimin e vlerës reale të gjendjes pasurore të Universitetit të Korçës në llogarinë 212, duke sjellë pasaktësi në pasqyrat financiare.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	1. Administratori i UFSNK të ngrejë një grup pune për të pasqyruar çfarë ka ndodhur me këto objekte, të ndërtojë gjurmën e auditimit për ecurinë e procesit të transferimit të këtyre pronave, duke saktësuar se çfarë është bërë me këto objekte, dhe vetëm pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe pas saktësimit të ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. 2. Drejtoria e Financës të merren masat që të bëjë përmirësimet në plotësimin e këtyre pasqyrave financiare/formateve përkatëse, të kryhen sistemimet në kontabilitet dhe të reflektojë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017, sa kontabilizuar padrejtësisht vlera e truallit te objektit "Shtëpia Ushtarakeve" dhe vlera e godinës së objektit "Baza prodhuese".
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 8:	Nuk është pasqyruar në kontabilitetin e UFSNK vlera e tokës, dhe fondi i tokës në administrim dhe pronësi EDE/UFSNK, nga sipërfaqja prej 59,58 ha në vitin 1991 aktualisht rezulton me një diferencë prej 40,48 ha. Vlerësim jo realist i këtyre trojeve dhe tokave bujqësore krijon riskun e abuzimet me tokat, trojet dhe terrenet që administrohen nga ky institucion shtetëror.

Situata:	Nuk është pasqyruar në kontabilitetin e UFSNK vlera e tokës truall, si dhe fondi i tokës bujqësore në administrim dhe pronësi EDE/UFSNK, e cila nga sipërfaqja prej 59,58 ha e evidentuar në vitin 1991 aktualisht rezulton **me një diferencë prej 40,48 ha**. Vlerësimi jo realist i këtyre trojeve dhe tokave bujqësore krijon riskun e abuzimet me tokat, trojet dhe terrenet që administrohen nga ky institucion shtetëror

	Llogaria 210, "Toka, troje e terrene" është e kontabilizuar për të dy vitet më shumë të njëjtë prej **576 mijë lekë**, mirëpo nuk është e zbërthyer në mënyrë analitike, për argumentimin e sipërfaqeve të përfshira në kontabilitetin e institucionit dhe çmimit të aplikuar për efekt vlerësimi dhe kontabilizimi. Nga kryqëzimi i të dhënave të raportuara nga ana e Universitetit në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës(shkresa nr. 7/20, datë 06.11.2012), në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pronave rezultojnë se për artikujt me nr. 8-13 të Formularit nr.1 për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, ata janë evidentuar me një sipërfaqe prej **21,119 m2, <u>apo 21,1 ha</u>**. Nga ana tjetër, Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE), si njësi që drejtohet nga Fakulteti i Bujqësisë dhe e ngritur me VKM nr.76, datë 20.05.1979, sipas të dhënave të disponuara nga ana e përgjegjësit të EDE, ka në zotërim fondin aktual të tokës prej 18,9 ha, ose 189,000 m2. Konstatohet se, fondi i tokës në administrim dhe pronësi EDE/UFSNK në vitin 1991 ishte në sipërfaqen prej **59,58 ha**, duke rezultuar me një diferencë prej **40,48 ha**, të cilën, strukturat përgjegjëse të Universitetit e arsyetojnë me "*kthime të pronave për ish-pronarët me vendime të KKKP, ndërtimi i autostradës, ndërtime të paligjshme, si dhe pallate banimi dhe terrene sportive, të cilat në tërësi kapin shifrën e mësipërme".* Mungojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që UFSNK ka në dispozicion si dhe bëhet domosdoshmëri përditësimi e azhurnimi i tyre i plotë, përmes matjeve fizike, azhurnimit dhe rakordimit me informacionin e administruar nga zyrat e kadastrës dhe të hipotekës. Për të njëjtën vlerë, ky zë i aktiveve është regjistruar dhe pasqyruar në kontabilitet dhe në pasqyrat e bilancit vjetor kontabël të vitit 2017, (ndonëse gjatë periudhës 2015-2017) ka patur disa transferime nga aktivet e Universitetit për tek Bashkia e Korçës dhe për rrjedhojë ky vlerësim është jorealist që denatyron vlerën e këtyre pronave dhe pasurive shtetërore. Referuar sipërfaqeve të evidentuara mbi tokat dhe trojet në vitin 2012, (shkresa dërguar Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), si dhe fondit të tokës në dispozicion të EDE, krahasuar me vlerësimin e tokës për efekt regjistrimi në bilanc, (ku është evidentuar për vleftën gjithsej 576, 000 lekë), sipërfaqja totale e tokës prej 210,119 m2 që ka UFSNK në dispozicion, (edhe kjo nuk konsiderohet si evidencë përfundimtare), rezulton të jetë vlerësuar me një çmim prej **2,7 lekë/m2** (576,000 lekë: 210,119 m2), gjë që tregon se ky **është çmim dhe vlerësim jo realist dhe që krijon riskun e abuzimet me tokat, trojet dhe terrenet e këtij institucioni shtetëror.** Referuar VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", rezulton se, vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit *"tokë truall"* për qytetin e Korçës, varion midis çmimeve 7,535 lekë/m2 deri në 9,055 lekë për m2, kurse vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit "*tokë bujqësore*" për rrethinat dhe fshatrat e Korçës, është me çmimin 100 lekë për m2.

	Për sa sipër, **a.** Nga përllogaritjet për tokën truall me sipërfaqe 21,119 m2, llogaritur me çmimin më të ulët për zonën kadastrale në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 prej 7535 lekë/m2, rezulton vlera 159,131,665 lekë ; **b.** Nga përllogaritjet për fondin aktual të tokës bujqësore në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016, për 189,000 m2 sipas çmimit më të ulët për zonën kadastrale të rrethinave prej 100 lekë/m2, rezulton vlera 18,900,000 lekë. Si përfundim, për të dy kategoritë, në total vlera minimale që duhej kontabilizuar për toka, troje e terrene duhet të ishte për 178,031,665 lekë, shifër kjo e konsideruar materiale për auditimin dhe dhënien e opinion mbi pasqyrat financiare, nga 576,000 lekë sa pasqyruar në bilanc, me një diferencë prej 177,455,665 lekë. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale.
Kriteri:	VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", referuar: • Vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit "tokë truall" për qytetin e Korçës, kjo vlerë varion midis çmimeve 7,535 lekë/m2 deri në 9,055 lekë për m2. • Vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit "tokë bujqësore" për rrethinat dhe fshatrat e Korçës, kjo vlerë është me çmimin 100 lekë për m2.
Ndikimi	*Për sa sipër,* **c.** Nga përllogaritjet për tokën truall 21,119 m2 x çmimin më të ulët për zonën kadastrale në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 prej 7535 lekë/m2 = 159,131,665 lekë ; **d.** Nga përllogaritjet për tokën bujqësore për fondin aktual të tokës bujqësore në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016, për 189,000 m2 x çmimin më të ulët për zonën kadastrale të rrethinave prej 100 lekë/m2 = 18,900,000 lekë. Për të dy kategoritë, në total vlera minimale që duhej kontabilizuar për toka, troje e terrene duhet të ishte për 178,031,665 lekë, shifër kjo e konsideruar materiale për auditimin dhe dhënien e opinion mbi pasqyrat financiare, nga 576,000 lekë sa pasqyruar në bilanc, me një diferencë prej 177,455,665 lekë.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	8.1.Administratori i UFSNK të ngrejë një grup pune për identifikuar me planimetri dhe genplane sipërfaqet e tokës truall të UFSNK si dhe tokës bujqësorë në funksion të Ekonomisë Didaktike Eksperimentale (EDE) dhe pas saktësimit të sipërfaqeve dhe vlerave nga ekspertet e fushës, të ndërmarren veprimet e nevojshme të regjistrimit në kontabilitetin, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. Për t të informohet Bordi i Administrimit të Universitetit. 8.2.Bordi i Administrimit të analizojë dhe mbikëqyrë në vijimësi rregullshmërinë e procedurave të ndjekura nga ana e komisioneve të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve që do të

	ngrihen nga Administratori si dhe të miratojë rezultatet e procesit.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vijimësi

Titulli i gjetjes 9 *:* Në llogarinë e AQPT janë përfshirë parregullsisht dhe elementë që nuk i plotësojnë kriteret për ti klasifikuar si të tilla, si fletëpalosje, monografi, postera, broshura, pyetësor, baner, programe konference, botime artikujsh shkencor, etj. Për pasojë, regjistrimi i këtij artikulli kontabël mbart pasaktësi, pasi aktivitetet promovuese të këtij karakteri nuk konsiderohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara.

Situata:	Nga analiza e llogarisë 202 " Studime dhe kërkime", rezulton se aty është përfshirë vlera bruto e studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 16,9 milionë lekë dhe 16,1 milionë lekë (vitet 2025 dhe 2016). Për këtë vlerë nga ana e degës së financës janë kryer dhe llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara. Nga shqyrtimi i të dhënave analitike, rezulton se nën llogaria 202 "Studime e projektime" ka të detajuara këto artikuj: Dollap arshive, 30,000 x3=90,000lekë; Pajisje laboratori për analiza= 1,515,500 lekë, Soft informatikë, 98,500 lekë. Gjithsej: 1,704, mijë lekë.Duke shtuar dhe vlerën sipas urdhër shpenzimeve nr. 322 e 323 prej 41,400 lekë dhe 37,800 lekë, vlera totale arrin në 1,783,200 lekë **Diferenca prej 16,161,131 lekë – 1,783,200= 14,377,931 lek, është e pa justifikuar në mënyrë të detajuar ngase ajo përbëhet.** Në këtë llogari të AAJM janë përfshirë parregullsisht dhe elementë të inventarit, që nuk i plotësojnë kriteret për t'i klasifikuar si AQPT, por në fakt janë elemente inventari si dollapë, pajisje laboratori, etj. rezulton se në këtë llogari janë përfshirë dhe parregullsisht elementë që nuk i plotësojnë kriteret për ti klasifikuar si AQPT, elemente që janë kontabilizuar në llogarinë 202 të tilla si fletëpalosje, monografi, postera, broshura, pyetësor, banera, programe konference, botime artikujsh shkencor, etj. Për pasojë regjistrimi i këtij artikulli kontabël mbart pasaktësi pasi aktivitetet promovuese të këtij karakteri nuk konsiderohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara. Grupi i auditimit sjell në vëmendje se, në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 60, i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "AAGJM dhe AAGJJM", Gjithashtu, nga shqyrtimi i përshkrimeve të këtyre ato paraqiten në këtë llogari janë regjistruar Kite laboratorike, (përkatësisht, 3 fletëdalje për pedagogë të Universitetit në vlerën e përgjithshme prej 275,616 lekë).
Kriteri:	VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", paragrafit nr. 60, i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "AAGJM dhe AAGJJM",
Rëndësia	Mesme

Rekomandimi	Dega e Financës të analizojë me përgjegjësi elementet e Aktiveve të Qëndrueshme të Patrupëzuara (AQPT ose AAGJJM), të identifikojë zërat analitike që klasifikohen si të tilla dhe të kryejë sistemimet e nevojshme në kontabilitetin dhe pasqyrat financiare që do të mbyllen në fund të vitit 2018.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

Titulli i gjetjes 10: Nga ana e UFSNK nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast.

Situata:	Pronat e Universitetit të Korçës, në vlerën 333,639 mijë lekë, (të tilla sipas pasqyrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2017, për zërin "ndërtesa", në vlerën 316,4 milionë lekë; "rrugë, rrjete e vepra ujore" në vlerën 16,7 milionë lekë, si dhe zëri "toka, troje e terrene" në vlerën 576 mijë lekë), nuk janë të regjistruara në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe për to nuk zotërohet certifikatë pronësie. Në kushtet që nga ana e UFSNK nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme". Nga ana e UFSNK nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast,
Kriteri:	VKM nr. 500, datë 14.08.2001"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar;ligji nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	1.1.Administratori i Universitetit, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. 1.2.Të riaplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017, duke përfshirë dhe efektet e situacionit prej 46,748 mijë lekë që reflekton vlerën e rikonstruksionit

	të objektit "Konvikti i shkollës mekanike", nën administrim të UFSNK, por për të cilin nuk janë kryer procedurat e transferimit nga kontabiliteti i Bashkisë së Korçës
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 11: Mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimeve fizike të aktiveve si dhe mos finalizimi i plotë i procesit të inventarizimit në të gjitha rastet me miratimet e titullarit dhe raportet përmbledhëse.

Situata:	Mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimeve fizike të aktiveve si dhe mos finalizimi i plotë i procesit të inventarizimit me miratimet e titullarit dhe raportet përmbledhëse. Për periudhën 2015-2017 procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit, si dhe asgjësimi janë kryer radhazi nga të njëjtët komisione, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", si dhe paragrafin nr. 84, të UMF nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, që shpreh se, "*Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision"*. Në listën e artikujve të propozuar nga Komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit rezultojnë disa artikuj dhe vlera materiale (artikuj magazine), të nxjerra jashtë përdorimit në sasi dhe vlerë të konsiderueshme, për të cilat nuk është kryer asnjë analizë dhe nxjerrje përgjegjësie si vijon: - Për v.2015 janë nxjerrë jashtë përdorimit kompjuterë, fotokopje, projektorë, etj me një vlerë të përgjithshme prej **1,371,491 lekë,** pa dhënë asnjë shpjegim mbi vitin e prodhimit/ blerjes, mbi faktin nëse mund të riparohen, pa kryer analiza mbi nivelin e amortizimit, çfarë është dëmtuar, etj. Pra, në shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi, janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit dhe janë asgjësuar kompjuterë, laptop dhe minilaptop dhe video projektorë, të blerë gjatë periudhës 2011-2015, duke krijuar shumë dyshime mbi një proces të drejtë e të ndershëm të vlerësimit dhe asgjësimit të këtyre aktiveve. - Referuar dokumentacionit të fletë inventarizimeve dhe procesverbaleve të administruara për këtë periudhë, rezulton se për inventarizimin e vlerave materiale në UFSNK për 6 raste, janë nxjerrë jashtë përdorimit 19 copë pjata argjendi dhe 6 medalje ari, me vlerën gjithsej **192 mijë lekë**, ku në kundërshtim me përcaktimet ligjore, komisioni ka vënë shënimin se këta materiale tërhiqen nga titullarët dhe dhurohen në raste vizitash apo aktivitete të përfaqësuesve të huaj dhe propozohen për jashtë përdorimi. - Referuar procesverbalit të mbajtur me datën 28 shkurt 2015 në mjediset e Rektoratit, në llogarinë 218, në kolonën e emërtimit është vënë zëri "Instalim fizik konfigurimi", në vlerën **696,000 lekë**, dhe propozuar për t'u nxjerrë jashtë përdorimit, me shënimin "punë, projekt".

	Nga shqyrtimi i procesverbalit për vlerësimin (28.2.2015) është propozuar "nxjerrja jashtë përdorimit" nga llogaria nr.218 me shënimin "punë/projekt" dhe me datën 20 prill 2015, në kuadër të artikujve të nxjerrë jashtë përdorimit është përfshirë dhe artikulli "instalim fiik konfigurimi", në shumën 696,000 lekë, ku në kolonën e destinacionit është vënë shënimi "u groposën". Nuk ka asnjë shpjegim, se çfarë përfshin ky zë dhe cilat janë arsyet e fshirjes së tij nga kontabiliteti. Si mangësi thelbësore për realizimin e këtij inventarizimi rezulton se komisioni nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar për sa ka propozuar komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë. Për daljet jashtë përdorimit të aktiveve dhe vlerave të inventarit për vitin 2017, në shumën **4,873,048 lekë** mungon miratimi nga ana e Bordit të Administrimit, për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisioni i vlerësimit sipas procesverbaleve që janë hartuar nga ana e komisioneve respektive. Në asnjë nga vendimet dhe mbledhjet e Bordit të Administrimit të kryera gjatë vitit 2017 nuk është trajtuar kjo çështje. Sa sipër, është vepruar në shkelje të përcaktimeve të UMF nr.30, 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Procesverbalet e vlerësimin nuk janë miratuar nga titullari i njësisë publike UFSNK, në shkelje të përcaktimeve të paragrafit nr. 105, kreu IV të Udhëzimit të MF me nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, që përcakton se, "Procesverbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga titullari i njësisë publike".
Kriteri:	ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, dt. 26.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet.
Ndikimi/ Efekti	Si rezultat i mos kryerjes të plotë të inventarizimeve fizike të aktiveve si dhe mos finalizimi i plotë të atyre të kryera shkelet parimi themelor kontabël. Procesi i inventarizimit të aktiveve është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë shpenzuese, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, që kryhet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Njësisë Shpenzuese
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	11.1.Nga strukturat përgjegjëse, që menaxhojnë këto aktivitete të administrimit material (Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues), të kryhet një proces i kujdesshëm inventarizimi, shoqëruar gjithashtu me vlerësimin rast pas rasti të aktiveve për t'u nxjerrë jashtë përdorimit si dhe për sistemimin e diferencave. Nëpunësi Autorizues me mbylljen e rezultateve të inventarizimeve të aktiveve detyrimisht duhet të lejë gjurmë për mbikëqyrjen e procesit dhe miratimin e procedurave deri në veprimet përkatëse të sistemit të diferencave apo kryerjes së veprimeve

	përkatëse për materialet që janë jashtë përdorimit. 11.2.Bordi i Administrimit, në përmbushje të përgjegjësive menaxheriale që rrjedhin nga neni 28 i Statutit të UFSNK, miratuar me Urdhrin nr.56, datë 08.02.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të marrë masat për analizimin dhe mbikëqyrjen e plotë të këtij procesi, bazuar në ndjeshmërinë dhe riskun e lartë që kanë aspektet e administrimit material.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vazhdimësi

Titulli i gjetjes 12 : Në UFSNK nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit.

Situata:	Nga auditimi konstatohet nga UFSNK gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive. Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit nga ana e personave te caktuar nga UFSNK për asgjësimin e këtyre materialeve ***nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit*****,** si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj. të shoqëruar me fotot përkatëse, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve të asgjësuara, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*. Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve, nuk kanë përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e inventarëve duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*.
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, dt. 26.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	1.1.- Nga ana e strukturave përgjegjëse të Universitetit "Fan S.Noli" të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, evidentimin e vend ndodhjes dhe groposjes së tyre, djegien, etj., shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar në mënyrë rigoroze procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve, në përputhje me UMF nr. 30, datë

	27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*. 1.2.- Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë e në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 13: Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në praktikë nga drejtuesit e programeve buxhetore.

Situata:	Nga auditimi u konstatua se, rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë praktika pak të zhvilluara në praktikë. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i "Menaxhimit të Riskut" dhe vendosja e kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e Universitetit të Korçës. Ndonëse janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, mungon monitorimi i kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. Në Universitetin e Korçës është hartuar regjistri i riskut ku janë evidentuar risqet para kontrollit dhe përcaktuar zotëruesit e këtyre risqeve. Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e risqeve dhe plani i veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 8/a, 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/ 2010. Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, konstatojmë se nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër përcaktohet në këtë udhëzim. rezulton se në institucionin e UFSNK, nuk ka patur në vitin 2016 regjistër të risqeve dhe nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një strategji me planin e veprimit për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni. *Konstatohet se:* 1. Ky dokument nuk është hartuar për vitin 2015 dhe 2016, është hartuar për v.2017 dhe nuk është dokument i protokolluar dhe tu jetë komunikuar degëve apo sektorëve. 2. Nuk janë pjesë e këtij regjistri aktivitet që realizon Sektori Juridik, Njësia e prokurimit, problemet e brendshme të vlerësimit të cilësisë, (Sektori i Kurikulave dhe Vlerësimit Institucional), etj., për kërcënimin e objektivave themelore dhe angazhimeve të marra

	përsipër. 3. Regjistri nuk identifikon shkallën e risqeve para dhe pas kontrolleve, por thjeshtë pasqyron monitorimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. 4. Nuk i janë dërguar kopje të tij MAS dhe MF . 5. Nuk parashikohet niveli i ri i risqeve pas aplikimit të kontrolleve, referuar programit buxhetor afatmesëm, etj.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar).
Ndikimi	Kërcënohen arritja e objektivave të institucionit
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	13.1Administratori i UFSNK të marrë masa që të plotësohet regjistri i riskut me të gjithë sektorët, fakultetet dhe aktivitetet, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin**.** 13.2.Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të azhornojë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut së bashku me planin e veprimit për arritjen e objektivave të programit, e cila të përditësohet rregullisht (çdo tre vjet), ose kur në mjedisin e institucionitt ndodhin ndryshime të rëndësishme
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 14:	Mungesa e planit të trajnimeve dhe e hartës së proceseve të punës në Institucion
Situata:	Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia arsimore vendore nuk disponon plane të trajnimeve dhe mungon një data-base mbi trajnimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikës nr. 3/1, nën çështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016. Nga auditimi u konstatua

	se, nga UFSNK nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të në drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe eficencës së punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë menaxhuese. U verifikua zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, mbi përgatitja e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se, ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së <u>përshkrimit të proceseve të punës</u>. Jo vetëm kaq, por përshkrimi i procesit të punës <u>konfondohet me përshkrimin e pozicionit të punës</u>. Për të bërë të mundur që çdo institucion të përgatisë manualin e proceseve të punës. struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave ka përgatitur dhe një format standard për të asistuar institucionet për ta realizuar këtë proces në vazhdimësi. Gjatë vitit 2015 - 2017, referuar të dhënave mbi realizimin e treguesve të buxhetit, të UFSNK, rezulton sa më poshtë vijon: • për vitin 2015 janë programuar për trajnime e seminare (llogaria 602011) shuma prej 100,560 lekë dhe janë realizuar vetëm 19,020 lekë, ose 18.9 % e kësaj shume; • për vitin 2016 janë programuar për trajnime e seminare (llogaria 602011) shuma prej 880,000 lekë dhe janë realizuar vetëm 19,020 lekë, ose 2% e saj; • për vitin 2017 janë programuar për trajnime e seminare (llogaria 602011) shuma prej 200,000 lekë dhe janë realizuar vetëm 173,520 lekë, ose 87% e saj.
Kriteri:	Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".
Ndikimi/Efekti	Trajnimi dhe kualifikimi synojnë që të përgatisin punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandimi	14.1.Nga Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me MASR, të merren masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartohen dhe kryhen trajnime dhe seminare nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht mbi aspektet e analizës së menaxhimit të riskut, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve në dispozicion, prokurimin

	publik elektronik, si dhe aspekte të tjera. 14.2.Të sigurohet pjesëmarrja në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, drejtuesve të fakulteteve si dhe specialistëve të tjerë. 14.3.Nga drejtuesit e Universitetit të përgatitet manuali i proceseve të punës, bazuar në modelimin dhe formatet standarde të lëshuara nga struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave, për të asistuar institucionet dhe realizuar këtë proces
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 15:	Nuk janë miratuar përshkrimet e pozicioneve të punës dhe vlerësimet vjetore për çdo punonjës
Situata:	Nga sa më sipër, nga zyrtarët e UFSNK si institucion i administratës shtetërore dhe e rregulluar me dispozitat e Kodit të Punës, nuk janë hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e punës, sipas afateve të përcaktuara në aktin nënligjor. *Konstatohet se:* 1. Ka një ndarje dhe ndjekje të detyrave sipas pozicionit të emërimit të çdo punonjësi. 2. Nuk janë hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet dhe personat, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Grupi i auditimit analizoi se si është pasqyruar ky fakt në pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2016 dhe 2017, (Komponenti "Mjedisi i Kontrollit", nën komponenti "Politikat dhe praktikat BNJ" dhe rezulton se është vlerësuar me 3 pikë, duke e konsideruar të realizuar këtë proces, gjë që tregon se vetëvlerësimi për disa zëra nuk është realist dhe i mbështetur. 3. Nuk ka një inventarizim të dosjeve të personelit me gjithë sistemin dokumentar përbërës; 4. Mungon vlerësimi i performancës në punë te çdo punonjësi, që të shërbejë për efekt promovimi dhe ngjitje në karrierë; 5. Në Rregulloren e brendshme vetëm janë vendosur në formë të përgjithshme detyrat e çdo dege, ku brenda së cilës mund të jenë përfshirë sektorë dhe qendra me detyra dhe përbërje të ndryshme , por ka vetëm një përshkrim shumë të përgjithshëm të detyrave të degës, pa i precizuar ato sipas personave përgjegjës.
Kriteri:	VKM nr. 142, datë 12.3.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të ndryshuar Pika 3.3, e manualit të MFK, (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016), mbi përgatitjen e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës

Ndikimi/ Efekti	Paqartësia në ndarjen e roleve dhe përgjegjësive të aktorëve në kuadër të proceseve të kontrollit të brendshëm, krijon konfuzion dhe mbivendosje të tyre.
Rëndësia	I Mesëm
Rekomandimi	Rektori i Universitetit, Administratori dhe Njësia përgjegjëse për menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të koordinojë veprimet për të hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës, akteve të dala në zbatim të tij si dhe VKM nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" .
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë
Titulli i Gjetjes 16:	Kuadri nënligjor dhe aktet normative themelore për organizimin dhe mirëfunksionimin e Universitetit të Korçës , të tilla si Statuti i Universitetit dhe rregullorja e degëve, sektorëve dhe administratës së rektoratit, janë hartuar në referencë te legjislacionit të vjetër e të shfuqizuar, si dhe janë konstatuar vonesa të pajustifikuara në zhvillimin e procedurave për miratimin e dokumenteve të reja dhe ngritjes se organeve të funksionimit të Universitetit, në përputhje më kërkesat e ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".Rregullorja e brendshme e institucionit nuk është përditësuar
Situata:	Rregullorja e brendshme e funksionimit të degëve, sektorëve, administratës së UFSNK, është miratuar me Vendimin nr.13 të Senatit Akademik, datë 30.03.2009, ku përcaktohen dhe trajtohen misioni, qëllimi, përbërja e degëve, veprimtaria, kompetencat, organizimi i sektorëve, bibliotekës, dhe kriteret e rregullat e disiplinës së punës, etj. Në rregullore duhen evidentuar detyrat specifike për çdo pozicion të punës si detyrat dhe përgjegjësitë e titullarit, përgjegjësit të sektorit duke specifikuar të ndara dhe detyrat e çdo specialisti për sektorët e veçantë. Në referencë të ligjit nr.9741/2007, është hartuar dhe miratuar rregullorja e brendshme, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore për çdo sektor, sipas strukturës dhe organikës së institucionit, në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Por, konstatohet se, në këtë akt, nuk janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në fushën e menaxhimit të financave, kontrollit të brendshëm financiar publik, etj. Duke analizuar përmbajtjen e ligjit që rregullon fushën e arsimit universitar, si dhe rregulloren e brendshme të institucionit, konstatohet se UFSNK ka funksionuar mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore si dhe të strukturave, të cilat nuk janë sjellë në koherencë me legjislacionin e sistemit buxhetor dhe ligjin organik që rregullon funksionimin e tyre, ligjin nr. 80/2015. **1**. Këto akte nuk janë në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr.

110/2015, datë 15.10.2015. Këto akte nuk janë të harmonizuara midis tyre edhe për faktin se, Statuti dhe Rregullorja janë hartuar në bazë dhe në detyrim të ligjit nr. 9741/2007, që është dispozitë e shfuqizuar.

2. Statuti i universitetit, si dokumenti ku rregullohen normat kryesore të veprimtarisë akademike e administrative për këtë institucion shtetëror, ka përfshirë deri më 31.12.2017 emërtesa dhe funksione administrative të rëna nga fuqia ligjore. Kështu, mund të përmendim:

- Në nenin nr.8 të Statutit, ku trajtohen Fakultetet, ato janë renditur: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore e Humane, Filiali i Universitetit "Fan S. Noli", në Pogradec", (që në fakt është mbyllur sipas Urdhrit të ministrit të MAS me nr. 440, datë 12.11.2014, "Për mbylljen e filialit të Universitetit "F.S.Noli" Korçë në qytetin e Pogradecit").
- Në nenin nr.12 të Statutit, ku trajtohen organet drejtuese dhe administrative të Universitetit, janë shënuar Senati, Rektorati, Këshilli i Profesorëve dhe Këshilli i Administrimit, institucion i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015.
- Në nenin nr.12 të Statutit, ku trajtohen organet drejtuese përcaktohet se, Këshilli i Administrimit përbëhet nga nëntë anëtarë, ndërsa në përcaktimet e nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, është përcaktuar se *"Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga* shtatë anëtarë*, të punësuar me kohë të pjesshme."*.

Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë ka miratuar Statutin e ri te UFSNK me Urdhrin nr. 65, datë 08.02.2018.

a. Rregullorja e degëve dhe sektorëve në rektorat është e vitit 2009 dhe nuk është përditësuar me normat dhe dispozitat e reja ligjore në fuqi.

Në nenin nr.13 të rregullores për degët, sektorët dhe administratën, ku trajtohen detyrat e Degës Ekonomike, janë shënuar referenca të dispozitave ligjore të shfuqizuara, si të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", shfuqizuar nga ligji nr. 10296/2010, etj.

Nuk është miratuar nga Bordi i Administrimit rregullorja financiare dhe ajo për shpërndarjen e të ardhurave.

Në kuadër të funksionimit të Bordit të Administrimit, vërehet se nuk kanë gjetur zbatim detyrimet që burojnë nga përcaktimet e nenit 49, germa "e" dhe "f", në bazë të të cilave, Bordi miraton rregulloren financiare të institucionit si dhe përcakton rregullat mbi shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë,

e) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar);
Ndikimi/Efekti	Mos rishikimi dhe miratimi i ndryshimeve në rregulloren e brendshme mbart risqe që lidhen me mos reflektimin e ndryshimeve të ndodhura në legjislacion si dhe përcaktimin e rregullave dhe detyrave të hollësishme që burojnë në kuadër të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të ndryshme të punës.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Të merren gjithë hapat për rishikimin dhe përditësimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm të strukturave si pjesë e rektoratit dhe me gjerë, duke mbajtur në vëmendje faktin se janë krijuar drejtoritë e reja dhe është miratuar sipas organigramës krijimi i njësisë së auditimit të brendshëm, të cilat duhet të gjejnë reflektim në këtë dokument që duhet miratuar nga Senati Akademik, referuar nenit 12 të Statutit në fuqi. Senati Akademik i Universitetit të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e rregullores në përputhje me ndryshimet që ka pësuar
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i gjetjes 17: Shkelje dhe veprime me risk fiktiviteti, në blerjen e librit për fondin e bibliotekës së Universitetit, për vlerën **5 milionë lekë.**

Situata:	Shkelje dhe risqe të veprimeve me risk fiktiviteti në blerjen e librit për fondin e bibliotekës së Universitetit, për vlerën **5 milionë lekë.** Me urdhër shpenzimin nr. 349, datë 29.12.2016, është kryer likuidimi faturës tatimore të shitjes me nr. 784, datë 20.12.2016 për subjektin privat "[redacted]" SHPK në shumën **4,848,370 lekë.** Në përshkrimin e kësaj fature, (bërë hyrje në UFSNK me nr. 90, date 28.12.2016) sipas urdhrit të prokurimit me nr. 88, datë 28.10.2016, me fond limit **5,000,000 lekë pa TVSH**, me procedurën "Kërkesë për propozim". Njësia e prokurimit sipas procesverbalit të datës 28.10.2016, vendosi të ftojë për të marrë pjesë në tender të paktën pesë operatorë ekonomikë, aktiviteti i të cilëve ka lidhje me këtë objekt prokurimi. Njoftimi i tenderit dhe formulari i njoftimit të kontratës së datës 22.11.2016 është botuar në buletinin e APP datë 30 nëntor 2016, ku operatori "[redacted] sipas raportit përmbledhës të hartuar nga Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, është shpallur fitues për vlerën 5,000,000 lekë, **duke e konsideruar "çmimi më i ulët"….**Në cilësinë e titullarit të AK, raporti përmbledhës është miratuar nga Kancelari i UFSNK. Kontrata për furnizim të mallrave është lidhur dhe nënshkruar me datën 24.11.2016 midis kancelarit dhe përfaqësuesit të autorizuar të "[redacted]". *Konstatimet:*

	5. Çmimi total i ofertës financiare të paraqitur në kuadër të kërkesës për propozim, nga ana e operatorit të vetëm pjesëmarrës është në shumën 5,000,000 lekë pa TVSH, (ose **kjo e barabartë me 100 % të vlerës së fondit limit sipas urdhër prokurimit**). Po kështu, vlera e kontratës së nënshkruar nga OE me AK është në të njëjtën shumë prej 5,000,000 lekë, (**ose e barabartë me 100 % të fondit limit**). **6.** Nga ana e AK nuk ka gjetur zbatim pika nr.4, e Nenit 39, "Kërkesa për propozim" e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku specifikohet se: *"Ne çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.* "Nuk ka asnjë argumentim nga ana e NJP **përse janë ftuar dy shtypshkronja dhe si mund të ofronin ato këtë nomenklaturë kaq të shtrirë të titujve të teksteve, kur një pjesë e madhe e tyre sigurohen nga ente prodhuese të huaja.** 7. **Fatura tatimore e lëshuar nga subjekti privat, për palën e UFSNK është nënshkruar nga kancelari znj.** [redacted] e cila është njëkohësisht në cilësinë e titullarit të AK, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014. **8.** Në DST janë listuar dhe kërkuar të prokurohen 607 tituj librash, të cilat janë bazuar në listat e "Kërkesave për botime për fondin e bibliotekës së fakultetit", të nënshkruara nga ana e dekanëve të fakulteteve. Nga ana e Fakulteteve nuk janë dërguar vetëm lista e titujve të librave që u nevojiten, por krahas janë shënuar sasitë, çmimet dhe vlerat e tyre. **Grupi i auditimit të KLSH vëren se, çmimeve të vendosura nga dekanët dhe ato të vënë në ofertën e vetme/ fituese të paraqitura nga operatori ekonomik si në tituj, sasi, çmimet për njësi dhe në vlerë janë absolutisht të njëjta. Ky fakt krijon premisa për risk dhe procedura jorealiste të këtij prokurimi.** 9. Nuk është respektuar furnizimi me 607 tituj të librave të prokuruar, për të cilin OE ka fituar të drejtën e furnizimit në vlerën 5,000,000 lekë, **por ka furnizuar 596 tituj ose 11 tituj më pak duke mos realizuar kontratën për 151,630 lekë, (vlera e faturës është 4,848,370 lekë).** Ky fakt **nuk është evidentuar nga Komisioni i marrjes në dorëzim të librave**, por është shënuar se "mbas verifikimit të librave dhe krahasimit me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, rezultoi se librat e dorëzuara sipas faturës nr. 784, datë 20.12.2016 janë dorëzuar në përputhje me të gjitha specifikimet teknike dhe përcaktuara nga AK dhe konform kushteve të kontratës" dhe ky mosveprim i ngarkon ato me përgjegjësi. Gjithashtu, një numër titujsh janë ndryshuar me synimin për të siguruar botime më të fundit, por këto veprime nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe DST. Nga Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave këto fakte nuk janë pasqyruar në asnjë procesverbal, duke treguar se ky akt marrje në dorëzim është dokument formal.

Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", me ndryshimet; dispozitat e prokurimit publik.
Ndikimi/ Efekti	Ekziston mundësia për veprime të paracaktuara dhe në shmangie të konkurrimit të drejtë e të ndershëm.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga UFSNK, të analizohet, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për veprimet dhe parregullsitë e konstatuara.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i gjetjes 18: *Në disa raste* kërkesat për kualifikim apo certifikatat e kërkuara nga AK janë *ekzagjeruara dhe jo në raport të drejtë me objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për trajtim jo të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur.*

Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik në Universitetin "Fan S.Noli" konstatohet se, kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në disa procedura të kryera, ose nuk kërkohen , dhe në disa procedura të tjera, kërkesat për kualifikim apo certifikatat të cilat kërkohen janë ***tejet të ekzagjeruara dhe jo në raport të drejtë me objektin e prokurimit duke krijuar kushte për trajtim jo të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit*** *dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik,* veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 29.12.2006, neni 23 "Specifikimet teknike". Gjatë auditimit është konstatuar se, NJP në rastet kur ka marë përsipër hartimin e specifikimeve teknike për mobiljet dhe orenditë, (referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje), nuk argumentohet se cilit standardi teknik i referohen, nëse ka një parashikim nga arkitekti i miratuar nga titullari, mbi një projekt ide mbi mobilimin e ambienteve, etj. Hartimi i këtyre specifikimeve nga NjP kur në përbërje të tij mungon specialisti i fushës është në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik", i ndryshuar, (neni 61, pika 1 dhe 2). Gjithashtu, konstatohet se komisionet e ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike për pajisjet elektronike, apo makineri, mobileje etj, (pra për një objekt specifik prokurimi), në shumicën e tyre nuk kanë në përbërje të tyre specialist të fushës përkatëse, si inxhinier elektronik ose informatik, arkitekt, mekanik sipas objektit që prokurohet, veprime

	këto në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar , (neni 61, pika 1 dhe 2).
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 29.12.2006, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29/12/2006 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga Universiteti "Fan S. Noli", duke respektuar frymën e ligjit për prokurimin publik, i cili kërkon krijimin e kushteve për trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe kërkesat specifike për kualifikim mos të shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, të merren masa në vijimësi që kriteret dhe specifikimet teknike të vendosura nga NJP të krijojnë kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë ofertuesve. Në çdo procedurë prokurimi, kërkesat për kualifikim apo certifikatat të cilat kërkohen të jenë në raport të drejtë me objektin e prokurimit dhe në përputhje me Nenin 23, "Specifikimet teknike", të Ligjit nr. 9643, datë 29.12.2006, i ndryshuar.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i gjetjes 19: *Parregullsi e mangësi në zbatimin e dispozitave ligjore për mbikëqyrjen dhe ndjekjen e kontratave.*

Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, gjatë verifikimit të dokumentacionit ligjor konstatohet se, në dy procedurat e prokurimit me objekt ***"blerje karburanti për kaldaja"*** dhe ***"automjete"*** të realizuara në vitin 2016 dhe vitin 2017 <u>në fazën e zbatimit të kontratës</u> nga ana e AK nuk janë ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në nenin 56 dhe nenin 77, pika 1-4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Në dosje mungon urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës për Lotin II për "***blerje karburanti për automjetet".*** Proces verbalet e mbajtura gjatë dorëzimit të mallit për Lotin e I nuk janë mbajtur në formën e kërkuar nga ligji, si dhe nuk janë në inventarin e dosjes së tenderit si pjesë integrale e saj. Mungon nënshkrimi i magazinieres kur janë marrë në dorëzim. Mungon raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës dhe kontrata është e pa protokolluar.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 29.12.2006, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29/12/2006 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Nga ana e titullarit të Universitetit të merren masa në vijimësi që, në procedurat e prokurimit që do të realizohen, të respektohen dispozitat ligjore të prokurimit publik lidhur me ngritjen e komisionit për

	mbikëqyrjen e kontratave në të gjitha rastet e procedurave të prokurimit, (kjo si për mallra ashtu dhe për punime e shërbime); të dokumentohen procedurat dhe hartohen procesverbalet gjatë dorëzimit të mallit, si dhe të përgatitet raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit në formën e kërkuar nga akti nënligjor për prokurimin publik.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi

Titulli i gjetjes 20: *Nuk janë ngritur komisionet për shqyrtimin e ankesave të karakterit teknik*

Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Rikonstruksioni i godinës së ish-Konviktit të Shkollës Mekanike"*** në vitin 2017 u konstatua se, nga ana e Administratorit të Universitetit, për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga OE pjesëmarrës në tender, është ngarkuar një specialiste finance, e cila nuk mund të shqyrtojë një ankesë për kriter të natyrës teknike (kriteret e veçanta të DST), pasi kërkohen njohuri profesionale të veçanta nga ana inxhinierike.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 29.12.2006, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29/12/2006 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa në vijimësi nga strukturat përgjegjëse të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë që, në procedurat e prokurimit që do të realizohen në të ardhmen të respektohen përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, duke ua ngarkuar specialistëve të fushës shqyrtimin e ankesave si dhe të ngrenë komisione për shqyrtimin e ankesave të natyrës teknike.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi

Titulli i gjetjes 21 : *Mbi parregullsitë në argumentimin dhe llogaritjen e fondit limit gjatë procedurave të prokurimit të fondeve.*

Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik në Universitetin "Fan S.Noli", konstatohet se, argumentimi dhe llogaritja e fondit limit nuk rezulton të jetë kryer në respektim të kërkesave të nenit 59, të ligjit për prokurimin publik, pasi nuk ka ndjekur asnjë nga hapat e përcaktuara në të. Në fondin e prokuruar, njësia e prokurimit nuk ka të argumentuar mënyrën se ku është bazuar në marrjen e çmimeve për llogaritjen e fondit limit, nuk ka asnjë referencë mbi çmimet e tregut, apo çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë intitucioni apo nga autoritete të tjera kontraktore, nuk janë marrë të dhëna nga organet statistikore, organet doganore dhe referencat të ndryshme

	ndërkombëtare, dhe analiza kostosh duke bërë që fondi limit të mos jetë real.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 29.12.2006, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29/12/2006 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga strukturat përgjegjëse të Universitetit "Fan S.Noli" në përmbushje të nenit 59, të Ligjit për prokurimin publik, të merren masat në vijimësi, për të ndjekur hapat e përcaktuara në përllogaritjen e fondit limit. Fondi i prokuruar, duhet të argumentohet me referencë mbi çmimet e tregut, apo çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore, AK duhet të marrë të dhëna nga organet statistikore, organet doganore dhe referencat të ndryshme ndërkombëtare dhe analiza të kostove, duke bërë që fondi limit të jetë real dhe i argumentuar dhe i bazuar në një gjurmë të besueshme të auditimit të hartuar për këtë qëllim.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi

Titulli i gjetjes 22: *Mungesë* argumentimi mbi përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë, mënyrën dhe seleksionimin e tyre për tu dërguar ftesën për ofertë, në procedurat e prokurimit të llojit "***kërkesë për propozim***"

Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik në Universitetin "Fan S. Noli", konstatohet se, procedurat e prokurimit të llojit "***kërkesë për propozim***" zënë rreth 70% të llojit të procedurave të tenderimit të kryera nga ky Universitet. Njësia e Prokurimit lidhur me përzgjedhjen e OE ka dokumentuar me proces verbal përzgjedhja e tyre, por në asnjë rast nuk ka argumentuar përse ka përzgjedhur këto operatorë, mënyrën dhe seleksionimin për tu dërguar ftesën për ofertë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin për prokurimin publik, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", si dhe kërkesat e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar, neni 39, 56, 57 / pikat 1 dhe 2.
Kriteri:	VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit Publik", i ndryshuar,
Rëndësia	I mesëm

Rekomandimi	Strukturat përgjegjëse në Universitet, duke respektuar frymën e ligjit për prokurimin publik, i cili nxit përdorimin e procedurave të hapura, të marrin masat në vijimësi dhe në rastet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit *"Kërkesë për propozim"* të argumentohet përzgjedhja e operatorëve ekonomik, mënyrën dhe seleksionimin e tyre për tu dërguar ftesën për ofertë, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Në vijimësi*

C.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Titulli i gjetjes 1: **Dëmi ekonomik të konstatuar në përdorimin e fondit shtesë rreth 20% të kontratës në vlerë 10,379,013 me TVSH, ku mungonin mbi 95 % të librezave të masave.**

Situata:	Në auditimin e dosjes së prokurimit me objekt *"Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të Shkollës Mekanike"* me fond limit 70,829,958 lekë pa TVSH, OE fitues "[redacted] SHPK, me vlerë të ofertës 43,247,820 lekë, ka rezultuar me çmimin më të ulët, rreth 39% më pak se fondi limit i llogaritur. Në procedurën e tenderimit kanë marrë pjesë 22 operatorë ekonomik, në të cilën janë kualifikuar 14 operatorë ekonomik. Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin teknik të zbatimit të punimeve të objektit u konstatua se kontrata është lidhur më datë 30.05.2017. Është nënshkruar kontratë shtesë më datë 20.10.2017, midis Autoritetit Kontraktor Universiteti "Fan S. Noli" dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "[redacted] SHPK & "[redacted] SHPK, në vlerën prej 10,379,013 me TVSH, ose në masën 19.9 % të kontratës fillestare. Shtesa e kontratës përfshin ndryshime në volume të kontratës fillestare, zëra të rinj të ndryshuar, shtesa në punime elektrike, punime kompjuterike dhe të vëzhgimit. Në dosjen teknike u konstatua se mungonin mbi 95 % të librezave të masave, (të cilat nuk gjendeshin në dosjen teknike). Pra, argumentimet e rritjeve të volumeve të punimeve nuk justifikohen me llogaritje metrike me librezën e masave, siç përcaktohet në Udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM", pika 3.2, ku përkatësisht përcaktohet se *"Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*". Për pasojë, nuk justifikohen me dokumentacion përmirësimet e objektit, apo rritjet dhe zbritjet e volumeve të punës, duke mos saktësuar në fakt volumet në rritje apo në zbritje për punimet e prishjeve, punimet e suvatimit, punimet e muraturës, punimet elektrike,

	hidrosanitare etj,. Rrjedhimisht nuk justifikohet përdorimi i fondit shtesë rreth 20% të kontratës, në vlerë 10,379,013 me TVSH. *Sa më sipër*, në pamje të parë duket se oferta fituese është ulur nga fondi limit në vlerën 43,247,820 lekë nga konkurrenca e lirë, por nga auditimi i zbatimit të punimeve vlera e kontratës është rritur në vlerën 8,649,177 lekë më shumë, e cila në total rezulton në vlerën 51,896,997 lekë pa TVSH. Gjithashtu, nga verifikimi i zërave të likuiduar në situacionin përfundimtar, *në mungesë të librezave të masave*, duke krahasuar volumet e proceseve të punës, u konstatuan disa pasaktësi të pajustifikuara, mospërputhje të punimeve dhe mbivendosje të zërave, në vlerën 1,068,188 lekë. Mungesa e dokumentacionit mbi justifikimet apo argumentimet e rritjes së sasive të volumeve të punimeve në vlerën prej **10,379,013 lekë me TVSH,** përbën përfitime të padrejta nga sipërmarrësi në dëm të buxhetit të shtetit, deri në momentin e justifikimit të sasive faktike të projektit.
Kriteri:	Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM, " Për mbikëqyrjen dhe kolauditimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
Ndikimi/ Efekti	Rritja e kostos së ndërtimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në dëm të buxhetit të shtetit. Nuk justifikohet përdorimin e fondit shtesë rreth 20% të kontratës në vlerë 10,379,013 me TVSH
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	-Universiteti "Fan S. Noli", të ngrejë një grup pune të veçantë, në përbërje të të cilit të ketë specialistë të fushës (inxhinierë ndërtimi), për kryerjen e verifikimeve dhe rakordimeve të punimeve të kryera në fakt në vlerën e përgjithshme prej **10,379,013 lekë me TVSH,** të pasqyruara në situacionin përfundimtar dhe të likuiduara, por të pa justifikuara me librezën e masave nga mbikëqyrësi i punimeve. Në përfundim të këtij procesi, të ndiqen procedurat ligjore dhe administrative për shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën **10,379,013 lekë**, **ose të vlerës së dëmit që mund të shtojë apo pakësojë këtë vlerë,** kjo e argumentuar me rezultatet e dala nga grupi i punës që do të bëjë verifikimin dhe rakordimin e punimeve të kryera në fakt.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i gjetjes 2 : Vendimmarrje nga Bordi i Administrimit në kushtet e konfliktit të interesit dhe dëmi ekonomik i arkëtueshëm nga përllogaritja e gabuar për pagesat e kryera . Anëtarët e Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej Përcaktim i shpërblimit për Bordin e Administrimit ne konflikt interesi dhe me shkelje te kuadrit ligjor me dëm në shumën **1,182,631 lekë**, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik

Situata:	Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) nr. 16, datë 27.07.2017, është vendosur të shpërblehen për çdo muaj anëtarët e BA me nga 35 mijë lekë dhe kryetari i BA me 40 mijë lekë. Këtu përfshihet dhe rimburimi i shpenzimeve dhe trajtimi financiar me dieta. Në vendim thuhet se "vendimi i shtrin efektet nga muaji dhjetor 2016." Pagesa e Bordit të Administrimit është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik" ku është përcaktuar se, *tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.* Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore" lidhja nr. 1, por përbën edhe konflikti interesi, pasi Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjor të përcaktojë tarifat e shpërblimit për vetveten, pasi në nenin 5 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar. Për sa më lartë, *anëtarët e Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej* 840,965 *lekë, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe pasqyrohet sipas përfituesve*.
Kriteri:	Pagesa e kryer është në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", lidhja nr. 1 "Arsimi i Lartë Publik" ku është përcaktuar se, *tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.* Në pikën nr. 3 të VKM nr. 418/2012, i ndryshuar, përcaktohet që,: *"Emërtesa e çdo këshilli, bordi apo komisioni, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së kryetarit dhe anëtarëve për çdo këshill, bord ose komision përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me përjashtim të rastit kur ligji specifik parashikon ndryshe".* iii. Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore" lidhja nr. 1, por përbën edhe konflikti interesi, pasi Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjor të përcaktojë tarifat e shpërblimit për vetveten, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit

	të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht se: *"Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga, të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre".*
Ndikimi/ Efekti	Për sa më lartë, anëtarët e brendshëm të Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej 341,666 lekë, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe pasqyrohet sipas përfituesve. Për sa më lartë, anëtarët e jashtëm të Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër shumën prej 840,965 lekë, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe pasqyrohet sipas përfituesve në tabelën e mëposhtme:
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,182,631 lekë**,
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Menjëherë*

Titulli i gjetjes 3 : Parregullsi e shkelje në largim nga detyra të ish-kancelarit [redacted] dhe komandimit/emërimit të kancelarit [redacted] dhe dhënia padrejtësisht e pagës për periudhën 20 Korrik 2016 deri më 4 Prill 2017, **në shumën 331,221 lekë** gjithsej është shpenzim i kryer në shkelje të disiplinës financiare, me dëm ekonomik për fondet publike

Situata:	Me urdhrin e Ministrit të MAS me nr. 389, datë 15.07.2016, është shkarkuar nga detyra Administratori i UFSNK z.[redacted] , bazuar në rezultatet e raportit të kontrollit të Njësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion (NJKBA) në Kryeministri, dërguar me shkresën nr. 2470/1, datë 27.06.2016. Në pikën nr.2 të këtij urdhri është përcaktuar se, "Funksionet e Kancelarit të Universitetit "F.S.Noli" Korçë të kryhen nga një punonjës i Universitetit i zgjedhur nga Këshilli i Administrimit të Arsimit të Lartë deri në përzgjedhjen e Administratorit me konkurs të hapur sipas nenit 51 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH". Bazuar në sa sipër, ish- Kryetari i Këshillit të Administrimit ka nënshkruar Vendimin nr.5 të Këshillit të Administrimit, datë 20.07.2016. Në pjesën përshkruese nënvizohet se KA i mbledhur me datën 20.7.2016 bazuar në urdhrin e mësipërm dhe "propozimin e Rektoratit të Universiteti për caktimin e punonjëses së universitetit, znj.[redacted] për kryerjen e funksioneve të Kancelarit të Universitetit, deri në zgjedhjen e

	Administratorit me konkurs, vendosi: "1.Të emërojë në pozicionin e kancelarit punonjësen e Universiteti znj.[redacted] për kryerjen e funksioneve të kancelares së universitetit "F.S.Noli" deri në përzgjedhjen e Administratorit me konkurs të hapur. , në dosjen e znj.[redacted], është administruar Vendimi nr.5 i Këshillit të Administrimit, datë 20.07.2016. Në pjesën përshkruese nënvizohet se KA i mbledhur me datën 20.7.2016 bazuar në urdhërin e mësipërm dhe "propozimin e Rektoratit të Universiteti për caktimin e punonjëses së universitetit, znj.[redacted], për kryerjen e funksioneve të Kancelarit të universitetit, deri në zgjedhjen e Administratorit me konkurs, vendosi:"1.Të ngarkojë në ushtrimin e funksionit të Kancelarit, në Universitetin "F.S.Noli" Korçë, punonjësen e Universiteti znj.[redacted] deri në emërimin në këtë emision të Administratorit sipas kuadrit ligjor në fuqi". Në këtë përgjigje Ministri i Arsimit dhe Sporteve është shprehur se: "Bazuar në VKM nr.875, datë 18.6.2008 "Për përcaktimin e të drejtave dhe detyrave dhe për procedurën e përzgjedhjes dhe të emërimit të kancelarit të institucioneve publike të arsimit të lartë" dhe ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL të RSH", znj.[redacted] nuk emërohet në pozicionin e kancelarit të Universitetit, por ngarkohet me ushtrimin e funksionit të kancelarit në këtë Universitet, deri në emërimin në këtë pozicion të administratorit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi". Pas marrjes së këtij qëndrimi, nga ana e Rektorit të UFSNK nuk është kryer anulimi i pagës së caktuar me Urdhrin Me Urdhrin nr.130, datë 26.07.2016,veprim që ngarkon me përgjegjësi rektorin e UFSNK z.[redacted] dhe Përgjegjësin e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës z.[redacted] që kanë caktuar e miratuar pagën e znj.[redacted] si Kancelare të Universitetit, pa miratim të organit të emërtesës. Pagesa e kryer për Administratoren e e komanduar në detyre, të caktuar për të ushtruar funksionet, nuk është e bazuar ligjërisht. Për pasojë, pagesa e kryer për znj.Viloeta Zere për periudhën 20 Korrik 2016 deri më 4 Prill 2017, në shumën 331,221 lekë gjithsej është shpenzim i kryer në shkelje të disiplinës financiare, me dëm ekonomik për fondet publike. Në kohën e caktimit për të kryer këto përgjegjësi të ushtrimit të funksionit, znj.[redacted] kryente detyrën e specialistit në Drejtorinë e Financës pranë Rektoratit.
Kriteri:	ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH
Ndikimi/ Efekti	dhënia padrejtësisht e pagës për periudhën 20 Korrik 2016 deri më 4 Prill 2017, në shumën 331,221 lekë gjithsej është shpenzim i kryer në shkelje të disiplinës financiare, me dëm ekonomik për fondet publike
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në

	vlerën **331,221 lekë**
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 4:	Dëmi ekonomik i arkëtueshëm dhe pagesë fiktive e kryer për 1200 m2 fiktivisht për shërbimin e DDD në ambientet Godina e ish-Shtëpia Ushtarakëve, zë 10,16% % të sipërfaqes së përgjithshme prej 11,800 m2 dhe në vlerën e përgjithshme të shlyer prej 594,480 lekë x 10,16**%= 60,455 lekë.**
Situata:	Sipas Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr.29. datë 15.05.2017, me fondin limit 505,200 lekë pa TVSH, nënshkruar nga Administratori znj.[redacted] me objekt: *"Dezinfektim, deratizim dhe deinsektizim* " me 7 (shtatë) zëra dhe me sipërfaqe të përgjithëshme prej 10,600 m2.Pagesa e kryer për 1200 m2 fiktivisht për shërbimin e DDD në ambientet Godina e ish-Shtëpia Ushtarakëve, zë 10,16% % të sipërfaqes së përgjithshme prej 11,800 m2 dhe në vlerën e përgjithshme të shlyer prej 594,480 lekë x 10,16%= 60,455 lekë, për të cilën është nënshkruar akt marrje në dorëzim e këtij shërbimi është procedurë fiktive, në kundërshtim me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe kërkesat e ligjit nr. 9228, "Për kontabilitetin" i ndryshuar. Kjo pagesë, e cila lidhet me një objekt, mbi të cilin UFSNK në periudhën e kryerjes së prokurimit, nuk ka patur asnjë të drejtë pronësie e përdorimi, pasi kanë ndodhur këto transferim të kësaj pasurie si vijon: Me VKM nr. 530, datë 07.08.2012, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te MASH për Universitetin "F.S.Noli" Korçë, të pronës nr. 549 me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...". Për sa sipër, është mbajtur akt dorëzimi i pronës, nga anëtarët e komisioneve respektive dhe është nënshkruar akt dorëzimi me nr. 286 prot datë 27.12.2012 të MM dhe me nr. 323 prot datë 15.01.2013 të MASH. *Sa më sipër*, nga data 19.2.2016 UFSNK nuk ka asnjë të drejtë pronësore e administrimi mbi objektin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë". Përfshirja në situacion e këtij shpenzimi prej 60,455 lekë dhe nënshkrimi si shpenzim i kryer përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për fondet publike.
Kriteri:	VKM nr. 530, datë 07.08.2012, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te MASH për Universitetin "F.S.Noli" Korçë, të pronës nr. 549 me emërtimin "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Republika" Korçë...". Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet
Rëndësia	I Lartë

Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **60,455 lekë.**
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 5: Dëmi i shkaktuar për pagesë gjobe, të dhënë nga policia rrugore në shumën prej **7,200 lekë,** sa ngarkuar fondeve te Universitetit

Situata:	Janë likuiduar shpenzime për gjobë, në adresë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë në shumën 7,200 lekë, sipas urdhërit të lëshuar nga Administratori me nr. 173 datë 05.12.2017 "Për pagesë gjobe", ku në pikën nr. 1 të tij, përcaktohet se, "të kryhet pagesa për kundërvajtje administrative për automjetin me targë AA272 AT në pronësi të UFSNK në masën 80% të saj". Pagesa e kryer për pagesë gjobe / kundërvajtje administrative nuk duhet të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit por duhet të ishte shlyer nga drejtuesi i mjetit. Shuma prej 7,200 lekë është shkelje të disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet nga drejtuesi i mjetit ose personi që ka urdhëruar mos likujdimin e saj.
Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **7,200 lekë,** të zhdëmtohet nga drejtuesi i mjetit ose personi që ka urdhëruar likujdimin nga fondet buxhetore të kësaj kundërvajtjeje administrative.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 6 : Dëmi ekonomik i arkëtueshëm nga përllogaritja e gabuar e dietave për urdhëtimet jashtë shtetit për **245 EURO ose 32,671 lekë**

Situata:	Autorizimi me nr. 442 prot., datë 21.11.2017 vetëm ka të përcaktuar përbërjen e delegacionit prej 6 (gjatë) personash që do marrin pjesë në workshop, dhe në autorizim thuhet se periudha do te jetë dy ditë, por nuk specifikohet data e nisjes dhe data e kthimit/ (ditët e pjesëmarrjes në këtë konferencë); Nuk ka asnjë përcaktim se kush i mbulon shpenzimet pasi nuk ka një urdhër të mirëfilltë administrativ. Janë lëshuar gjashte

	fatura hoteli , por nuk ka në asnjë rast kasën fiskale të printuar. Të gjithë autorizimet për shërbim jashtë shteti mbajnë nënshkrimin e çdo personi udhëtues dhe jo të titullarit apo nëpunësit autorizues; Përllogaritjet e hotelit nuk i referohen faturës së lëshuar nga hoteli por janë shumëzuar me dy. Sa sipër, pagesa e kryer prej 245 EURO x 133,38 Lekë/ EURO = 32,671 lekë sa paguar padrejtësisht dhe sa likuiduar pa dokumentacionin e plotë, të pa nënshkruar rregullisht, dhe për pasojë, është vepruar në shkelje të Vendimit nr. 870 datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin E punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", të ndryshuar dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 22, datë 10.7.2013 dalë në zbatim të këtij vendimi.
Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **32,671 lekë.**
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 7: Shkelje në respektimin e kuotave financiare të pritjeve dhe përcjelljeve zyrtare realizuar me rastin e 45 vjetorit të UFSNK, me dëm në **vlerën 56,100 lekë.**

Situata:	Në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 3, të VKM nr.243, datë 15.5.1995, "Për pritjet, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhen delegacioneve të huaja", ndryshuar me VKM nr. 327 datë 26.6.1995, VKM me nr. 118, datë 26.2.1996 dhe VKM me nr. 258, datë 03.6.1999, nga titullari i institucionit (rektori i Universitetit), në programin e miratuar nuk është përcaktuar numri i punonjësve të UFSNK dhe konfirmuar lista e personave që do të shoqërojnë delegacionin për realizimin e festimeve dhe konferencës jubilare. Në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 12 të këtij vendimi, që përcakton se (citojmë): " Pagesa e shpenzimeve të kryera do të bëhet në bazë të programit të miratuar për këtë qëllim, preventivit të shpenzimeve, dhe dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e tyre". Grupi i auditimit sjell në vemendje se, nuk ka një preventiv të hollësishëm të shpenzimeve; nuk ka një analizë dhe pasqyrim të kostove financiare dhe të mënyrës se si është llogaritur fondi për këto aktivitete; kërkesa e rektorit që i është bashklidhur pagesës nuk ka as ekstremitetet shkresore dhe as nënshkrimet; *Fatura e lëshuar nga subjekti privat nuk pasqyron në mënyrë të detajuar listën e artikujve të shpenzuar, të pijeve dhe ushqimeve të konsumuara.* Nga ana e auditimit konstatohet se janë respektuar normativat financiare

	për darkat zyrtare dhe akomodimin në hotel, mirëpo nuk janë zbatuar normativat dhe janë shkelur kuotat maksimale për pritjet zyrtare për kategorinë/grupin e dytë të delegacioneve. *Më konkretisht, nga 450 lekë/personi janë shpenzuar 824 lekë/person. Për pasojë është paguar padrejtësisht (824 -450)= 374 x 150= 56,100 lekë* .Sa më sipër, bazuar në përcaktimet e pikës nr. 12 të këtij vendimi, që përcakton se (citojmë): "Tejkalimi i normativave financiare konsiderohet shkelje e disiplinës financiare dhe personat përgjegjës detyrohen të kthejnë vlerën e dëmit të shkaktuar", shuma prej 56,100 lekë është dëm i arkëtueshëm .
Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **56,100 lekë.**
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 8 : Mungesa dhe mosdorëzim të inventarit pas shkëputjes së marrëdhënieve të punësimit), **në 3 (tre) raste, përkatësisht pedagogët [redacted] dhe [redacted], me vlerë 308,462 lekë**

Situata:	Nga shqyrtimi i relacionit të hartuar nga ana e komisionit të inventarizimit, të datës 11 mars 2016, rezulton se pas inventarizimit të aktiveve në përdorim, për dy ish-punonjës të UFSNK, paraqitet kjo situatë: • Në fakultetin e Shkencave të Natyrës, në ngarkim të z.[redacted] ka kaluar një laptop me vlerë 98,462 lekë. Punonjësi është larguar. • Në fakultetin Ekonomik, në ngarkim të znj.[redacted] ka kaluar një laptop me vlerë 75,410 lekë. Punonjësi është larguar. Me vendimin e Këshillit të Administrimit nr.3, datë 29.03.2016 , (ose tre ditë para asgjësimit dhe mbajtjes së procesverbalit nga ana e Komisionit të Vlerësimit), është dhënë miratimi paraprak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe vlerësuara nga komisioni i vlerësimit. Nga auditimi i kryer pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezulton se, në dosjet e personelit të personave të sipërcituar mungon procesverbali i dorëzimit të detyrës, bazës materiale e inventarit në dorëzim. ✓ Bazuar në procesverbalin e datës 20.10.2015 dhe Urdhrin e Rektorit me nr.164, datë 30.10.2015, një komision ka hapur zyrën dhe inventarizuar artikujt e inventarit, për të cilat ka mbajtur dhe procesverbalin. Sipas procesverbalit të datës 20.10.2015, rezultojnë se mungojnë artikujt laptop dhe flash 8 Gb.

	✓ Sipas një procesverbali që ka mbajtur Komisioni i Vlerësimit, me datën 1 prill 2016, pajisja laptop 15 HP 620 i dorëzuar nga znj. [redacted], është i dëmtuar fizikisht dhe jashtë funksionit dhe sugjerohet dalja jashtë përdorimi. ✓ Sipas shkresës së datës 26.04.2016, të nënshkruar nga Përgjegjësi i IT, [redacted] dhe drejtuar kancelarit z.[redacted] është evidentuar dorëzimi i laptopit të pedagoges znj.[redacted], me datën 26.4.2016. ✓ Nga shqyrtimi i procesverbaleve të asgjësimit, konstatohet se, 3. Me datën 1 prill 2016, kompjuteri laptop 15" HP 620 [redacted]), me vlerën 75,409 lekë është asgjësuar (groposur), 4. Me datën 17 prill 2017, kompjuteri laptop 15" HP 620 ([redacted]), me vlerën 75,409 lekë është asgjësuar (groposur), Të intervistuar nga ana e grupit të auditimit, [redacted] pranojnë së kanë nënshkruar procesverbalin për dalje jashtë përdorimi, por ky laptop është asgjësuar në vitin 2017. Ky laptop nuk është përfshirë në procesverbalin e Komisionit të Vlerësimit për jashtë përdorimi, dhe procedurat e nënshkruara nga komisioni i asgjesimit për këtë artikull janë procedura fiktive dhe jorealiste, gjë që i ngarkon këtë komisionin e asgjesimit të vitit 2016 me përgjegjësi. Nga ana tjetër, nuk është kthyer dhe bërë hyrje në UFSNK nga ana e z.[redacted] një laptop me vlerë 98,462 lekë. Mbështetur në relacionin e hartuar nga Kryetarja e Komisionit të Inventarizimit të plotë periodik të aktiveve afatshkurtëra e aftagjata materiale per v.2018, znj.[redacted] nga krahasimi i të dhënave kontabile dhe fizik të inventarit, rezultojnë mungesa për përsonat e mëposhtëm: • Në ambientet e rektoratit, mungon një vendroje me vlerë 151,500 lekë, në ngarkim të z.[redacted] dhe • Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, nuk janë bërë dorëzimet e inventarit në ngarkim të znj.[redacted] prej tre artikujsh, më një vlerë totale prej 58,500 lekë, (e përbërë nga një mininotebook me vlerën 48,000 lekë, i libër me autor [redacted] me çmim 350 lekë x 10 fish= 3500 lekë dhe 1 libër me autor z.[redacted] me çmim 700 lekë x 10 fish=7,000 lekë)
Kriteri:	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **308,462 lekë.**
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 9: Shkelje në pagesat për honorare për 16 profesorë, anëtarët e Senatit Akadamik të Universitetit, në shumën neto prej **37,149 lekë.**

Situata:	Janë paguar për honorare për 16 profesorë, anëtarët e Senatit Akadamik të Universitetit, në shumën neto prej 408,000 lekë, referuar Urdhrit të Administratorit nr. 170, datë 04.12.2017. Kjo pagesë është kryer duke aplikuar mbajtjen e tatimit në burim, por llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është kryer në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, në bazë të cilit, "*Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës*"; nenit 9/1 "Tarifat tatimore", sipas të cilit, *"Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të tatohen sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij*.", si_dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 20.01.2016 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Sa llogaritur me pak, vlera prej 37,149 lekë, detyrim i arkëtueshëm.
Kriteri:	Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Per tatimin mbi te ardhurat" Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.5, datë 20.01.2016 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet;
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 37,149 **lekë.**
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Gjetje për efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve pa efektivitet dhe ekonomicitet, në vlerën **19,755,212 lekë.**

Titulli i Gjetjes 1: **Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 15,059,295 lekë.**

Situata:	U konstatua se, gjatë periudhës objekt auditimi (2016, 2017), janë kryer shpenzime dhe janë bërë dalje karburante për gjithë veprimtarinë mësimore dhe ndihmëse, në sasinë 99,984 litra dhe në vlerën 15,059,295 lekë pa asnjë dokumentacion justifikimi të këtyre shpenzimeve. Sa sipër,

	është vepruar në shkelje të parimeve dhe kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 26.12.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe UMF nr.30. 20111 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar dhe shuma prej **15,059,295 lekë konsiderohet si shpenzim i kryer pa efektivitet.** **1**. Për automjetet janë shpenzuar 9651 litra karburant për automjetet, me vlerë 1,516,641 lekë, të konsideruara shpenzime pa efektivitet në vlerën e ndarë në periudha si vijon: - në sasinë 5,095 litra, me vlerën 819,367 lekë lekë për vitin 2016, - në sasinë 6,049 litra, me vlerën 931,696 lekë për vitin 2017, për 3 automjetet në dispozicion të Universitetit, por pa u shoqëruar me dokumentacion të nënshkruar rregullisht, që të konfirmojë kryerjen e shërbimit dhe të justifikojë realizimin efektivisht të këtyre shpenzimeve. 2. janë kryer shpenzime për procese të ndryshme si plugim, frezim, transport materialesh, hapje kanali, mbjellje, që për v. 2016 arrijnë në 750 litra x 160 lek/litri dhe për v. 2017 në 743 litra karburant x 154 lek/litri. Nuk ka në asnjë rast procesverbale apo situacioneve të punimeve të kryera, për të dokumentuar dhe justifikuar shpenzimin prej 1493 litra me vlerë 234,422 lekë, ndaj kjo vlerë përbëbn shpenzim pa efektivitet të fondeve publike. 3. Nga auditimi rezulton se për dy vitet 2016 dhe 2017, vetëm për katër kaldajat e UFSNK janë bërë dalje 88,840 litra naftë x 149,7 lekë= 13,308,232 lekë. Nuk ka asnjë dokument për justifikimin e karburantit për kaldajën, , asnjë regjistër për dokumentimin e kohës së punës së kaldajave, oraret e ndezjes së tyre etj, Ka rezultuar se, nuk është dokumentuar **konsumi i karburantit për kaldajën, duke mos dokumentuar ndezjen e sajë, (çdo ditë dhe monitorimi të konfirmohej me mbajtjen e një proces verbali ditor). Nuk kishte një grafik të miratuar për ndezjen e kaldajës nga strukturat menaxhuese të universitetit**,
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar si dhe paragrafi nr. 36, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30/ 2011.
Ndikimi/Efekti	Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shenzuara për **15,059,295 lekë konsiderohet si shpenzim i kryer pa efektivitet** për buxhetin e shtetit
Rëndësia	I lartë

Rekomandimi	1. Nga ana e administratorit te Universitetit të ngrihet një grup pune për përcaktimin e normativave të harxhimit për automjetet dhe kaldajat si dhe të përllogaritet bilanci material i konsumit të karburantit të shpenzuar, të nxirret përgjegjësia për mosveprimet si dhe të vihen ngarkim sasitë e pajustifikuara të karburantit që do të rezultojë i pajustifikuar. 2. Sipas kompetencës së miratimit, nga universiteti duhet të miratohet grafiku kohor i mbajtjes në punë të kaldajave dhe të standardizohet sistemi dokumentar dhe libri për shpenzimin e tij duke u kundër firmuar nga Drejtori Ekonomik dhe Drejtori i Financës. Gjithashtu të përcaktohen personat përgjegjës si për funksionimin e saj, ashtu dhe për monitorimin dhe dokumentimin e përdorimit të kaldajës, për rrjedhojë matjen e dokumentuar të konsumit të karburantit, si dhe efektshmërinë e sistemit të ngrohjes në institucion..
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 2: **Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 139,205 lekë.**

Situata:	Me urdhër shpenzimin nr. 136 , datë 24.05.2017, , është kryer likuidimi i faturës tatimor te shitjes për shoqërinë private "[redacted]" SHPK për pjesëmarrje në panairin e Arsimit të lartë në shumën prej 139,205 lekë. Kjo pagesë është kryer sipas shkresës së ish -Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 5232/1, datë 20.05.2016, më e objekt "Ftesë për pjesëmarrje", nënshkruar nga ish Sekretar i Përgjithshëm i MAS. Sipas kësaj shkrese, *"MAS me datat 26, 27 dhe 28 maj 2016 do të organizojë panairin e Arsimit të Lartë në ambientet e [redacted] pranë [redacted] për informimin e maturantëve mbi programet që ofrohen si dhe njohjen e kritereve të pranimit të maturantëve në këto institucione për vitin akademik 2016-2017*". Shkresa e mësipërme është dërguar për zbatim nga 14 Universitet Shtetërore, për të lidhur kontratës me subjektin "[redacted]" me objekt "*Organizimin e panairit pranë [redacted] për njohjen e kritereve të pranimit të maturantëve në vitin akademik 2016-2017*". Pagesa e kryer me tarifën 70 Euro/m^2 për stendën e vendosur nga Universiteti "F.S.Noli" Korçë në "[redacted]", është kryer pa procedure prokurimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, pagesë e cila përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike, pasi për kryerjen e këtij aktiviteti, ish Ministria e Arsimit dhe e Sporteve duhej të përdorte ambientet e çdo Universiteti, si dhe publikimin e kritereve në faqen zyrtare të MASH dhe të 14 Universiteteve të vendit, apo mënyra të tjera komunikimi me medien e shkruar dhe elektronike.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe*

	shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	E gjithë shuma për 139,205 lekë është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit, meqenëse i përket praktikave administrative dhe vendimmarrjeve të gabuara
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shenzuara për 139,205 lekë, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 3: **Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 1,382,000 lekë.**

Situata:	**Shmangie nga realizimi i procedurës së prokurimit për blerje kompjuterash dhe pajisje, në vlerën prej 1,382,000 lekë** Nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për blerje kompjuterash dhe pajisjesh t tjera kompjuterike në shumën totale prej 1,382,000 lekë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, **pasi është pranuar fatura e thjeshtë tatimore e lëshuar nga subjekti privat S.Marko në vlerën 1,382,000 lekë pa asnjë procedura prokurimi, për artikujt: desktop kompjuter, copë 8 x 125,000=1,000,000 lekë; printer/ skaner/ fotokopje, copë 2 x 115,000= 230,000 lekë; video projektor, copë 2 x 63,000 = 126,000 lekë; ekran projeksioni EPAC, copë 1 x 26,000 = 26,000 lekë, si blerje në kuadër të projektit.** 2.Ndonëse projekti i kërkimit shkencor është paraqitur nga Departamenti që në muajin qershor të vitit 2016, miratimi për realizimin e fondeve është dhënë më datën 2 dhjetor 2016, pra pas afro 6-muajsh. Sipas Urdhrit të Rektorit me nr. 176, datë 06.12.2016, drejtuar administratorit, urdhërohet "të kryhet realizimi për shpenzimet e realizuara prej drejtuesit të projektit". Mungon bashkëlidhur pagesës vlerësimi i projektit nga Grupi i Vlerësimit të projekteve, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 11 dhe 12 të Udhëzimit të MASH me nr. 19, datë 31.05.2011, "Për detajimin e buxhetit ë IAL në programin "Për kërkim fondamental dhe ekselencë". 3. Përfitimet e projektit, i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme, (përndryshe sa ka shkruar Kancelarja në shkresën me nr.111, datë 07.12.2016), Më konkretisht, në faqen nr.8 të Projektit, në pikën A, është shkruar qartë se përfituesit nga projekti janë (citojmë):

	1.Përfituesit direkt: *Studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit "Histori-Gjeografi" dhe* **2. Përfituesit indirekt**: *Stafi akademik dhe ndihmës akademik i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.*
	Për rrjedhojë, nuk duhet shmangur realizimi i procedurës së prokurimit publik, dhe për veprimet e mosveprimet hallkat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi. 4.Mungon ngritja e komisionit për marrjen në dorëzim të këtij projekti, ku të vlerësohej niveli i realizimit të çdo komponenti të tij, si dhe akti i marrjes në dorëzim të projektit si një i tërë; bërja hyrje dhe kontabilizimi i projektit si AQPT. Sa sipër, është vepruar në shkelje të dispozitave të UMF nr.30, datë 2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", por janë bërë hyrje vetem një pjesë e komponentëve të tij: pajisjet kompjuterike.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	E gjithë shuma për **1,382,000 lekë** është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit, meqenëse i përket praktikave administrative dhe vendimmarrjeve të gabuara
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **1,382,000 lekë** lekë., si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 4: **Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 1,090,800 lekë**

Situata:	**4.1**. Dokumentacioni për veprimet e dhurimit është hartuar dhe nënshkruar në vitin 2015, (për 330 copë libra, me vlerë 366,300 lekë), që lidhen me aktivitete që janë kryer 3-4 vite më parë, përkatësisht gjatë viteve 2012 dhe 2014 dhe nuk ka asnjë gjurmë veprime në kontabilitetet e viteve respektive. Këto veprime ngarkojnë më përgjegjësi ish-Dekanin e Fakultetit z[redacted] dhe përfaqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted]. *Konkretisht:* ✓ Procesverbal i datës 12 janar 2015, për shpërndarje libri, në konferencën "Lidhjet kulturore dhe historike të shqiptaro-rumune", (Korçë, mars 2012), nënshkruar nga dekani [redacted] dhe përfaqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted], për 110 kopje libra. ✓ Procesverbal i datës 12 janar 2015, për shpërndarje libri, në

	aktivitetin "Akademia Jubilare me rastine 40 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit", (Korçë, nëntor 2012), nënshkruar nga dekani [redacted] dhe për faqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted], për 110 kopje libra. ✓ Procesverbal i datës 12 janar 2015, për shpërndarje libri, të botimit "Vjetari shkencor "FEF Simpozium shkencor; ndihmesat e pedagogëve doktorantë në fushën e edukimit dhe filologjisë", (Korçë, Shtator 2014), nënshkruar nga ish-dekani [redacted] dhe për faqësuesi i Qendrës së Ekselencës z. [redacted], për 110 kopje libra. Sa vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 34, të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", që përcakton se, "*Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi".* Për parregullsitë e mësipërme, kjo shumë prej 366,300 lekë është shpenzim i pajustifikuar dhe pa efektivitet. <u>4.2.Nuk ka asnjë praktikë shkresore e administrativ për justifikimin e shumës prej 727,500 lekë, që u përkojnë 1164 librave libra,</u> (nga një kontingjent prej 9900 copë libra të siguruara nga donatorët në kuadër të projektit "[redacted]"), <u>dhe që u janë dhuruar universiteteve të tjera</u>. Bashkëlidhur dokumentacionit të disponuar nga ana e Drejtorisë së Financës për artikujt kontabël të regjistruar, është një plan shpërndarje që mban nënshkrimet e punonjësit të bibliotekës Znj.[redacted] përgjegjëses së departamentit znj.[redacted] dhe koordinatorit të projektit [redacted]. <u>Ky plan nuk është i miratuar, pra nuk ka nënshkrim nga ana e rekorit për shpërndarje të këtyre librave dhe shkresa është pa datë</u>. Sipas këtij plani, 20 komplete me nga 20 copë janë shpërndarë në panairin e organizuar nga Ministria e Integrimit; 9 komplete me nga 20 copë janë shpërndarë nga [redacted] në universitet që kanë programe studimi në infermieri; 18 komplete me nga 20 copë janë tërhequr nga pedagogia [redacted], së bashku me 180 libra obstetrike-gjinekologji, 60 libra fiziologji, 43 libra ABC e jetës, diabetit dhe dhimbjes, të cilat u janë shpërndarë studentëve, por mungon miratimi për sa sipër. Sa vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 34, të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", që përcakton se, "*Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi".* Për parregullsitë e mësipërme, kjo shumë prej 727,500 lekë është shpenzim i pajustifikuar e pa efektivitet.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 "*Për disa ndryshime dhe*

	shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **1,090,800 lekë** si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 5: **Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 712,421 lekë.**

Situata:	Janë kryer për vitet 2016 dhe 2017 pagesat për punë të kryer jashtë kohës normale të saj, prej **712,421 lekë**, në kundërshtim me kuadrin rregullator dhe dispozitat nënligjore në fuqi. Pagesat e kryera nuk janë të justifikuara me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sa vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 463, datë 16.6.2011 "Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.7.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011", duke krijuar një shpenzim të pa dokumentuar rregullisht.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar; VKM nr. 463, datë 16.6.2011 "Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.7.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011",
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **712,421 lekë** si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 6: **Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 1,371,491 lekë**

Situata:	Në listën e artikujve të propozuar nga komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit për periudhën objekt auditimi, rezultojnë disa artikuj dhe vlera materiale (artikuj magazine), të nxjerra jashtë përdorimit në sasi dhe vlerë të konsiderueshme, Referuar procesverbaleve të mbajtura në magazinën e institucionit, rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe asgjësuar 272 copë bojëra printerësh dhe fotokopjesh, me shënimin

	se këto bojëra janë "tharë", në vlerën 1,371,491 lekë, për të cilat nuk është kryer asnjë analizë dhe nxjerrje përgjegjësie.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me ndryshimet;
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **712,421 lekë** si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

Në vijim po paraqesim një opinion, bazuar në konstatimet kryesore që kanë rezultuar gjatë auditimit dhe të pasqyruara më lartë:

Baza për opinionin:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" dhe *ISSAI 1700*[3]*, dhe ISSAI 4000*[4].

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe atij financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Menaxhimi i Universitetit është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në UFSNK krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në

[3] **ISSAI 1700-** *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

[4] **ISSAI 4000** – *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.*

fuqi (*kriteret*), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe konsistojnë si më poshtë:

I. ***Nga auditimi financiar***: Në mbajtjen e kontabilitetit, nuk janë aplikuar në mënyrë të drejtë rregullat kontabël, në bazë të parimit të angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara; ekzistojnë shkelje e mangësi në hartimin e dokumentacionit justifikues të shpenzimeve për karburante e lëndë djegëse në sasinë 99,984 litra dhe në vlerën 15,059,295 lekë; mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimeve fizike të aktiveve; janë kryer transferime të aktiveve pa i pasqyruar në librat e llogarisë; mosdokumentim i sipërfaqeve dhe vlerave të tokës truall dhe fondit të tokave bujqësore, që rezultojnë me një diferencë prej 40,48 ha, etj.

Opinion:

Nga ***auditimi i pasqyrave financiare***, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualet e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord *(kriteret e auditimit financiar),* u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara ***materiale, por jo të përhapura***, *për të cilën japim* ***opinion të kualifikuar***[5]*"*

II. ***Nga auditimi mbi përputhshmërinë***[6]: Institucioni nuk ka përditësuar rregulloren e brendshme me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor; parregullsi në zbatimin e dispozitave të prokurimit publik, (që nga përllogaritja e fondit limit deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punimeve e shërbimeve, dobësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit; pagesa të personelit akademik për orët e ngarkesës mbi normë 30-70% (paguar gjithsej 26,266 orë mësimore me vlerë 22,385,780 lekë), në kundërshtim me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë dhe Udhëzimet e MAS; në përdorimin e fondit shtesë rreth 20% të kontratës me objekt "*Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të Shkollës Mekanike" me* vlerë 10,379,013 me TVSH, ku mungonin në dosjen teknike mbi 95 % të librezave të masave; pagesa të pa ligjshme të Bordit të Administrimit dhe në konflikt interesi dhe me dëm në shumën 1,182,631 lekë; dobësi në zbatimin e procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrolleve të brendshme, etj.

Opinion:

Nga ***auditimi i përputhshmërisë****, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i*

[5]- Sipas ***Manualit të Auditimit Financiar*** të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, "Opinioni me rezerve" do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

[6] *Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".*

*përputhshmërisë, u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara **materiale, por jo të përhapura**, për të cilën japim **opinion të kualifikuar**[7].*

V. ANEKSE

Anekset janë pjesë përbërëse e Raportit të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështjet e mëposhtme:

***Aneksi nr.1**: Qasja dhe metodologjia e Auditimit,*
***Aneksi nr. 2**: Llojet e opinionit të aplikuar nga KLSH-ja,*
***Aneksi nr.3**: Administrimi i karburantit për kaldajat 2016-2017.*
***Aneksi nr.4**: Çështjet gjyqësore te ndjekura nga Universiteti i Korçës,*
***Aneksi nr.5**: Vendimet e Këshillit Administrativ 2016,*
***Aneksi nr.6**: Vendimet e Bordit të Administrimit 2017.*
***Aneksi nr.6**: Buxheti 2016 dhe 2017.*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT **DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

[7] Sipas ***Manualit të Auditimit Përputhshmërisë*** të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, ***Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:*** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, *audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura,* ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.

ANEKSI I:
QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar **materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë** të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë **faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet**, niveli i precizionit pranohet në vlerën **20,814,218** lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm **kanë risk të ulët deri në të moderuar**. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.
Mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (*u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli*);

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e cështjeve për auditimi, (në këtë **rast 50 çështje ose artikuj**) mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Çështje për t'u shqyrtuar = (Artikulli buxhetor : Precizioni x Faktor risku)

Niveli i materialitetit për vitin 2016, është përllogaritur sipas tabelës së mëposhtme.:

UNIVERSITETI "FAN S.NOLI" KORCE, 2016			
Viti 2010	Baza e materialitetit	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7, 2, 3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Paga (600)	**232,074,971**	0.70	**27**
Sigurime Shoqërore (601)	**34,479,583**	0.70	**4**
Mallra e Shërbime (602)	**52,125,322**	2.00	**17**
Të tjera transferta korrente (604)	**-**	0.70	**0**
Transferta korrente të huaja (605)	**-**	0.70	**0**
Tranf. buxhetet familjare indiv. (606)	**18,111,632**	0.70	**21**
Investime të brendshme (230)	**79,200**	2.00	**0**
Investime të brendshme (231)	**37,908,795**	2.00	**12**
Garanci kontrate (5%)	**-**	0.70	**0**

Totali	**374,779,503**

Materialiteti në %	2%

Materialiteti në vlerë	**7,495,590**

Përllogaritja e saktësisë	
Materialiteti	7,495,590
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	**749,559**
Nën-Totali	6,746,031
Saktësia e planifikuar (80 - 90%)	90%
Saktësia (precizioni)	**6,071,428**

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2016, grupi i auditimit mori në shqyrtim 45 çështje/artikuj për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizmin, mbi llogarinë 600 e 601. Gjithashtu u shqyrtuan 22 çështje për llogarinë 230 nga12 e llogaritura sipas formulës (ose mbi 100% e mbulimit të këtij zëri), për të verifikuar plotësinë, ndodhjen, matjen, rregullshmërinë dhe zbatueshmërinë; dhe aspekte te regjistrimit mbi çështje te lidhura me llogarinë 602 nga 1 e llogaritur sipas formulës, (blerja e mallrave dhe shërbimeve).
Mbi verifikimin dhe rakordimin e gjendjeve të llogarive në fund të periudhës, grupi i auditimit analizoi dhe verifikoi ekzistencën, plotësinë, vlerësimin dhe alokimin e tyre.
Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione

ANEKSI II:
LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Baza për Opinionin

a. *Manuali i auditimit të përputhshmërisë në KLSH.*

Audituesi duhet të shprehë një ***opinion të pamodifikuar*** mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

Një ***opinion i pakualifikuar*** (*pa rezervë*) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinioni me rezerve. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinioni qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të

ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI III:

Administrimi i karburantit në përdorim nga kaldajat 2016-2017:

Janar 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
18.1 .2016	[redacted]	1290 Fakulteti Shk. Humane	19.1..2016	**1290**	
18.1.2016	[redacted]	3000 Fakulteti Ekonomik	19.1.2016	**2900**	
18.1.2016	[redacted]	2500 Fakulteti Shk. Edukimit	19.1.2016	**2400**	
	permbledhje			**6590**	

Shkurt+ mars 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
.2016	[redacted]	Fakulteti Shk. Humane	.2016	**1360+ 910**	
.2016	[redacted]	Fakulteti Ekonomik	.2016	**2000+ 2600**	
.2016	[redacted]	Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri	2016	**1900**	
2016	[redacted]	Fakulteti Shk. Edukimit	.2016	**2800+ 2850**	
	permbledhje				

Prill 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
.2016	[redacted]	Fakulteti Shk. Humane	.2016	**2000**	
.2016	[redacted]	Fakulteti Ekonomik	.2016	**2000**	
.2016	[redacted]	Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri	2016	**1330**	
2016	[redacted]	Fakulteti Shk. Edukimit	.2016	**2000**	
	permbledhje				

Tetor 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
20.10.2016	[redacted]	1500 Fakulteti Shk. Humane	24.10.2016	**1400**	
19.10.2016	[redacted]	1500 Fakulteti Ekonomik	24.10.2016	**1280**	
19.10.2016	[redacted]	1500 Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri	24.10.2016	**1490**	
19.10.2016	[redacted]	3500 Fakulteti Shk. Edukimit	24.10.2016	**3310**	
	permbledhje				

Nentor 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
21.11.2016	[redacted]	1000 Fakulteti Shk. Humane	23.11.2016	**1000**	
23.11.2016	[redacted]	2000 Fakulteti Ekonomik	23.11.2016	**1700**	
	[redacted]	== Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri	23.11.2016	==	
21.112016	[redacted]	2500 Fakulteti Shk. Edukimit	23.11.2016	**2300**	
	permbledhje				

Dhjetor 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
===	[redacted]	=== Fakulteti Shk. Humane	14.12.2016	**1000**	
12.12.2016	[redacted]	3100 Fakulteti Ekonomik	14.12.2016	**3050**	
12.12.2016	[redacted]	== Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri	14.12.2016	**970**	
12.12.2016	[redacted]	3500 Fakulteti Shk. Edukimit	14.12.2016	**3500**	
	permbledhje				

Dhjetor 2016

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
===	[redacted]	=== Fakulteti Shk. Humane	14.12.2016	**3500**	
12.12.2016	[redacted]	3100 Fakulteti Ekonomik	14.12.2016	**3050**	
12.12.2016	[redacted]	**== Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri**	**14.12.2016**	**970**	
16.12.2016	[redacted]	**== Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri**	**14.12.2016**	**3500**	
12.12.2016	[redacted]	3500 Fakulteti Shk. Edukimit	14.12.2016	**3500**	
	permbledhje				

Janar 2017

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
09.01.2017	[redacted]	**3000 Fakulteti Ekonomik**	**10.01.2017**	**2600**	
26.01.2017	[redacted]	**2500 Fakulteti Ekonomik**	**27.01.2017**	**2370**	
13.01.2017	[redacted]	2500	16.01.2017	**2120**	

		Fakulteti Shk. Natyres			
09.01.2017	[redacted]	**3500 Fakulteti Shk. Edukimit**	**14.01.2017**	**3000**	
27.01.2017	[redacted]	**2000 Fakulteti Shk. Edukimit**	**31.01.2017**	**1900**	
	permbledhje				

shkurt 2017

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
10.02.2017	[redacted]	3000 Fakulteti Ekonomik	13.02.2017	**1800**	
9.02.2017	[redacted]	2500 Fakulteti Shk. Natyres e humane	10.02.2017	**500**	
23.02.2017	[redacted]	2000 Fakulteti Shk. Edukimit	24.02..2017	**1400**	
	permbledhje				

Mars 2017

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
23.3.2017	[redacted]	500 Fakulteti Ekonomik	23.03.2017	**500**	
03.03.2017	[redacted]	1000 Fakulteti Shk. Natyres e humane	06.03.2017	**560**	
23.03.2017	[redacted]	250 Fakulteti Shk. Edukimit	23.3.2017	**250**	
	permbledhje				

Nëntor 2017

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
.2017	[redacted]	500 Fakulteti Ekonomik	.2017	**3000**	
.2017	[redacted]	1000 Fakulteti Shk.	.2017	**2800**	

		Natyres e humane			
.2017	[redacted]	250 Fakulteti Shk. Edukimit	2017	**3000**	
		Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri		**1200**	
	permbledhje				

Dhjetor 2017

Kerkesa nr date	Hartuar nga	Sasia e naftes se kerkuar per ngrohje (litra)	Pv marrje ne dorezim	sasia naftes se marre ne dorezim (litra)	Dokumentimi I shpenzimit te lendes djegese (libri I kaldajave)
	[redacted]	500 Fakulteti Ekonomik	2017	**500+3000**	
	[redacted]	1000 Fakulteti Shk. humane	2017	**2000**	
	[redacted]	250 Fakulteti Shk. Edukimit	2017	**3000**	
		Fakulteti Shk. Natyres/Infermieri		**2000**	
	permbledhje				

ANEKSI IV

NË LIDHJE ME ÇËSHTJET GJYQËSORE PËR VITET 2016 DHE 2017

Padia	**Objekti**	**Paditësi/t**	**I/Të padituri/t / Personi/a i/të tretë**	**Statusi i Gjykimit dhe Të Dhëna të Tjera**
1. Civile (Kërkesë padia datë 27.1.2016)	Detyrimi i palës së paditur për përmbushjen e detyrimit…	Shoqëria tregtare "[redacted]" shpk	Universiteti "Fan S. Noli", Shoqëria tregtare "[redacted]" shpk	Përfunduar në Gjykatën e Apelit Korçë (paditësi hoqi dorë nga e drejta e padisë). Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë rrëzoi pretendimet e paditësit kundrejt të padituritit "Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.
2. Civile (Kërkesë padia datë 5.7.2016)	Ndryshimi i Vendimit nr.310, datë 30.6.2000, pika 1/a, i KKKP Korçë…	[redacted]	[redacted] Tiranë, Bashkia Korçë dhe Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	I papërfunduar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë shpalli me vendimin nr.421, datë 6.4.2017 moskompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes dhe ia dërgoi aktet për kompetencë Gjykatës së Apelit Korçë, e cila iu drejtua Gjykatës së Lartë për rregullimin e kompetencës. Me vendimin nr.00-2018-128, datë 10.1.2018, Gjykata e Lartë vendosi kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
3. Civile	Ndryshimi i Vendimit nr.224, datë 15.9.1999, pika a, Vendimit nr.309, datë 30.6.2000, pika 1/b, të KKKP Korçë…	[redacted]	AKKP Tiranë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë etj.	I papërfunduar. Me vendimin nr.1027, datë 31.5.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi pranimin e kërkesë padisë. Universiteti "Fan S.

				Noli", Korçë, Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Korçë etj. ankimuan vendimin në Gjykatën e Apelit Korçë. Çështja është duke u gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë.
4. Civile (Kërkesë padia datë 25.7.2013)	Anulimi i Vendimit nr.931, datë 20.6.2013, të AKKP-së Tiranë	[redacted]	AKKP Tiranë, i paditur dhe Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Bashkia Korçë dhe Shkolla e Mesme "Demir Progri" Korçë, persona të tretë	I papërfunduar. Me vendimin nr.41-2016-2543 (1222), datë 1.7.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi pranimin e kërkesë padisë. Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Korçë etj. ankimuan vendimin në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila vendosi për lënien në fuqi të tij. Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Korçë etj. kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.
5.Administrative (Kërkesë padia datë __/__2015)	Detyrimi i palës së paditur për të shpërblyer dëmin e shkaktuar ndaj paditësit [redacted] në vlerën **14.000.000 lekë**	[redacted]	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë,	I papërfunduar.Çështja i ka kaluar për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Me vendimin nr.873 (345), datë 13.7.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë vendosi mospranimin e kërkesë padisë. Paditësi ankimoi vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
6. Civile (Kërkesë padia datë 6.9.2016)	Deklarim pavërtetësi shënimesh në regjistrin e programit studimor	[redacted]	Universiteti "Fan S. Noli" (Fakulteti i Ekonomisë), Korçë	I përfunduar. Me vendimin nr.1889, datë 11.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi për pranimin e kërkesë padisë dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore paditëses.
7. Civile	Njohja e pavërtetësisë së shënimeve të bëra në regjistrin e veçantë nr.2179, me numër amze të gjimnazit "Muharrem Çollaku" Pogradec dhe regjistrit nr. 28, nr.1014 të kursit dyvjeçar mjekësor, që ndodhet pranë Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, përsa i përket datëlindjes 9.8.1974 dhe saktësimin sipas akteve të gjendjes civile 15.9.1974	[redacted]	Shkolla e Mesme "Muharrem Çollaku", Pogradec dhe Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	I përfunduar. Me vendimin nr. (78)-27, datë 24.1.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec vendosi për pranimin e kërkesë padisë dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore të paditurit në masën 3070 lekë.

ANEKSI V

VENDIME TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT, VITI 2016

Vendim nr.1 datë	Vendim për miratimin e raportit vjetor financiar të Universitetit "Fan S.

04.02.2016	Noli"
Vendim nr.2 datë 19.02.2016	Vendim për miratimin e fondit prej 89.000 lek për pagesën e Yllson Manokut i cili ka dalë në pension pleqërie
Vendim nr.3 datë 29.03.2016	Vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit nga komisioni
Vendim nr.4 datë 07.06.2016	Vendim për kryerjen e pagesës për shpërblimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore
Vendim nr.5 datë 20.07.2016	Vendim për emërimin e znj. [redacted] në pozicionin e Kancelarit deri në zgjedhjen e Administratorit
Vendim nr.6 datë 12.08.2016	Vendim për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019
Vendim nr.7 datë 09.09.2016	Vendim për miratimin e ndryshimeve në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve publike,në strukturën e përgjithshme të punonjësve ,të dhënies me qira të dy ambjenteve ,të tarifës së regjistrimit,të riorganizimit të grupit mësimor biologji-kimi
Vendim nr.8 datë 20.10.2016	Vendim për miratimin e tarifave vjetore për çdo program studimi, të njëjta me ato të vitit 2016-2016
Vendim nr.9 datë 20.10.2016	Vendim për miratimin e ngarkesës së pagueshnme mbi normën vjetore deri 200 orë për pedagogët efektivë
Vendim nr.10 datë 07.12.2016	Vendim për miratimin e shpërblimit për festat e fundvitit nga të ardhurat e UK në masën 10.000 lek
Vendim nr.11 datë 19.12.2016	Vendim për miratimin e nr. të punonjësve në të gjitha nivelet në Universitet sipas propozimit ë Senatit

ANEKSI VI
VENDIME TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, VITI 2017

Vendim nr.1 datë 04.01.2017	Vendim për miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, përdorimin e të ardhurave, Regjistrit të Prokurimeve Publike, detajimit të investimeve
Vendim nr.2 datë 10.02.2017	Vendim për miratimin e propozimit të Rektoratit për ndryshime në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike
Vendim nr.3 datë 10.02.2017	Vendim për përcaktimeve e kritereve për Administrator të Universitetit "Fan S. Noli"
Vendim nr.4 datë 10.02.2017	Vendim për miratimin e propozimit të Rektoratit "Për shpërblimin e personelit akademik që ngarkohet të kryejë funksione drejtuese"
Vendim nr.5 datë 10.02.2017	Vendim për miratimin Rregullores së Bordit të Administrimit të Universitetit "Fan S. Noli"
Vendim nr.6 datë 10.02.2017	Vendim për miratimin e kërkesës së Rektoratit "Për miratimin e çmimeve të analizave që ofron Laboratori i "Agroushqimit"
Vendim nr.7 datë 03.04.2017	Vendim për miratimin paraprak të projektstatutit të UK dhe t'ja përcjellë për miratim Senatit Akademik
Vendim nr.8 datë 03.04.2017	Vendim për miratimin e Planit Strategjik të zhvillimit të institucionit , propozuar nga Senati
Vendim nr.9 datë 03.04.2017	Vendim për përzgjedhjen si kandidaturë fituese për Administrator znj. [redacted]
Vendim nr.10 datë 03.04.2017	Vendim për emërimin e znj. znj. [redacted] Administrator të Universiteti "Fan S. Noli"
Vendim nr.11 datë 07.04.2017	Vendim për ankimin e z[redacted] dhe pretendimet e ankimuesit si kandidat për Administrator
Vendim nr.12 datë 28.04.2017	Vendim për miratimin e përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve sipas listave
Vendim nr.13 datë 26.05.2017	Vendim për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së administratorëve të njësive

Vendim nr.14 datë 26.05.2017	Vendimi për shfuqëzimin e vendimit nr.4 të Bordit të Administrimit datë 10.02.2017 për miratim e shpërblimit të personelit akademik që ngarkohet të kryejë fuksione
Vendim nr.15 datë 27.07.2017	Vendim për anulimin e konkursit të shpallur për vendin e punës "Administrator të njësisë kryesore"
Vendim nr.16 datë 27.07.2017	Vendim për përcaktimin e shpërblimeve të anëtarëve të Bordit të Administrimit
Vendim nr.17 datë 11.08.2017	Vendim për miratimin e programit Buxhetor Vjetor dhe Afatmesëm 2018-2020
Vendim nr.18 datë 11.08.2017	Vendim për miratimin e tarifave vjetore për çdo program studimi për 2017-2018
Vendim nr.18/1 datë 15.09.2017	Vendim për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik "Specialist" në Degën e Burimeve Njerëzore
Vendim nr.19 datë 29.09.2017	Vendim për miratimin e dhënies së ambienteve me qira: Librari Universitare dhe Bar-Kafe
Vendim nr.20 datë 12.10.2017	Vendim për miratimin e ngarkesës së pagueshme mbi normën vjetore për pedagogët efektivë, deri në 200 orë
Vendim nr.21 datë 13.10.2017	Vendim për miratimin e kërkesës për zhvillimin e aktivitetit promocional nga Telekom dhe tarifa përkatëse
Vendim nr.22 datë 26.10.2017	Vendim për miratimin e ndarjes së grantit buxhetor 2017, dhe ndryshimit të Regjistrit të Prokurimeve Publike
Vendim nr.23 datë 08.11.2017	Vendim për miratimin e aktiviteteve shkencore
Vendim nr.24 datë 02.12.2017	Vendim për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik "Specialist" në Degën e Financës
Vendim nr.25 datë 07.12.2017	Vendim për shpërblimin e fundvitit për personelin efektiv: akdemik, ndihmësakademik, administrativ dhe punonjës shërbimi
Vendim nr.25/1 datë 12.12.2017	Vendim për pezullimin e vendimit nr.16, 27.07.2017 në lidhje me pagesën e anëtarve të Bordit
Vendim nr.26 datë 14.12.2017	Vendim për ndryshimin e përdorimit të të ardhurave për vitin 2017
Vendim nr.26/1 datë 14.12.2017	Vendim për shpërblimin nga të ardhurat e veta për të gjithë personelin efektiv me rastin e festave
Vendim nr.27 datë 22.12.2017	Vendim për disa ndryshime në vendimin nr.16, 27.07.2017 për shpërblimin mujor të anëtarve të Bordit të Administrimit
Vendim nr.28 datë 22.12.2017	Vendim për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, 2017-2018 të studentëve të vitit I dhe II, Bachelor
Vendim nr.29 datë 22.12.2017	Vendim për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, 2017-2018 të disa studentëve të vitit I dhe II, Bachelor
Vendim nr.30 datë 22.12.2017	Vendim për miratimin e bursave për vitin 2017-2018 të studentëve të shkelqyer dhe atyre të shtresave në nevojë viti II, III, Bachelor
Vendim nr.31 datë 29.12.2017	Vendim për shtesë në listën e studentëve që përjashtohen nga tarifa vjetore me Vendim 28, 22.12.2017 të Bordit
Vendim nr.32 datë 29.12.2017	Vendim për shtesë në listën e studentëve që përjashtohen nga tarifa vjetore me Vendim 28, 22.12.2017 të Bordit

ANEKSI VII.
Buxheti 2016 dhe 2017

Realizimi i shpenzimeve sipas planit dhe faktit sipas nënzërave përkatës për vitin 2016.

Tabela nr. 6 *Në lekë*

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Plani 2016	Realizimi 2016	Realizimi ne %
1	6020100	Kancelari + Leter	3,600,000	2,708,696	75%
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	960,000	929,452	97%
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	880,000	317,280	36%
4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	800,000	252,000	32%
5	6020500	Blerje dokumentacioni	120,000	119,400	100%
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjith.	960,000	925,953	96%
7	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	100,000	-	0%
8	6021002	Plehera kimike, farera, fidane, etj	960,000	286,292	30%
9	6021003	Ilace, materiale mjekesore per laboratoret	960,000	769,230	80%
10	6021007	Libra dhe publikime profesionale	960,000	33,360	3%
11	6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes dhe bimeve	450,000	419,066	93%
12	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	800,000	-	0%
13	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	960,000	246,000	26%
15	6021099	Te tjera materiale dhe shërbime speciale	960,000	906,200	94%
16	6022001	Energji elektrike	5,260,000	5,221,589	99%
17	6022002	Ujë	950,000	940,995	99%
18	6022003	Shërbime telefonike (interneti)	1,400,000	1,398,546	100%
19	6022004	Sherbime postare	98,000	92,964	95%
20	6022005	Sherbim per ngrohje	225,000	-	0%
21	6022007	Sherbime bankare	5,000		0%
22	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	14,849,600	14,849,600	100%
23	6022009	Sherbime pastrimi e gjelberimi	480,000	115,200	24%
24	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	960,000	918,466	96%
25	6022011	Kosto trajnimi e seminare	880,000	19,020	2%
26	6022099	Sherbime te tjera	960,000	876,866	91%
27	6023100	Lende djegese, Karburant dhe vaj	8,200,000	8,200,000	100%
28	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	750,000	295,733	39%
29	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	250,000	248,600	99%
30	6023900	Shpezime te tjera transporti	800,000	538,240	67%
31	6024100	Udhetim brenda vendit	1,260,000	1,264,700	100%
32	6024200	Udhetim jashte vendit	235,000	231,000	98%
33	6025100	Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore	110,000	102,000	93%
34	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	960,000	360,960	38%
35	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	960,000	329,120	34%
36	6025400	Sh. mirmbajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	960,000	884,757	92%
37	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	880,000	540,900	61%
38	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	610,000	83,930	14%

39	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	850,000	199,000	23%
40	6029001	Sh. per pritje percjellje	780,000	375,468	48%
41	6029002	Sh. per aktivitete sociale per personelin	150,000	88,400	59%
42	6029003	Sh. gjyqesore	27,180	-	0%
43	6029004	Sh. sigurim ndertese	960,000	795,000	83%
44	6029005	Sh. per honorare	4,350,000	4,346,866	100%
45	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	960,000	248,205	26%
46	6029008	Sh. tatim dhe taksa	106,000	105,768	100%
48	6029099	Sh. te tjera materiale dhe sherbime operative	960,000	540,500	56%
Shuma			**64,655,780**	**52,125,322**	**81%**
Detyrime					
Shuma totale					

Tabela nr.7

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2016 dhe krahasimi me vitin 2015 , të detajuara sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.7

Tabela nr.7 *Në lekë*

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Fakti 2015	Fakti 2016	Realizimi ne %
1	6020100	Kancelari + Leter	1,401,362	2,708,696	193%
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	9,882,806	929,452	9%
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	2,678,361	317,280	12%
4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	-	252,000	
5	6020500	Blerje dokumentacioni	89,700	119,400	133%
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjith.	69,780	925,953	1327%
7	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	-	-	
8	6021002	Plehera kimike, farera, fidane, etj	798,733	286,292	36%
9	6021003	Ilace, materiale mjekesore per laboratoret	-	769,230	
10	6021007	Libra dhe publikime profesionale	88,360	33,360	38%
11	6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes dhe bimeve	64,400	419,066	651%
12	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	-	-	
13	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	187,200	246,000	131%
15	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	181,900	906,200	498%
16	6022001	Energji elektrike	3,743,736	5,221,589	139%
17	6022002	Uje	1,056,075	940,995	89%
18	6022003	Sherbime telefonike (interneti)	1,885,160	1,398,546	74%
19	6022004	Sherbime postare	68,856	92,964	135%
20	6022005	Sherbim per ngrohje		-	
21	6022007	Sherbime bankare			

22	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	12,159,510	14,849,600	122%
23	6022009	Sherbime pastrimi e gjelberimi	28,000	115,200	411%
24	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	342,720	918,466	268%
25	6022011	Kosto trajnimi e seminare	100,560	19,020	19%
26	6022099	Sherbime te tjera	967,426	876,866	91%
27	6023100	Lende djegese, Karburant dhe vaj	819,760	8,200,000	1000%
28	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	361,700	295,733	82%
29	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	107,400	248,600	231%
30	6023900	Shpezime te tjera transporti	5,680	538,240	9476%
31	6024100	Udhetim brenda vendit	1,678,365	1,264,700	75%
32	6024200	Udhetim jashte vendit	1,459,480	231,000	16%
33	6025100	Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore		102,000	
34	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	22,800	360,960	1583%
35	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	82,800	329,120	397%
36	6025400	Sh. mirmbajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	314,988	884,757	281%
37	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	-	540,900	
38	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	35,980	83,930	233%
39	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	86,800	199,000	229%
40	6027400	shp gjyqesore largim nga puna	86,920		
41	6029001	Sh. per pritje percjellje	99,600	375,468	377%
42	6029002	Sh. per aktivitete sociale per personelin	62,040	88,400	142%
43	6029003	Sh. gjyqesore	-	-	
44	6029004	Sh. sigurim ndertese	785,000	795,000	101%
45	6029005	Sh. per honorare	4,037,600	4,346,866	108%
46	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	408,800	248,205	61%
47	6029008	Sh. tatim dhe taksa	171,013	105,768	62%
48	6029099	Sh. te tjera materiale dhe sherbime operative	1,102,167	540,500	49%
Shuma			**47,523,538**	**52,125,322**	**110%**
Detyrime					
Shuma totale					

Realizimi i shpenzimeve sipas planit dhe faktit sipas të nënzërave përkatës për vitin 2017, paraqitet në tabelën nr.15, në anekset e raportit.

Tabela nr.15 *Në lekë*

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Plani Viti 2017	Realizimi Viti 2017	Realizimi ne %
1	6020100	Kancelari + Leter	3,000,000	2,789,012	93%
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	960,000	960,000	100%
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	600,000		0%

4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	500,000		0%
5	6020500	Blerje dokumentacioni	800,000	389,400	49%
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjith.	960,000	42,280	4%
7	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	120,000	99,000	83%
8	6021002	Plehera kimike, farera, fidane, etj	800,000	361,433	45%
9	6021003	Ilace, materiale mjekesore per laboratoret	600,000	78,000	13%
10	6021007	Libra dhe publikime profesionale	960,000	243,480	25%
11	6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes dhe bimeve	600,000	136,200	23%
12	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	300,000	180,180	60%
13	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	960,000	100,800	11%
15	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	960,000	438,200	46%
16	6022001	Energji elektrike	4,900,000	4,365,244	89%
17	6022002	Uje	784,000	760,063	97%
18	6022003	Sherbime telefonike (interneti)	880,000	773,294	88%
19	6022004	Sherbime postare	61,000	60,124	99%
20	6022005	Sherbim per ngrohje	120,000		0%
21	6022007	Sherbime bankare	5,000		0%
22	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	14,785,687	14,619,486	99%
23	6022009	Sherbime pastrimi e gjelberimi	120,000	118,260	99%
24	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	960,000	217,760	23%
25	6022011	Kosto trajnimi e seminare	200,000	173,520	87%
26	6022099	Sherbime te tjera	2,600,000	2,568,445	99%
27	6023100	Lende djegese, Karburant dhe vaj	8,200,000	8,184,018	100%
28	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	500,000	206,400	41%
29	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	300,000	255,600	85%
30	6023900	Shpezime te tjera transporti	900,000	715,680	80%
31	6024100	Udhetim brenda vendit	1,490,000	1,348,320	90%
32	6024200	Udhetim jashte vendit	985,000	929,187	94%
33	6025100	Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore	200,000		0%
34	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	960,000		0%
35	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	960,000	237,552	25%
36	6025400	Sh. mirmbajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	960,000	28,800	3%
37	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	880,000	102,000	12%
38	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	450,000	199,978	44%
39	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	600,000	116,409	19%
40	6029001	Sh. per pritje percjellje	800,000	358,680	45%
41	6029002	Sh. per aktivitete sociale per personelin	400,000	70,000	18%
42	6029003	Sh. gjyqesore	194,313	7,200	4%
43	6029004	Sh. sigurim ndertese	960,000	795,000	83%

44	6029005	Sh. per honorare	7,700,000	6,071,853	79%
45	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	945,000	859,342	91%
46	6029008	Sh. tatim dhe taksa	120,000	111,747	93%
48	6029099	Sh. te tjera materiale dhe sherbime operative	960,000	725,308	76%
Shuma			**67,000,000**	**50,797,255**	**76%**
Detyrime				**428,760**	
Shuma totale				**50,368,495**	

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2017 dhe krahasimi me vitin 2016 , të detajuara sipas natyrës dhe llojit të shpenzimeve paraqiten në tabelën nr.16

Tabela 16 *Në lekë*

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Fakt Viti 2016	Fakt Viti 2017	Realizimi ne %
1	6020100	Kancelari + Leter	2,708,696	2,789,012	102 %
2	6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	929,452	960,000	103 %
3	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	317,280		-
4	6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	252,000		-
5	6020500	Blerje dokumentacioni	119,400	389,400	326 %
6	6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjith.	925,953	42,280	4.5 %
7	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	-	99,000	-
8	6021002	Plehera kimike, farera, fidane, etj	286,292	361,433	126 %
9	6021003	Ilace, materiale mjekesore per laboratoret	769,230	78,000	10 %
10	6021007	Libra dhe publikime profesionale	33,360	243,480	729 %
11	6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes dhe bimeve	419,066	136,200	32 %
12	6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike	-	180,180	-
13	6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	246,000	100,800	40 %
15	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	906,200	438,200	48 %
16	6022001	Energji elektrike	5,221,589	4,365,244	83 %
17	6022002	Uje	940,995	760,063	80 %
18	6022003	Sherbime telefonike (interneti)	1,398,546	773,294	55 %
19	6022004	Sherbime postare	92,964	60,124	64 %
20	6022005	Sherbim per ngrohje			-
21	6022007	Sherbime bankare			-
22	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	14,849,600	14,619,486	98 %
23	6022009	Sherbime pastrimi e gjelberimi	115,200	118,260	102 %
24	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	918,466	217,760	23 %
25	6022011	Kosto trajnimi e seminare	19,020	173,520	912 %
26	6022099	Sherbime te tjera	876,866	2,568,445	292 %
27	6023100	Lende djegese, Karburant dhe vaj	8,200,000	8,184,018	99 %

28	6023200	Pjese kembimi automjete, goma bateri	295,733	206,400	69 %
29	6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	248,600	255,600	102 %
30	6023900	Shpezime te tjera transporti	538,240	715,680	133 %
31	6024100	Udhetim brenda vendit	1,264,700	1,348,320	106 %
32	6024200	Udhetim jashte vendit	231,000	929,187	402 %
33	6025100	Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore	102,000		-
34	6025200	Shpenzime per mirembajtje objekteve specifike	360,960		-
35	6025300	Sh. per mirembajtje objekteve ndertimore	329,120	237,552	72 %
36	6025400	Sh. mirmbajte rrjeteve hidraulike,elektrike,telefon, etj	884,757	28,800	3.2 %
37	6025500	Sh. mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	540,900	102,000	18.5 %
38	6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	83,930	199,978	238 %
39	6025800	Sh. per mirembajte Pajisje zyre	199,000	116,409	58 %
40	6029001	Sh. per pritje percjellje	375,468	358,680	95 %
41	6029002	Sh. per aktivitete sociale per personelin	88,400	70,000	79 %
42	6029003	Sh. gjyqesore	-	7,200	-
43	6029004	Sh. sigurim ndertese	795,000	795,000	100 %
44	6029005	Sh. per honorare	4,346,866	6,071,853	139 %
45	6029007	Sh. Pjesmarrje ne konferenca	248,205	859,342	346 %
46	6029008	Sh. tatim dhe taksa	105,768	111,747	105 %
48	6029099	Sh. te tjera materiale dhe sherbime operative	540,500	725,308	134 %
Shuma			**52,125,322**	**50,797,255**	**97.4** %
Detyrime				**428,760**	
Shuma totale				**50,368,495**	

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike